



# *COMARC/B* *Formati* *për të dhënat* *bibliografike*

*Manual për përdoruesit*



United Nations  
Educational, Scientific and  
Cultural Organization

Regional Centre for  
Library Information Systems and  
Current Research Information Systems  
Regionalni center za knjižnične  
informacijske sisteme in informacijske  
sisteme o raziskovalni dejavnosti



© IZUM, 2024

Titulli origjinal: COMARC/B Format : za bibliografske podatke; janar 2024

COBISS, COMARC, COBIB, COLIB, IZUM janë marka të regjistruara në pronësi të institucionit publik IZUM.

Marka të tjera të përdorura janë me pronësi tjetër.

Manuali përmban të gjitha përditësimet nga botimi i versionit të parë në vitin 1991 deri sot. Përmbajtja është në përputhje me programin COBISS3, V14.0 dhe COBISS Cat, V1.4, ndërsa vlenë për të gjitha versionet në vazhdim të programit, deri në anulimin ose botimin e versionit të ri të manualit në formë elektronike.

© IZUM, ndryshimet e fundit të përmbajtjes: janar 2024, përkthyer në gjuhën shqipe: janar 2024

ISSN 2463-9699

---

# PËRMBAJTJA

**HYRJE** ..... **HYRJE - 1**

**0XX BLOKU I IDENTIFIKIMIT** ..... **0XX - 1**

001	Etiketa e regjistrimit	001 - 1
010	Numri Standard Ndërkombëtar i Librit (ISBN)	010 - 1
011	ISSN	011 - 1
012	Identifikuesi Fingerprint	012 - 1
013	Numri Standard Ndërkombëtar i Botimeve Muzikore (ISMN)	013 - 1
016	Kodi Standard Ndërkombëtar i Regjistrimit (ISRC)	016 - 1
017	Identifikues të tjerë	017 - 1
020	Numri i bibliografisë kombëtare	020 - 1
021	Numri i kopjes së detyruar	021 - 1
022	Numri i botimit zyrtar	022 - 1
040	CODEN	040 - 1
041	Kode të tjera*	041 - 1
071	Numri i botuesit	071 - 1

**1XX BLOKU I TË DHËNAVE TË KODUARA** ..... **1XX - 1**

100	Të dhënat e përgjithshme për përpunimin	100 - 1
101	Gjuha e njësisë	101 - 1
102	Shteti i botimit ose i prodhimit	102 - 1
105	Materiali tekst monografik	105 - 1
106	Materiali tekst - përshkrimi fizik	106 - 1
110	Burimet në vazhdim	110 - 1
115	Projeksionet pamore, videoregjistrimet dhe filmat	115 - 1
116	Materialet grafike	116 - 1
117	Objektet tridimensionale dhe reale	117 - 1
120	Materialet hartografike - të dhëna të përgjithshme	120 - 1
121	Materialet hartografike – përshkrimi fizik	121 - 1
122	Periudha kohore e përmbajtjes së njësisë	122 - 1
123	Materialet hartografike – shkalla dhe koordinatat	123 - 1
124	Materialet hartografike - përcaktimi specifik i materialit	124 - 1
125	Regjistrimet zanore dhe materialet muzikore të shtypura	125 - 1
126	Regjistrimet zanore - përshkrimi fizik	126 - 1
127	Kohëzgjatja e regjistrimeve zanore dhe e kompozimit në muzikë	127 - 1
128	Ekzekutimet muzikore dhe partiturat	128 - 1
130	Mikroformat - përshkrimi fizik	130 - 1

135	Burimet elektronike .....	135 - 1
140	Antikuarët – të përgjithshme .....	140 - 1
141	Antikuarët – karakteristikat e kopjes .....	141 - 1
<b>2XX</b>	<b>BLLOKU I PËRSHKRIMIT KRYESOR .....</b>	<b>2XX - 1</b>
200	Titulli dhe të dhënat për përgjegjësinë .....	200 - 1
205	Të dhënat për botimin .....	205 - 1
206	Materialet hartografike – të dhëna matematikore .....	206 - 1
207	Burimet në vazhdim – numërtimi .....	207 - 1
208	Materialet muzikore të shtypura .....	208 - 1
210	Botimi, shpërndarja etj. ....	210 - 1
211	Data e parashikuar e botimit .....	211 - 1
215	Përshkrimi fizik .....	215 - 1
225	Seria .....	225 - 1
230	Burimet elektronike - karakteristikat .....	230 - 1
251	Organizimi dhe klasifikimi i materialeve .....	251 - 1
<b>3XX</b>	<b>BLLOKU I SHËNIMEVE .....</b>	<b>3XX - 1</b>
300	Shënimi i përgjithshëm .....	300 - 1
301	Shënimi për numrin e identifikimit .....	301 - 1
304	Shënimi për titullin dhe përgjegjësinë** .....	304 - 1
305	Shënimi për botimin dhe historinë bibliografike** .....	305 - 1
306	Shënimi për botimin, shpërndarjen etj.** .....	306 - 1
311	Shënimi për fushën në lidhshmëri .....	311 - 1
314	Shënimi për përgjegjësinë intelektuale .....	314 - 1
316	Shënimi për kopjen që katalogohet .....	316 - 1
317	Shënimi për prejardhjen .....	317 - 1
318	Shënimi për procedurën .....	318 - 1
320	Shënimi për bibliografitë/indekset/përmbledhjet brenda burimit .....	320 - 1
321	Shënimi për indekset/abstraktet/referimet jashtë burimit .....	321 - 1
322	Shënimi për bashkëpunëtorët (materiale projektimi, video dhe regjistrime zanore) .....	322 - 1
323	Shënimi për interpretuesit (materiale projektimi, video dhe regjistrime zanore) .....	323 - 1
324	Shënimi për origjinalin .....	324 - 1
325	Shënimi për riprodhimin .....	325 - 1
326	Shënimi për periodicitetin .....	326 - 1
327	Shënimi për përmbajtjen .....	327 - 1
328	Shënimi për disertacionin (tezën) .....	328 - 1
330	Përmbledhja ose abstrakti .....	330 - 1
333	Shënimi për përdoruesit .....	333 - 1
334	Shënimi për çmimin .....	334 - 1
336	Shënimi për llojin e burimit elektronik .....	336 - 1
337	Shënimi për kërkesat e sistemit .....	337 - 1
338	Shënimi për financimin .....	338 - 1
<b>4XX</b>	<b>BLLOKU PËR LIDHJE .....</b>	<b>4XX - 1</b>
410	Seria .....	410 - 1
411	Nënseria .....	411 - 1
421	Shtojca .....	421 - 1
422	Burimi i shtojcës .....	422 - 1
423	Vepra e shtuar, e fshehur dhe e përfshirë .....	423 - 1
430	Është vazhdim i .....	430 - 1
431	Pjesërisht është vazhdim i .....	431 - 1

434	Përvetëson .....	434 - 1
435	Pjesërisht përvetëson .....	435 - 1
436	Formuar nga bashkimi i _ , _ dhe _ .....	436 - 1
440	Vazhdon si .....	440 - 1
441	Pjesërisht vazhdon si .....	441 - 1
444	Përvetësuar nga .....	444 - 1
445	Pjesërisht përvetësuar nga .....	445 - 1
446	Ndarë në _ , _ dhe _ .....	446 - 1
447	Bashkuar me _ , _ për të formuar _ .....	447 - 1
452	Botim tjetër në mjedis tjetër .....	452 - 1
453	Përkthim ose botim në gjuhë tjetër .....	453 - 1
454	Përkthim i .....	454 - 1
461	Grupi .....	461 - 1
462	Nëngrupi .....	462 - 1
464	Njësia kryesore (monografi) .....	464 - 1
481	Lidhur në këtë vëllim edhe .....	481 - 1
482	Lidhur me .....	482 - 1
488	Vepër tjetër në lidhshmëri .....	488 - 1
<b>5XX</b>	<b>BLLOKU I TITUJVE NË LIDHSHMËRI .....</b>	<b>5XX - 1</b>
500	Titulli uniform .....	500 - 1
503	Nënemërtimi formal* .....	503 - 1
510	Titulli i saktë paralel .....	510 - 1
512	Titulli i kapakut .....	512 - 1
513	Titulli në faqen paralele të titullit .....	513 - 1
514	Titulli i kreut .....	514 - 1
515	Titulli në çdo faqe .....	515 - 1
516	Titulli në shpinë .....	516 - 1
517	Variante të tjera të titullit .....	517 - 1
518	Titulli në drejtshkrimin bashkëkohor standard .....	518 - 1
520	Titulli i mëparshëm .....	520 - 1
530	Titulli kyç .....	530 - 1
531	Titulli kyç i shkurtuar .....	531 - 1
532	Titulli i zgjeruar .....	532 - 1
539	Titulli i saktë me komandat LaTeX* .....	539 - 1
540	Titulli shtesë i vënë nga kataloguesi .....	540 - 1
541	Titulli i përkthyer i vënë nga kataloguesi .....	541 - 1
<b>6XX</b>	<b>BLLOKU I ANALIZËS SË PËRMBAJTJES .....</b>	<b>6XX - 1</b>
600	Emër vetjak si emërtim lëndor .....	600 - 1
601	Emër organizate si emërtim lëndor .....	601 - 1
602	Emër familje si emërtim lëndor .....	602 - 1
604	Emër dhe titull si emërtim lëndor .....	604 - 1
605	Titull si emërtim lëndor .....	605 - 1
606	Emër lënde si emërtim lëndor .....	606 - 1
607	Emër gjeografik si emërtim lëndor .....	607 - 1
608	Emërtimi lëndor kronologjik* .....	608 - 1
609	Forma si emërtim lëndor* .....	609 - 1
610	Emërtime lëndore të pakontrolluara .....	610 - 1
620	Kërkimi me vend të botimit .....	620 - 1
675	Klasifikimi Dhjetor Universal (KDU) .....	675 - 1
676	Klasifikimi Dhjetor i Djujt .....	676 - 1

680	Klasifikimi i Bibliotekës së Kongresit .....	680 - 1
686	Klasifikime të tjera .....	686 - 1
<b>7XX</b>	<b>BLLOKU I TË DHËNAVE PËR PËRGJEGJËSINË .....</b>	<b>7XX - 1</b>
700	Emër vetjak – përgjegjësi parësore .....	700 - 1
701	Emër vetjak – përgjegjësi alternative .....	701 - 1
702	Emër vetjak – përgjegjësi dytësore .....	702 - 1
710	Emër organizate – përgjegjësi parësore .....	710 - 1
711	Emër organizate – përgjegjësi alternative .....	711 - 1
712	Emër organizate – përgjegjësi dytësore .....	712 - 1
<b>8XX</b>	<b>BLLOKU I PËRDORIMIT NDËRKOMBËTAR .....</b>	<b>8XX - 1</b>
802	Qendra Kombëtare e ISSN-së .....	802 - 1
830	Shënime të përgjithshme të kataloguesit .....	830 - 1
856	Vendndodhja elektronike dhe qasja .....	856 - 1
<b>9XX</b>	<b>BLLOKU I PËRDORIMIT KOMBËTAR .....</b>	<b>9XX - 1</b>
900	Emër vetjak – përgjegjësi parësore (varianti i emërimit)* .....	900 - 1
901	Emër vetjak – përgjegjësi alternative (varianti i emërimit)* .....	901 - 1
902	Emër vetjak – përgjegjësi dytësore (varianti i emërimit)* .....	902 - 1
903	Emër vetjak (emërtim në lidhshmëri)* .....	903 - 1
904	Emër vetjak (emërtim paralel)* .....	904 - 1
910	Emër organizate – përgjegjësi parësore (varianti i emërimit)* .....	910 - 1
911	Emër organizate – përgjegjësi alternative (varianti i emërimit)* .....	911 - 1
912	Emër organizate – përgjegjësi dytësore (varianti i emërimit)* .....	912 - 1
913	Emër organizate (emërtim në lidhshmëri)* .....	913 - 1
916	Emër organizate – formë e palidhur* .....	916 - 1
960	Emër vetjak si emërtim lëndor (varianti)* .....	960 - 1
961	Emër organizate si emërtim lëndor (varianti)* .....	961 - 1
962	Emër familje si emërtim lëndor (varianti)* .....	962 - 1
964	Emër dhe titull si emërtim lëndor (varianti)* .....	964 - 1
965	Titull si emërtim lëndor (varianti)* .....	965 - 1
966	Emër lënde si emërtim lëndor (varianti)* .....	966 - 1
967	Emër gjeografik si emërtim lëndor (varianti)* .....	967 - 1
968	Emërtimi lëndor kronologjik (varianti)* .....	968 - 1
969	Forma si emërtim lëndor (varianti)* .....	969 - 1
970	Fusha për nevojat e bibliografisë* .....	970 - 1
992	Fusha për nevojat lokale* .....	992 - 1
993	Fusha me përmbajtje lokale të definuar* .....	993 - 1
<b>LITERATURA .....</b>	<b>LITERATURA - 1</b>	
<b>Shtojcat</b>		
<b>A</b>	<b>LISTA E FUSHAVE/NËNFUSHAVE .....</b>	<b>SHTOJCA A - 1</b>
<b>B</b>	<b>SHENJAT E PIKËSIMIT .....</b>	<b>SHTOJCA B - 1</b>
<b>C</b>	<b>INDEKSET E KËRKIMIT .....</b>	<b>SHTOJCA C - 1</b>
<b>D</b>	<b>MONOGRAFITË NË DISA VËLLIME .....</b>	<b>SHTOJCA D - 1</b>

<b>E</b>	<b>SIMBOLET MATEMATIKORE DHE SIMBOLET E TJERA TË VEÇANTA NË TITUJ</b> .....	<b>SHTOJCA E - 1</b>
<b>F</b>	<b>UDHËHEQJA E BIBLIOGRAFIVE NË SISTEMIN COBISS</b>	
	F.1 Të përgjithshme .....	Shtojca F.1 - 1
	F.2 Karakteristikat e shënimit të të dhënave në fushat/nënfushat e veçanta .....	Shtojca F.2 - 1
	F.3 Të dhëna retrospektive për serialet .....	Shtojca F.3 - 1
	F.4 Karakteristikat në përpunimin e disa llojeve të dokumenteve .....	Shtojca F.4 - 1
	F.5 Paraqitja e bibliografive në sistemin COBISS .....	Shtojca F.5 - 1
	F.6 Tipologjia e dokumenteve/veprave – përcaktimet dhe rekomandimet .....	Shtojca F.6 - 1
	F.7 Lista e kodeve të institucioneve /organizatave .....	Shtojca F.7 - 1
	F.8 Regjistrimi bibliografik për veprën e ekzekutuar (ngjarjen) .....	Shtojca F.8 - 1
<b>G</b>	<b>TABELA E KDU-SË (675C) .....</b>	<b>SHTOJCA G - 1</b>
<b>H</b>	<b>KODET PËR LLOJIN E AUTORËSISË (70X4, 71X4) .....</b>	<b>SHTOJCA H - 1</b>
<b>I</b>	<b>PËRPUNIMI PËRMBLEDHËS I MATERIALEVE BIBLIOTEKARE – REGJISTRIMET PËR KOLEKSIONET ARTIFICIALE .....</b>	<b>SHTOJCA I - 1</b>





---

# HYRJE

COMARC/B, formati i lexueshëm nga makina për përshkrimin dhe shkëmbimin e të dhënave bibliografike në sistemin COBISS, bazohet në formatin UNIMARC për të dhënat bibliografike, i cili është një standard ndërkombëtar dhe deri në mars të vitit 2003 e ka zhvilluar IFLA's Universal Bibliographic Control and International MARC Programme (UBCIM) me seli në Deutsche Bibliothek, Frankfurt am Main. Programi UBCIM u mbyll në mars të vitit 2003 dhe National Library of Portugal (NLP) mori përsipër zhvillimin e mëtejshëm të formatit UNIMARC.

Përveç fushave/nënfushave standarde të formatit UNIMARC, formati për të dhënat bibliografike COMARC/B përmban një numër karakteristikash specifike të strukturës së regjistrimeve bibliografike në sistemin COBISS.

Përveç formatit COMARC/B, në sistemin COBISS përdoren edhe dy formate të tjera: formati për koleksionet e bibliotekës COMARC/H dhe formati për të dhënat e njësuara COMARC/A, për të cilët ekzistojnë manuale të veçanta.

Gjatë zbatimit të formatit UNIMARC në sistemin COBISS, fillimisht është përdorur manuali *Priručnik za UNIMARC* (Përshtatja në gjuhën serbo-kroate e *Manualit UNIMARC*, 1987). Ky manual është përkthyer dhe përshtatur në vitin 1989 nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare në Zagreb dhe në të njëjtin vit ai u përkthye në sllovenisht (*Priručnik za UNIMARC*) nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare, Lubjanë.

Krahas zhvillimit të funksioneve të reja në sistemin COBISS, ishte e nevojshme që formati UNIMARC të plotësohej me fusha dhe nënfusha të reja, gjë e cila çoi në zhvillimin e formatit COMARC/B. Fillimisht u botuan udhëzimet për Serialet si pjesë përbërëse e bazës së të dhënave bibliografike (katalogut) të Jugosllavisë (projekt-dokument), në Maribor, më 18 dhjetor 1990.

Në vitin 1991 vazhdoi përgatitja e formatit COMARC/B për monografitë, disertacionet dhe serialet, ndërsa më vonë edhe me një numër përditësimesh të tjera.

Në vitin 1994 u mor vendimi për bashkimin e udhëzimeve për lloje të ndryshme të materialeve në një format të vetëm bibliografik – COMARC/B. Për përgatitjen e manualit për formatin COMARC/B u siguria leja nga Programi UBCIM i IFLA-s për të përdorur pjesë nga përkthimi i botimit të dytë të *UNIMARC Manual. Bibliographic Format* (UBCIM Publications – New Series, Vol. 14, 1994).

Përmirësimi i manualit *COMARC/B Formatit për të dhënat bibliografike*, i cili do të përfshijë të gjitha udhëzimet e nevojshme nga *UNIMARC Manual* dhe të gjitha karakteristikat e sistemit COBISS, është bërë hap pas hapi.

Fushat/nënfushat janë transferuar tërësisht nga moduli "Disertacionet" në strukturën e integruar të botimit *COMARC/B*, ndërsa moduli "Serialet" do të transferohet gradualisht. Karakteristikat e një niveli bibliografik dhe të një lloji të materialit janë shpjeguar në fushat/nënfushat e veçanta, si dhe janë të përfshira edhe udhëzimet e duhura nga *UNIMARC Manual*. Deri tani janë transferuar të gjitha fushat nga blloqet 0XX, 1XX, 2XX, 3XX dhe 4XX, ndërsa nga blloqet e tjera disa fusha të caktuara.

Në përditësimet në vazhdim, në manualin *COMARC/B* do të përfshihen vetëm fushat/nënfushat, të cilat përdoren në sistemet COBISS.

Fushat, nënfushat, kodet dhe treguesit, të cilët nuk ndodhen në UNIMARC, por ndodhen në COMARC janë identifikuar me një yllth "\*". Fushat, nënfushat, kodet dhe treguesit, të cilët janë hequr janë identifikuar me dy yllthe "\*\*".

Formati COMARC/B i është përshtatur sistemit të përbashkët të katalogimit COBISS, i cili përshkruhet në manualin *COBISS3/Katalogimi*.

Për shënimin e të dhënave në sistemin e përbashkët të katalogimit përdoren maskat për shënimin e të dhënave, të cilat përmbajnë fushat dhe nënfushat e përdorura më shpesh gjatë shënit të të dhënave në një nivel të caktuar bibliografik. Fushat e tjera përdoren vetëm nëse janë të parapara në modelin e direktorisë së maskës së caktuar.

Ekzistojnë këto maska për shënimin e të dhënave: M – monografi, K – burime në vazhdim, Z – koleksione, A – artikuj dhe pjesë të tjera përbërëse si dhe N – materiale jolibra.

Fushat përcaktohen me një varg prej tre numrash, ndërsa nënfushat me një shkronjë ose numër. Njësia më e vogël e informacionit, që njihet nga programi, është nënfusha (gjatë kërkimit, shfaqjes), apo elementi i nënfushës në formatin për të dhënat e koleksioneve të bibliotekës COMARC/H.

Disa fusha kanë vlera të përcaktuara të treguesve, që zakonisht përcaktojnë mënyrën e shfaqjes. Në disa raste fushat dhe nënfushat janë të përsëritshme.

Lista e të gjitha fushave dhe nënfushave, të cilat përdoren për momentin, ndodhet në *Shtojcën A*.

Shenjat e pikësimit midis fushave dhe nënfushave zakonisht nuk shënohen, sepse ato vendosen në mënyrë automatike. Një përshkrim i shenjave të pikësimit, të përcaktuara nga ISBD-ja, paraqitet në *Shtojcën B*.

Në *Shtojcën C* janë përshkruar indekset për kërkim, që përdoren në sistemin e përbashkët të katalogimit COBISS.

Monografitë në disa vëllime janë përshkruar në *Shtojcën D*.

Tabela e shenjave më të shpeshta matematikore dhe shenjave të tjera të veçanta, që shfaqen në tituj, shënimin dhe shpjegimi i tyre në fushën 200 dhe në fushat e tjera, është dhënë në *Shtojcën E*.

Të gjitha karakteristikat, që kanë të bëjnë me bibliografitë në sistemin COBISS nga marsi i vitit 1996, janë përshkruar në *Shtojcat F.1–F.8*.

*Shtojca G* përmban listën e kodeve të numrave të KDU-së të caktuara për kërkimin uniform në sistem (nënfusha 675c).

Kodet për llojin e autorësisë me përkufizimet e tyre paraqiten në *Shtojcën H*.

Në *Shtojcën I* janë paraqitur udhëzimet për katalogimin përmbledhës të materialeve. Është përshkruar mënyra e shënit të të dhënave në fusha të veçanta të regjistrimeve përmbledhëse. Gjithashtu, janë dhënë shembujt e fushave të veçanta dhe regjistrimeve të plota.

Në manual janë paraqitur dy lloj shembujsh në fushat e veçanta. Shembujt, që nuk janë identifikuar në mënyrë të veçantë, janë marrë nga *UNIMARC Manual. Bibliographic Format*. Ata janë përgatitur në gjuhë të ndryshme dhe sipas rregullave të ndryshme të katalogimit. Për këtë arsye jo gjithmonë përshtaten me praktikën tonë të katalogimit. Me një yllth "\*" janë identifikuar shembujt e shtuar sllovenë si dhe shembujt nga bibliotekat e tjera, të përfshira në rrjetin COBISS.Net. Këta të fundit përmbajnë edhe shenjen COBISS.net.

Në zhvillimin e formatit COMARC/B kanë marrë pjesë ekspertë nga institucione të ndryshme, të cilët ende kontribuojnë me sugjerimet e tyre dhe për këtë ne i falenderojmë në mënyrë të veçantë. Në këtë fazë të zhvillimit, nuk ka qenë e mundur të zbatohen të gjitha sugjerimet, për këtë arsye me to do të merremi në të ardhmen.

Lusim, të gjithë përdoruesit e këtij manuali, që me sugjerimet e tyre të ndihmojnë në përmirësimin e zgjidhjeve të realizuara deri tani.



---

# 0XX BLOKU I IDENTIFIKIMIT

## LISTA E FUSHAVE

- 001 Etiketa e regjistrimit
- 010 Numri Standard Ndërkombëtar i Librit (ISBN)
- 011 ISSN
- 012 Identifikuesi Fingerprint
- 013 Numri Standard Ndërkombëtar i Botimeve Muzikore (ISMN)
- 016 Kodi Standard Ndërkombëtar i Regjistrimit (ISRC)
- 017 Identifikues të tjerë
- 020 Numri i bibliografisë kombëtare
- 021 Numri i kopjes së detyruar
- 022 Numri i botimit zyrtar
- 040 CODEN
- 041 Kode të tjera\*
- 071 Numri i botuesit

Ky bllok përmban të dhënat, të cilat identifikojnë regjistrimin ose njësinë e regjistruar në të. Fusha 001 është e detyrueshme në çdo regjistrim.



## 001 ETIKETA E REGJISTRIMIT

Kjo fushë përmban të dhëna të përgjithshme, të nevojshme për përpunimin e regjistrimit. Etiketa e regjistrimit i është përshtatur kryesisht nevojave të katalogimit të përbashkët online. Për rrjedhojë, përdorimi i saj nuk është plotësisht në përputhje me ISO 2709, i cili është përcaktuar për shkëmbimin e të dhënave të lexueshme nga makina në shirita, disketa etj.

Numri identifikues i regjistrimit (sipas UNIMARC-ut në fushën 001) nuk shënohet në mënyrë manuale, sepse programi COBISS e përcakton atë në mënyrë automatike.

Te shkëmbimi ndërkombëtar i të dhënave, gjatë procesit të konvertimit të formatit COMARC në MARC, Etiketa e regjistrimit krijohet sipas ISO 2709.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
001	Etiketa e regjistrimit	nr
<b>a</b>	<i>Statusi i regjistrimit</i>	nr
<b>b</b>	<i>Lloji i regjistrimit</i>	nr
<b>c</b>	<i>Niveli bibliografik</i>	nr
<b>d</b>	<i>Niveli hierarkik</i>	nr
<b>e</b>	<i>Numri i vjetër i regjistrimit*</i>	nr
<b>g</b>	<i>Kodi i plotësisë së regjistrimit</i>	nr
<b>h</b>	<i>Forma e përshkrimit bibliografik</i>	nr
<b>t</b>	<i>Tipologjia e dokumenteve/veprave*</i>	nr
<b>x</b>	<i>Numri i regjistrimit zëvendësues*</i>	nr
<b>7</b>	<i>Shkrimi i katalogimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 001a Statusi i regjistrimit

Kodi, i përbërë nga një karakter, përcakton statusin e përpunimit të regjistrimit. Nënfusha është e detyrueshme.

<b>c</b>	<i>regjistrim i redaktuar</i> Kodi vendoset, kur regjistrimi është redaktuar përfundimisht (pa gabime gramatikore dhe pa gabime në përmbajtje).
<b>d</b>	<i>regjistrim i fshirë</i> Kodi vendoset, kur regjistrimin dëshironi ta fshini nga baza e përbashkët bibliografike e të dhënave, mirëpo këtë nuk mund ta bëni, sepse regjistrimin tashmë e ka shkarkuar së paku një

	<p>bibliotekë. Kodi përdoret për zgjidhjen e problemit me regjistrimet dublikatë dhe te monografitë me shumë vëllime, të kataloguara në mënyrë hierarkike (shih shembullin 1).</p> <p>Regjistrimin e fshini sipas kësaj procedure:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në nënfushën 001a shënoni kodin "d" – <i>regjistrim i fshirë</i>.</li> <li>2. Në nënfushën 001x shënoni numrin identifikues (ID) të regjistrimit, sipas rregullave të përshkruara në nënfushën 001x.</li> <li>3. Regjistrimin e ruani në bazën e përbashkët bibliografike të të dhënave.</li> <li>4. Regjistrimin në bazën lokale e fshini.</li> </ol> <p>Regjistrimi do të fshihet nga baza e përbashkët e të dhënave, kur edhe biblioteka e fundit ta fshij atë nga baza lokale.</p>
<b>i</b>	<p><i>përshkrimi i parë i regjistrimit*</i></p> <p>Kodi përdoret për krijimin e regjistrimeve, për të cilat nuk keni të gjitha të dhënat e nevojshme bibliografike (botimi është në procesin e pasurimit). Kjo ka të bëjë më shumë me botimet e huaja, ndërsa botimet vendase bëjnë përjashtim (kur nuk është regjistrimi CIP). Regjistrimi mund të ketë kodin "i" vetëm për një kohë të shkurtër dhe në rrethana të veçanta. Kodi nuk përdoret për artikujt dhe pjesët e tjera përbërëse.</p>
<b>n</b>	<p><i>regjistrim i ri</i></p> <p>Kodi përdoret në çdo regjistrim të ri, me përjashtim të regjistrimeve CIP-it dhe regjistrimeve për botimet, të cilat janë në procesin e pasurimit.</p>
<b>p</b>	<p><i>regjistrim paraprak i papërfunduar</i></p> <p>Kodi përdoret për regjistrimet CIP.</p>
<b>r</b>	<p><i>regjistrim i përkohshëm për librat e rrallë**</i></p> <p>Kodi u përdor deri në vitin 1991 në regjistrimet për librat e rrallë.</p>

## 001b Lloji i regjistrimit

Disa kode për llojin e regjistrimit, por jo të gjithë, janë të ngjashëm me përcaktimin e përgjithshëm të materialit. E dhëna për llojin e regjistrimit është shumë e rëndësishme, sepse përdoret si kriter bazë për të bërë dallimin midis llojeve të ndryshme të materialeve në kuadër të të gjitha moduleve të programit COBISS. Nënfusha është e detyrueshme.

<b>a</b>	<i>material tekst, i shtypur</i>
<b>b</b>	<i>material tekst, dorëshkrim</i>
<b>c</b>	<i>materiale muzikore të shtypura</i>
<b>d</b>	<i>materiale muzikore, dorëshkrim</i>
<b>e</b>	<i>material hartografik, i shtypur</i>
<b>f</b>	<i>material hartografik, dorëshkrim</i>
<b>g</b>	<i>material projektimi dhe video</i>
<b>i</b>	<i>regjistrime zanore, jo muzikore</i>
<b>j</b>	<i>regjistrime zanore, muzikore</i>
<b>k</b>	<i>material grafik dydimensional (piktura, vizatime etj.)</i>
<b>l</b>	<i>burime elektronike</i>
<b>m</b>	<i>multimedia</i>
<b>r</b>	<i>materiale tredimensionale dhe reale</i>
<b>u</b>	<p><i>ngjarje*</i></p> <p>Kodi u shtua për nevojat e regjistrimit të rezultateve të punës shkencore. Ky kod përdoret, kur për një vepër të ekzekutuar nuk ekziston forma fizike.</p>



## 001c Niveli bibliografik

Të përcaktuara janë këto vlera:

<b>a</b>	<p><i>analitik (pjesë përbërëse)</i></p> <p>Njësia bibliografike, e cila është pjesë fizike e një njësie tjetër. Identifikimi i pjesës përbërëse varet nga identifikimi i njësisë, pjesë e së cilës është. Një pjesë përbërëse mund të jetë në një ose në disa pjesë.</p> <p>Shembuj të materialeve të shënuara me kodin "a": artikull në një revistë; rubrikë e përhershme ose fejtton në një gazetë; pjesë përbërëse në një përmbledhje punimesh; kapitull në një libër.</p>
<b>c</b>	<p><i>koleksion</i></p> <p>Regjistrimi për njësinë bibliografike, e cila është një koleksion i krijuar në mënyrë artificiale. Kodi më herët është përdorur edhe në regjistrimet për koleksionet e librave. Në bazën e të dhënave COBIB.SI ekzistojnë regjistrime të vjetra për koleksionet e librave, të cilat kanë këtë kod. Në regjistrimet e reja përdoret kodi "c" vetëm në regjistrimet për koleksionet e krijuara në mënyrë artificiale.</p> <p>Shembuj të materialeve, në regjistrimet e të cilave vendoset kodi "c": një koleksion broshurash të vendosura në kuti; suvenire të ndryshme që përbëjnë një koleksion; koleksion dorëshkrimesh të një autori.</p>
<b>d</b>	<p><i>vepër e ekzekutuar*</i></p> <p>Kodi është shtuar për nevojat e bibliografisë. Përdoret vetëm në rastet kur forma fizike e veprës nuk ekziston. Zakonisht, për njësi të tilla nuk ekziston dokumenti parësor, prandaj regjistrimi bëhet duke u bazuar në një certifikatë ose në disa dokumente të tjera për veprën e ekzekutuar.</p> <p>Shembuj të materialeve, në regjistrimet e të cilave vendoset kodi "d": leksion i pabotuar; ekspozitë; koncert.</p>
<b>i</b>	<p><i>burim i integruar</i></p> <p>Burim bibliografik, që plotësohet ose ndryshohet me përditësimet, të cilat integrohen në tërësinë e burimit. Burimet e integruara mund të jenë të përfunduara (fondi i botimit dihet) ose që vazhdojnë (fondi i botimit nuk dihet).</p> <p>Shembuj të materialeve, në regjistrimet e të cilave vendoset kodi "i": fletë të palidhura me përmbajtje të këmblyshme; bazë e të dhënave; faqe elektronike.</p>
<b>m</b>	<p><i>monografi</i></p> <p>Njësi bibliografike, e përfunduar në një apo disa pjesë (të ndara fizikisht), numri i të cilave është i kufizuar paraprakisht.</p> <p>Shembuj të materialeve, në regjistrimet e të cilave vendoset kodi "m": monografi; monografi në disa pjesë; vëllim i një monografie me shumë vëllime që katalogohet i veçantë; libër në një koleksion; numër special i një seriali që katalogohet i veçantë; hartë në një koleksion; koleksion i përfunduar i hartave; glob gjeografik.</p>
<b>s</b>	<p><i>serial</i></p> <p>Burim në vazhdim, që del me numra të veçantë ose pjesë të njëpasnjëshme, zakonisht të numëruara, ndërsa fondi i botimit nuk është i paracaktuar.</p> <p>Shembuj të materialeve, në regjistrimet e të cilave vendoset kodi "s": revistë; gazetë; revistë elektronike; regjistër; raport vjetor; seri monografike.</p>

Niveli bibliografik i regjistrimit lidhet me pjesën kryesore të regjistrimit, përkatësisht me njësinë parësore bibliografike, titulli i së cilës është i shënuar në fushën 200. Nënfisha është e detyrueshme.

## 001d Niveli hierarkik

Kodi tregon nëse regjistrimi është i lidhur në mënyrë hierarkike me regjistrimet e tjera dhe cili është pozicioni i tij. Nënfisha është e detyrueshme.

<b>0</b>	<i>nuk ka lidhje hierarkike</i>
<b>1</b>	<i>regjistrim në nivelin më të lartë</i>
<b>2</b>	<i>regjistrim nën nivelin më të lartë</i>

Në programin COBISS zbatohet vetëm lidhja hierarkike e regjistrimeve për pjesët përbërëse, të cilat gjithmonë duhet të lidhen me regjistrimin për burimin kryesor, sepse nuk përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për të ekzistuar si regjistrime të pavarura.

Në regjistrimin për pjesën përbërëse vendoset gjithmonë kodi "2". Në regjistrimin për serialin ose monografinë vendoset kodi "0", në qoftë se nuk katalogohet në mënyrë analitike ose "1", në qoftë se në bazën e të dhënave ekziston edhe regjistrimi për ndonjërin nga pjesët përbërëse të tyre.

## 001e Numri i vjetër i regjistrimit\*

Nënfisha përmban numrin e vjetër identifikues (është numër identifikimi nga baza origjinale e të dhënave) në regjistrimet, që janë transferuar përmes konvertimit nga bazat e tjera të të dhënave.

## 001g Kodi i plotësisë së regjistrimit

Kodi tregon nivelin e plotësisë së një regjistrimi dhe jep informacion nëse njësia është kontrolluar gjatë krijimit të regjistrimit apo jo. Nënfisha nuk plotësohet nëse regjistrimi krijohet duke patur njësinë në duar.

<b>1</b>	<i>nënniveli 1 (të dhënat janë marrë nga skedat e katalogut klasik)</i> Njësia nuk është kontrolluar gjatë krijimit të regjistrimit. Të dhënat mund të jenë marrë nga skeda e katalogut, prandaj nuk janë aq të sakta sa mund të ishin, sikur të merreshin nga materiali origjinal.
<b>2</b>	<i>nënniveli 2 (regjistrimi CIP)</i> Regjistrim para botimit (CIP). Këto regjistrime bëhen përpara se materiali të botohet dhe për këtë arsye, zakonisht nuk janë të plota.
<b>3</b>	<i>nënniveli 3 (përshkrim jo i plotë)</i> Regjistrimi nuk përmban përshkrimin e plotë. Regjistrimi mund të plotësohet më pas.

## 001h Forma e përshkrimit bibliografik

Kodi tregon formën e përdorur për pjesën përshkruese të regjistrimi. Nënfisha plotësohet vetëm nëse fushat nga 200 deri 225 nuk janë të krijuara plotësisht sipas rregullave të ISBD-së. Vlerat e kodeve janë:

<b>i</b>	<i>regjistrimi është pjesërisht në formën e ISBD-së</i> Vetëm disa fusha në regjistrim janë plotësuar sipas rregullave të ISBD-së.
----------	---

<b>n</b>	<i>regjistrimi nuk është në formën e ISBD-së</i> Asnjë e dhënë në regjistrim nuk është shënuar sipas rregullave të ISBD-së.
----------	--

## 001t Tipologjia e dokumenteve/veprave\*

Nënfusha plotësohet për klasifikimin e dokumenteve/veprave në bibliografi (shih shembullin 4).

Plotësimi i nënfushës është i detyrueshëm te regjistrimet e të gjitha dokumenteve/veprave, autorët e të cilave janë regjistruar si kërkues shkencorë në Agjencinë për Veprimtarinë Kërkimore, dhe te regjistrimet për artikujt nga serialet, të cilat i bashkëfinancon ministria. Plotësimi i nënfushës është i detyrueshëm edhe te të gjitha regjistrimet e tjera për dokumentet/veprat, të cilat dëshironi t'i klasifikoni sipas tipologjisë në përgatitjen e bibliografisë personale ose në përgatitjen e bibliografisë së institucionit/organizatës.

ARTIKUJ DHE PJESË TË TJERA PËRBËRËSE	
<b>1.01</b>	<i>artikull shkencor origjinal</i>
<b>1.02</b>	<i>artikull recensues</i>
<b>1.03</b>	<i>artikuj të tjerë shkencorë</i>
<b>1.04</b>	<i>artikull profesional</i>
<b>1.05</b>	<i>artikull popullor</i>
<b>1.06</b>	<i>kontribut shkencor i botuar në konferencë (ligjëratë e të ftuarit)</i>
<b>1.07</b>	<i>kontribut profesional i botuar në konferencë (ligjëratë e të ftuarit)</i>
<b>1.08</b>	<i>kontribut shkencor i botuar në konferencë</i>
<b>1.09</b>	<i>kontribut profesional i botuar në konferencë</i>
<b>1.10</b>	<i>përmbledhje (abstrakt) e kontributit shkencor të botuar në konferencë (ligjëratë e të ftuarit)</i>
<b>1.11</b>	<i>përmbledhje (abstrakt) e kontributit profesional të botuar në konferencë (ligjëratë e të ftuarit)</i>
<b>1.12</b>	<i>përmbledhje (abstrakt) e kontributit shkencor të botuar në konferencë</i>
<b>1.13</b>	<i>përmbledhje (abstrakt) e kontributit profesional të botuar në konferencë</i>
<b>1.16</b>	<i>pjesë përbërëse shkencore e pavarur ose kapitull në një monografi</i>
<b>1.17</b>	<i>pjesë përbërëse profesionale e pavarur ose kapitull në një monografi</i>
<b>1.18</b>	<i>pjesë përbërëse profesionale në fjalor, enciklopedi ose leksikon</i>
<b>1.19</b>	<i>recension, recension libri, kritikë</i>
<b>1.20</b>	<i>parathënie, editorial, pasthënie</i>
<b>1.21</b>	<i>polemikë, diskutim, koment</i>
<b>1.22</b>	<i>intervistë</i>
<b>1.23</b>	<i>pjesë përbërëse artistike</i>
<b>1.24</b>	<i>bibliografi, indeks etj.</i>
<b>1.25</b>	<i>pjesë të tjera përbërëse</i>
<b>1.26</b>	<i>pjesë përbërëse shkencore në fjalor, enciklopedi, leksikon</i>

MONOGRAFI DHE VEPRA TË TJERA TË PËRFUNDUARA	
<b>2.01</b>	<i>monografi shkencore</i>
<b>2.02</b>	<i>monografi profesionale</i>
<b>2.03</b>	<i>tekst mësimor universitar, i arsimit të lartë ose i shkollës së lartë, i recensuar</i>
<b>2.04</b>	<i>tekst mësimor për shkollat fillore, të mesme ose tekste të tjera mësimore të recensuara</i>
<b>2.05</b>	<i>material tjetër mësimor</i>
<b>2.06</b>	<i>fjalor, enciklopedi, leksikon, manual, atlas, hartë</i>

<b>2.07</b>	<i>bibliografi</i>
<b>2.08</b>	<i>disertacion për doktoratë</i>
<b>2.09</b>	<i>tezë për master</i>
<b>2.10</b>	<i>tezë për specialist</i>
<b>2.11</b>	<i>punim diplome (universitare)</i>
<b>2.12</b>	<i>raport përfundimtar i rezultateve të kërkimit</i>
<b>2.13</b>	<i>trajtesë, studim paraprak, studim</i>
<b>2.14</b>	<i>dokumentacion projekti (projekt paraprak, projekt pune)</i>
<b>2.15</b>	<i>vendime ekspertize, arbitrazhi</i>
<b>2.16</b>	<i>vepër artistike</i>
<b>2.17</b>	<i>katalog ekspozite</i>
<b>2.18</b>	<i>film shkencor; botim shkencor audio ose video</i>
<b>2.19</b>	<i>transmetim në radio ose televizion, podcast, intervistë, konferencë për gazetarë</i>
<b>2.20</b>	<i>koleksion i plotë shkencor i të dhënave kërkimore</i>
<b>2.21</b>	<i>program (softuare)</i>
<b>2.22</b>	<i>varietet i ri</i>
<b>2.23</b>	<i>aplikimi për patentë</i>
<b>2.24</b>	<i>patentë</i>
<b>2.25</b>	<i>monografi të tjera dhe vepra të tjera të përfunduara</i>
<b>2.26</b>	<i>fjalor themelor shkencor ose leksik</i>
<b>2.27</b>	<i>fjalor terminologjik shkencor, enciklopedi ose leksikon tematik</i>
<b>2.28</b>	<i>botim kritik</i>
<b>2.29</b>	<i>model</i>
<b>2.30</b>	<i>përmbledhje të kontributeve profesionale ose shkencore të parecensuara nga konferencat</i>
<b>2.31</b>	<i>përmbledhje të kontributeve shkencore të recensuara nga konferencat ndërkombëtare ose të huaja</i>
<b>2.32</b>	<i>përmbledhje të kontributeve shkencore të recensuara nga konferencat kombëtare</i>
<b>2.33</b>	<i>film shkencor, videoregjistrim ose audioregjistrim</i>

<b>VEPRA TË EKZEKUTUARA (NGJARJE)</b>	
<b>3.10</b>	<i>interpretim artistik</i>
<b>3.11</b>	<i>ngjarje në radio ose televizion</i>
<b>3.12</b>	<i>ekspozitë</i>
<b>3.13</b>	<i>organizimi i takimeve shkencore dhe profesionale**</i>
<b>3.14</b>	<i>leksion në universitetin e huaj</i>
<b>3.15</b>	<i>kontribut konference i pabotuar</i>
<b>3.16</b>	<i>leksion i të ftuarit në konferencë i pabotuar</i>
<b>3.25</b>	<i>vepra të tjera të ekzekutuara</i>

Një kategori e veçantë e rezultateve të veprës kërkimore është autorësia dytësore, e cila nuk shënohet në nënfushën për tipologjinë e dokumenteve/veprave. Në bibliografi kjo paraqitet në bazë të kodeve të autorësisë në fushat 702 dhe 712, përkatësisht nga baza e të dhënave për serialet retrospektive.

Përcaktimet për tipologjinë e dokumenteve/veprave dhe rekomandimet lidhur me klasifikimin e llojeve të veçanta ndodhen në *Shtojcën F.6*.

## 001x Numri i regjistrimit zëvendësues\*

Nënfusha përdoret për zgjidhjen e problemit me regjistrimet dublikatë. Përmban numrin identifikues të regjistrimit, që duhet të shkarkohet në vend të regjistrimit, i cili është shënuar për t'u fshirë me kodin "d" në nënfushën 001a.

Në regjistrimin e shënuar për t'u fshirë, përveç nënfushës 001a, në të cilën vendoset kodi "d" për regjistrimin e fshirë, duhet të plotësohet edhe nënfusha 001x, ku shënohet numri identifikues i regjistrimit zëvendësues (shih shembullin 1).

Në rastet kur regjistrimi zëvendësues nuk ekziston – kjo më së shpeshti ndodhë tek regjistrimet CIP, ku botuesi kërkon regjistrimin CIP për botimin, i cili më vonë nuk botohet – në nënfushën 001x shënohet "-".

Në qoftëse kjo fushë plotësohet në mënyrën e duhur, mund të realizohet kontrolli i herëpashershëm automatik rreth përputhjes së bazës lokale dhe bazës së përbashkët të të dhënave. Të gjitha bibliotekat, të cilat në bazat e tyre lokale kanë shkarkuar një regjistrim të shënuar për t'u fshirë, marrin një mesazh përmes postës elektronike, i cili ndihmon në rritjen e cilësisë së bazës së të dhënave. Mesazhi përmban një tabelë me ID-të e regjistrimeve dublikatë, përkatësisht regjistrimeve të cilat duhet të fshihen dhe ID-të e regjistrimeve, të cilat duhet të shkarkohen në vend të regjistrimeve të fshira.

## 0017 Shkrimi i katalogimit

Përmes kësaj nënfushe përcaktohet shkrimi i shfaqjes së të dhënave në fushat, të cilat shfaqen në shkrimin, të cilin e përdor biblioteka për katalogun.

E dhëna është e detyrueshme. Bibliotekat mund të përdorin një nga këto kode:

<b>ba</b>	<i>latin</i>
<b>ca</b>	<i>cirilik – i paspecifikuar*</i>
<b>cb</b>	<i>cirilik – serb*</i>
<b>cc</b>	<i>cirilik – maqedon*</i>
<b>vv</b>	<i>disa shkrime*</i>
	Kodi përdoret nga bibliotekat, të cilat kanë dy katalogë – një në shkrim cirilik dhe një në latin.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Etiketa e regjistrimit ndodhet në fillim të çdo regjistrimi dhe përmban të dhëna për regjistrimin. Nënfushat a, b, c dhe d janë të detyrueshme, dhe për to, varësisht nga maska për shënimin e të dhënave, vetitë zakonisht paracaktohen.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

Të dhënat, të cilat ndodhen në etiketën e një regjistrimi nuk janë të pranishme askund tjetër në formatin COMARC. Megjithëse duket që, disa nga vlerat e kodeve për llojin e regjistrimit dhe nivelin bibliografik

kanë kuptim të njëjtë me disa të dhëna të tjera të koduara, kodet në etiketën e regjistrimit i referohen karakteristikave të regjistrimit dhe jo vetëm njësisë bibliografike.

## SHEMBUJ

### 1. \* COBISS.net

001	□□	<b>ad x35997440 ba cm d0</b>
200	0□	<b>a</b> Tehnična keramika <b>f</b> Drago Kolar <b>g</b> [ilustrirala Medeja Gec] <i>(Bibliotekat, të cilat kanë shkarkuar këtë regjistrim në bazën e tyre lokale të të dhënave, do të marrin përmes postës elektronike një listë me regjistrime, që duhet të fshihen. Në mesin e tyre do të jetë edhe regjistrimi me ID 3698696 – dublikatë.)</i>

### 2. \* COBISS.net

001	□□	<b>ac bl cs d0 7ba</b>
200	1□	<b>a</b> PIRS <b>b</b> Računalniška datoteka <b>e</b> poslovni imenik Republike Slovenije <i>(Regjistrim i redaktuar për serialin në një mjedis të lexueshëm nga makina.)</i>

### 3. \* COBISS.net

001	□□	<b>an be cm d0 7ba</b>
200	1□	<b>a</b> Kolovec <b>b</b> Kartografsko gradivo <b>ekarta</b> za orientacijski tek <b>f</b> reambulacija Anderluh Gregor ... [et al.] <b>g</b> risal Anderluh Gregor <i>(Regjistrim i ri për material hartografik.)</i>

### 4. \* COBISS.net

001	□□	<b>an ba ca d2 t1.04 7ba</b>
200	0□	<b>a</b> Izjave v podporo <b>Majniške deklaracije f</b> Vlasta Stavbar <i>(Regjistrim për një artikull profesional.)</i>

### 5. \* COBISS.net

001	□□	<b>an bl ci d0 7ba</b>
200	1□	<b>a</b> Vodja.com <b>b</b> Elektronski vir <b>e</b> praktični nasveti za vodenje podjetja in ljudi <i>(Regjistrim për një burim në vazhdim.)</i>

### 6. \* COBISS.net

001	□□	<b>an ba cm d0 7cc</b> <i>(Shkrimi i katalogimit është cirilik maqedon, të cilin e tregon kodi në nënfushën 0017.)</i>
-----	----	---

## 010 NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT (ISBN)

Kjo fushë përmban numrin standard ndërkombëtar të librit (ISBN) dhe shpjegimin, të cilin e përcakton ISBN, në rastet kur regjistrimi përmban më shumë se një ISBN. Fusha i përshatet zonës së numrit standard (ose të tjerë) dhe kushteve të disponueshmërisë në ISBD. Fusha mund të përmbajë kushte të disponueshmërisë dhe/ose çmimin, edhe kur nuk ka ISBN (shih shembullin 3).

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
010		Numri Standard Ndërkombëtar i Librit (ISBN)	r
	<b>a</b>	<i>Numri</i>	nr
	<b>b</b>	<i>Shpjegimi</i>	nr
	<b>d</b>	<i>Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi</i>	nr
	<b>z</b>	<i>ISBN e gabuar</i>	r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 010a Numri

Numri i saktë i ISBN-së, përfshirë edhe vizat ndarëse. ISBN-ja përcaktohet nga agjencia kombëtare e ISBN-së.

### 010b Shpjegimi

Shpjegimi për ISBN-në në nënfushën a (nëse ekziston): zakonisht emri i botuesit, lloji i lidhjes së kopjes ose shpjegimi i marrëdhënies në mes të ISBN-së me kompletin ose me një vëllim të veçantë (shih shembujt 3, 5, 6, 7, 11, 12, 14). Në programin COBISS shpjegimin nuk e vendosni brenda kllapave sepse ato vendosen në mënyrë automatike.

### 010d Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi

Çmimi i njësisë dhe çfarëdo shënimi për disponueshmërinë e saj (shih shembujt 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8).

## 010z ISBN e gabuar

ISBN-ja që është vendosur gabim në njësi ose është e pavlefshme. Numri i njëjtë i ISBN-së mund të jetë vendosur në dy botime të ndryshme dhe për këtë arsye është anuluar (shih shembullin 8) ose mund të jetë printuar me gabime (shih shembullin 9). Agjencia Kombëtare e ISBN-së njofton bibliotekën nëse vëren se në nënfushën a është shënuar ISBN-ja e gabuar. Më pas biblioteka të dhënë nga nënfusha a e transferon në nënfushën z.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

### Struktura e ISBN-së

ISBN-ja është një numër unik, i cili i ndahet në pjesë të botuar në përputhje me standardin ISO 2108.

ISBN-10 përbëhet nga katër pjesë, të cilat ndahen nga njëra tjetra me vizë ose me hapësirë. Këto pjesë janë:

- Identifikuesi i grupit: Caktohet për çdo vend ose grupe vendesh ose grupe gjuhësh nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së. Edhe organizatat ndërkombëtare, p.sh. Kombet e Bashkuara, kanë identifikuesin e grupit të tyre.
- Identifikuesi i botuesit: Caktohet për çdo botues nga Agjencia Kombëtare ose Rajonale e ISBN-së.
- Identifikuesi i titullit: Caktohet për çdo titull (dhe çdo botimi të titullit) nga botuesi.
- Shifra e kontrollit: Llogaritet në bazë të nëntë numrave të tjerë të ISBN-së.

ISBN-10 përbëhet prej numrave arab nga 0 deri te 9, me përjashtim të shifrës së kontrollit që mund të jetë numër arab ose romak X.

ISBN-13 përbëhet nga pesë pjesë; ISBN-së me 10 karaktere i është shtuar parashtesa (prefiksi) dhe shifra e kontrollit i cili llogaritet nga fillimi:

- Parashtesa: numri trashifror EAN, i cili tregon industrinë e librit (978, 979).
- Shifra e kontrollit: llogaritet në bazë të dymbëdhjetë numrave të tjerë të ISBN-së.

ISBN-13, bashkë me shifrën e kontrollit, përbëhet prej numrave arab nga 0 deri 9.

### Verifikimi i shifrës së kontrollit për ISBN-në me numër 10 shifror

Saktësia e ISBN-së verifikohet në këtë mënyrë: çdo shifër shumëzohet me një numër, vlera e të cilit varet nga pozicioni i shifrës (pesha), shifrat mbledhen dhe rezultati pjesëtohet me 11. Në qoftë se pas pjesëtim me 11 rezultati nuk është 0, atëherë një ose disa shifra janë gabim. Për ilustrim mund të përdorni shembullin 9:

ISBN	0	1	1	8	8	4	0	9	4	X (d.m.th. 10)
pesha	10	9	8	7	6	5	4	3	2	1
rezultati	0	9	8	56	48	20	0	27	8	10 = gjithsej 186

186 nuk plotpjesëtohet me 11, si përfundim ISBN-ja është e gabuar.

### Verifikimi i shifrës së kontrollit për ISBN-në me numër 13 shifror

Shifra e kontrollit llogaritet duke përdorur një algoritëm me 10 module.



Secili prej dymbëdhjetë numrave të parë të ISBN-së, pos shifrës së kontrollit, shumëzohet në mënyrë alternative me 1 ose 3 nga e majta në të djathtë. Në mënyrë që ISBN të jetë e saktë, shuma e përfituar e rezultateve, së bashku me shifrën e kontrollit, duhet të pjesëtohet me 10 dhe nuk duhet të ketë mbetje.

Shembull:

	identifikuesi i grupit										identifikuesi i titullit	nr.i kontr.	shuma	
	parashtesa			identifikuesi i botuesit										
ISBN	9	7	8	0	3	9	3	0	4	0	0	2	9	
pesha	1	3	1	3	1	3	1	3	1	3	1	3	-	
rezultati	9	21	8	0	3	27	3	0	4	0	0	6	-	81+9

Gjithsej:  $81 + 9$  (shifra e kontrollit) = 90

90 plotpjesëtohet me 10, si përfundim ISBN 978-0-393040-02-9 është numër i saktë standard ndërkombëtar i librit.

### Forma e të dhënave

Shkurtesa ISBN, e cila në botim është e shtypur bashkë me numrin, nuk shënohet në fushën 010.

Çdo ISBN, e cila është shtypur gabim në njësi, mund të shënohet në nënfushën 010z – ISBN e gabuar. Në këtë mënyrë mundësohet kërkimi edhe përmes numrit të gabuar që ndodhet në njësi.

Vizat ndarëse përdoren për të ndarë ISBN-në në katër (ISBN-10) ose pesë (ISBN-13) pjesë në nënfushat a dhe z. Përdorimi i shenjave të tjera të pikësimit nuk lejohet. Kur ISBN-ja shfaqet në skedë vendosja e vizave ndarëse ose hapësirave është e detyrueshme. Shumë agjenci kombëtare nuk i vendosin vizat ndarëse apo hapësirat në regjistrime, sepse ato mund të përftoheshin nëpërmjet algoritmit nëse njihen identifikuesit e botuesve. Te shkëmbimi ndërkombëtar i regjistrimeve nuk është e domosdoshme, që pranuesi i regjistrimeve të njohë identifikuesit e botuesit, të vendosur në pjesën e parë të ISBN-së. Prandaj rekomandohet, që për shkak të paraqitjes së saktë vizat ndarëse të shënohen gjithmonë.

Zakonisht, çdo libër ka një ISBN. Në një regjistrim duhet të vendosen disa ISBN në këto raste: kur botuesi publikon një vepër në disa lidhje të ndryshme ose forma fizike me ISBN të ndryshme, por të gjitha janë të përfshira në një regjistrim; kur krijohet një regjistrim i vetëm për njësinë me disa vëllime (pjesë) dhe botuesi i ka vendosur çdo vëllim dhe kompletin ISBN të ndryshme; kur një njësi ka disa botues ose shpërndarës, dhe secili nga ata i ka vendosur njësisë ISBN-në e tij.

Kur në regjistrim ndodhen disa ISBN, shtohet shpjegimi për të bërë dallimin midis tyre.

Shpeshherë, çdo ISBN ka kushtet e veta të disponueshmërisë dhe çmimin. Kjo e dhënë shënohet në të njëjtën fushë.

Fusha duhet të përsëritet për çdo ISBN të vlefshme. Ajo duhet të përsëritet edhe për ISBN-në e pavlefshme, përveç nëse kjo ISBN e pavlefshme lidhet qartë me ISBN-në e vlefshme të shënuar në regjistrim; në këtë rast ISBN e pavlefshme vendoset në të njëjtën fushë si ISBN-ja e vlefshme përkatëse (shih shembujt 8, 9).

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 011 ISSN

Një numër i ngjashëm në përdorim me ISBN-në por që zbatohet për burimet në vazhdim.

## SHEMBUJ

1.

010	uu	<b>a0-246-11007-4 d£2.95</b> <i>(Libër i botuar në Angli, lidhje pëlhure, çmimi £2,95, ISBN-ja në njësi është në formën: 0 246 11007 4.)</i>
-----	----	---

2.

010	uu	<b>a963-592-149-7 d\$25.00 (outside Hungary)</b> <i>(Libër i botuar në Hungari. Jashtë vendit shitet me çmimin \$25,00.)</i>
-----	----	---

3.

010	uu	<b>d£3.50</b>
010	uu	<b>bpbk d£2.50</b> <i>(Libër i lidhur me pëlhurë dhe në formë broshure. Nuk ka ISBN.)</i>

4.

010	uu	<b>a0-85997-276-3 d£5.20 (£3.90 to members of the Library Association)</b> <i>(Libër i botuar me ulje çmimi për anëtarët e Library Association.)</i>
-----	----	---

5.

010	uu	<b>a0-915408-15-5 dUnpriced</b>
010	uu	<b>a0-915408-16-3 bSigned ed. dUnpriced</b> <i>(Libër i lidhur me pëlhurë, në dispozicion edhe me kapak të trashë dhe i firmosur nga përkthyesi. Secila formë ka ISBN-në e vet.)</i>

6.

010	uu	<b>a0-306-35054-8 d£22.05</b>
010	uu	<b>a0-306-35050-5 bSet of six vols d£97.29</b> <i>(Regjistrim për vëllimin e 4-të të monografisë "Treatise on solid state chemistry", botuar në 6 vëllime, secili me ISBN-në e vet. Komplet i ka gjithashtu ISBN-në e vet dhe çmimin.)</i>

7.

010	uu	<b>a0-563-12887-9 b(B.B.C.)</b>
010	uu	<b>a0-233-96847-4 b(Deutsch)</b> <i>(Libër i botuar nga British Broadcasting Corporation dhe Deutsch.)</i>

8.

010	uu	<b>a0-95045-372-2 d£0.55 z0-95045-711-6</b> <i>(Botuesi vendos gabimisht të njëjtën ISBN në të gjitha njësitë. Agjencia Kombëtare e ISBN-së ndan ISBN-të e vlefshme për secilën njësi. Në regjistrimin e çdo njësie ISBN-ja e saktë vendoset në nënfushën a, ndërsa e gabuara në nënfushën z.)</i>
-----	----	---

9.

010	uu	<b>a0-11-884094-0 z0-11-884094-X</b> <i>(ISBN 0-11-884094-X është shtypur gabimisht me shifrën e kontrollit X.)</i>
-----	----	--

10. \* COBISS.net

010	uu	<b>a86-11-02519-9</b>
200	0u	<b>aFuqia e fjalës</b>

## 11. \* COBISS.net

010	□□	a978-99956-16-16-8 bVëll. 1
010	□□	a99927-1-786-6 bVëll. 2
010	□□	a99927-36-60-7 bVëll. 4
200	0□	aShqiptarët midis lindjes dhe perëndimit

## 12. \* COBISS.net

010	□□	a99-92787-91-0 bbrosh.
200	1□	aShqiptarët në udhëkryq

## 13. \* COBISS.net

010	□□	a0-393040-02-X
010	□□	a978-0-393040-02-9
		<i>(Shifrat e kontrollit të ISBN-ve me numra 10 shifror dhe 13 shifror janë të ndryshme.)</i>

## 14. \* COBISS.net

010	□□	a978-951-45-9693-3
010	□□	a978-951-45-9694-0 bbrosh.
010	□□	a978-951-45-9695-7 bPDF
010	□□	a978-951-45-9696-4 bHTML
		<i>(Libër i lidhur në pëlhurë dhe në formë broshure, si dhe në formë elektronike në formatin PDF dhe HTML. Nga 1 Janari 2007 të gjithë botimet e reja do të kenë ISBN me numër 13 shifror.)</i>



## 011 ISSN

Bazë për krijimin e regjistrimeve bibliografike për burimet në vazhdim është baza e të dhënave ISSN, e cila është në dispozicion përmes sistemit të katalogimit të përbashkët. Transferimi i regjistrimeve nga baza e të dhënave ISSN (formati ISSN) në bazën e përbashkët të të dhënave (formati COMARC/B) është i automatizuar dhe bëhet përmes ISSN-së.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
011		ISSN	nr
	<b>a</b>	<i>ISSN - artikull*</i>	nr
	<b>c</b>	<i>Numri i brendshëm i burimit në vazhdim*</i>	nr
	<b>d</b>	<i>Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi</i>	r
	<b>e</b>	<i>ISSN e vlefshme*</i>	nr
	<b>f</b>	<i>ISSN e paverifikuar*</i>	nr
	<b>l</b>	<i>ISSN-L*</i>	nr
	<b>m</b>	<i>ISSN-L e anuluar*</i>	r
	<b>s</b>	<i>ISSN e artikullit në seri me nënseri ose në shtojcë*</i>	nr
	<b>y</b>	<i>ISSN e anuluar</i>	r
	<b>z</b>	<i>ISSN e gabuar</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Niveli i interesit</i></b>
	□	<i>Nuk ka të dhëna</i>
	0	<i>Burimi në vazhdim me interes kombëtar ose ndërkombëtar</i>
	1	<i>Burimi në vazhdim me interes lokal</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 011a ISSN - artikull\*

Kjo e dhënë shënohet vetëm për artikujt, të cilët janë të lidhur me një serial, ISSN-ja (ose numri i përkohshëm ose numri COBIB) e të cilit është shënuar në këtë nënfushë.

---

**011c Numri i brendshëm i burimit në vazhdim\***

Në këtë nënfushë shënohet numri COBIB dhe numri i PËRKOHSHËM i burimit në vazhdim (shih shembujt 7, 8).

---

**011d Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi**

Çmimi i njësisë dhe çdo lloj shënimi mbi disponueshmërinë e saj (shih shembujt 3, 4, 6).

---

**011e ISSN e vlefshme\***

Është një ISSN e përdorur saktë, përfshirë vizën ndarëse midis shifrës së katërt dhe të pestë.

Te burimet në vazhdim të huaja ISSN-ja është e vlefshme vetëm atëherë, kur në bazën e të dhënave të ISSN-së ekziston regjistrimi me këtë numër. Te burimet në vazhdim vendase ISSN-ja është e vlefshme, kur regjistrimi në bazën e përbashkët të të dhënave është redaktuar nga Qendra Kombëtare e ISSN-së.

Meqenëse në nënfushën 011a shënohet ISSN e artikullit, ISSN-ja e burimit në vazhdim shënohet në nënfushën 011e.

Për të evituar krijimin e regjistrimeve dublikatë në bazën e përbashkët të të dhënave, programi ekzekuton kontrollin automatik të uniformitetit të numrave identifikues (ISSN, ISSN e paverifikuar, numri COBIB, numri i përkohshëm, termi për kërkim: Select SP=011e OR SP=011f OR SP=011c OR SF=011e OR SF=011f OR SF=011c). Plotësimi i nënfushës 011e ose 011f ose 011c është i detyrueshëm.

---

**011f ISSN e paverifikuar\***

ISSN-ja e paverifikuar shënohet vetëm për burimet e huaja në vazhdim, kur burimi në vazhdim ka një ISSN të shtypur, por regjistrimi për të nuk ndodhet në bazën e të dhënave të ISSN-së.

Qendra Kombëtare e ISSN-së siguron verifikimin e këtyre ISSN-ve përmes Qendrës Ndërkombëtare të ISSN-së në Paris, bazuar në fotokopjet e faqes së titullit dhe faqeve të tjera të rëndësishme. Nëse ndonjë bibliotekë kryen katalogimin analitik, këtyre botimeve u ndahet edhe numri i përkohshëm.

Pasi të bëhet verifikimi, Qendra Kombëtare vendos ISSN-në në nënfushën 011e dhe fshin nënfushën 011f. Nëse botimi ka numër të përkohshëm, ai mbetet në nënfushën 011c edhe pas verifikimit të ISSN-së (shih shembullin 8).

---

**011i ISSN-L\***

ISSN, që e ndan rrjeti i ISSN-së për lidhjen e burimeve në vazhdim, që janë në mjedise të ndryshme (shih shembujt 10, 11).

---

### **011m ISSN-L e anuluar\***

ISSN-L, që i është ndarë gabimisht burimit në vazhdim (shih shembullin 12).

---

### **011s ISSN e artikullit në seri me nënseri ose në shtojcë\***

Kjo e dhënë shënohet vetëm për artikujt nga seriali, i cili është seri me nënseri ose shtojcë e një seriali tjetër. Të dy serialet kanë ISSN-në e tyre, numrin e përkohshëm ose një numër COBIB.

Artikulli, zakonisht lidhet (nënfusha 011a) me serialin ku është botuar, me përjashtim të artikujve nga shtojca, që lidhen me njësinë kryesore.

ISSN-ja e serialit tjetër (alternativ) shënohet në nënfushën 011s, ndërsa numërtimi alternativ i serialit në nënfushat 215opqrs.

---

### **011y ISSN e anuluar**

ISSN e vlefshme më parë, por që është fshirë nga Qendra e ISSN-së (shih shembujt 2, 9).

---

### **011z ISSN e gabuar**

Çdo ISSN e pasaktë, përveç asaj të anuluar. Zakonisht janë numrat e ISSN-së të shtypur gabim. Shënohet ISSN-ja e shtypur në botim, mirëpo ndryshon nga ISSN-ja në bazën e të dhënave të ISSN-së. Një ISSN e vendosur në këtë nënfushë mund të ekzistojë si ISSN e vlefshme në nënfushën 011e, por në një regjistrim tjetër (shih shembullin 5).

## **SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS**

ISSN-ja e burimit në vazhdim përcaktohet në përputhje me ISO 3297. Sistemi për përcaktimin e ISSN-ve kontrollohet nga Qendra Ndërkombëtare e ISSN-ve në Paris. Qendrat Kombëtare përcaktojnë ISSN-të për burimet e reja në vazhdim nga grupi i numrave të përcaktuar për ta nga Qendra Ndërkombëtare e ISSN-ve. Më pas të dhënat për këtë ia komunikojnë Qendrës Ndërkombëtare.

Sistemi ISSN, si pjesë e programit UNISIST, u krijua në fillim të viteve 1970, me firmosjen e një marrëveshje midis UNESCO-s dhe qeverisë franceze. Në këtë mënyrë u krijua Qendra Ndërkombëtare për regjistrimin dhe identifikimin e serialeve, më shumë e njohur si Qendra Ndërkombëtare e ISSN-së. Detyra kryesore e saj është ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemit të automatizuar për identifikimin dhe regjistrimin e burimeve në vazhdim, përkatësisht ndërtimin e bazës ndërkombëtare të të dhënave për burimet në vazhdim, kryesisht për ato që përmbajnë njohuri të reja shkencore dhe teknologjike.

Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të ISSN-së janë të ngarkuara Qendrat kombëtare dhe rajonale të ISSN-së. Përmes marrëveshjeve specifike me Qendrën Ndërkombëtare në sistem janë përfshirë edhe shtetet, të cilat formalisht nuk janë anëtare.

Bazën për identifikimin uniform të burimeve në vazhdim e formojnë: ISSN-ja, titulli kyç dhe titulli kyç i shkurtuar. Këto elemente janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Qendrës Ndërkombëtare të ISSN-së.

Për përditësimin e bazës së përbashkët të të dhënave, e cila bazohet në identifikimin uniform të burimeve në vazhdim me ndihmën e numrit të ISSN-së, bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të ISSN-ve nevojitet zakonisht në dy raste. Nevojitet gjithmonë kur:

- botimi ka ISSN të shtypur, mirëpo regjistrimi ende nuk është në bazën e të dhënave të ISSN-së, ose
- botimi nuk ka ISSN.

Te botimet, të cilat kanë ISSN të shtypur, por regjistrimi për to nuk ndodhet në bazën e të dhënave të ISSN-së, numri i ISSN-së duhet të verifikohet. Te botimet, të cilat akoma nuk kanë ISSN, ndërsa i plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara, duhet të fillohet procedura për marrjen e ISSN-së.

Në këtë rast, Qendrës Kombëtare të ISSN-së duhet t'i dërgohet fotokopja e faqeve të të titullit dhe/ose faqeve të tjera të relevante, së bashku me formën e aplikimit të përcaktuar nga Qendra Kombëtare. Më e rëndësishmja është faqja e kolofonit.

Procedura për verifikim dhe marrjen e një ISSN-je për burimet në vazhdim:

Numrat e ISSN-së për burimet në vazhdim Qendra Kombëtare i ndanë në dy mënyra:

- botuesit para se botimi të dal ose
- në bazë të kopjes së detyruar.

Mund të ndodhë, që ndonjë nga pjesëmarrësit në sistemin e katalogimit të përbashkët të siguroj një botim para se ai të arrij në qendrën e ISSN-së.

Në rastin e parë, Qendra Kombëtare e ISSN-së përcakton ISSN-në dhe përgatit regjistrimin fillestar bazuar mbi të dhënat që ka marrë nga botuesi. Pasi merr kopjen e detyruar, Qendra Kombëtare e ISSN-së përfundon regjistrimin dhe ia dërgon atë bazës Ndërkombëtare të ISSN-së. Nëse botuesi nuk ka kërkuar numër të ISSN-së para se burimi në vazhdim të jetë botuar, Qendra Kombëtare krijon regjistrimin bazuar në kopjen e detyruar. Nëse ndonjë nga pjesëmarrësit në sistemin e përbashkët të katalogimit e merr botimin para se Qendra Kombëtare e ISSN-së të marrë kopjen e detyruar, ai ia dërgon asaj fotokopjet e faqeve relevante, në bazë të të cilave Qendra Kombëtare krijon regjistrimin fillestar, të cilin pjesëmarrësit e tjerë e shkarkojnë në bazat e tyre lokale. Pasi Qendra Kombëtare e ISSN-së merr botimin, regjistrimi përditësohet.

Kërkesat për verifikimin ose ndarjen e numrit të ISSN-së për burimet e huaja në vazhdim, Qendra Kombëtare e ISSN-së ia dërgon Qendrës Ndërkombëtare në Paris.

Kur Qendra Kombëtare merr një kërkesë për verifikim ose ndarje të një ISSN-je, burimit në vazhdim i ndan një **numër të përkohshëm** dhe për këtë njofton institucionin që ka bërë kërkesën. Kërkesën për verifikimin e ISSN-së ekzistuese ose ndarjen e një ISSN-je të re ia dërgon Qendrës Ndërkombëtare.

Nëse botimi ka ISSN, por regjistrimi ende nuk është në bazën e të dhënave të ISSN-së, ISSN-ja shënohet në nënfushën *011f- ISSN e paverifikuar\** (shih shembullin 8).

Në sistemin e përbashkët të katalogimit është e nevojshme të dallohen burimet në vazhdim, për të cilat ndarja e ISSN-së nuk është justifikuar. Për këto botime ndahet **numri COBIB**. Numrin COBIB e ndan Qendra Kombëtare e ISSN-së e cila është përgjegjëse për zonën kombëtare, në bazë të kopjes së detyruar ose kërkesës së botuesit, nëse burimi në vazhdim nuk i përmbush kriteret për të marrë një ISSN.

## Numri COBIB

Numrin COBIB e marrin burimet në vazhdim që nuk i përmbushin kriteret për të marrë një ISSN. Nga ana tjetër këto botime janë të rëndësishme për bazën e përbashkët të të dhënave (për përgatitjen e bibliografive, funksionimin e katalogëve online për serialet e huaja, katalogimin analitik etj.).



Numri COBIB ka strukturë të ngjashme me ISSN-në, por fillon me shkronjën "C". Numri në pozicionin e dytë identifikon Qendrën Kombëtare të ISSN-së (p.sh. C500-0022 është numri COBIB i caktuar nga NUK).

Para se të caktoj një numër COBIB, Qendra Kombëtare duhet të kontrolloj nëse ekziston regjistrimi për burimin në vazhdim në bazën e përbashkët të të dhënave COBIB. Nëse po, regjistrimi shkarkohet bashkë me numrin COBIB ekzistues. Regjistrimi sipas nevojës redaktohet.

Qendra Kombëtare ndan numrin COBIB bazuar në fotokopjet e faqes së titullit dhe faqeve të tjera relevante të këtyrë botimeve.

### **Numri i përkohshëm**

Numri i përkohshëm u ndahet vetëm burimeve të huaja në vazhdim.

Qendra Kombëtare e ISSN-së, e cila dërgon kërkesë për identifikimin e burimit në vazhdim Qendrës Ndërkombëtare të ISSN-së, ndan numrin e përkohshëm vetëm për burimet në vazhdim që:

- kanë ISSN të shtypur dhe përpunohen në mënyrë analitike, por regjistrimet për to nuk ndodhen në bazën e të dhënave të ISSN-së,
- nuk kanë ISSN dhe
  - përveç kriterit të botimit (të botuara pas vitit 1971), plotësojnë edhe kriteret e tjera për t'u përfshirë në bazën e të dhënave të ISSN-së,
  - nuk plotësojnë kriterin e botimit (të botuara pas vitit 1971), mirëpo Qendra Kombëtare justifikon ndarjen e ISSN-së me rëndësinë e botimit.

Numri i përkohshëm ka strukturë të ngjashme me ISSN-në, por fillon me shkronjën "Y". Numri në pozicionin e dytë identifikon Qendrën Kombëtare të ISSN-së (p.sh. Y500-0022 është një numër i përkohshëm i caktuar nga NUK)

Qendra Kombëtare merr ISSN-në nga Qendra Ndërkombëtare në Paris, bazuar në fotokopjet e faqeve të titujve dhe faqeve të tjera relevante të këtyrë botimeve.

Pasi regjistrimi të ruhet në bazën e të dhënave të ISSN-së, Qendra Kombëtare vendos ISSN-në në nënfushën 011e. Numri i përkohshëm mbetet në nënfushën 011c, nëse përmes tij janë lidhur artikujt me burimin (shih shembullin 7).

Para se të ndahet numri i përkohshëm, Qendra Kombëtare duhet të kontrollojë nëse regjistrimi për këtë burim në vazhdim ekziston në bazën e përbashkët të të dhënave COBIB. Nëse po, ai shkarkohet bashkë me numrin ekzistues. Qendra Kombëtare, e cila ka ndarë numrin e përkohshëm dhe ka nisur kërkesën për ISSN tek Qendra Ndërkombëtare, pas marrjes së numrit të ISSN-së duhet të informoj për këtë pjesëmarrësit e tjerë në sistemin e përbashkët të katalogimit.

### **Formati i të dhënave**

Numri i ISSN-së përbëhet nga 8 shifra, dy grupe me nga 4 numra të ndarë nga një vizë. Këto janë numra arabë nga 0 deri 9, përveç numrit të fundit (shifra e kontrollit), i cili mund të jetë numër romak X. Shifra e kontrollit llogaritet nga një modul me bazë 11 duke përdorur vlerat 8 deri 2. Llogaritja është e ngjashme me atë që realizohet për ISBN-në (shih fushën 010). Në fushën 011 shënohet vetëm numri i ISSN-së me vizën ndarëse, ndërsa shkurtesa ISSN shfaqet në mënyrë automatike.

Nënfushat 011a dhe 011s përdoren vetëm në regjistrimet për artikujt, ndërsa nënfushat e tjera 011 përdoren vetëm në regjistrimet për botimet në vazhdim.

**ISSN-L ose ISSN e lidhur**

ISSN-L i ndahet burimit në vazhdim në përputhje me rregullat e standardit ISO 3297. ISSN-L mundëson klasifikimin ose shpërndarjen e burimit në mjedise të ndryshme, p.sh. versioni i shtypur dhe elektronik i revistës.

**FUSHAT NË LIDHSHMËRI**

- 010** *NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT (ISBN)*  
Numër i ngjashëm për nga përdorimi me ISSN-në, por që përdoret për librat.
- 040** *CODEN*  
Sistem tjetër për identifikimin e serialeve.
- 225** *SERIA*  
ISSN-ja e serisë, të cilës i takon njësia që përshkruhet. Shënohet në nënfushën 225x.
- 530** *TITULLI KYÇ*  
Titulli kyç i burimit në vazhdim.
- 531** *TITULLI KYÇ I SHKURTUAR*  
Titulli kyç i shkurtuar i burimit në vazhdim.
- 4XX** *BLLOKU PËR LIDHJE*  
ISSN-në e burimit në vazhdim, i cili është i lidhur me burimin në vazhdim që përshkruhet (seria, nënseria), mund ta shënoni në nënfushën x të fushës përkatëse në bllokun 4XX.

**SHEMBUJ**

1.

011	□□	e0003-9756 (ISSN për "Archives européennes de sociologie".)
-----	----	--

2.

011	□□	e0105-0064 y0036-5646 ("Scandinavian times" dhe "Scandinavian times magazine" kanë pasur ISSN të njëjtë. Ky numër i ISSN-së është anuluar dhe secilit botim i është ndarë ISSN e re. Shembulli tregon përmbajtjen e fushës 011 në regjistrimin "Scandinavian times".)
-----	----	--

3.

011	□□	e0260-7743 dFree to members of the federation only (Në regjistrimin për "Newsletter" të Federatës Londineze dhe Galerive të Arteve ndodhet edhe e dhëna për kushtet e disponueshmërisë.)
-----	----	---

4.

011	□□	e0009-3947 d£1.00 d£13.25 yearly (Në regjistrim është shënuar çmimi për një numër dhe abonimi për një vit.)
-----	----	--

5.

011	□□	e0263-3264 z0226-7223 z0068-2691
-----	----	----------------------------------

*(Botimi "Yearbook of European law", 1984, ka dy ISSN të ndryshme dhe të dyja janë të pasakta. Në regjistrim përveç ISSN-së së saktë janë shënuar edhe dy ISSN-të e pasakta.)*

6.

011 □□ **d**£2.95  
*(Botimi ka të shtypur çmimin, por jo numrin e ISSN-së.)*

7. \*

011 □□ **c**C500-0017  
200 1□ **a**Nova proga eglasilo Slovenskih železnic  
*(Ka numër të përkohshëm.)*

011 □□ **c**C500-0017 **e**1408-3728  
200 1□ **a**Nova proga eglasilo Slovenskih železnic  
*(Pas marrjes së ISSN-së së vlefshme.)*

8. \*

011 □□ **c**Y501-3674 **f**0939-6233  
200 1□ **a**Vestigia Bibliae **e**Jahrbuch des Deutschen Bibel-Archivs Hamburg  
*(Botimi ka ISSN të shtypur, por regjistrimi për të nuk ndodhet në bazën e të dhënave të ISSN-së.)*

011 □□ **e**0939-6233 **c**Y501-3674  
200 1□ **a**Vestigia Bibliae **e**Jahrbuch des Deutschen Bibel-Archivs Hamburg  
*(Pas verifikimit të ISSN-së, domethënë regjistrimi është ruajtur në bazën e të dhënave të ISSN-së.)*

9. \*

011 □□ **e**0371-4039 **y**0081-3966  
200 1□ **a**Glas **f**Srpska akademija nauka i umetnosti. Odeljenje medicinskih nauka  
*(Në njësi janë shënuar ISSN-ja e vlefshme dhe ISSN-ja e anuluar.)*

10.

011 0□ **e**1819-1371 **I**1819-1371  
*(ISSN dhe ISSN-L e burimit në vazhdim "Construction law international", i botuar në formë të shtypur; botimi në mjedisin mjedisit tjetër nuk ekziston.)*

11.

011 0□ **e**1818-5894 **I**1818-5894  
*(ISSN dhe ISSN-L e burimit në vazhdim "Social policy highlight", i botuar në formë të shtypur.)*

011 0□ **e**1818-5940 **I**1818-5894  
*(ISSN dhe ISSN-L e burimit në vazhdim "Social policy highlight", i botuar në formë elektronike.)*

12.

011 0□ **e**1234-1231 **I**1234-1231  
*(Regjistrimi për versionin e shtypur.)*

011 0□ e1560-1560 I1234-1231 m1560-1560

*(Regjistrimi për versionin elektronik. Versionet i burimit në mjedise të ndryshme janë identifikuar veç e veç dhe është bërë gabim sepse nuk janë lidhur menjëherë.)*

## 012 IDENTIFIKUESI FINGERPRINT

Kjo fushë përmban kodin e identifikuesit fingerprint për monografitë e vjetra (antikuarë) dhe kodin e institucionit, së cilës i përket fusha. Kodi bën dallimin midis identifikuesve fingerprint, kur regjistrimi përmban më shumë se një. Fusha korrespondon me zonën e numrit standard (ose të tjerë) dhe me kushtet e disponueshmërisë në ISBD.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
012	Identifikuesi Fingerprint	r
	<b>a</b> <i>Fingerprint</i>	nr
	<b>0</b> <i>Numri i vendit për të cilin zbatohet fusha*</i>	nr
	<b>2</b> <i>Kodi i sistemit Fingerprint</i>	nr
	<b>5</b> <i>Institucioni për të cilin zbatohet fusha</i>	nr
	<b>9</b> <i>Numri i inventarit për të cilin zbatohet fusha*</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 012a Fingerprint

Fingerprint i llogaritur. Fingerprint caktohet nga institucioni, i cili krijon regjistrimin.

### 0120 Numri i vendit për të cilin zbatohet fusha\*

Nëse institucioni ka më shumë se një kopje, shënohet numri për të cilin zbatohet fusha.

### 0122 Kodi i sistemit Fingerprint

Kodi i sistemit, sipas të cilit caktohet identifikuesi fingerprint. Në sistemin COBISS përdoret shkurtesa *fei* (*Fingerprints = Empreintes = Impronte*).

## 0125 Institucioni për të cilin zbatohet fusha

Emri i institucionit në formë të koduar. Meqenëse kodet e pranuar ndërkombëtarisht nuk ekzistojnë, për bibliotekat sllovene përdoret kodi kombëtar (kodi i institucionit).

## 0129 Numri i inventarit për të cilin zbatohet fusha\*

Në nënfushë shënohet numri i inventarit të kopjes, me të cilën ka të bëjë përmbajtja e nënfushës. Kjo shërben si lidhje me të dhënat për gjendjen e koleksioneve. Nëse pëshkruani kopjen në disa pjesë dhe keni disa numra inventari, ata mes vete i ndani me shenjën ";".

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fingerprint është një mënyrë për të identifikuar monografitë e vjetra. Ai ndërtohet duke marrë grupe karakteresh (shkronjash) nga faqe të caktuara, me qëllim që çdo botim të identifikohet në mënyrë unike.

Meqenëse nuk ka një formulë të pranuar ndërkombëtarisht për përcaktimin e identifikuesit fingerprint, konsiderohen të pranueshme forma të ndryshme fingerprint. Në sistemin COBISS ka një metodë për përcaktimin e identifikuesit fingerprint, e cila gjendet në manualin *Fingerprints = Empreintes = Imprime*. Paris : Institut de Recherche et d'Histoire des Textes në basgkëpunim me National Library of Scotland, 1984.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**010** *NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT (ISBN)*

Fusha përmban Numrin Standard Ndërkombëtar të Librit.

**301** *SHËNIMI PËR NUMRIN E IDENTIFIKIMIT*

Fusha përmban shënimin për identifikuesin fingerprint.

## SHEMBUJ

1.

012	□□	<b>aocon</b> humi nche covn 3 MDLXXX 2fei 5CiZaNSB 0R II F-8°-307 ( <i>Fingerprint për "Opera di Marco Marulo da Spalato Circa L'Institutione del buono e beato vivere". Venecia, 1580. Fingerprint është marrë nga kopja në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare e Zagrebit me numrin e vendit R II F-8°-307, sipas sistemit "Fingerprints = Empreintes = Imprime".</i> )
-----	----	---

2.

012	□□	<b>a165512</b> - al *2 dol : a2 *6 m\$ - bl A r : b2 2E7 \$quid\$ 2stcn 5NeHKB
-----	----	--

*(Fingerprint për Erasmus "Colloquia". Amstelodam, 1655. Fingerprint është marrë nga një kopje në Bibliotekën Mbretërore (Koninklijke Bibliothek), Hagë sipas sistemit të hartuar për Short Title Catalogue (Holandë).)*

3. \*<sup>1</sup>

012 □□ **ajua- r,o, t,ji desa 31800A 2fei 550001 0222182 9030000010**  
*(Fingerprint për antologjinë poetike të Maksimiljan Redeskini "Osem inu shestdeset sveteh pesm ...". V' Lublani, 1800. Fingerprint është marrë nga kopja në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në Lubjanë me numrin e vendit 222182 sipas sistemit "Fingerprints = Empreintes = Impronte".)*

<sup>1</sup> Shembullin e ka përgatitur Biblioteka Kombëtare dhe Universitare në Lubjanë.





## 013 NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I BOTIMEVE MUZIKORE (ISMN)

Kjo fushë përmban Numrin Standard Ndërkombëtar të Botimeve Muzikore dhe shpjegimin, kur regjistrimi ka më shumë se një ISMN. Kjo fushë korrespondon me zonën e Numrit Standard (ose të tjerë) dhe zonën e kushteve të disponueshmërisë në ISBD. Fusha mund të përmbajë kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimin edhe kur nuk ka ISMN.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
013		Numri Standard Ndërkombëtar i Botimeve Muzikore (ISMN)	r
	<b>a</b>	<i>Numri</i>	nr
	<b>b</b>	<i>Shpjegimi</i>	nr
	<b>d</b>	<i>Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi</i>	nr
	<b>z</b>	<i>ISMN e gabuar</i>	r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 013a Numri

Numri i saktë i ISMN-së, përfshirë edhe vizat ndarëse. ISMN-ja përcaktohet nga agjencia kombëtare e ISMN-së.

### 013b Shpjegimi

Shpjegimi për ISMN-në në nënfushën a (nëse ekziston): zakonisht emri i botuesit, lloji i lidhjes së njësisë ose shpjegimi i marrëdhënies së ISMN-së me kompletin ose me një vëllim të veçantë (shih shembujt 1, 2). Kur të bëni shpjegimi në programin COBISS nuk keni nevojë të vendosni kllapat, sepse ato vendosen në mënyrë automatike (shih shembujt 4, 5).

## 013d Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi

Çmimi i njësisë dhe çdo lloj shënimi mbi disponueshmërinë e saj. Nëse regjistrimi përmban edhe fushën 010 – *Numri Standard Ndërkombëtar i Librit (ISBN)* dhe përmbajtja e nënfushës 013d është vetëm përsëritje e përmbajtjes së nënfushës 010d, nënfushën 013d nuk keni nevojë ta plotësoni.

## 013z ISMN e gabuar

ISMN, e identifikuar si e vendosur gabim në një njësi ose e pavlefshme. E njëjta ISMN mund të jetë vendosur në dy botime të ndryshme dhe në këtë rast anulohet, ose mund të jetë shtypur gabim (shih shembullin 3).

# SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

### Struktura e ISMN-së

ISMN-ja përdoret për të identifikuar botimet muzikore, të cilat janë në shitje, jepen me qira, falas ose për të ruajtur të drejtën e autorit, në përputhje me standardin ISO 10957.

Çdo pjesë e veçantë e një njësie, e cila është e disponueshme, duhet të ketë ISMN-në e saj. Numri ISMN përbëhet nga 10 ose 13 shifra. Para numrit gjithmonë ndodhet shkurtesa ISMN. Në vendet ku nuk përdoret alfabeti latin, përkrah shkronjave latine ISMN, mund të shënohet edhe ato në alfabetin cirilik.

ISMN-10 përbëhet nga shkronja M dhe nëntë shifra. ISMN është e ndarë në katër pjesë, dy prej të cilave kanë gjatësi të ndryshueshme, ndërsa mes vete janë të ndara me vizë ose me hapësirë.

- *Elementi dallues*: Shkronja M është elementi dallues midis ISMN-së dhe ISBN-së.
- *Identifikuesi i botuesit*: Përcakton botuesin e një botimi të caktuar muzikor. Numri caktohet për çdo botues nga Agjencia Kombëtare ose Rajonale e ISMN-së.
- *Identifikuesi i njësisë*: Identifikon botimin e një vepre dhe të njësisive të ndryshme brenda saj. Një njësi sipas standardit është pjesë përbërëse e një botimi muzikor, e cila mund të shitet ose gjendet si e veçantë
- *Shifra e kontrollit*: Kjo është shifra në fund të ISMN-së që shërben për të bërë verifikimin automatik të saktësisë së ISMN-së. Kjo llogaritet në bazë të numrave të tjerë

ISMN-13 përbëhet nga 13 shifra. ISMN-së me 10 shifra i shtohet parashtesa (prefiksi) 979; shkronja M zëvendësohet me zero (0). Identifikuesi i botuesit dhe njësisë si dhe shifra e kontrollit janë të njëjtë si të ISMN-10 (shih shembullin 6). ISMN-13 është identike me EAN për muzikën e shtypur.

### Verifikimi i shifrës së kontrollit për ISMN-në me numër 10 shifror dhe 13 shifror

Shifra e kontrollit për ISMN-10 ose ISMN-13 llogaritet sipas modulit 10 dhe vlerat alternative 1 dhe 3 të përcaktuara nga e majta në të djathtë. Për ISMN-10 shkronja M llogaritet si 3.

Kjo do të thotë që çdo njëra prej nëntë shifrave të para të ISMN-10, dhe 12 shifrave të para të ISMN-13 – duke përjashtuar shifrën e kontrollit – shumëzohet në mënyrë alternative me numrat 1 dhe 3 nga e majta në të djathtë. Shuma e përftuar nga mbledhja e produkteve, së bashku me shifrën e kontrollit, duhet të pjesëtohet me 10 pa mbetje.

Shembull për ISMN me numër 10 shifror:

		identifikuesi i botuesit			identifikuesi i njësisë					shifra e kontrollit
ISMN	M	3	4	5	2	4	6	8	0	5
pesha	3	1	3	1	3	1	3	1	3	
rezultati	9	3	12	5	6	4	18	8	0	= 65

Gjithsej:  $65 + 5$  (shifra e kontrollit) = 70

Meqë 70 mund të pjesëtohet me 10 pa mbetje, M-345-24680-5 është një Numër Standard Ndërkombëtar i vlefshëm për botimet muzikore.

Shembull për ISMN-13:

		parashtesa			identifikuesi i grupit			identifikuesi i njësisë					shifra e kontrollit
ISMN	9	7	9	0	3	4	5	2	4	6	8	0	5
pesha	1	3	1	3	1	3	1	3	1	3	1	3	
rezultati	9	21	9	9	3	12	5	6	4	18	8	0	= 95

Gjithsej:  $95 + 5$  (shifra e kontrollit) = 100

Meqë 100 mund të pjesëtohet me 10 pa mbetje, 979-0-345-24680-5 është një Numër Standard Ndërkombëtar i vlefshëm për botimet muzikore.

### Forma e të dhënave

Shkurtesa ISMN, e cila në botim është e shtypur bashkë me numrin, nuk shënohet në fushën 013.

Çdo ISMN, e cila është shtypur gabim në njësi, mund të shënohet në nënfushën 013z – ISMN e gabuar.

Vizat ndarëse përdoren për të bërë ndarjen e pjesëve të veçanta të ISMN-së në nënfushat a dhe z. Përdorimi i shenjave të tjera të pikësimit nuk lejohet. Kur ISBN-ja shfaqet në skedë vendosja e vizave ndarëse ose hapësirave është e detyrueshme. Shumë agjenci kombëtare nuk i vendosin vizat ndarëse apo hapësirat në regjistrime, sepse ato mund të përftoheshin nëpërmjet algoritmit nëse njihen identifikuesit e botuesve. Te shkëmbimi ndërkombëtar i regjistrimeve nuk është e domosdoshme, që pranuesi i regjistrimeve të njohë identifikuesit e botuesit. Prandaj rekomandohet, që për shkak të paraqitjes së saktë vizat ndarëse të shënohen gjithmonë.

Zakonisht, çdo botim muzikor ka një ISMN. Në një regjistrim duhet të vendosen disa ISMN në këto raste,: kur botuesi publikon një vepër në disa lidhje të ndryshme ose forma fizike me ISMN të ndryshme, por të gjitha janë të përfshira në një regjistrim; kur krijohet një regjistrim i vetëm për njësinë me disa vëllime (pjesë) dhe botuesi i ka vendosur çdo vëllim dhe kompletit ISMN të ndryshme; kur një njësi ka disa botues ose shpërndarës, dhe secili nga ata i ka vendosur njësinë ISMN-në e tij.

Kur në regjistrim ndodhen disa ISMN, shtohet shpjegimi për të bërë dallimin midis tyre.

Shpeshherë, çdo ISMN ka kushtet e veta të disponueshmërisë dhe çmimit. Kjo e dhënë shënohet në të njëjtën fushë.

Fusha duhet të përsëritet për çdo ISMN të vlefshme. Ajo duhet të përsëritet edhe për ISBN-në e pavlefshme, përveç nëse kjo ISMN e pavlefshme lidhet qartë me ISMN-në e vlefshme të shënuar në regjistrim; në këtë rast ISMN e pavlefshme vendoset në të njëjtën fushë si ISMN-ja e vlefshme përkatëse (shih shembullin 3).

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 010 NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT (ISBN)

Kjo fushë përmban Numrin Standard Ndërkombëtar të Librit. Nganjëherë është e vështirë të përcaktohet nëse botimi është muzikë e shtypur ose libër “i zakonshëm” apo të dyja. Në këto raste mund të caktohen të dyja, ISMN dhe ISBN.

### 011 ISSN

Vetëm disa botime muzikore dalin si periodik, ndërsa shumë prej tyre botohen në seri. Në të tilla raste duhet të caktohet ISSN-ja për titullin e serisë dhe ISMN-ja për çdo njësi në seri.

## SHEMBUJ

1.

013	uu	aM-706700-00-7 b(HDS)
013	uu	aM-706701-00-4 b(MIC)
<i>(Njësia është botuar nga Hrvatsko drustvo skladatelja dhe Muzicki informativni centar.)</i>		

2.

013	uu	aM-9005202-2-7 b(bound)
013	uu	aM-9005202-3-4 b(pbk)
<i>(Botimi është i disponueshëm me kapak të trashë dhe të hollë.)</i>		

3.

013	uu	aM-9005202-1-0 zM-9005202-1-X
<i>(ISMN-ja M-9005202-1-0 është shtypur gabim me X si numër kontrolli.)</i>		

4. \*

013	uu	aM-008-04847-0 bSämtliche Werke
013	uu	aM-008-04848-7 bViolinkonzert

5. \*

013	uu	aM-001-11420-2 bBd. 7,1
013	uu	aM-001-12205-4 bBd. 7,2
013	uu	aM-001-12620-5 bBd. 7,3

6. \*

013	uu	a979-0-571-10051-3
<i>(ISMN-të 10 shifrore të papërdorura (p.sh. ISMN M-571-10051-3), botuesit mund t'i përdorin në formën e re 13 shifrore. Shifra e kontrollit i ISMN-së 10 dhe 13 shifrore është i njëjtë.)</i>		

## 016 KODI STANDARD NDËRKOMBËTAR I REGJISTRIMIT (ISRC)

Fusha përmban Kodin Standard Ndërkombëtar të Regjistrimit dhe shpjegiminin, kur regjistrimi bibliografik ka disa ISRC. ISRC identifikon regjistrimet zanore dhe regjistrimet muzikore në video, por jo produktet fizike dhe është në harmoni me sistemet ekzistuese me shifra (EAN, numri i botuesit).

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
016		Kodi Standard Ndërkombëtar i Regjistrimit (ISRC)	r
	<b>a</b>	<i>Numri</i>	nr
	<b>b</b>	<i>Shpjegimi</i>	nr
	<b>z</b>	<i>ISRC e gabuar</i>	r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 016a Numri

Numri i saktë i ISRC-së, përfshirë edhe vizat ndarëse. ISRC-ja përcaktohet nga institucioni i autorizuar i një vendi. Nënfusha është e detyrueshme, përpos nëse ISRC është shënuar në nënfushën z.

### 016b Shpjegimi

Shpjegimi për ISRC-në në nënfushën a (nëse ekziston): zakonisht shpjegimi i marrëdhënies së ISRC-së me format e caktuara shprehëse.

### 016z ISRC e gabuar

ISRC, e cila është përdorur gabimisht në një regjistrim të caktuar, ose është e pavlefshme në ndonjë mënyrë tjetër. E njëjta ISRC mund të jetë vendosur në dy botime të ndryshme dhe në këtë rast anulohet, ose mund të jetë shtypur gabim.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

### Struktura e ISRC-së

ISRC përdoret për të identifikuar regjistrimet zanore, video ose audiovizuale, në përputhje me rregullat e ISO 3901.

Çdo pjesë e veçantë e një botimi, që është e disponueshme, duhet të ketë ISRC-në e saj. Numri i ISRC-së përbëhet nga 12 shifra. Para numrit gjithmonë ndodhet shkurtesa ISRC. Në vendet ku nuk përdoret alfabeti latin, përkrah shkronjave latine ISRC, mund të shënohet edhe ato në alfabetin cirilik.

ISRC është përbëhet nga katër pjesë, të cilat mes vete janë të ndara me viza. Më herët ISRC kishte pesë pjesë, ndërsa tani pjesa e katërt dhe e pestë janë bashkuar.

- *Kodi i shtetit:* Kodi i përbërë nga dy shkronja, i ndarë nga ISO 3166-1.
- *Kodi i regjistruerit:* Kodi i përbërë nga tri karaktere, të cilin e ndajnë institucionet e autorizuara.
- *Viti:* Dy shifrat e fundit të vitit, që kanë të bëjnë me vitin kur regjistrimi ka marrë numrin ISRC.
- *Kodi i regjistrimit:* Përbëhet nga pesë shifra, të cilat i cakton regjistruesi.

### Forma e të dhënave

Shkurtesa ISRC, e cila në botim është e shtypur bashkë me numrin, nuk shënohet në fushën 016.

ISRC e gabuar shënohet në nënfushën 016z – ISRC e gabuar.

Vizat ndarëse ndajnë pjesët e veçanta të ISRC-së në nënfushat a dhe z. Përdorimi i shenjave të tjera të pikësimit nuk lejohet.

Kur në regjistrim ndodhen disa ISCR, shtohet shpjegimi për të bërë dallimin midis tyre.

Fusha duhet të përsëritet për çdo ISCR të vlefshme. Ajo duhet të përsëritet edhe për ISCR-në e pavlefshme, përveç nëse kjo ISCR e pavlefshme lidhet qartë me ISCR-në e vlefshme të shënuar në regjistrim; në këtë rast ISCR e pavlefshme vendoset në të njëjtën fushë si ISCR-ja e vlefshme përkatëse

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 010** NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT (ISBN)
- 011** ISSN
- 071** NUMRI I BOTUESIT

## SHEMBUJ

1.

016	□□	aFR-Z03-91-01231
<i>(ISRC në katër pjesë, e cila në vitin 1991 i është ndarë fonogramit francez.)</i>		

## 017 IDENTIFIKUES TË TJERË

Kjo fushë përmban identifikuesin e botuar në njësi, i cili nuk i përket asnjë fushe tjetër dhe shpjgimin, i cili bën përcaktimin shtesë të identifikuesit, kur në regjistrim janë disa. Fusha korrespondon me zonën e numrit standard (ose tjetër) dhe kushteve të disponueshmërisë në ISBD. Fusha mund të përmbajë kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimin, edhe nëse nuk përmban identifikuesin.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
017	Identifikues të tjerë	r
<b>a</b>	<i>Identifikuesi</i>	nr
<b>b</b>	<i>Shpjgimi</i>	nr
<b>d</b>	<i>Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi</i>	nr
<b>z</b>	<i>Identifikuesi i gabuar</i>	r
<b>2</b>	<i>Kodi i sistemit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 017a Identifikuesi

Identifikuesi; forma varet nga sistemi nga i cili është përcaktuar.

### 017b Shpjgimi

Shpjgimi për identifikuesin në nënfushën a (nëse ekziston): zakonisht emri i botuesit, lloji i lidhjes së kopjes ose shpjgimi i marrëdhënies së identifikuesit me kompletin ose me një vëllim të veçantë.

### 017d Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi

Çmimi i njësisë dhe çfarëdo shënimi për disponueshmërinë e saj.

## 017z Identifikuesi i gabuar

Është identifikuesi i vendosur gabim në njësi ose është i pavlefshëm në ndonjë mënyrë tjetër. Gjithashtu mund të jetë vendosur në dy botime të ndryshme dhe në këtë rast anulohet, ose mund të jetë shtypur gabim.

## 0172 Kodi i sistemit

Kodi i sistemit, nga i cili është përcaktuar identifikuesi.

<b>doi</b>	<i>identifikuesi digjital i objektit</i>
<b>hdl</b>	<i>handle</i>
<b>isan</b>	<i>numri standard ndërkombëtar i materialit audiovizual</i>

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në nënfushën 2 vendoset kodi i sistemit, nga i cili është përcaktuar identifikuesi.

DOI® – Digital Object Identifier (Identifikuesi Digjital i Objektit) është sistem për identifikimin funksional dhe të vazhdueshëm si dhe për menaxhimin e përmbajtjes intelektuale dhe meta-të dhënave në rrjetet digjitale. Identifikuesi DOI është varg karakteresh që përcakton entitetin unik brenda sistemit DOI.

ISAN – International Standard Audiovisual Number (Numri Standard Ndërkombëtar i Materialit Audiovizual) është sistem për identifikimin e veprës audiovizuale, e cila ndërtohet nga imazhet lëvizëse, të shoqëruara ose jo me tingull. Në këtë rast nuk është e rëndësishme se në çfarë forme fizike vepra shpërndahet. Versionin e caktuar të veprës audiovizuale e identifikon V-ISAN – International Standard Audiovisual Number (ISAN) – Version identifier (Numri standard ndërkombëtar i materialit audiovizual – identifikuesi i versionit).

Hdl – Handle është sistem për identifikimin e përhershëm të objekteve digjitale ose burimeve të atyre organizatave, të cilat janë të regjistruara në Handle.Net Registry. Administratori për ndarjen e parashtesave është organizata CNRI – Corporation for National Research Initiatives. Në sistemin Handle System bazohet edhe DOI.

### Struktura DOI

Struktura DOI bazohet në standardin ISO 26324:2012.

DOI ndërtohet nga parashtesat dhe prapashtesat, të cilat i ndan viza e pjerrët (slash) "/", p.sh. 10.1000/12345.

Parashtesa (p.sh. 10.1000) është e përbërë nga dy pjesë të ndara me pikë. Pjesa e parë "10" është numri i direktorisë dhe është i njëjtë te të gjithë identifikuesit DOI. Pjesa e dytë (p.sh. 1000) është një varg numrash që i ndahen organizatës, e cila dëshiron të regjistroj DOI-n. Pjesa e dytë e parashtesës mund të jetë i ndarë më tej, dhe pjesët e tjera në vazhdim ndahen me pikë (p.sh. 1000.10). Nuk ka kufizime në numrin e karaktereve të DOI-t që mund të kërkojë një agjenci regjistrimi. Parashtesa e DOI-t nuk ofron të dhëna për pronësinë, të drejtat dhe administrimin me pronën intelektuale.

Parashtesa pas vizës së pjerrët "/" ndiqet nga prapashtesa unike (p.sh. 12345), e cila përcakton entitetin. Kombinimi i parashtesës, që përcakton regjistruesin dhe prapashtesës unike, të cilën regjistruesi e për zgjedh vet, përjashton nevojën për menaxhimin e centralizuar të identifikuesve DOI.



Prapashtesa mund të jetë një numër i njëpasnjëshëm ose përfshin një identifikues nga një sistem tjetër, p.sh. ISBN, ISSN, PII, SICI ... (shih shembujt 1, 2). Identifikuesit ekzistues dhe/ose të dhënat bibliografike të përdorura për prapashtesë, nuk kanë ndonjë kuptim të veçantë brenda sistemit DOI.

### Struktura ISAN

ISAN është sistem i numërtimit i bazuar në standardin ISO 15706:2002 dhe ISO 15706-2:2007 për V-ISAN.

ISAN mund të jetë 17 ose 26 shifror.

Identifikuesi ISAN 17 shifror përbëhet nga 16 shifra heksadecimale (karakteret: 0 deri 9 dhe A deri F) të ndara në dy segmente dhe shifra e kontrollit. Pas segmentit të parë, i cili përmban 12 karaktere për veprën kryesore, vijon segment i dytë me 4 karaktere për episodet. Kur vepra nuk është episod, për plotësim përdoren zerot (karakteret: 0 deri 9 dhe A deri Z).

Përveç identifikuesit ISAN 17 shifror, ISAN (V-ISAN) 26 shifror e përbëjnë edhe 8 shifrat heksadecimale, që tregojnë versionin. Në fund ndodhet shifra alfanumerike e kontrollit.

Shembull ISAN 1881-66C7-3420-0000-7-9F3A-0245-U:

	vepra kryesore												episodi				sh.k.	versioni					sh.k.										
ISAN	1	8	8	1	-	6	6	C	7	-	3	4	2	0	-	0	0	0	0	-	7	-	9	F	3	A	-	0	2	4	5	-	U

Parashtesa ISAN dhe shifra e kontrollit si karakteri i 17-të (dhe si karakteri i 26-të kur identifikuesit ISAN i shtohet edhe numri i versionit) janë gjithmonë të pranishme kur ISAN shfaqet në formën e lexueshme. Çdo grup prej 4 shifrash heksadecimale si dhe shifra e kontrollit ndahen me viza ndarëse ose hapësira.

V-ISAN është një kombinim i numrit standard ndërkombëtar i veprës audiovizuale (ISAN) dhe numrave shtesë të versionit (shih shembullin 3).

### Struktura Handle

Sistemi Handle është përcaktuar në dokumentet RFC 3650, 3651 dhe 3652 të grupit Internet Engineering Task Force (IETF) dhe ka për qëllim zgjidhjen e URL-ve me ndihmën e regjistrimit qendror Handle.Net Registry.

Treguesi handle përbëhet nga parashtesa dhe prapashtesa, të cilat i ndanë viza e pjerrët "/", p.sh. 20.1000/100.

Parashtesa tregon organizatën për emërimin. Nëse parashtesa përbëhet nga disa pjesë, ato janë të ndara me pikë dhe përfaqësojnë disa segmente në hierarkinë e organizatës për emërimin. Çdo parashtesë e treguesit handle fillon me "20" dhe prezanton organizatën CNRI – Corporation for National Research Initiatives, pas së cilës vije kodi i organizatave të regjistruara në Handle.Net Registry (shih shembujt 4, 5). Parashtesa mund të jetë e përbërë nga të gjitha kodet nga Unicode UCS-2, me përjashtim të kodit "/".

Pas parashtesës vjen viza e pjerrët dhe më pas prapashtesa, e cila tregon emrin lokal të burimit. Prapashtesa mund të përbëhet nga të gjitha kodet Unicode UCS-2.

### Forma e të dhënave

Shkurtesa e sistemit, e cila në njësi zakonisht është e shtypur së bashku me identifikuesin, në fushën 017 nuk shënohet.

Çdo tregues, që në njësi është i shtypur gabim, mund të shënohet nënfushën 017z – *Identifikuesi i gabuar*.

Vizat ndarëse ose viza e pjerrët vendoset në nënfushat a dhe z për të ndarë pjesët e ndryshme të identifikuesit.

Në mënyrë që të bëhet dallimi ndërmjet identifikuesve, kur në regjistrim janë disa, mund të vendoset shpjegimi.

Identifikuesit shpesh kanë kushtet e tyre të disponueshmërisë dhe çmimin. Prandaj, kjo e dhënë shënohet në të njëjtën fushë.

Fusha duhet të përsëritet për çdo identifikues të vlefshëm. Ajo duhet të përsëritet edhe identifikuesin e pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur ky identifikues i pavlefshëm lidhet qartë me një identifikues të vlefshëm, që ndodhet në regjistrim. Në këtë rast, identifikuesi i pavlefshëm vendoset në të njëjtën fushë me identifikuesin e vlefshëm.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 010**    *NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT (ISBN)*
- 011**    *ISSN*
- 013**    *NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I BOTIMEVE MUZIKORE (ISMN)*
- 020**    *NUMRI I BIBLIOGRAFISË KOMBËTARE*
- 021**    *NUMRI I KOPJES SË DETYRUAR*
- 022**    *NUMRI I BOTIMIT ZYRTAR*
- 040**    *CODEN*
- 041**    *KODE TË TJERA\**
- 071**    *NUMRI I BOTUESIT*

Këto fusha përdoren për numra të veçantë e.

## SHEMBUJ

1. \* COBISS.net

017    □□    **a10.3359/oz0702058 2doi**  
*(DOI për artikullin e botuar në "Organizacija znanja".)*

2. \* COBISS.net

017    □□    **a10.4567/0028-0836(18770503)16:392 2doi**  
*(Për shkak se botuesi përdor SICI "0028-0836(18770503)16:392", atë e ka zgjedhur si prapashtesë në DOI.)*

3. \* COBISS.net

017    □□    **a0000-0000-7570-0000-F-0000-0001-R 2isan**  
*(V-ISAN për videoregjistrimin e titulluar "Princeza i goblin".)*

4. \* COBISS.net

017    □□    **a20.1000/100 2hdl**  
*(Handle "20.1000/100" është tregues për licencën e programit Handle.Net. Parashtesa 20.1000 në këtë rast prezanton vetëm organizatën Handle.Net dhe është e ndërtuar nga simbolet për organizatën kryesore dhe organizatën vartëse. Organizata kryesore është CNRI, ndërsa 1000 tregon organizatën vartëse për emërimin. Prapashtesa 100 është emri lokal brenda kësaj hapësire emrash.)*

## 5. \* COBISS.net

017	□□	<b>a20.500.12556/DiRROS-13864 2hdl</b>
017	□□	<b>a20.500.12556/dirros/50967165-baf4-47ee-8926-184895760f98 2hdl</b> <i>(Shembulli "20.500.12556/DiRROS-13864" është treguesi handle për regjistrimin e meta të dhënave të burimit, i cili është përfshir në repositorët DiRROS. Treguesi handle "20.500.12556/dirros/50967165-baf4-47ee-8926-184895760f98" i është caktuar burimit. Parashtesën 20.500.12556 e përbën pjesa 20.500, që përfaqëson përdoruesit e regjistruar të sistemit Handle, dhe pjesa 12556, që i është caktuar repositorit të shkencës së hapur në Slloveni.)</i>



## 020 NUMRI I BIBLIOGRAFISË KOMBËTARE

Kjo fushë përmban numrin, të cilin institucioni kombëtar bibliografik i ndanë njësisë bibliografike në bibliografinë kombëtare, dhe kodin për shtetin e këtij institucioni.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
020	Numri i bibliografisë kombëtare	r
<b>a</b>	<i>Kodi i shtetit</i>	nr
<b>b</b>	<i>Numri</i>	nr
<b>z</b>	<i>Numri i gabuar</i>	r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

---

### 020a Kodi i shtetit

Shteti i bibliografisë kombëtare.

---

### 020b Numri

Numri, të cilin e ndanë institucioni kombëtar bibliografik.

---

### 020z Numri i gabuar

Numri, i cili i është ndarë gabim njësisë bibliografike (shih shembullin 2).

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Numri i bibliografisë kombëtare shënohet në nënfushën b në të njëjtën formë siç e ka ndarë institucioni bibliografik, duke përfshirë hapësirat, vizat dhe shenjat e tjera të pikësimit. Kodi i shtetit vendoset në nënfushën a sipas standardit ISO 3166

Numrin e gabuar mund ta shënoni në nënfushën z. Kur dihet vetëm numri i gabuar, plotësohet vetëm nënfusha a dhe z.

Në sistemin COBISS.SI fushën e plotëson vetëm Biblioteka Kombëtare dhe Universitare. Në nënfushën a përdoret kodi "SI" – *Slovenia*, ndërsa në nënfushën b kodet nga lista lokale e kodeve e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare.

## SHEMBUJ

1.

020	uu	<b>aAU b67-6</b> <i>(Numër i bibliografisë kombëtare australiane.)</i>
-----	----	---

2.

020	uu	<b>aCA bCM73-6722XF</b>
020	uu	<b>aCA zCM78-6722XF</b> <i>(Numri i saktë dhe i gabuar i bibliografisë kanadeze.)</i>

3.

020	uu	<b>aDD b83,A16,0553</b>
020	uu	<b>aDD b82,N46,0092</b> <i>(Regjistrimi për njësinë në "Deutsche Bibliographie" përmban fushën e përsëritshme 020, sepse njësia është shfaqur dy here në bibliografi; version i parë i regjistrimit ka qenë regjistrimi CIP. Megjithëse regjistrimi që përmban fushat e përsëritshme është thjesht një përmirësim i regjistrimit CIP, ai përmban edhe numrin e mëparshëm, sepse në këtë institucion katalogojnë në këtë mënyrë.)</i>

4.

020	uu	<b>aGB bB81-15605</b> <i>(Numër nga "British National Bibliography".)</i>
-----	----	--

5. \*

020	uu	<b>aSI bM1998K1</b> <i>(Numër nga bibliografia sllovene e librave.)</i>
-----	----	--

## 021 NUMRI I KOPJES SË DETYRUAR

Fusha përmban numrin, të cilin njësisë ia ndan institucioni përgjegjës për kopjen e detyruar ose agjencia e të drejtës së autorit e shtetit të caktuar.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
021		Numri i kopjes së detyruar
	<b>a</b>	<i>Kodi i shtetit</i>
	<b>b</b>	<i>Numri</i>
	<b>z</b>	<i>Numri i gabuar</i>
		r
		nr
		nr
		r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 021a Kodi i shtetit

Shteti i institucionit, i cili ndan numrin e kopjes së detyruar.

### 021b Numri

Numri, të cilin e ndan institucioni.

### 021z Numri i gabuar

Numri, i cili i është ndarë gabimisht njësisë.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Numri i kopjes së detyruar shënohet në atë formë që e ka ndarë institucioni, duke përfshirë hapësirat, vizat dhe shenjat e tjera të pikësimit. Në nënfushën a vendoset kodi i shtetit sipas standardit ISO 3166.

Numrin e gabuar mund ta shënoni në nënfushën z. Kur dihet vetëm numri i gabuar, plotësohet vetëm nënfusha a dhe z.

**SHEMBUJ**

1.

021	□□	<b>aUS bA68778</b> <i>(Numër i kopjes së detyruar në SHBA.)</i>
-----	----	--

2. \*

021	□□	<b>asvn b9902853</b> <i>(Numër i kopjes së detyruar në Slloveni.)</i>
-----	----	--



## 022 NUMRI I BOTIMIT ZYRTAR

Kjo fushë përmban numrin, të cilin institucioni zyrtar i ndan botimit, të cilin e ka botuar vet ose është botuar në emër të tij.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
022		Numri i botimit zyrtar r
	<b>a</b>	<i>Kodi i shtetit</i> nr
	<b>b</b>	<i>Numri</i> nr
	<b>z</b>	<i>Numri i gabuar</i> r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 022a Kodi i shtetit

Shteti, në të cilin është botuar dokumenti.

### 022b Numri

Numri, të cilin e ndan institucioni zyrtar.

### 022z Numri i gabuar

Numri, i cili i është ndarë gabim botimit zyrtar.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret për numrat e dokumenteve zyrtare në të gjitha nivelet. Mund të përdoret për botimet e çdo niveli qeveritar dhe për organizatat ndërkombëtare e ndërqeveritare. Në nënfushën a vendoset kodi i shtetit sipas standardit ISO 3166. Për botimet e organizatave ndërkombëtare ose ndërqeveritare, nënfusha a nuk plotësohet (shih shembullin 4).

Numri shënohet në atë formë siç është në dokument, përfshirë hapësirat, presjet dhe shenjat e tjera të pikësimit. Numri i gabuar mund të futet në nënfushën z. Kur njihet vetëm numri i gabuar fusha do të përmbajë vetëm nënfushat a dhe z.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 100f** *TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIMIN, Kodi për botimin zyrtar*  
E dhëna tregon se bëhet fjalë për botimin zyrtar dhe llojin e institucionit, që ka botuar atë.

## SHEMBUJ

1.

022	uu	<b>aZA bRP64/77</b> (Numër i botimit zyrtar të Afrikës së Jugut.)
-----	----	--

2.

022	uu	<b>aUS bhE17.302.W58/91</b> (Botim zyrtar i SHBA-së.)
-----	----	--

3.

022	uu	<b>aGB bECC.56/81</b> (Botim i Essex County Council, Kombet e Bashkuara.)
-----	----	--

4.

022	uu	<b>bPGI/81/WS/22</b> (Botim i UNESCO-s.)
-----	----	---

5. \*

022	uu	<b>ausa bI 49.6/2:F 52/8/PACK</b> (Botim zyrtar i SHBA-së.)
-----	----	--

6. \*

022	uu	<b>asvn bRUJV-RP-022</b> (Numër i botimit zyrtar të Sllovenisë.)
-----	----	---

## 040 CODEN

Kjo fushë përmban një kod unik, të cilin Shërbimi Ndërkombëtar CODEN e ndan për serialet.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
040	CODEN	r
	<b>a</b> <i>CODEN</i>	nr
	<b>z</b> <i>CODEN i gabuar</i>	r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 040a CODEN

Kod i përbërë nga gjashtë karaktere, ku karakteri i fundit është një shifër alfanumerike.

### 040z CODEN i gabuar

CODEN, i cili në njësinë e caktuar është përdorur gabim ose është e pavlefshme në ndonjë mënyrë tjetër. I njëjti CODEN mund të jetë vendosur në dy botime të ndryshme dhe në këtë rast anulohet, ose mund të jetë shtypur gabim.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

CODEN është një kod i përbërë nga gjashtë karaktere, të cilin Shërbimi Ndërkombëtar CODEN e ndan për serialet nga fusha e shkencës dhe teknologjisë.

Pesë karakteret e para të CODEN janë shkronja dhe bazohen në titullin e serialit, ndërsa karakteri i fundit është shifra e kontrollit, shkronjë ose numër, p.sh. JACSAT është kodi për *Journal of the American Chemical Society*, ku T është shifra e kontrollit.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 011 ISSN

Numër identifikues, i cili gjithashtu u ndahet serialeve.

## SHEMBUJ

1.

040	□□	<b>aANPYA2</b> (CODEN për "Annalen der Physik".)
-----	----	---

2.

040	□□	<b>aJPHYA7</b> (CODEN për "Journal of Physiology", London.)
-----	----	--

3.

040	□□	<b>aKREBAG</b> (CODEN për "Krebsarzt".)
-----	----	--

## 041 KODE TË TJERA\*

Në këtë fushë mund të shënoni çdo kod tjetër të serialeve, përveç CODEN dhe ISSN.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
041		Kode të tjera*	r
	<b>a</b>	<i>Kodi</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 041a Kodi

Shënohet kodi, i cili i është ndarë serialit.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha është marrë nga baza e të dhënave e ISSN-së. Shfaqet në regjistrimet e marra në mënyrë automatike nga baza e ISSN-së.

## SHEMBUJ

1.

041	□□	<b>a</b> NU053
200	1□	<b>a</b> Bulletin of the International Bureau of Education



## 071 NUMRI I BOTUESIT

Fusha përmban numrin e botuesit, të cilin nuk e përcakton asnjë standard ndërkombëtar dhe zakonisht përdoret për regjistrimet zanore, materialet muzikore të shtypura, videoregjistrimet dhe burimet elektronike. Fusha i përshtatet zonës së numrit standard (ose tjetër) dhe kushteve të disponueshmërisë në ISBD. Fusha mund të përmbajë kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimin, edhe nëse nuk përmban numrin e botuesit.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
071	Numri i botuesit	r
<b>a</b>	<i>Numri</i>	nr
<b>b</b>	<i>Burimi</i>	nr
<b>c</b>	<i>Shpjegimi</i>	nr
<b>d</b>	<i>Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi</i>	nr
<b>z</b>	<i>Numri i gabuar i botuesit</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Lloji i numrit të botuesit</i></b>
	0	<i>Numri i botimit (regjistrim zanor)</i>
	1	<i>Numri i modelit (regjistrim zanor)</i>
	2	<i>Numri i pllakës (materiale muzikore të shtypura)</i>
	3	<i>Numër tjetër (materiale muzikore të shtypura)</i>
	4	<i>Numri i videoregjistrimit</i>
	5	<i>Lloji tjetër i numrit të botuesit</i>
	6	<i>Numri i burimit elektronik (p.sh. CD-ROM)</i>
2		<b><i>Tregues i shënimit</i></b>
	0	<i>Shënimi nuk shfaqet</i>
	1	<i>Shënimi shfaqet</i>

Treguesi i parë tregon llojin e numrit të botuesit në fushë.

Treguesi i dytë tregon nëse nga fusha shfaqet shënimi apo jo. Nëse shfaqja e shënimit nuk është e nevojshme (p.sh. sepse të dhënat janë shënuar edhe në fushën 300 ose 301, vlera e treguesit duhet të jetë "0" (shih shembullin 3).

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 071a Numri

Numri, të cilin e ka ndarë botuesi.

---

## 071b Burimi

Botuesi, i cili ka ndarë numrin.

---

## 071c Shpjegimi

Përdoret për dallimin e numrave të botuesve, nëse regjistrimi përmban disa numra.

---

## 071d Kushtet e disponueshmërisë dhe/ose çmimi

Çmimi i njësisë dhe cilido shënim për disponueshmërinë e saj.

---

## 071z Numri i gabuar i botuesit

Numri i botuesit, i cili në njësinë e caktuar të materialit është përdorur gabim ose në një mënyrë tjetër është i pavlefshëm. Mund të jetë gjithashtu numri, i cili i është ndarë dy botimeve të ndryshme dhe më pas është anuluar, ose ka qenë i shtypur gabimisht.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Numrin e botimit (shih shembujt 1, 7) botuesi e ndan për regjistrimin zanor, ekzekutimin e veçantë muzikor në një regjistrim zanor ose në një grup regjistrimesh zanore të botuara si komplet. Numri i botimit zakonisht është i shtypur në tiketë dhe shpesh në paketim. Te kompletet numrat e botimit mund të jenë në çdo kopje, ndërsa numri shtesë për kompletin në paketimin e përbashkët.

Numri i modelit përdoret për identifikimin e modelit, nga i cili është prodhuar regjistrimi i veçantë dhe zakonisht shtypet në pllakën e diskut. Ky numër mund të përdoret për identifikimin e regjistrimit zanor kur mungon numri i botimit.

Numri i pllakës (shih shembujt 2, 3) është një numër serie i përcaktuar nga botuesi për një material muzikor të shtypur. Zakonisht është i shtypur në fund të çdo faqeje të botimit dhe ndonjëherë edhe në faqen e titullit.

Numra të tjerë të botuesit (shih shembullin 4) janë numra të ngjashëm me numrat e pllakave, por nuk shfaqen në çdo faqe të botimit. Ata mund të jenë në faqen e titullit, në kapak, dhe/ose në faqen e parë të materialit muzikor të shtypur.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 010**    *NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT (ISBN)*
- 011**    *ISSN*
- 013**    *NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I BOTIMEVE MUZIKORE (ISMN)*



**016** KODI STANDARD NDËRKOMBËTAR I REGJISTRIMIT (ISRC)

**017** IDENTIFIKUES TË TJERË

**301** SHËNIMI PËR NUMRIN E IDENTIFIKIMIT

Në fushën 301 shënohen numrat e pastrukturuar të botuesit. Nëse forma e numrit në fushën 071 është e pështatshme për shfaqjen e shënimit, vlera e treguesit të dytë është "1" dhe shënimi do të shfaqet. Në të kundërtën vlera e treguesit është "0" dhe shënimi bëhet në fushën 301.

## SHEMBUJ

1.

071	01	<b>a</b> STMA 8007 <b>b</b> Tamla Motown (Numër botimi për regjistrimin zanor të botuesit Tamla Motown. Si shënim shfaqet përmbajtja e të dyja nënfushave.)
-----	----	--

2.

071	21	<b>a</b> A 880 V <b>b</b> Ars Viva Verlag (Numri i pllakës për materialin muzikor.)
-----	----	--

3.

071	20	<b>a</b> B. & H. 8797 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
071	20	<b>a</b> B. & H. 8798 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
071	20	<b>a</b> B. & H. 8799 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
071	20	<b>a</b> B. & H. 8800 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
071	20	<b>a</b> B. & H. 8801 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
301	□□	<b>a</b> Plate no.: B. & H. 8797-8801 (Disa numra të pllakave për materialet muzikore të shtypura. Fushat 071 nuk shfaqen (vlera e treguesit 2 është "0") dhe në vend të kësaj në fushën 301 bëhet shënimi i përbashkët.)

4.

071	31	<b>a</b> N.M. 170 <b>b</b> Nova Music (Numri i botuesit për materialet muzikore të shtypura.)
-----	----	--

5.

071	41	<b>a</b> 990103 <b>b</b> TAG films production <b>c</b> oîte
200	1□	<b>a</b> Sculptez vos cuisses et vos fessiers <b>b</b> Images animées <b>f</b> Catherine Jeannin, Alain Derenne, réal. <b>g</b> Nancy Marmorat, concept., présent. <b>g</b> Sandra Macedo, voix (Numri i botuesit për videoregjistrimin.)

6.

071	61	<b>a</b> SLES 51203 <b>b</b> PlayStation 2
200	1□	<b>a</b> Enter the Matrix <b>b</b> Ressource électronique <b>f</b> written and directed by the Wachowski brothers <b>g</b> developed by Shiny entertainment (Numri i botuesit për botimin elektronik.)

7. \*

071	01	<b>a</b> 104527 <b>b</b> ZKP RTS
200	0□	<b>a</b> Klavirske skladbe <b>b</b> Zvočni posnetek

*(Numri i botuesit për regjistrimin zanor botuar nga Založbe kaset in plošč RTV Slovenija)*

8. \*

071	41	<b>a</b> 901126bRTV Slovenija
200	1□	<b>a</b> Slavnostni koncert ob petisedemdesetletnici Slovenske akademije znanosti in umetnostibVideoposnetek dGala concert on the occasion of the seventy-fifth anniversary of the Slovenian Academy of Sciences and Arts frežiserka Urška Žnidaršič gglavni kamerman Rok Škodlargkamermani Mirko Čavničar ... [et al.] <i>(Numri i botuesit për videoregjistrimin.)</i>

---

# 1XX BLOKU I TË DHËNAVE TË KODUARA

## LISTA E FUSHAVE

- 100 Të dhënat e përgjithshme për përpunimin
- 101 Gjuha e njësisë
- 102 Shteti i botimit ose i prodhimit
- 105 Materiali tekst monografik
- 106 Materiali tekst - përshkrimi fizik
- 110 Burimet në vazhdim
- 115 Projektionet pamore, videoregjistrimet dhe filmat
- 116 Materialet grafike
- 117 Objektet tridimensionale dhe reale
- 120 Materialet hartografike - të dhëna të përgjithshme
- 121 Materialet hartografike – përshkrimi fizik
- 122 Periudha kohore e përmbajtjes së njësisë
- 123 Materialet hartografike – shkalla dhe koordinatat
- 124 Materialet hartografike - përcaktimi specifik i materialit
- 125 Regjistrimet zanore dhe materialet muzikore të shtypura
- 126 Regjistrimet zanore - përshkrimi fizik
- 127 Kohëzgjatja e regjistrimeve zanore dhe e kompozimit në muzikë
- 128 Ekzekutimet muzikore dhe partiturat
- 130 Mikroformat - përshkrimi fizik
- 135 Burimet elektronike
- 140 Antikuarët – të përgjithshme
- 141 Antikuarët – karakteristikat e kopjes

Në formatin UNIMARC disa fusha të bllokut 1XX nuk ndahen në nënfusha të tjera, por kodet vendosen në vendet e përcaktuara paraprakisht në nënfushën a. Në formatin COMARC këto fusha ndahen në nënfusha të tjera.



## 100 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIMIN

Kjo fushë përmban të dhëna të koduara, të cilat kanë të bëjnë me regjistrimet e materialeve të çdo lloji.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
100	Të dhënat e përgjithshme për përpunimin	nr
<b>b</b>	<i>Lloji i vitit të botimit</i>	nr
<b>c</b>	<i>Viti i botimit 1</i>	nr
<b>d</b>	<i>Viti i botimit 2</i>	nr
<b>e</b>	<i>Kodi për kategorinë e publikut</i>	nr
<b>f</b>	<i>Kodi për botimin zyrtar</i>	nr
<b>g</b>	<i>Kodi për regjistrimin e modifikuar</i>	nr
<b>h</b>	<i>Gjuha e katalogimit</i>	nr
<b>i</b>	<i>Kodi për transliterimin</i>	nr
<b>l</b>	<i>Shkrimi i titullit të saktë</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 100b Lloji i vitit të botimit

Kodi shpjegon llojin e datave të shënuara në nënfushën *c* – *Viti i botimit 1* dhe nënfushën *d* – *Viti i botimit 2*. Shënohet këto kode:

<b>a</b>	<i>burim në vazhdim që vazhdon të botohet</i> Nënfusha <i>c</i> përmban vitin e fillimit të botimit, ndërsa nënfusha <i>d</i> "9999" (shih shembujt 1, 17). Nëse viti i fillimit nuk dihet saktë, në vend të numrave shënoni "?" (shih shembullin 2).
<b>b</b>	<i>burim në vazhdim që nuk botohet më</i> Nënfusha <i>c</i> përmban vitin e fillimit të botimit, ndërsa nënfusha <i>d</i> vitin e përfundimit të botimit (shih shembujt 3, 18). Nëse viti i fillimit ose i përfundimit nuk dihet saktë, në vend të numrave shënoni "?".
<b>c</b>	<i>burim në vazhdim me status të panjohur</i> Nuk dihet, nëse botimi do të vazhdojë të botohet ose jo. Ky kod përdoret kryesisht për katalogimin retrospektiv, kur nuk dihet nëse botimi është mbyllur përfundimisht apo përkohësisht. Nënfusha <i>c</i> përmban vitin e fillimit të botimit, ndërsa nënfusha <i>d</i> "?????" (shih shembujt 4, 19). Nëse viti i fillimit nuk dihet saktë, në nënfushën <i>c</i> në vend të numrave shënoni "?".
<b>d</b>	<i>monografi që ka dalë e plotë ose brenda një viti kalendarik</i>

	<p>Botim në një vëllim ose në disa vëllime, të botuara njëherësh ose me të njëjtin vit botimi, p.sh. botuar në të njëjtin vit kalendarik.</p> <p>Nënfusha c përmban vitin e botimit, ndërsa nënfusha d nuk plotësohet (shih shembullin 5), pos në rastet kur në botim është shtypur gabim viti. Në këtë rast duhet të gjeni vitin e saktë të botimit dhe ta shënoni në nënfushën c; ndërsa vitin e gabuar e shënoni në nënfushën d (shih shembullin 21).</p> <p>Kodi përdoret edhe për vitin e dyshimtë të botimit (shih shembullin 5). Nëse dihet vetëm periudha në të cilën është botuar, por jo viti i saktë, vendoset kodi "f".</p>
<b>e</b>	<p><i>riprodhim i një dokumenti</i></p> <p>Njësia që katalogohet është riprodhim, d.m.th.shtypje e veçantë, faksimile ose botim i përsëritur, por jo botim i ri. Nëse riprodhimi është një burim në vazhdim, ose nëse origjinali apo riprodhimi është botuar disa vite rresht, shënohet viti i parë i botimit të riprodhimit dhe origjinalit.</p> <p>Nënfusha c përmban vitin e botimit të riprodhimit, ndërsa nënfusha d përmban vitin e botimit të origjinalit (shih shembullin 7). Nëse viti i botimit të riprodhimit apo origjinalit nuk dihet saktë, në vend të numrave mund të shënoni "?".</p>
<b>f</b>	<p><i>monografi me datë botimi të dyshimtë</i></p> <p>Në nënfushat c dhe d shënohet periudha e vlerësuar: nënfusha c përmban vitin më të hershëm të mundshëm të botimit, ndërsa nënfusha d vitin më të vonshëm të mundshëm të botimit (shih shembujt 8, 20).</p>
<b>g</b>	<p><i>monografi, botimi i së cilës vazhdon më shumë se një vit</i></p> <p>Monografi në disa vëllime, të cilat janë botuar (ose botohen) për më shumë se një vit.</p> <p>Nënfusha c përmban vitin e fillimit të botimit, ndërsa nënfusha d vitin e fundit të botimit (shih shembullin 10). Nëse viti i fillimit ose përfundimit është e dyshimtë, në vend të numrave mund të shënoni "?" (shih shembullin 11). Nëse monografia botohet ende dhe është botuar vetëm vëllimi i parë në nënfushën d shënohet "9999" (shih shembullin 9), në të kundërtën viti i botimit të vëllimit të fundit.</p>
<b>h</b>	<p><i>monografi me vit të botimit dhe vit të së drejtës së autorit</i></p> <p>Viti i botimit ndryshon nga viti i së drejtës së autorit që ndodhet në botim, ose viti i botimit nuk dihet.</p> <p>Nënfusha c përmban vitin e botimit, ndërsa nënfusha d datën e së drejtës së autorit (shih shembullin 12). Nëse dihet vetëm viti i së drejtës së autorit, ai shënohet në nënfushën c dhe jo në c (shih shembullin 13).</p>
<b>i</b>	<p><i>monografi me vit të shpërndarjes/botimit dhe prodhimit</i></p> <p>Përdoret për filmin dhe muzikën, kur ekziston hapësira kohe midis prodhimit/regjistrimit të njësisë dhe shpërndarjes së saj.</p> <p>Nënfusha c përmban vitin e shpërndarjes/botimit, ndërsa nënfusha d vitin e prodhimit/regjistrimit (shih shembullin 14).</p>
<b>j</b>	<p><i>monografi me datë të saktë të botimit</i></p> <p>Kodi përdoret kur në regjistrim duhet të shënohet muaji (sipas mundësisë edhe dita) i botimit</p> <p>Nënfusha c përmban vitin e botimit, ndërsa nënfusha d datën e saktë në formën MMDD (muaji, dita) (shih shembujt 15, 16).</p>
<b>l</b>	<p><i>distanca kohore e një koleksioni artificial</i></p> <p>Kodi përdoret për regjistrimet e përmbledhura.</p> <p>Nënfusha c përmban vitin më të vjetër të materialit në koleksionin artificial. Nëse viti më i vjetër nuk dihet saktë, në vend të numrave mund të shënoni "?".</p> <p>Nënfusha d përmban vitin më të ri të materialit në koleksionin artificial. Nëse njësitë në koleksion janë krijuar në periudhën brenda një viti kalendarik, data shënohet në nënfushën c dhe d. Nëse viti më i ri nuk dihet saktë, në vend të numrave mund të shënoni "?".</p>

Kodet "a", "b" dhe "c" përdoren vetëm në regjistrimet për burimet në vazhdim, kodin "l" për regjistrimet e përmbledhura, ndërsa kodet "d", "e", "f", "g", "h", "i" dhe "j" përdoren në të gjitha regjistrimet e tjera, edhe në regjistrimet për burimet e integruara të përfunduara.

### 100c Viti i botimit 1

Në këtë nënfushë shënohet viti i botimit – bazuar në përmbajtjen e nënfushës b.

Te burimet në vazhdim viti i botimit 1 është i njëjtë si viti i parë në nënfushën 207a – *Viti dhe vëllimi*, mirëpo mund të ndryshoj nga viti në nënfushën 210d – *Viti i botimit, shpërndarjes etj.*, shpërndarjes etj.

Në rastet kur botimi i serialit shtrihet në dy vite (p.sh. 1980/81) në nënfushën c shënohet vetëm viti i parë.

### 100d Viti i botimit 2

Në këtë nënfushë shënohet viti i botimit – bazuar në përmbajtjen e nënfushës b.

### 100e Kodi për kategorinë e publikut

Kodi përcakton llojin e lexuesve, të cilëve u shërben botimi.

<b>a</b>	<i>fëmijë në përgjithësi</i> Kodi përdoret në vend të kodeve "b", "c", "d" ose "e", kur këto kode nuk përdoren apo nuk janë të përshtatshme.
<b>b</b>	<i>fëmijë 0-5 vjeç</i>
<b>c</b>	<i>fëmijë 5-10 vjeç</i>
<b>d</b>	<i>fëmijë 9-14 vjeç</i>
<b>e</b>	<i>të rinj mbi 14 vjeç</i>
<b>k</b>	<i>të rritur (joletrar)</i>
<b>m</b>	<i>të rritur (letrar)</i>
<b>u</b>	<i>nuk dihet</i>

### 100f Kodi për botimin zyrtar

Kodi tregon nëse bëhet fjalë për botim zyrtar dhe llojin e organit qeveritar, i cili ka nxjerr ose ka financuar botimin. Institucionet akademike nuk konsiderohen organe qeveritare.

<b>a</b>	<i>federatë, shtet i pavarur</i> Shteti i pavarur dhe territori me autonomi të kufizuar, p.sh. me legjislacion të vetin.
<b>b</b>	<i>provincë, republikë, shtet federal</i>

	Njësia administrative nën nivelin e federatës ose shtetit, me autonomi të kufizuar dhe legjislacion të vetin, mirëpo pa përgjegjësi për marrëdhëniet me jashtë, p.sh. provincat kanadeze, landet gjermane, shtetet e veçanta të SHBA-së etj.
<b>c</b>	<i>krahinë, qark, dikastere</i> Njësia administrative në nivelin mesatar, zakonisht pa legjislacion të vetin, p.sh. dikasteret në Francë, kontetë në Mbretërinë e Bashkuar (shih shembullin 1).
<b>d</b>	<i>qytet, bashki etj.</i> Njësia administrative me kompetencat më të vogla, p.sh. qyteti, vendi ose fshati.
<b>e</b>	<i>organ me kompetenca në nivel lokal në më shumë se një zonë</i> Njësia administrative dhe organet e saj nën nivelin e federatës ose shtetit, që përfshinë disa kompetenca, p.sh një qendër kompjuterike që i përket autoriteteve të disa qyteteve ose autoritetit transportues që është përgjegjëse për disa bashki (komuna).
<b>f</b>	<i>organizatë ndërqeveritare</i> Organizatata ndërkombëtare dhe organet e tyre. Në këtë kategori hyjnë entitetet të cilat mund të bëjnë marrëveshje me shtetet e pavarura p.sh. Fondi Monetar Ndërkombëtar ose Kombet e Bashkuara.
<b>g</b>	<i>qeveri në mërgim ose klandestine</i> Qeveri jozyrtare si p.sh. qeveria e Francës në mërgim në vitet 1941-1944.
<b>h</b>	<i>niveli i organit nuk është përcaktuar</i> Kodi përdoret për botimet zyrtare, mirëpo nuk mund të përcaktohet niveli i institucionit.
<b>y</b>	<i>nuk është botim zyrtar</i>
<b>z</b>	<i>nivel tjetër</i> Kodi përdoret për botimet zyrtare, mirëpo vetëm në rastet kur asnjëri prej kodeve nga nënfusha "a" deri në "g" nuk i përshtatet llojit të institucionit.

## 100g Kodi për regjistrimin e modifikuar

Kodi vendoset vetëm nëse vargu i simboleve, i cili është i disponueshëm në sistem, nuk mjafton për të transkriptuar të dhënat nga njësia. Nëse, për shkak të kufizimeve të grupit të simboleve për përpunimin kompjuterik, simbolet e caktuara është dashur të transiliterohen ose transkriptohen, regjistrimi është i modifikuar.

Regjistrimi nuk është i modifikuar, nëse faqja e titullit nuk mund të transkribohet për arsye se përmban simbole ose fotografi, të cilat nuk ndodhen në asnjë varg simbolesh.

<b>0</b>	<i>regjistrim i pamodifikuar</i>
<b>1</b>	<i>regjistrim i modifikuar</i>

## 100h Gjuha e katalogimit

Kodi përcaktohet automatikisht dhe tregon gjuhën e përdorur për katalogim (shih shembujt 1, 3). E dhëna është e detyrueshme.



## 100i Kodi për transliterimin

Kodi tregon llojin e transliterimit të përdorur.

<b>a</b>	<i>transliterimi ISO</i>
<b>b</b>	<i>transliterime të tjera</i> Kodi përdoret për transliterimin sipas PPIAK, përfshirë dhe transliterimin për shkrimin cirilik. Kodi përdoret vetëm kur biblioteka i shfaq të gjitha regjistrimet në shkrim latin.
<b>b1</b>	<i>transliterimi COBISS për shkrimin cirilik**</i> Kur programi nuk mundëson shënimin e të dhënave në shkrim cirilik, kodi përdoret në regjistrimet e krijuara dhe të ruajtura në shkrim latin, e njëkohësisht të përgatitura për t'u shfaqur në shkrim cirilik.
<b>b2</b>	<i>transliterimi COBISS për të gjitha shkrimet**</i> Kodi paraqitet në regjistrimet e vjetra të bibliotekave, të cilat shfaqin regjistrimet në shkrim cirilik, cirilik i vjetër dhe shkrim grek.
<b>c</b>	<i>disa transliterime</i>
<b>y</b>	<i>nuk është përdorur tabelë transliterimi</i>

## 100l Shkrimi i titullit të saktë

Kodi tregon shkrimin e titullit të saktë. Ky i referohet shkrimit të njësisë dhe jo vargut të simboleve në regjistrim.

<b>ba</b>	<i>latin</i>
<b>ca</b>	<i>cirilik - i papërcaktuar</i>
<b>cb</b>	<i>cirilik – serb*</i>
<b>cc</b>	<i>cirilik – maqedon*</i>
<b>da</b>	<i>japonez - i papërcaktuar</i>
<b>db</b>	<i>japonez - kanji</i>
<b>dc</b>	<i>japonez - kana</i>
<b>ea</b>	<i>kinez</i>
<b>fa</b>	<i>arab</i>
<b>ga</b>	<i>grek</i>
<b>ha</b>	<i>hebre</i>
<b>ia</b>	<i>thai</i>
<b>ja</b>	<i>devanagari</i>
<b>ka</b>	<i>korean</i>
<b>la</b>	<i>tamil</i>
<b>oc</b>	<i>cirilik – i vjetër*</i>
<b>zz</b>	<i>shkrime të tjera</i>

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**210d** *BOTIMI, SHPËRNDARJA ETJ., Viti i botimit, shpërndarjes etj.*

Viti i botimit shënohet edhe në nënfushën 210d.

## SHEMBUJ

Shembujt 1 dhe 3 janë shembuj për fushën 100. Shembujt e tjerë ilustrojnë përdorimin e simboleve të ndryshme për vitin e botimit.

1.

100 □□ **ba c1959 d9999 em fc heng lba**  
*(Seriali ka filluar të botohet në vitin 1959 dhe vazhdon të botohet. U dedikohet lexuesve të rritur. Botimi është raport vjetor i botuar nga Hampshire County Council. Regjistrimi është i pamodifikuar, gjuha e katalogimit është anglishtja, ndërsa titulli është në shkrim latin.)*

2.

100 □□ **ba c192? d9999**  
*(Seriali ka filluar të botohet midis viteve 1922 e 1925 dhe vazhdon të botohet.)*

3.

100 □□ **bb c1810 d1860 hfre lba**  
*(Seriali është botuar nga viti 1810 deri në vitin 1860. Regjistrimi nuk është i modifikuar, gjuha e katalogimit është frëngjishtja dhe titulli është në shkrim latin.)*

4.

100 □□ **bc c1980 d????**  
*(eriali ka filluar të botohet në vitin 1980, mirëpo nuk dihet nëse botimi i tij vazhdon apo është ndërprerë.)*

5.

100 □□ **bd c1750**  
*(Njësia është botuar ose ndoshta është botuar në vitin 1750. Viti në nënfushën 210d mund të shënohet në mënyra të ndryshme: 1750 për vitin, i cili ndodhet në botim brenda burimit të të dhënave për përshkrimin bibliografik, [1750] për vitin, i cili ndodhet në botim por jo në burimin e të dhënave për përshkrimin bibliografik ose për vitin e gjetur, [1750?] për vitin e dyshimtë të botimit)*

6.

100 □□ **bd c1972**  
*(Monografia është botuar në tre vëllime në vitin 1972.)*

7.

100 □□ **be c1968 d1952**  
*(Dokument i botuar në vitin 1952, i rishtypur në vitin 1968.)*

8.

100 □□ **bf c1962 d1966**  
*(Monografia nuk ka datë botimi, por nga përmbajtja e saj kuptohet se nuk është botuar para vitit 1962. Është siguruar në vitin 1966. Supozohet që është botuar ndërmjet viteve 1962 dhe 1966.)*

9.

100 □□ **bg c1983 d9999**  
*(Monografia është botuar në 5 vëllime. Vëllimi i parë është botuar në vitin 1983, ndërsa të tjerët janë botuar më vonë. Regjistrimi nuk është i përfunduar, sepse mungojnë të dhënat për vëllimet e tjera.)*

10.

100	□□	<b>bg c1975 d1976</b> ( <i>Monografia është botuar në tre vëllime nga viti 1975 deri në vitin 1976.</i> )
-----	----	--

11.

100	□□	<b>bg c1962 d196?</b> ( <i>Monografia ka filluar të botohet në vitin 1962. Nuk dihet data e saktë e botimit të vëllimit të fundit, por mendohet të jetë viti 1968 ose 1969.</i> )
-----	----	--

12.

100	□□	<b>bh c1985 d1983</b> ( <i>Dokumenti është botuar në vitin 1985, viti i së drejtës së autorit është 1983.</i> )
-----	----	--

13.

100	□□	<b>bh c1972</b> ( <i>Dihet vetëm viti i së drejtës së autorit.</i> )
-----	----	---

14.

100	□□	<b>bi c1950 d1943</b> ( <i>Filmi është prodhuar në vitin 1943, por ka filluar të shfaqet vetëm në vitin 1950.</i> )
-----	----	--

15.

100	□□	<b>bj c1985 d0412</b> ( <i>Raport teknik i botuar më 12 Prill 1985.</i> )
-----	----	--

16.

100	□□	<b>bj c1985 d11??</b> ( <i>Raport i botuar në nëntor të vitit 1985. Dita e botimit është e panjohur ose është e parëndësishme.</i> )
-----	----	---

17. \* COBISS.net

100	□□	<b>ba c1904 d9999</b>
200	1□	<b>aPolitika</b> ( <i>Serial i botuar për herë të parë në vitin 1904 dhe vazhdon të botohet.</i> )

18. \*

100	□□	<b>bb c1950 d1952</b>
200	1□	<b>aLjudska tehnika</b> ( <i>Serial i botuar midis viteve 1950 dhe 1952.</i> )

19. \*

100	□□	<b>bc c1990 d????</b>
200	1□	<b>aEuromaske</b> ( <i>Seriali ka filluar të botohet në vitin 1990. Nuk dihet nëse akoma vazhdon të botohet.</i> )

20. \*

100	□□	<b>bf c1890 d1900</b>
200	0□	<b>aEarly Australian voyages fby John Pinkerton</b> ( <i>Monografia është botuar midis viteve 1890 dhe 1900. Viti i saktë i botimit nuk dihet.</i> )

21. \*

100	□□	<b>bd c1991 d1919</b>
-----	----	-----------------------

*(Në botim është shtypur viti i gabuar. Vepra është botuar në vitin 1991, ndërsa në botim është shtypur viti 1919.)*

## 101 GJUHA E NJËSISË

Kjo fushë përmban kodin e gjuhës së njësisë, pjesëve të saj, titullit si dhe gjuhës së origjinalit, nëse njësia që përshkruhet është përkthim.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
101	Gjuha e njësisë	nr
	<b>a</b> <i>Gjuha e tekstit</i>	r
	<b>b</b> <i>Gjuha e tekstit të ndërmjetëm</i>	r
	<b>c</b> <i>Gjuha e veprës origjinale</i>	r
	<b>d</b> <i>Gjuha e përmbledhjes</i>	r
	<b>e</b> <i>Gjuha e faqes së përmbajtjes</i>	r
	<b>f</b> <i>Gjuha e faqes së titullit</i>	r
	<b>g</b> <i>Gjuha e titullit të saktë</i>	nr
	<b>h</b> <i>Gjuha e libretit etj.</i>	r
	<b>i</b> <i>Gjuha e materialit shoqërues</i>	r
	<b>j</b> <i>Gjuha e titrave</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Treguesi i përkthimit</i></b>
	0	<i>Njësia është në gjuhën origjinale të veprës</i> (shih shembujt 3, 5, 7, 12, 13, 14)
	1	<i>Njësia është përkthim</i> (shih shembujt 1, 2, 4, 6, 15)
	2	<i>Njësia përmban përkthime</i> (shih shembujt 8, 9, 10, 11)
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Vlera "2" nuk përdoret nëse përkthimet e vetme në botim janë përmbledhjet ose abstraktet e artikujve etj.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 101a Gjuha e tekstit

Gjuha e tekstit, e regjistrimit zanor etj. Nënfusha përsëritet nëse teksti është në disa gjuhë (shih shembujt 5, 7, 13, 14).

---

### **101b Gjuha e tekstit të ndërmjetëm**

Gjuha e përkthimit të ndërmjetëm kur njësia nuk është përkthim i origjinalit (shih shembujt 2, 4, 6, 15). Nënfisha përsëritet nëse teksti është përkthyer nga disa gjuhë të ndërmjetme (shih shembullin 6), ose përmes disa gjuhëve të ndërmjetme (p.sh. Greqisht – Latinisht – Frëngjisht - Anglisht).

---

### **101c Gjuha e veprës origjinale**

Gjuha e veprës origjinale, kur njësia që përshkruhet është përkthim (shih shembujt 1, 2, 4, 6, 8, 15). Nënfisha përsëritet nëse teksti origjinal është në disa gjuhë.

---

### **101d Gjuha e përmbledhjes**

Gjuha e përmbledhjeve/abstrakteve të njësisë ose të pjesëve të veçanta apo artikujve që përmban njësia. Nënfisha përsëritet nëse njësia përmban përmbledhje në disa gjuhë (shih shembullin 7).

---

### **101e Gjuha e faqes së përmbajtjes**

Gjuha e faqes së përmbajtjes, kur ndryshon nga gjuha e tekstit (shih shembullin 3). Nënfisha përsëritet për çdo gjuhë të përmbajtjes.

---

### **101f Gjuha e faqes së titullit**

Gjuha e faqes së titullit, kur ndryshon nga gjuha ose gjuhët e tekstit (shih shembujt 3, 8). Nënfisha përsëritet për çdo gjuhë të faqes së titullit.

---

### **101g Gjuha e titullit të saktë**

Gjuha e titullit të saktë, kur ndryshon nga gjuha e tekstit në nënfushën e parë ose të vetme a (shih shembullin 1). Nënfisha nuk është e përsëritshme, sepse titulli i saktë zakonisht është në një gjuhë. Nëse titulli i saktë është edhe në një gjuhë tjetër ai quhet titull paralel. Kodi për gjuhën e titullit paralel vendoset në nënfushën 200z.

---

### **101h Gjuha e libretit etj.**

Gjuha e tekstit, kur njësia e përshkruar përfshin përmbajtje vokale (të folur ose të kënduar) në formë të shtypur, qoftë si material shoqërues ose si pjesë e njësisë. Nënfisha nuk përdoret vetëm për libreta (shih shembullin 9).

## 101i Gjuha e materialit shoqërues

Gjuha e materialit shoqërues si: parathënie, komente, udhëzime etj. (shih shembullin 10).

## 101j Gjuha e titrave

Gjuha e titrave të filmat, kur ndryshon nga gjuha e regjistrimit zanor (shih shembujt 11, 12).

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në nënfushë vendoset kodi i gjuhës i përbërë nga tre karaktere, sipas standardit ISO 639-2. Kur nënfusha përsëritet, renditja e kodeve të vendosura duhet të pasqyroj shtrirjen dhe rëndësinë e gjuhëve të njësisë. Në qoftë se kjo është e pamundur, atëherë kodet e gjuhëve renditen në radhë alfabetike. Nëse nënfushën duhet përsëritur disa herë, atëherë mund të përdoret kodi "*mul*" – *shumëgjuhësh* (shih shembullin 8). Nëse gjuha nuk mund të përcaktohet, përdoret kodi "*und*" – *e papërcaktuar* (shih shembullin 16). Kodi "*zxx*" – *nuk ka përmbajtje gjuhësore* përdoret kur njësia nuk përmban fjalë të shkruara ose të folura, p.sh. materialet muzikore me nota, fotografitë etj. (shih shembullin 17).

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 100h TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIMIN, Gjuha e katalogimit

Nënfusha përmban kodin e gjuhës që e përdor kataloguesi për ato pjesë të regjistrimit, të cilat nuk varen nga gjuha e njësisë (p.sh. shënimet).

### 200 TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË

Gjuha e titullit paralel, që shfaqet në këtë fushë, vendoset në nënfushën 200z.

### 510-541 TITUJT NË LIDHSHMËRI

Disa fusha të bllokut 5XX kanë nënfushën z, ku vendoset kodi për gjuhën e titullit paralel, nëse ndryshon nga gjuha kryesore e njësisë.

## SHEMBUJ

1.

101	1□	<b>afre ceng geng</b> ( <i>Libri me titull "Guidebook to Henry VIII's Palace of Hampton Court" është përkthim në frëngjisht nga origjinali në anglisht. Titulli i saktë është në anglisht, dhe pasohet nga një titull paralel në frëngjisht; teksti është në frëngjisht.</i> )
-----	----	---

2.

101	1□	<b>afre beng crus</b>
-----	----	-----------------------

*(Një material shkencor në rusisht, të cilën një agjenci ndërkombëtare e ka përkthyer në anglisht. Këtë tekst të ndërmjetëm (tekstin në anglisht) një institut kërkimor francez e ka përkthyer në frëngjisht.)*

3.

101 0<sub>1</sub> **ajpn eeng feng**  
*(Një botim zyrtar japonez që ka përmbajtjen dhe faqen shitesë të titullit në anglisht; teksti është në japonisht.)*

4.

101 1<sub>1</sub> **aeng bger crus**  
*(Ditari i një udhëtari me titull "Journey to Khiva through the Turkoman country" i autorit Nikolay Murav'yov. Originali në rusisht është përkthyer në gjermanisht dhe më pas nga gjermanishtja në anglisht.)*

5.

101 0<sub>1</sub> **aeng awel**  
*(Botimi zyrtar i Gwent County Council me tekst paralel në dy gjuhë: anglisht dhe në gjuhën e Uellsit.)*

6.

101 1<sub>1</sub> **aeng bger bfre cakk**  
*(Një tekst në gjuhën e vjetër Akkadian, është përkthyer një pjesë në gjermanisht dhe një pjesë në frëngjisht. Përkthimi në anglisht është bazuar në përkthimin gjermanisht dhe frëngjisht.)*

7.

101 0<sub>1</sub> **aeng afre ager deng dfre dger**  
*("IFLA Journal" përmban abstraktet nga të gjitha kontributet në anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Shumica e kontributeve janë në anglisht të ndjekura paralelisht dhe në frëngjisht dhe gjermanisht.)*

8.

101 2<sub>1</sub> **amul ceng ffre**  
*(Libër për lexuesit francezë që ka faqen e titullit në frëngjisht dhe përmban përkthime nga anglishtja të akteve të dramave të Shekspirit në 25 gjuhë.)*

9.

101 2<sub>1</sub> **afre hfre hger**  
*(Regjistrim zëri, këngë në frëngjisht me tekst shoqërues në frëngjisht dhe gjermanisht.)*

10.

101 2<sub>1</sub> **azxx ieng**  
*(Regjistrim zëri që nuk ka tekst, mirëpo shënimet janë në anglisht.)*

11.

101 2<sub>1</sub> **aswe jfre**  
*(Filmi "Tystnaden" i Bergman me titra në frangjisht.)*

12.

101 0<sub>1</sub> **azxx jeng**  
*(Filmi "Modern Times" i Chaplin me titra në anglisht.)*



## 13. \*

101	0□	<b>aeng afre</b>
200	1□	<b>a</b> Annotated bibliography of national sources of adult education statistics <i>(Bibliographie annotée des sources nationales de statistiques sur l'éducation des adultes (Botimi është në dy gjuhë paralele, në anglisht dhe frëngisht.)</i>

## 14. \* COBISS.net

101	0□	<b>ascr aeng ager</b>
200	1□	<b>a</b> Radovi <i>(Serial me tekst në tre gjuhë.)</i>

## 15. \* COBISS.net

101	1□	<b>aalb bger cchi</b>
200	0□	<b>a</b> Kur Kina ende kishte shpresë
300	1□	<b>a</b> Përkthim i: Pekingmensen <i>(Libri është përkthyer në gjuhën shqipe, bazuar në përkthimin gjerman.)</i>

## 16. \*

101	1□	<b>aeng cund</b>
200	1□	<b>a</b> Fear <b>f</b> [edited by Monica Narula, Shuddhabrata Sengupta, Jeebesh Bagchi <b>g</b> translations Shveta Sarda] <i>(Gjuha e tekstit origjinal nuk dihet ose nuk mund të verifikohet, për këtë arsye në nënfushën 101c shënohet kodi "und" – e papërcaktuar.)</i>

## 17. \* COBISS.net

101	0□	<b>azxx fslv</b>
200	0□	<b>a</b> 25 vjet të bendit të zjarrëfikësve Lovrenc në Pohorje <b>b</b> Regjistrim zanor <b>f</b> [dirigjent Andrej Branko] <i>(Burimi përmban instrumentale muzikore. Për shkak se materiali nuk ka tekst, në nënfushën 101a vendoset kodi "zxx" – nuk ka përmbajtje gjuhësore. Plotësohet edhe nënfusha 101f, ku vendoset kodi i gjuhës së faqes së titullit.)</i>



## 102 SHETI I BOTIMIT OSE I PRODHIMIT

Fusha përmban kodin për një ose disa shtete të botimit ose prodhimit të njësisë.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
102	Shteti i botimit ose i prodhimit	nr
<b>a</b>	<i>Shteti</i>	r
<b>b</b>	<i>Rajoni</i>	r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 102a Shteti

Kodi me tre karaktere që tregon shtetin, në të cilin është botuar ose prodhuar njësi. Kodet shënohen sipas standardit ISO 3166. Respektohet gjendja aktuale e shteteve (kodet e vendeve ekzistues), pavarësisht se kur është botuar njësi. Nënfusha përsëritet nëse njësi është botuar në disa shtete.

Në listën e kodeve të shteteve është edhe kodi "*int*" – *organizatë ndërkombëtare*. Kodi shfaqet gjatë shkarkimit të regjistrimeve nga baza e të dhënave e ISSN-së. Këtë kod e kanë regjistrimet për serialet, botuar nga organizatat ndërkombëtare.

### 102b Rajoni

Kodi me dy karaktere që tregon rajonin ku është botuar njësi. Nënfusha përsëritet nëse njësi është botuar në disa rajone. Përdoren këto kode:

<b>br</b>	<i>Distrikti i Brçkos</i>
<b>cr</b>	<i>Mali i Zi**</i>
<b>cs</b>	<i>Serbia Qendrore</i>
<b>fb</b>	<i>Federata BiH</i>
<b>ko</b>	<i>Kosova**</i>
<b>rs</b>	<i>Republika Serbe</i>
<b>sr</b>	<i>Serbia**</i>
<b>vj</b>	<i>Vojvodina</i>

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Çdo nënfushë b duhet të vendoset menjëherë pas nënfushës a, të cilës i referohet. Rekomandohet vendosja e kodit për çdo vend botimi ose prodhimi që ndodhet në fushën 210.

Te monografitë e vjetra emri i shtypshkronjës dhe vendi i shtypjes janë të barasvlershme me botuesin ose shpërndarësin. Për këtë arsye, në këtë fushë vendoset kodi i shtetit ose i rajonit të shtypshkronjës, botuesit ose shpërndarësit. Kodet vendosen sipas gjendjes aktuale të kufijve të vendit.

Në nënfushën 102a shënohet kodi "xxx" – *shteti nuk dihet* (shih shembullin 6), kur shteti nuk mund të përcaktohet.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**210** *BOTIMI, SHPËRNDARJA ETJ.*

Fush përmban vendin e botimit ose të prodhimit në formë teksti.

**620** *KËRKIMI ME VEND TË BOTIMIT*

Fusha përmban vendin e botimit ose të prodhimit në formë teksti të strukturuar.

## SHEMBUJ

1.

102	□□	<b>ahun</b> (Njësia është botuar në Hungari.)
-----	----	--

2.

102	□□	<b>aita</b> (Njësia është botuar në Venecia në vitin 1485.)
-----	----	--

3. \*

102	□□	<b>asrb bvj</b> (Njësia është botuar në Vojvodinë.)
-----	----	--

4. \* COBISS.net

102	□□	<b>abih bfb</b> (Njësia është botuar në Federatën BiH.)
-----	----	--

5. \*

102	□□	<b>asvn</b>
210	□□	<b>a[Sllovenia] cCreativ d2000-</b> (Vepra është botuar në Slloveni. Për shkak se vendi i botimit nuk dihet, në nënfushën 210a shënohet zona më e gjërë gjeografike.)

6. \*

102	□□	<b>axxx</b>
210	□□	<b>a[S. l.] cWulfenia Journal d[2012]-</b> (Vendi dhe shteti i botimit nuk dihen.)

## 105 MATERIALI TEKST MONOGRAFIK

Fusha përmban të dhëna të koduara që lidhen me materialin tekst monografik.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
105	Materiali tekst monografik	nr
	<b>a</b> <i>Kodet për ilustrimet</i>	r
	<b>b</b> <i>Kodet për llojin e përmbajtjes</i>	r
	<b>c</b> <i>Kodi për botimin nga konferenca</i>	nr
	<b>d</b> <i>Kodi për botimin përkujtimor</i>	nr
	<b>e</b> <i>Kodi për indeksin</i>	nr
	<b>f</b> <i>Kodi për letërsinë</i>	nr
	<b>g</b> <i>Kodi për biografinë</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 105a Kodet për ilustrimet

Nënfusha përdoret për përshkrimin e ilustrimeve të rëndësishme në botim (shih shembujt 1, 2, 3, 5). Nëse botimi përmban lloje të ndryshme të ilustrimeve, nënfusha përsëritet. Kodet në këtë nënfushë lidhen me përshkrimin fizik të njësisë dhe duhet të përputhen me të dhënat në nënfushën 215c.

<b>a</b>	<i>ilustrime</i> Kodi përdoret për llojet e ilustrimeve, të cilat nuk janë përfshirë më poshtë, ose kur llojet e ilustrimeve nuk vendosim si të veçanta.
<b>b</b>	<i>harta</i>
<b>c</b>	<i>portrete</i> Portrete personale ose në grup.
<b>d</b>	<i>harta detare</i> Harta të veçanta të projektuara për t'u përdorur nga lundëtarët (marinë, ajër etj.).
<b>e</b>	<i>plane</i> P.sh. plane për ndërtime.
<b>f</b>	<i>shtojca (të lidhura)</i> Fletë me ilustrime dhe me tekst shoqërues ose pa të, që nuk përshihen në numërimin e faqeve ose fletëve.

<b>g</b>	<i>muzikë</i> Si material tekst monografik. Për regjistrimet zanore si materiale shoqëruese përdoret kodi "m".
<b>h</b>	<i>faksimile</i> Riprodhim i hollësishëm i një pjese ose i një dokumenti të plotë.
<b>i</b>	<i>këllëf arme</i>
<b>j</b>	<i>tabela gjenealogjike</i>
<b>k</b>	<i>formularë</i>
<b>l</b>	<i>modele</i>
<b>m</b>	<i>regjistrime zanore</i> P.sh. pllakë gramafoni në xhepun e librit.
<b>n</b>	<i>diapozitiva</i> P.sh. komplet diapozitivash në xhepin e librit.
<b>o</b>	<i>ilustrime</i> Shkronja ose tekste të dorëshkrimeve mesjetare të ilustruara me fotografi me ngjyra.
<b>y</b>	<i>pa ilustrime</i>

## 105b Kodet për llojin e përmbajtjes

Nënfusha përdoret për përshkrimin e përmbajtjes së një botimi ose të pjesëve të rëndësishme të tij (shih shembujt 1, 3). Kodi përdoret nëse njësia përmban këtë lloj të materialit ose kur ai si tërësi është një lloj i tillë i materialit, me përjashtim të kodit "c" – *indeks*, i cili përdoret vetëm kur njësia është indeks (shih shembullin 4). Nëse njësia është katalog shënohet kodi "b"; nëse njësia, pos të tjerave përmban edhe katalog, sërish vendoset kodi "b".

<b>8</b>	<i>separat*</i>
<b>9</b>	<i>tjetër*</i>
<b>a</b>	<i>bibliografi</i> Listë e njësive bibliografike, e përgatitur sipas parametrave të caktuar.
<b>b</b>	<i>katalog</i> Regjistrim i njësive në një koleksion, në një ekspozitë ose katalogu i shitjes i një shtëpie botuese ose shtypshkronje.
<b>c</b>	<i>indeks</i> Listë alfabetike termash (emra, nocione) me vendin ku mund të gjenden ata. Kodi përdoret vetëm nëse njësia është një indeks. Nëse njësia që përshkruhet ka edhe indeks, përdoret kodi për indeksin (nënfusha 105e).
<b>d</b>	<i>abstrakt ose përmbledhje</i> Janë të përfshira abstraktet përshkruese, treguese dhe informuese.
<b>e</b>	<i>fjalor</i> Listë alfabetike e fjalëve me përshkrim të shkurtër të kuptimit të tyre dhe përdorimit, ose me fjalët përkatëse në gjuhën tjetër.
<b>f</b>	<i>enciklopedi, leksikon</i> Listë e thjeshtë alfabetike e emrave ose termave nga një fushë e caktuar me përshkrim të gjerë.
<b>g</b>	<i>listë emrash</i>

	Listë e rregulluar e personave, organizatave ose vendeve me të dhënat përkatëse.
<b>h</b>	<i>vjetar*</i>
<b>i</b>	<i>statistika</i> Të dhëna numerike për gjëra të caktuara, të mbledhura në mënyrë sistematike dhe të paraqitura në formë tabelare.
<b>j</b>	<i>tekst mësimor</i>
<b>j1</b>	<i>tekst mësimor për shkollat fillore*</i>
<b>j1d</b>	<i>libër me ushtrime për shkollat fillore*</i>
<b>j2</b>	<i>tekst mësimor për shkollat e mesme*</i>
<b>j2d</b>	<i>libër me ushtrime për shkollat e mesme*</i>
<b>j3</b>	<i>tekst mësimor për arsimin e lartë*</i>
<b>j3d</b>	<i>libër me ushtrime për arsimin e lartë*</i>
<b>jd</b>	<i>libër me ushtrime*</i>
<b>k</b>	<i>patentë</i> Dokument që përfshin përshkrimin e shpikjes dhe shpikësit i jep të drejtën e përdorimit ose të shitjes për një periudhë të caktuar. Përfshin edhe aplikimet për patentë.
<b>l</b>	<i>standard</i> Dokument, të cilin e boton një institucion zyrtar dhe i cili rekomandon mënyrën e përpunimit, që do të garantonte cilësinë e caktuar.
<b>m</b>	<i>disertacion për doktoratë*</i>
<b>m2</b>	<i>tezë masteri*</i>
<b>m3</b>	<i>tezë për specialist*</i>
<b>m4</b>	<i>kualifikim për mësimdhënie*</i>
<b>m5</b>	<i>punim diplome*</i>
<b>m6</b>	<i>punim diplome i shkollës profesionale*</i> Punim diplome universiteti e dorëzuar nga studentët që mbarojnë studimet profesionale në kolegji.
<b>m7</b>	<i>punim mature*</i>
<b>mb11</b>	<i>punim diplome (niveli i parë i studimeve sipas programit të Bolonjës)*</i> Punimet e diplomës, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të parë të studimeve sipas programit të Bolonjës.
<b>mb12</b>	<i>punim i përfunduar (niveli i parë i studimeve sipas programit të Bolonjës)*</i> Punimet e përfunduara, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të parë të studimeve sipas programit të Bolonjës.
<b>mb13</b>	<i>punim projekti (niveli i parë i studimeve sipas programit të Bolonjës)*</i> Punimet e projekteve, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të parë të studimeve sipas programit të Bolonjës.
<b>mb14</b>	<i>punim seminari i përfunduar (niveli i parë i studimeve sipas programit të Bolonjës)*</i> Punime seminari, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të parë të studimeve sipas programit të Bolonjës.
<b>mb15</b>	<i>punim dramaturgjik (niveli i parë i studimeve sipas programit të Bolonjës)*</i> Punime dramaturgjike, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të parë të studimeve sipas programit të Bolonjës.
<b>mb16</b>	<i>studim reflektues i përfunduar (niveli i parë i studimeve sipas programit të Bolonjës)*</i>

	Studime reflektuese të përfunduara, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të parë të studimeve sipas programit të Bolonjës.
<b>mb21</b>	<i>punim diplome (niveli i dytë i studimeve sipas programit të Bolonjës)*</i> Punimet e diplomës, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të dytë të studimeve sipas programit të Bolonjës ose programit unifom master të Bolonjës.
<b>mb22</b>	<i>tezë masteri (studime sipas programit të Bolonjës)*</i> Teza masteri, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të dytë të studimeve sipas programit të Bolonjës ose programit unifom master të Bolonjës.
<b>mb31</b>	<i>tezë doktorate (studime sipas programit të Bolonjës)*</i> Teza doktorate, të dorëzuara nga studentët pas përfundimit të nivelit të tretë të studimeve sipas programit të Bolonjës.
<b>n</b>	<i>ligje</i> Njësi që përmbajnë tekste të ligjeve. Për traktate përdoret kodi "s".
<b>o</b>	<i>tabelë numerike</i> Informacione numerike të paraqitura në formë tabelle. Nëse të dhënat janë statistikore, përdoret kodi "i".
<b>o1</b>	<i>taksa*</i>
<b>o2</b>	<i>listë çmimesh*</i>
<b>p</b>	<i>raport teknik</i> Dokument, që përmban rezultatet e një kërkimi ose studimi, në një fushë shkencore ose teknike.
<b>p1</b>	<i>punim seminari në shkollën fillore*</i>
<b>p2</b>	<i>punim seminari në shkollën e mesme*</i>
<b>p3</b>	<i>projekt kërkimor në shkollën fillore*</i>
<b>p4</b>	<i>projekt kërkimor në shkollën e mesme*</i>
<b>p5</b>	<i>projekt kërkimor në kolegji*</i>
<b>q</b>	<i>material provimi (teste)</i> Pyetje për provim në formë të shtypur.
<b>r</b>	<i>raport kërkimor*</i>
<b>r1</b>	<i>rishikim i përmbajtjes*</i>
<b>r2</b>	<i>punim shkencor*</i>
<b>r3</b>	<i>raport paraprak*</i>
<b>r4</b>	<i>punim profesional*</i>
<b>r5</b>	<i>raport konference*</i>
<b>r6</b>	<i>i/e pakategorizuar*</i> Kodet "r1" deri në "r5" vendosen vetëm në bazë të kategorizimit, i cili është i pranishëm në një artikull ose në një botim (udhëzime për autorët për ndërtimin e artikujve). Nëse kategorizimi nuk është i qartë, vendoset kodi "r6".
<b>s</b>	<i>traktate</i> Kodi përdoret për marrëveshjet formale ndërkombëtare, të ratifikuara midis shteteve. Për ligjet e tjera përdoret kodi "n".
<b>t</b>	<i>kërkim zhvillimor*</i>
<b>u</b>	<i>rregullore*</i>
<b>u1</b>	<i>statut*</i>
<b>u2</b>	<i>program organizate*</i>
<b>v</b>	<i>manual*</i>
<b>v1</b>	<i>udhëzues*</i>



<b>v2</b>	<i>udhëzime*</i>
<b>w</b>	<i>kërkim për zbatim*</i>
<b>x1</b>	<i>strip*</i>
<b>x2</b>	<i>libër me piktura*</i>
<b>y</b>	<i>analizë/recension letrar*</i> Analiza kritike në letërsi, film, teatër etj.
<b>z</b>	<i>përmbledhje punimesh*</i>

### 105c Kodi për botimin nga konferenca

Kodi tregon nëse njësia përmban punime, raporte ose përmbledhje nga një konferencë, kongres, mbledhje ose simpozium. Ky kod përdoret pavarësisht, se a i bëhet apo jo konferencës, etj. një përshkrim formal.

<b>0</b>	<i>nuk është botim nga konferenca</i>
<b>1</b>	<i>është botim nga konferenca</i>

### 105d Kodi për botimin përkujtimor

Kodi tregon nëse njësia është botim përkujtimor. Botimi përkujtimor (jubilar) është një botim në formën e një përmbledhje esesh, fjalimesh ose të kontributeve bibliografike, shkencore e kontributeve të tjera. Botohet për nder të një personi, institucioni apo shoqate, zakonisht me rastin e krenimit të ndonjë përvjetori.

<b>0</b>	<i>nuk është botim përkujtimor</i>
<b>1</b>	<i>është botim përkujtimor</i>

### 105e Kodi për indeksin

Kodi tregon nëse njësia përmban edhe indeks (shih shembullin 1). Nëse vet njësia është indeks në një vepër tjetër, në nënfushën 105b vendoset kodi "c".

<b>0</b>	<i>botimi nuk ka indeks</i>
<b>1</b>	<i>botimi ka indeks</i>

### 105f Kodi për letërsinë

Nëse njësia është tekst letrar, kodi tregon llojin e tekstit letrar (shih shembullin 5).

Për shkak të uniformitetit të përpunimit në bazën e përbashkët të të dhënave, është e nevojshme vendosja e kodit me dy karaktere, nëse ai ekziston dhe është i përshtatshëm për përshkrimin e njësisë (p.sh.: përdoret kodi "a1" – roman social social dhe jo "a" – roman).

<b>a</b>	<i>roman</i>
<b>a1</b>	<i>roman social*</i>

<b>a2</b>	<i>roman aventuresk*</i>
<b>a3</b>	<i>roman historik, me luftë*</i>
<b>a4</b>	<i>roman kriminalistik, me spiunazh, me detektivë*</i>
<b>a5</b>	<i>roman (auto) biografik, biografi në përgjithësi*</i>
<b>a6</b>	<i>prozë fantastike (shkencore)*</i>
<b>b</b>	<i>dramë</i>
<b>b1</b>	<i>radiodramë*</i>
<b>b2</b>	<i>skenar (TV ose tjetër)*</i>
<b>b3</b>	<i>libret*</i> Kodi përdoret kur vepra botohet si e pavarur (monografi).
<b>c</b>	<i>ese</i>
<b>d</b>	<i>humor, satirë, parodi</i>
<b>e</b>	<i>letra</i> Kodi përdoret për letrat si formë letrare; për korrespondencën përdoret nënfusha 105g – Kodi për biografinë.
<b>f</b>	<i>prozë e shkurtër</i> Kodet, të cilat fillojnë me shkronjën "f", përdoren për tekstet, autori i të cilave dihet; për letërsinë popullore shih kodet "x", "x1", "x2" dhe "x3".
<b>f1</b>	<i>përralla*</i>
<b>f2</b>	<i>anekdota*</i>
<b>f3</b>	<i>aforizma, proverba*</i>
<b>f4</b>	<i>fabula*</i>
<b>g</b>	<i>poezi</i> Kodi përdoret edhe për veprat joletrare në vargje.
<b>g1</b>	<i>gjëgjëza*</i> Kodi përdoret për gjëgjëzat, autori i të cilave dihet; për gjëgjëzat popullore shih kodet "x", "x1" dhe "x2".
<b>g2</b>	<i>antologji e poezisë*</i>
<b>h</b>	<i>fjalime, oratori</i>
<b>h2</b>	<i>intervistë*</i>
<b>i</b>	<i>kujtime, ditare, kujtime udhëtimi, përshkrime** (shih i1, i2)</i>
<b>i1</b>	<i>kujtime, ditar*</i>
<b>i2</b>	<i>kujtime udhëtimi*</i>
<b>x</b>	<i>letërsi popullore*</i>
<b>x1</b>	<i>poezi popullore*</i>
<b>x2</b>	<i>prozë popullore*</i>
<b>x3</b>	<i>mite, legjenda*</i>
<b>z</b>	<i>lloje të përziera ose forma të tjera letrare</i> Kodi përdoret, nëse njësi është vepër letrare, mirëpo nuk mund të përcaktohet forma ose duhet të përdoren disa kode njëherësh.
<b>z1</b>	<i>antologji (forma të tjera letrare)*</i> Kodi përdoret për antologjitë e prozës dhe dramës, si dhe për antologjitë në të cilat tekstet e përzgjedhura janë të llojeve të ndryshme letrare; për antologjitë e poezisë shih kodin "g2" – antologji e poezisë.
<b>z2</b>	<i>vepra të përmbledhura*</i>
<b>z3</b>	<i>vepra të zgjedhura*</i>

## 105g Kodi për biografinë

Nëse njësia është vepër biografike, kodi tregon llojin e biografisë (shih shembullin 1).

<b>a</b>	<i>autobiografi</i> Janë të përfshira edhe letrat dhe korrespondenca.
<b>b</b>	<i>biografi personale</i>
<b>c</b>	<i>biografi kolektive</i> P.sh. vepra, e cila përmban biografinë e disa personave ose familjeve.
<b>d</b>	<i>përmban të dhëna biografike</i> P.sh. listë adresash, listë emrash.
<b>y</b>	<i>nuk është vepër biografike</i>

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**001bc** *ETIKETA E REGJISTRIMIT, Lloji i regjistrimit, Niveli bibliografik*

Nënfusha b tregon se a është njësia material tekst, ndërsa nënfusha c se a është njësia monografi.

**106** *MATERIALI TEKST - PËRSHKRIMI FIZIK*

Fusha përmban të dhëna të koduara, të cilat kanë të bëjnë me formën fizike të njësisë.

**215** *PËRSHKRIMI FIZIK*

Fusha përmban të dhëna tekst për formën fizike të njësisë.

## SHEMBUJ

1.

105	□□	<b>ab af ba e1 gb</b> <i>(Botimi përmban harta dhe fletë të ilustruara. Përmban edhe bibliografi dhe indeks. Për shkak se përshkruan jetën dhe udhëtimin e personave të caktuar, vendoset edhe kodi për biografinë personale.)</i>
-----	----	---

2. \*

105	□□	<b>ab ag</b>
200	0□	<b>a#The #rise of European music e1380-1500</b> <i>(Botimi përmban harta dhe muzikë.)</i>

3. \*

105	□□	<b>aa bm</b>
200	0□	<b>aU#tjecaj promjenjivog polja visokog radijalnog ubrzanja na unutrašnju balistiku raketnih motora sa dvobaznim gorivom</b> <i>(Disertacion për doktoratë me grafikë.)</i>

4. \*

105	□□	<b>bc</b>
200	0□	<b>aImensko in stvarno kazalo k Jezikoslovnim delom patra Stanislava Škrabca</b>

(Botimi është indeks.)

5. \*

105 □□ **aa ff2**

200 1□ **a**Dober dan, smeh eizbrane anekdote in prigode dolenjских ljudi  
(Botim me ilustrime, që përmban anekdota.)

## 106 MATERIALI TEKST - PËRSHKRIMI FIZIK

Fusha përmban të dhëna të koduara, që lidhen me formën fizike të materialit tekst.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
106		Materiali tekst - përshkrimi fizik	nr
	<b>a</b>	<i>Kodi për formën fizike</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 106a Kodi për formën fizike

<b>d</b>	<i>format i madh</i>
<b>e</b>	<i>format gazete</i>
<b>f</b>	<i>shkrim Braille ose Moon</i>
<b>g</b>	<i>shtyp mikro</i>
<b>h</b>	<i>dorëshkrim</i>
<b>i</b>	<i>multimedia</i> P.sh. njësia në shtyp të zakonshëm me shtojcë në formën e një mikrofishë.
<b>j</b>	<i>shtyp i vogël</i>
<b>r</b>	<i>shtyp i zakonshëm</i>
<b>z</b>	<i>forma të tjera të materialit tekst</i>

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Kur materiali tekst është në shtyp të zakonshëm mund të vendoset kodi "r" ose fusha nuk plotësohet fare.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**001b** *ETIKETA E REGJISTRIMIT, Lloji i regjistrimit*

**1XX** *BLLOKU PËR TË DHËNAT E KODUARA (për llojet e tjera të materialeve)*

**200b** *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË, Përcaktimi i përgjithshëm i materialit*

**500b** *TITULLI UNIFORM, Përcaktimi i përgjithshëm i materialit*

## **SHEMBUJ**

1.

106	□□	<b>ae</b> <i>(Njësia është gazetë.)</i>
-----	----	--

## 110 BURIMET NË VAZHDIM

Fusha përmban të dhëna të koduara, të cilat kanë të bëjnë me burimet në vazhdim, përfshirë edhe seritë monografike, kur katalogohet seria si tërësi dhe jo botimet e veçanta.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
110	Burimet në vazhdim	nr
	<b>a</b> <i>Lloji i burimit në vazhdim</i>	nr
	<b>b</b> <i>Periodiciteti i botimit</i>	nr
	<b>c</b> <i>Rregullsia</i>	nr
	<b>d</b> <i>Kodi për llojin e materialit</i>	nr
	<b>t</b> <i>Faktori i ndikimit**</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 110a Lloji i burimit në vazhdim

<b>a</b>	<p><i>periodik</i></p> <p>Lloji i burimit në vazhdim, i cili zakonisht botohet më shumë se një herë në vit dhe karakteristike e të cilit është shumëllojshmëria e kontributeve dhe autorëve, si në kuadër të një numri ashtu edhe ndërmjet numrave të ndryshëm. Botimet periodike mund të jetë në formë të shtypur ose digjitale. Midis tyre bëjnë pjesë revistat shkencore, revistat për publikun e përgjithshëm, direktoritë e shtypura dhe buletinët informativë.</p> <p>Kodi tregon grupin e gjerë të botimeve periodike dhe mund ta përdorni nëse nuk dëshironi të vendosni kod më të saktë. Në rast të kundërt i jepet përparësi kodeve për llojet e veçanta të botimeve periodike.</p>
<b>b</b>	<p><i>seri monografike</i></p> <p>Botohet e rregullt ose e parregullt dhe zakonisht ka numërtim. Seria ka titullin e saj të përhershëm, ndërsa secila pjesë/vëllim i veçantë ka titullin e saj. Pjesa/vëllimi i veçantë shpesh ka edhe autorin e vet. Zakonisht secili vëllim përmban një pjesë ose grupin e pjesëve të lidhura mes vete.</p>
<b>c</b>	<p><i>gazetë</i></p> <p>Lloji i botimit periodik, karakteristike e të cilit është se përmban të dhëna për ngjarjet aktuale dhe i dedikohet publikut të gjerë. Botohet në intervale të caktuara ose të shpeshta (çdo ditë, një herë në javë, çdo katërbëdhjetë ditë) dhe zakonisht është i shtypur në kolonë (shih shembujt 3, 4).</p>
<b>d</b>	<p><i>direktori</i></p> <p>Lista e të dhënave për identifikimin ose kërkimin e personave, gjësendeve, organizatave ose vendeve, të cilat mund të jenë të renditura sipas radhës alfabetike, kronologjike ose të klasifikuara</p>

	<p>ndryshe në mënyrë sistematike dhe kohë pas kohe përditësohen. Direktoritë mund të jenë të shtypura ose digjitale.</p> <p>Nëse nuk dëshironi kode të sakta, për direktorinë e shtypur mund të përdorni kodin "a", ndërsa për direktorinë digjitale kodin "g".</p>
<b>e</b>	<p><i>fletë të palidhura me përmbajtje të këmbyeshme</i></p> <p>Burim në vazhdim që përbëhet nga një ose disa vëllime dhe përmbajtja e të cilit përditësohet me faqe të veçanta, të cilat shtohen, largohen ose zëvendësohen (shih shembullin 6).</p>
<b>f</b>	<p><i>bazë të dhënash</i></p> <p>Koleksion i të dhënave të lidhura mes vete, që ruhen në një ose në disa skedarë kompjuterikë. Zakonisht krijohet dhe mirëmbahet me ndihmën e sistemit për administrimin e bazave të të dhënave dhe është i disponueshëm përmes ndërfaqes për kërkim (shih shembujt 5, 7).</p> <p>Nëse nuk dëshironi kode të sakta, mund të përdorni kodin "g".</p>
<b>g</b>	<p><i>faqe elektronike</i></p> <p>Koleksioni i faqeve elektronike dhe përmbajtjeve të ngjashme, që ndryshon ose përshtatet me qëllimin e sigurimit të informacioneve më të reja (shih shembullin 8).</p> <p>Kodi përdoret kur nuk dëshironi të vendosni kode të sakta. Në rast të kundërt i jepet përparësi kodeve për llojet e veçanta të faqeve elektronike ("f", "h", "d" (vlenë për direktorinë digjitale), "i").</p>
<b>h</b>	<p><i>blog</i></p> <p>Botim periodik online në faqe elektronike, që mund të përmbaj linqe dhe/ose komente në ndonjë temë (të ngushtë ose të gjerë), shpesh në formë të artikujve të shkurtër, të cilët në aspektin kronologjik janë të klasifikuar në atë mënyrë që më të rinjt shfaqen në fillim.</p> <p>Përmbajtjen e blogit e shkruan ose e përzgjedh pronari i faqes elektronike ose kontribuojnë përdoruesit (shih shembullin 9).</p> <p>Nëse nuk dëshironi kode të sakta, mund të përdorni kodin "g".</p>
<b>i</b>	<p><i>repositor</i></p> <p>Arkiv i kopjeve digjitale të produksionit intelektual të disa institucioneve ose grupit të institucioneve (sidomos atyre akademike dhe kërkimore) me qëllim mbledhjen, ruajtjen dhe transmetimin e këtyre kopjeve. Mund të jetë edhe koleksion i materialeve në një temë të caktuar ose nga një komunitet i caktuar. Përfshinë materialet e shtypura online, raportet teknike, tezat dhe disertacionet, grupin e të dhënave dhe materialet për mësimdhënie e mësimnxënie.</p>
(Burim elektronik me qasje nga largësia. Përmban të dhëna dhe program; midis dy përcaktimeve të burimit është shënuar lidhësja "dhe".)

7. \* COBISS.net

135 □□ **av bi**  
230 □□ **a**Multimedia ndërvepruese  
(Regjistrim për faqen elektronike interaktive me kombinim të disa mjediseve. Të dhënat në fushën 230 duhet të pëputhen me të dhënat e koduara në fushën 135.)

8. \* COBISS.net

135 □□ **av bh**  
215 □□ **a**1 disk oprik (CD-ROM) **d**12 cm  
230 □□ **a**Të dhëna tekst dhe programe  
(Fusha 230 mund të plotësohet edhe te burimet elektronike me qasje lokale. Të dhënat në fushat 215 dhe 230 duhet të pëputhen me të dhënat e koduara në fushën 135.)



## 9. \* COBISS.net

135	□□	<b>ad bi</b>
230	□□	<b>a</b> Revistë elektronike <i>(Regjistrim për një revistë elektronike.)</i>

## 10. \* COBISS.net

135	□□	<b>ad bi</b>
230	□□	<b>a</b> Libër elektronik



## 251 ORGANIZIMI DHE KLASIFIKIMI I MATERIALEVE

Fusha përmban të dhënat për organizimin dhe klasifikimin e materialeve brenda një koleksioni si dhe të dhënat për pozitën e njësisë në hierarkinë e përshkrimit arkivor.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
251		Organizimi dhe klasifikimi i materialeve	r
	<b>a</b>	<i>Organizimi</i>	r
	<b>b</b>	<i>Klasifikimi</i>	r
	<b>c</b>	<i>Niveli</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 251a Organizimi

Mënyra, në të cilën materiali i përshkruar është ndarë në njësi më të vogla, p.sh. koleksioni në grupe, grupet në nëngrupe.

### 251b Klasifikimi

Shprehjet, me të cilat është përshkruar mënyra e klasifikimit të materialeve në njësi (sipas radhës alfabetike, kronologjike etj.).

### 251c Niveli

Shprehja, me të cilën identifikohet pozicioni i materialeve të përshkruara në tërë hierarkinë e përshkrimit.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**001d** *ETIKETA E REGJISTRIMIT, Niveli hierarkik*

Kodi tregon nëse regjistrimi është i lidhur në mënyrë hierarkike me regjistrimet e tjera dhe cila është pozita e tij në hierarkinë e përshkrimit.

## SHEMBUJ

1.

200	1□	<b>a</b> Николай II, император. 1868-1918 <b>j</b> 1860-1991
251	□□	<b>a2</b> описи <b>c</b> Фонд <i>(Koleksioni i letrave të carit rus Nikolaj II., të ndara në dy grupe.)</i>

2. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> Trashëgimia e Lasgush Poradecit <b>j</b> 1920-1987
251	□□	<b>c</b> Fondi <b>a</b> Trashëgimia është organizuar në 10 grupe

200	1□	<b>a</b> Letërkëmbimi <b>j</b> 1920-1987
251	□□	<b>c</b> Grupi <b>b</b> Letrat janë klasifikuar sipas radhësalfabetike të dërguesve <i>(Trashëgimia e Lasgush Poradecit është përshkruar në regjistrimin për koleksionet. Fondi në tërësi është i ndarë në 10 grupe, të cilat janë përshkruar në detaje në regjistrimet e veçanta. Një nga grupet është letërkëmbimi i Lasgush Poradecit. Në regjistrimin për letërkëmbimin, në fushën 251 vendoset shënimi se letërkëmbimi është klasifikuar sipas radhës alfabetike.)</i>

---

# 3XX BLOKU I SHËNIMEVE

## LISTA E FUSHAVE

- 300 Shënimi i përgjithshëm
- 301 Shënimi për numrin e identifikimit
- 304 Shënimi për titullin dhe përgjegjësinë\*\*
- 305 Shënimi për botimin dhe historinë bibliografike\*\*
- 306 Shënimi për botimin, shpërndarjen etj.\*\*
- 311 Shënimi për fushën në lidhshmëri
- 314 Shënimi për përgjegjësinë intelektuale
- 316 Shënimi për kopjen që katalogohet
- 317 Shënimi për prejardhjen
- 318 Shënimi për procedurën
- 320 Shënimi për bibliografitë/indekset/përmbledhjet brenda burimit
- 321 Shënimi për indekset/abstraktet/referimet jashtë burimit
- 322 Shënimi për bashkëpunëtorët (materiale projektimi, video dhe regjistrime zanore)
- 323 Shënimi për interpretuesit (materiale projektimi, video dhe regjistrime zanore)
- 324 Shënimi për origjinalin
- 325 Shënimi për riprodhimin
- 326 Shënimi për periodicitetin
- 327 Shënimi për përmbajtjen
- 328 Shënimi për disertacionin (tezën)
- 330 Përmbledhja ose abstrakti
- 333 Shënimi për përdoruesit
- 334 Shënimi për çmimin
- 336 Shënimi për llojin e burimit elektronik
- 337 Shënimi për kërkesat e sistemit
- 338 Shënimi për financimin

Bloku 3XX korrespondon me zonën e shtatë të përshkrimit bibliografik të ISBD-së. Ky bllok përmban shënime (në formë të tekstit të lirë) që plotësojnë ose shpjegojnë përshkrimin, si dhe përshkruajnë formën dhe përmbajtjen e njësisë.

Shenjat e pikësimit, përmbajtjen dhe formën e disa shënimeve i përcakton ISBD. Shënimet bëhen në gjuhën e kataloguesit, ndërsa frazat hyrëse dhe shkurtesat duhet të jenë standarde.

Nëse një shënim në aspektin e përmbajtjes i përket më shumë se një llojt të shënimeve midis fushave 301 deri 318, atë e e vendosni në fushën e parë përkatëse. Shënimet, të cilat i përkasin fushave nga 320 e tutje, vendosen në këto fusha dhe jo në fushat e mëparshme. Nëse dy shënime i përkasin të njëjtit lloj të shënimeve, secila nga ato vendoset në fushën e vet, që do të thotë se fusha përsëritet.

Shënimi mund të përftohet edhe në mënyrë automatike nga të dhënat në fushat e tjera, p.sh. nga fushat në lidhshmëri 4XX. Nëse shënimi krijohet nga fushat e tjera, ai nuk vendoset në fushat 3XX.

## 300 SHËNIMI I PËRGJITHSHËM

Fusha përmban shënimin e përgjithshëm për njësinë bibliografike ose për regjistrimin e saj bibliografik.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
300	Shënimi i përgjithshëm	r
a	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Treguesi për shfaqjen**</i></b>
	0	<i>Shfaqet në katalogë dhe bibliografi</i>
	1	<i>Shfaqet në katalogë</i>
	□	<i>Nuk jepet informacion</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 300a Teksti i shënimit

Shënimi i përgjithshëm në forma të ndryshme.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Çdo shënim i veçantë bëhet në një fushë të përsëritshme 300.

Në fushën 300 vendosen edhe shënimet për të cilat nuk ekziston një fushë e veçantë në bllokun 3XX.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

Shih fushat e tjera për shënime.

## SHEMBUJ

1.

300 □□ **a**Skeleton outline of events contemporary of Lady Margaret Roper (Alexander Alesius) : (1 folded leaf) in pocket  
(*Shënim për materialin e bashkëngjitur.*)

2.

300 □□ **a**Containing details of hunts, including their countries, histories and former Masters of Foxhounds, Harriers, Staghounds, Draghounds, Beagles, Basset Hounds, Otterhounds and Bloodhounds in the United Kingdom and Ireland; hunts of America, the Commonwealth and Europe, results of hound shows, three maps showing boundaries of foxhounds and one of distribution of hare hunts.

3. \* COBISS.net

300 □□ **a**Tit. i origj.: Tristram Shandy  
300 □□ **a**Jeta dhe mendimet e zotriut Tristram Shandy / Katarina Bogataj: f. 271-278  
(*Shënimi për titullin e origjinalit që ndodhet në botim dhe shënimi për shtojcën në përmbajtje. Numri i faqeve gjithmonë shënohen pas titullit dhe përgjegjësisë.*)

4. \* COBISS.net

300 □□ **a**Tit. i saktë origj.: Brandvägg; përkthyer nga angl.  
(*Shënimi i titullit origjinal, i cili nuk ndodhet në burimin e përshkruar.*)

5. \* COBISS.net

300 □□ **a**Punimet në shqip ose gjermanisht; përmbledhjet në gjuhën e punimeve dhe në anglisht.  
(*Te përmbledhjet e punimeve, shënimi për gjuhët e tekstit kryesor (punimeve) dhe shënimi për gjuhët e përmbledhjeve mund të bashkohen në një shënim të vetëm.*)

6. \* COBISS.net

300 □□ **a**Got.  
(*Shënimi për shkrimin.*)

7. \* COBISS.net

001 □□ **7cc**  
300 □□ **a**Превод на делото: La femme rompue / Simone de Beauvoir  
300 □□ **a**Белешка за авторот: стр. 236-237  
(*Shkrimi i katalogimit është cirilik maqedon (shih nënfushën 0017). Në shënimin e parë është vendosur titulli i origjinalit që duhet të shfaqet në shkrim latin.*)



## 301 SHËNIMI PËR NUMRIN E IDENTIFIKIMIT

Fusha përmban shënimin për çdo numër identifikimi që ndodhet në njësi ose në regjistrim.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
301	Shënimi për numrin e identifikimit	r
a	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 301a Teksti i shënimit

Shënimi për çdo numër identifikimi që ndodhet në dokument ose ju ka ndarë atij dokumenti.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha mund të përdoret për të shënuar vetë numrat, nëse ata nuk mund të shënohen në asnjërën nga fushat 010 deri 071 që kanë të bëjnë me numrat e identifikimit ose për shpjegimin e numrave të caktuar. Shënimi për çdo numër identifikimi bëhet në fushën e përsëritshme 301.

Para numrit mund të shënohet fraza përkatëse hyrëse, p.sh. "Numri i kontratës:" ose "Nr. i brend.:".

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 0XX BLOKU I IDENTIFIKIMIT

Shënimi i të dhënave në fushat e bllokut të identifikimit rekomandohet kur të dhënat janë në formë të strukturuar.

## SHEMBUJ

1.

071	20	<b>a</b> B. & H. 8797 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
071	20	<b>a</b> B. & H. 8798 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
071	20	<b>a</b> B. & H. 8799 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
071	20	<b>a</b> B. & H. 8800 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
071	20	<b>a</b> B. & H. 8801 <b>b</b> Breitkopf & Härtel
301	□□	<b>a</b> Plate no.: B. & H. 8797-8801 <i>(Numrat e pllakave për materialet muzikore janë shënuar në fushat e përsëritura 071. Shënimi i përbashkët për numrat e pllakave është bërë në fushën 301.)</i>

2. \* COBISS.net

301	□□	<b>a</b> Nr. i brend.: 21/185-91
712	01	<b>a</b> Tiranë <b>b</b> Universiteti i Mjekësisë 4400 <i>(Hulumtimi me numër të brendshëm 21/185-91 është bërë me porosinë e Universiteti të Mjekësisë në Tiranë.)</i>

3. \* COBISS.net

301	□□	<b>a</b> Numri i kontratës: 616-18-487-1/C128
301	□□	<b>a</b> Numri i kontratës: 616-18-123-2/C129 <i>(Raporti për rezultatet e hulumtimeve ka dy numra kontrate: 616-18-487-1/C128 dhe 616-18-123-2/C129.)</i>

4. \* COBISS.net

301	□□	<b>a</b> Nr. i patentës: 20404
-----	----	--------------------------------

5. \* COBISS.net

301	□□	<b>a</b> Numri qarkullues: AD/C/Y5389Tri/1/5.04/4000
-----	----	--

## 304 SHËNIMI PËR TITULLIN DHE PËRGJEGJËSINË\*\*

Fusha përmban shënimin që ka të bëjë me titullin ose përgjegjësinë në fushën 200.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
304		Shënimi për titullin dhe përgjegjësinë**	r
	a	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 304a Teksti i shënimit

Shënimi për titullin dhe përgjegjësinë.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në shënime mund të vendoset burimi i titullit ose teksti nga titulli që është lënë jashtë përshkrimit. Gjithashtu mund të shpjegohen ose zgjerohen të dhënat për përgjegjësinë. Kur në njësi janë më shumë se tre emra, në fushën 200 shënohet vetëm emri i parë, ndërsa emrat e tjerë mund të shënohen në fushën 304 (shih shembullin 4). Fusha përsëritet për çdo shënim.

Te burimet elektronike sipas ISBD(ER) gjithmonë duhet të shënohet burimi i titullit kryesor (shih shembujt 5, 8).

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 305 SHËNIMI PËR BOTIMIN DHE HISTORINË BIBLIOGRAFIKE\*\*

Fusha 305 përdoret për shënimin e titujve të mëhershme ose të mëvonshme të lidhur me titullin në fushën 200.

### 314 SHËNIMI PËR PËRGJEGJËSINË INTELEKTUALE

Fusha 314 përdoret për shënimin e të dhënave për përgjegjësinë intelektuale që nuk janë të shënuar në fushën 200.

## SHEMBUJ

1.

200	1□	<b>a</b> Who did/done it <b>ea</b> crime reader for students of English <b>f</b> Carlos A. Yoico, L. A. Morse
304	□□	<b>a</b> The word "done" in the title is crossed out. <i>(Titulli në faqen e titullit është shënuar në formën "Who did done it".)</i>

2.

304	□□	<b>a</b> Cover title <i>(Titulli i saktë është marrë nga kapaku.)</i>
-----	----	--

3.

304	□□	<b>a</b> Written by F. G. Cockman as if by Horace Mann <i>(Teksti në faqen e titullit: Midland Engineman by Horace Mann edited by F. G. Cockman. Shënimi tregon se dokumentin e ka shkruar F. G. Cockman, i cili ka respektuar dhe ripunuar raportin e Horace Mann.)</i>
-----	----	---

4.

200	1□	<b>a</b> Philosophy and literary criticism <b>f</b> edited by F. R. Leavis [et al.]
304	□□	<b>a</b> Edited by F. R. Leavis, A. C. Quine, A. Kenny and R. Quirk <i>(Kur për veprën janë përgjegjës më shumë se tre persona, në shënime vendosen emrat e të gjithëve.)</i>

5.

304	□□	<b>a</b> Title from home page <i>(Sipas ISBD(ER) shënimi për burimin e titullit të saktë të burimit elektronik është i detyrueshëm.)</i>
-----	----	---

6. \* COBISS.net

304	□□	<b>a</b> Tit. në kapak: Live USA <i>(Shënimi për variantin e titullit.)</i>
-----	----	--

7. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> Shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore <b>b</b> Material grafik
304	□□	<b>a</b> Tit. i fotografisë është përshkruar nga shpina e librit

8. \* COBISS.net

304	□□	<b>a</b> Tit. nga ekrani.
-----	----	---------------------------

## 305 SHËNIMI PËR BOTIMIN DHE HISTORINË BIBLIOGRAFIKE\*\*

Fusha përmban shënimin që ka të bëjë me botimin e njësisë ose me historinë e saj bibliografike.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
305		Shënimi për botimin dhe historinë bibliografike**	r
	<b>a</b>	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 305a Teksti i shënimit

Shënimi për botimin dhe historinë bibliografike.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban shënime për botimin e njësisë ose për veprat që lidhen me njësinë, nëse në regjistrim nuk ndodhet fushë përkatëse 4XX për lidhje. Fusha përsëritet për çdo shënim.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 300 SHËNIMI I PËRGJITHSHËM

Në vend të fushës 305 mund të përdoret fusha 300.

### 311 SHËNIMI PËR FUSHËN NË LIDHSHMËRI

Fusha përdoret për shënimet rreth historisë bibliografike, që lidhen me fushat në lidhshmëri.

### 4XX BLOKU PËR LIDHJE

Shënimet e caktuara për historinë bibliografike krijohen në mënyrë automatike nga fushat 4XX.

## SHEMBUJ

1.

305 □□ **a**V. 2. 2nd ed.  
*(Regjistrimi është për monografinë që është botuar në tri vëllime. Vetëm vëllimi i dytë është botim i dytë.)*

2.

305 □□ **a**Previous ed.: 1978  
*(Njësia është botuar në vitin 1980. Botimi i mëparshëm me të njëjtin titull ka dalë në vitin 1978.)*

3.

305 □□ **a**Originally published: London : Constable, 1957

4.

305 □□ **a**"A tentative draft for the experimental use, not yet approved by the Committee on Administrative Practice" - Pref.  
*(Teksti i shënimeve është marrë nga njësia, për këtë arsye janë përdorur thonjëzat. Është shënuar edhe burimi i të dhënave.)*

5.

305 □□ **a**"Five of the stories were published in the compiler's "T'ai-wan pen-ti tso-chia tuan-p'ien hsiao-shuo hsun" published in 1972" - CIP data  
*(Teksti i shënimeve është marrë nga CIP-i.)*

6. \* COBISS.net

305 □□ **a**Regjistruar nga shoqata e filmit: Columbia pictures  
*(Shënimi në regjistrimin për videokasetën që është publikuar në Shqipëri.)*

## 306 SHËNIMI PËR BOTIMIN, SHPËRNDARJEN ETJ.\*\*

Fusha përmban shënimin për botimin e njësisë, shpërndarjen etj.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
306		Shënimi për botimin, shpërndarjen etj.**	r
	<b>a</b>	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 306a Teksti i shënimit

Shënimi për botimin, shpërndarjen etj.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban të dhënat për botimin dhe shpërndarjen e njësisë, të cilat nuk janë në fushën 210 – *Botimi, shpërndarja etj.* Fusha përsëritet për çdo shënim.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 210 *BOTIMI, SHPËRNDARJA ETJ.*

Disa rregulla të katalogimit përcaktojnë shënimin e të dhënave për shpërndarësin dhe shtypshkronjën në fushën 306 (shih shembullin 1).

### 620 *KËRKIMI ME VEND TË BOTIMIT*

Në fushën 620 mund të shënohet vendi i botimit, shpërndarjes etj. në formën e pështatshme për kërkim.

**SHEMBUJ**

1.

306	□□	<b>a</b> The imprint is false; printed by Ruddiman on the evidence of the ornaments
-----	----	---

2.

306	□□	<b>a</b> Imprint in volume 3: Tring : Lion Press <i>(Imprint në vëllimin e tretë të botimit që ka dalë në tri vëllime, ndryshon nga e dhëna në dy vëllimet e para.)</i>
-----	----	--

3. \* COBISS.net

306	□□	<b>a</b> Film i xhiruar në bashkëpunim me RTK-në, me mbështetje financiare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
-----	----	---



## 311 SHËNIMI PËR FUSHËN NË LIDHSHMËRI

Fusha përmban shënimin që ka të bëjë me një nga fushat në lidhshmëri 4XX.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
311		Shënimi për fushën në lidhshmëri	r
	a	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 311a Teksti i shënimit

Shënimi për fushën në lidhshmëri.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret për shënimet në lidhje me të dhënat në fushat 4XX. Këto fusha përdoren për të shfaqur marrëdhënien midis njësisë së përshkruar dhe njësisë që është e lidhur me të. Nëse shënimi në fushën 4XX nuk tregon këtë marrëdhënie, bëhet shënim në fushën 311 (në këtë rast treguesi në fushën 4XX duhet të ketë vlerën "0" – *Shënimi nuk shfaqet*). Fusha 311 parasgjithash përdoret për shënimin për fushën në lidhshmëri 488, kjo do të thotë për të shpjeguar marrëdhënien midis njësisë së përshkruar dhe njësisë në fushën 488. Fusha përsëritet për çdo shënim.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**305** *SHËNIMI PËR BOTIMIN DHE HISTORINË BIBLIOGRAFIKE\*\**

Fusha përdoret për të bërë shënim për historinë bibliografike që lidhet me fushat në lidhshmëri.

**4XX** *BLLOKU PËR LIDHJE*

**SHEMBUJ**

1.

311	□□	<b>a</b> Produced in conjunction with the "Bloodstock breeders' annual".
488	□0	<b>a</b> Bloodstock breeders' annual <i>(Në fushën 311 është përshkruar marrëdhënia midis njësisë së përshkruar dhe asaj në lidhshmëri. Në regjistrimin për njësinë me titull "The stallion review" në fushën 488 është vendosur njësia në lidhshmëri me titullin "Bloodstock breeders' annual". Vlera e treguesit në fushën 488 është "0" – Shënimi nuk shfaqet.)</i>

## 314 SHËNIMI PËR PËRGJEGJËSINË INTELEKTUALE

Fusha përmban shënimin rreth përgjegjësisë intelektuale për veprën.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
314	Shënimi për përgjegjësinë intelektuale	r
a	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 314a Teksti i shënimit

Shënimi rreth përgjegjësisë për veprën, mirëpo jo shënimi për të dhënat e përgjegjësisë që bëhet në fushën 300.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret për shënimet rreth përgjegjësisë intelektuale (persona ose organizata), të cilët nuk janë shënuar në përshkrimin kryesor. Çdo shënim bëhet në një fushë të përsëritshme 314.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 300 SHËNIMI I PËRGJITHSHËM

Shënimi për përgjegjësinë bëhet në fushën 300 dhe jo në fushën 314.

### 338 SHËNIMI PËR FINANCIMIN

Fusha përdoret për shënimin e të dhënave për kontratën, programin dhe projektin, kur vepra është rezultat i një projekti të financuar.

### 7XX BLOKU I TË DHËNAVE PËR PËRGJEGJËSINË

Të dhënat për përgjegjësinë nga fusha 314 shënohen edhe në bllokun 7XX.

**SHEMBUJ**

1.

314	uu	<b>a</b> "Sponsored by the Environmental Mutagen Society" <i>(Kjo e dhënë nuk ndodhet në fushën 200.)</i>
-----	----	--

2.

314	uu	<b>a</b> Compiled by Samuel French Ltd.
-----	----	---

3.

314	uu	<b>a</b> Designed and compiled by the Publication Relations Unit, Melbourne
-----	----	---

4.

314	uu	<b>a</b> Text by Denise Hooker
-----	----	--------------------------------

5.

314	uu	<b>a</b> Compiled by J. W. Jolliffe
-----	----	-------------------------------------

6.

314	uu	<b>a</b> Commissioned by the Royal Australian College of Surgeons
-----	----	---

7. \* COBISS.net

200	0u	<b>a</b> Katalogu i veprave artistike <b>f</b> Artan Dado <b>g</b> [autor i tekstit profesional Mirko Gashi <b>g</b> fotografitë Fjolla Nalbani]
314	uu	<b>a</b> Ekspozuan: Vullnet Demo, Gresa Koçi, Marina Hazizi, Faton Ismajli dhe Drin Basha <i>(Shënimi për përgjegjësinë intelektuale që nuk është shënuar në fushën 200.)</i>

8. \* COBISS.net

314	uu	<b>a</b> Ekspozita porositur nga: Fakulteti i Arteve në Prishtinë
-----	----	---

9. \* COBISS.net

200	0u	<b>a</b> Kisha katolike në Kosovë <b>b</b> Burim elektronik <b>f</b> Alban Rama, Valentina Buja <b>g</b> dizajni Violeta Ndreca
314	uu	<b>a</b> Këshilltar profesional: Instituti Shqiptar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore

## 316 SHËNIMI PËR KOPJEN QË KATALOGOHET

Fusha përmban shënimin që lidhet me kopjen e veçantë të monografisë. Shënimi në këtë fushë korrespondon me shënimin në zonën e shënimeve në ISBD.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
316	Shënimi për kopjen që katalogohet	r
	<b>a</b> <i>Teksti i shënit</i>	r
	<b>0</b> <i>Numri i vendit për të cilin zbatohet fusha*</i>	nr
	<b>5</b> <i>Institucioni për të cilin zbatohet fusha</i>	nr
	<b>9</b> <i>Numri i inventarit për të cilin zbatohet fusha*</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 316a Teksti i shënit

Shënimi për karakteristikat e kopjes që përshkruhet te monografitë, p.sh. për fletët që mungojnë, lidhjen, kopjet e numërtuara në kuadër të një botimi etj.

### 3160 Numri i vendit për të cilin zbatohet fusha\*

Nëse institucioni ka më shumë se një kopje vendoset numri i vendit të kopjes për të cilin zbatohet fusha.

### 3165 Institucioni për të cilin zbatohet fusha

Emri i institucionit në formë të koduar. Shënohet numri identifikues i bibliotekës (kodi).

## 3169 Numri i inventarit për të cilin zbatohet fusha\*

Në nënfushë shënohet numri i inventarit i kopjes për të cilën zbatohet fusha, si lidhje me të dhënat e koleksioneve të bibliotekës. Nëse përshkruhet botimi me shumë vëllime dhe janë disa numra inventari, ata ndahen nga njëri-tjetri me ";".

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në regjistrim zakonisht përshkruhet kopja ideale. Në këtë fushë vendosen karakteristikat e kopjes, të cilën e keni në dorë, p.sh. fletët që mungojnë, karakteristikat e kopjes, lidhja, kopjet e numërtuara të një botimi, shënimet me dorë në faqen e titullit ose anash, fletët e lidhura, njësitë etj. Për shumë botime të vjetra është vështirë të përcaktohet, nëse karakteristikat e një kopjeje vlejnë edhe për kopjet e tjerat ose për të gjitha kopjet.

Fusha mund të përmbaj këto karakteristika të kopjes që katalogohet:

- karakteristikat e kopjes (shih shembujt 1, 4, 11)
- kopjet e numërtuara të një botimi (shih shembujt 3, 7)
- fletët që mungojnë, zbrazëtirat dhe dëmtimet (shih shembujt 2, 9, 13, 14)
- niveli i ruajtjes së njësisë
- lidhja dhe dimensionet (shih shembujt 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13)
- titulli artificial (titulli që vendos kataloguesi më pas, p.sh. kur njësia është lidhur sërish)

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 141 *ANTIQUARËT – KARAKTERISTIKAT E KOPJES*

Fusha përmban të dhëna të koduara që kanë të bëjnë me karakteristikat e kopjeve të veçanta të monografive të vjetra.

### 317 *SHËNIMI PËR PREJARDHJEN*

Fusha përmban shënimin për prejardhjen e njësisë, p.sh. për exlibrisin (etiketa e librit), nënshkrimin e autorit ose pronarit, vulën etj.

### 321 *SHËNIMI PËR INDEKSET/ABSTRAKTET/REFERIMET JASHTË BURIMIT*

Fusha mund të përdoret edhe për regjistrimin e referimeve bibliografike që kanë të bëjnë me njësinë që përshkruhet (p.sh. ekspozitat e katalogëve etj.).

### 481 *LIDHUR NË KËTË VËLLIM EDHE*

Fusha përdoret për lidhjen e njësisë kryesore me njësitë e lidhura. Përdoret kryesisht për monografitë e vjetra (antikuarët).

### 482 *LIDHUR ME*

Fusha përdoret për lidhjen e njësisë tjera me njësinë kryesore. Përdoret kryesisht për monografitë e vjetra (antikuarët).

**SHEMBUJ**

1.

316	□□	aLeaves 15-6 bound between h3 and h4 5DLC
-----	----	---

2.

316	□□	aWanting all after p. 312 5CaOONL
-----	----	-----------------------------------

3.

316	□□	aNo. 23 of an edition of 75 copies 5Uk
-----	----	--

4.

316	□□	aMs notes by the author 5DLC
-----	----	------------------------------

5.

316	□□	aGilt-tooled centrepiece binding by Williamson of Eton, ca. 1605 5UkCU
-----	----	--

6.

316	□□	aEarly 18thcentury blind-tooled panelled calf binding 5Uk
-----	----	---

7.

316	□□	aLimited to 1000 copies signed by the author. Knopf copy is no. 281. 5TxAuHRH 0PR6023 L2 1928B HRC KNOPF <i>(Romani "Lady Chatterley's lover" D. H. Lawrencea në vitin 1928 është shtypur në 1000 kopje në Firencë. Një nga kopjet ndodhet në Alfred/Blanche Knopf Library, Harry Ransom Humanities Research Center, University of Texas, e cila ruan shumë botime të kësaj vepre.)</i>
-----	----	---

8.

316	□□	aAnche legato con: Nuovi esperimenti di Gianbattista Beccaria ... per confermare, ed estendere la meccanica del fuoco elettrico; e con: Della elettricità terrestre atmosferica a ciel sereno aLegatura in pelle; dorso ornato; piatti della cop. con cornice dorata; tagli in rosso; (26x20x6 cm) 5IT-TO0741 MOS : SV 327
-----	----	--

9.

316	□□	aFront. di insieme mancante; libro quinto mancante; p. 121-124 mancanti aLegatura in pergamena rigida; (24x18x5 cm) 5IT-TO0741 MOS : SV 320
-----	----	--

10.

316	□□	aP. 121-135 déchirées avec mq. de texte aRel. avec : "Essequie dell'illustre sig. Alessandro abate Pucci ...dal M. R. P. M. Arcangelo Giani...", 1601, et "Poesie latine, e toscane nell'essequie del molto illust. e reverendissimo signor Alessandro abate Pucci...", 1601 aCartonnage plein papier à la colle rose aEx-libris ms. : "Bibliotheca Colbertina" ; l'ouvragea peut-être figuré dans la bibliothèque du vivant de Jean-Baptiste Colbert. Ex-libris ms. : Abbaye de Saint-Germain des Prés, à Paris aEstampille de la bibliothèque du tribunal, à Paris. Estampille de la Bibliothèque royale (1782-1792 et 1815-1817) 5FR-751131010:YC-1129 <i>(Në nënfushat e përsëritura a janë paraqitur karakteristikat e kopjes që përshkruhet: dëmtimet (mungesa e tekstit); përshkrimi i njërive të lidhura me njësinë që përshkruhet; përshkrimi i lidhjes; ex-libris; vulat.)</i>
-----	----	---

11.

- 316 □□ **a**Papillon impr. collé sur le vers 11 ("Mes coups furent par tout plus craints que le Tonnerre :"), couvrant une version antérieure **a**Rel. dans un recueil de pièces du XVIIe s **a**Rel veau, filets sur les plats, chiffres de Nicolas Fouquet et de la compagnie de Jésus au dos, indiquant un achat sur la rente offerte par le surintendant au collège des jésuites de Paris **a**Ex-libris ms. : collège Louis-le-Grand, à Paris **a**Estampille de la Bibliothèque du Roi n° 14 sur la première pièce (1735-1782)  
*(Në nënfushat e përsëritura a janë paraqitur karakteristikat e kopjes që përshkruhet: ndryshimi në tekstin e shtypur më parë duke i bashkangjitur një shtojcë; lidhur në koleksionin artificial; përshkrimi i lidhjes; ex-libris; vulat.)*

12. \* COBISS.net

- 316 □□ **a**Kopje ka qenë e dëmtuar dhe më pas është restauruar në Bibliotekën Publike të Shkodrës: në dy fletët e para të zbrazëta është një shënim i besimit fetar apostolik dhe fillimi i një letre [?], në faqen e titullit nënshkrimi i Leopold Maximilian Raspa  
*(Nëse shënimi për kopjen dhe shënimi për prejardhjen është më mirë të bashkohen, komplet teksti vendoset në fushën 316.)*

13. \* COBISS.net

- 316 □□ **a**E prerë në 21 cm, mungojnë 22 faqet e para të panumërtuara së bashku me faqen e titullit dhe f. 1-10 dhe 589-626, faqja e titullit është përshkruar në fletën e lidhur **550001 0R 222928/3 9030000033**
- 316 □□ **a**E prerë në 20 cm, mungojnë 22 faqet e para të panumërtuara së bashku me faqen e titullit dhe f. 523-526, të cilat janë zëvendësuar me fletët e lidhura me tekstin e përshkruar
- 316 □□ **a**E prerë në 20 cm **550001 0R 10172/3 9030000031**
- 316 □□ **a**...
- (Në fushat e përsëritura 316 janë vendosur karakteristikat e kopjeve të veçanta, p.sh. fletët që mungojnë, lidhja.)*



## 317 SHËNIMI PËR PREJARDHJEN

Fusha përmban shënimin për prejardhjen e njësisë. Përputhet me shënimin për kopjen në zonën e shënimeve të ISBD(A).

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
317	Shënimi për prejardhjen	r
	<b>a</b> <i>Teksti i shënimit</i>	nr
	<b>0</b> <i>Numri i vendit për të cilin zbatohet fusha*</i>	nr
	<b>5</b> <i>Institucioni për të cilin zbatohet fusha</i>	nr
	<b>9</b> <i>Numri i inventarit për të cilin zbatohet fusha*</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 317a Teksti i shënimit

Shënimi për prejardhjen e njësisë, p.sh. për ekslibrisin, nënshkrimin e autorit ose pronarit, vulën etj.

### 3170 Numri i vendit për të cilin zbatohet fusha\*

Nëse institucioni ka më shumë se një kopje, në nënfushë shënohet numri i vendit i kopjes për të cilën zbatohet fusha.

### 3175 Institucioni për të cilin zbatohet fusha

Emri i institucionit në formë të koduar. Kur kodet e pranuar ndërkombëtarisht mungojnë, për bibliotekat sllovene vendoset kodi kombëtar (numri identifikues i bibliotekës).

## 3179 Numri i inventarit për të cilin zbatohet fusha\*

Në nënfushë vendoset numri i inventarit i kopjes për të cilën përdoret fusha, dhe atë si lidhje me të dhënat për koleksionet. Nëse përshkruhet kopja në disa vëllime dhe janë disa numra inventari, ata ndahen mes vete me ";".

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në regjistrim zakonisht përshkruhet kopja ideale. Në fushë përshkruhet prejardhja e kopjes që katalogohet, në formën siç paraqitet në libër, p.sh. ekslibrisi, nënshkrimi i autorit ose pronarit, vula etj.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 316 SHËNIMI PËR KOPJEN QË KATALOGOHET

Fusha përmban shënimin për karakteristikat e kopjes që katalogohet, p.sh. për fletët që mungojnë, lidhjen, kopjet e numërtuara në kuadër të një botimi etj.

## SHEMBUJ

1.

317	uu	aInscription on inside of front cover: Theodorinis ab Engelsberg 5Uk
-----	----	--

2.

317	uu	aInscription on the title page in sixteenth century hand, "Iohannes Wagge me iure tenet" 5DB/S-5-KK.555
-----	----	---

3.

317	uu	aRegjistrimi në faqen e tit.: "Dhuron Muzeut Kombëtar Aleksander Shue... Famullitari në Stenjevec" 5CiZaNSK 0RII F-8° - 1541a 9030000648
317	uu	aRegjistrimi në faqen e tit.: "Colegii Zagrabiensis Soc. Jesu. Inscriptus. 1698" 5CiZaNSK 0RII F-8° - 1541b 9030000567 <i>(Shënime për dedikimet, të cilat ndodhen në faqet e titujve të kopjeve të veçanta të njësisë së njëjtë.)</i>

4.

317	uu	aEx libris: "Nikolai Skerlecz de Lomniza" 5CiZaNSK 0L III H13 9398800534
-----	----	--

5.

317	uu	aRegjistrimi në faqen e tit.: "Dhuron Bibliotekës Universitare Ivan Kranj" 5CiZaNSK 0RII C-8° - 100b 9030000987
317	uu	aLartë në faqen e tit. nënshkrimi glagolitik 5CiZaNSK 0RII C-8° - 100b 9030000987 <i>(Kopjen Bibliotekës Universitare ia ka dhuruar Ivan Kranj. Në të njëjtën kopje gjendet një nënshkrim glagolitik me dorë, ndoshta nga dhuruesi.)</i>

6.

317	□□	<b>a</b> From the Library of Kenneth Roberts, with his book plate, dated 20 November 1939. <b>5ViU 0PS3535 .O176 Z42 .S8 G7 1939</b>
317	□□	<b>a</b> Author's inscription: "For Irving Bacheller I am honoured to inscribe this book. John Steinbeck Tos Gator 1939." <b>5ViU 0PS1054 .B3 Z9 .S74 G7 1939</b>
317	□□	<b>a</b> Gift of C. W. Barrett. <b>5ViU 0PS1054 .B3 Z9 .S74 G7 1939</b> <i>(Dy kopje të librit "Grapes of wrath" në Clifton Waller Barrett Library of American Literature, University of Virginia library. Në kopjen e dytë jepen dy periudha të prejardhjes së saj.)</i>

7. \*<sup>1</sup>

317	□□	<b>a</b> Izvod Marka Pohlina z lastniškim vpisom in njegovimi zapiski <b>550001 018367 9030001681</b> <i>(Nga tri kopjet e librit "Tu malu besedishe treh jesikov" të Mark Pohlin, të cilat i ruan Biblioteka Kombëtare dhe Universitare, njëra ishte në pronësi të autorit.)</i>
-----	----	--

8. \*

317	□□	<b>a</b> Iz knjižnice in z ekslibrisom (grbom) Karla Peera <b>550001 0R 4380 9030000338</b> <i>(Shënimi për ekslibrisin.)</i>
-----	----	--

9. \* COBISS.net

317	□□	<b>a</b> Vula në faqen e tit.: Biblioteka "Aleksandër Mojsiu" <b>580017 0RPallt II 1 9000250540</b>
-----	----	---

<sup>1</sup> Shembullin e ka përgatitur Biblioteka Kombëtare dhe Universitare në Lubjanë.



## 318 SHËNIMI PËR PROCEDURËN

Fusha përmban informacion për ruajtjen dhe trajtimin e materialit. Në përgjithësi përdoret për monografitë e vjetra (antikuarë).

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
318	Shënimi për procedurën	r
<b>a</b>	<i>Procedura</i>	nr
<b>b</b>	<i>Identifikimi i procedurës</i>	r
<b>c</b>	<i>Data e procedurës</i>	r
<b>d</b>	<i>Intervali kohor i procedurës</i>	r
<b>e</b>	<i>Mundësia e ekzekutimit të procedurës</i>	r
<b>f</b>	<i>Aprovimi</i>	r
<b>h</b>	<i>Kompetenca</i>	r
<b>i</b>	<i>Metoda e procedurës</i>	r
<b>j</b>	<i>Vendi i procedurës</i>	r
<b>k</b>	<i>Ekzekutuesi i procedurës</i>	r
<b>l</b>	<i>Statusi</i>	r
<b>n</b>	<i>Shtrirja e procedurës</i>	r
<b>o</b>	<i>Lloji i njësisë</i>	r
<b>p</b>	<i>Shënimi i brendshëm</i>	r
<b>r</b>	<i>Shënimi publik</i>	r
<b>0</b>	<i>Numri i vendit për të cilin zbatohet fusha*</i>	nr
<b>5</b>	<i>Institucioni për të cilin zbatohet fusha</i>	nr
<b>9</b>	<i>Numri i inventarit për të cilin zbatohet fusha*</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 318a Procedura

Përshkrimi i procedurës.

### 318b Identifikimi i procedurës

Kodi ose shenja që identifikon një procedurë të caktuar, edhe në lidhje me kohën e ekzekutimit të procedurës, p.sh. kodi i projektit.

---

**318c Data e procedurës**

Data e procedurës në formatin ISO (viti, por edhe muaji dhe dita).

---

**318d Intervali kohor i procedurës**

Nënfusha përdoret kur koha nuk mund të shprehet në formën e datës, p.sh.: në fund të vitit akademik, çdo pesë vjet (shih shembullin 7).

---

**318e Mundësia e ekzekutimit të procedurës**

Nënfusha përdoret kur koha e ekzekutimit të procedurës është e lidhur me ngjarjen e paparashikuar, p.sh. me rastin e pranimit të materialit (shih shembujt 3, 6).

---

**318f Aprovimi**

Nënfusha përmban tekst ose rregull, udhëzim etj., që ndikon në procedurë (shih shembullin 4).

---

**318h Kompetenca**

Emri i personit, institucionit ose pozitës së punës në kuadër të institucionit, përgjegjës për procedurën (shih shembullin 7).

---

**318i Metoda e procedurës**

Metoda e ekzekutimit të procedurës (shih shembullin 6).

---

**318j Vendi i procedurës**

Vendi i ekzekutimit të procedurës (shih shembullin 8).

---

**318k Ekzekutuesi i procedurës**

Emri i personit ose organizatës që ekzekuton procedurën (shih shembujt 4, 8).

---

**318l Statusi**

Gjendja e kopjes së përshkruar para ose pas ekzekutimit të procedurës (shih shembujt 1, 2, 4).

---

**318n Shtrirja e procedurës**

Nënfusha përdoret kur procedura ka të bëjë vetëm me një pjesë të njësisë (shih shembullin 5).

---

**318o Lloji i njësisë**

Nënfusha përdoret kur procedura ka të bëjë vetëm me një pjesë të njësisë (shih shembullin 5).

---

**318p Shënimi i brendshëm**

Shënim për kataloguesit.

---

**318r Shënimi publik**

Shënim për përdoruesit (shih shembullin 8).

---

**3180 Numri i vendit për të cilin zbatohet fusha\***

Nëse institucioni ka më shumë se një kopje, në këtë nënfushë vendoset numri i vendit i kopjes për të cilën zbatohet fusha.

---

**3185 Institucioni për të cilin zbatohet fusha**

Emri i institucionit në formë të koduar. Kur kodet e pranura ndërkombëtarisht mungojnë, për bibliotekat sllovene vendoset kodi kombëtar (numri identifikues i bibliotekës).

---

**3189 Numri i inventarit për të cilin zbatohet fusha\***

Në nënfushë vendoset numri i inventarit i kopjes për të cilën përdoret fusha, dhe atë si lidhje me të dhënat për koleksionet. Nëse përshkruhet kopja në disa vëllime dhe janë disa numra inventari, ata ndahen mes vete me ";".

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në regjistrim zakonisht përshkruhet kopja ideale. Të dhënat në fushën 318 lidhen vetëm me kopjen që përshkruhet.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 141 *ANTIQUARËT – KARAKTERISTIKAT E KOPJES*

Fusha përmban të dhëna të koduara që lidhen me karakteristikat e kopjes te monografitë vjetra.

## SHEMBUJ

1.

318	□□	<b>a</b> Condition reviewed <b>c</b> 19911121 <b>l</b> text stained, binding intact, water damage <b>5</b> QL/ <b>P</b> 18
-----	----	---

2.

318	□□	<b>a</b> Repaired <b>c</b> 1991 <b>l</b> original retained, rebacked <b>5</b> CA/U-1
-----	----	--

3.

318	□□	<b>a</b> Review condition <b>e</b> when deposit is complete <b>5</b> CA/U66
-----	----	---

4.

318	□□	<b>a</b> Condition reviewed <b>c</b> 19911112 <b>l</b> binding intact <b>f</b> SCAN <b>k</b> CCM <b>5</b> Uk <i>(Gjendjen e materialit në kuadër të projektit SCAN e ka verifikuar nëpunësi me inicialet CCM.)</i>
-----	----	---

5.

318	□□	<b>a</b> Fumigate <b>n</b> 12 <b>o</b> archives boxes <b>c</b> 19861010 <b>5</b> LO/N-1
-----	----	---

6.

318	□□	<b>a</b> Dispose of <b>e</b> five years after closing file <b>i</b> incinerate <b>5</b> CaQQCT
-----	----	--

7.

318	□□	<b>a</b> Review <b>d</b> Every five years <b>h</b> Archives Unit <b>5</b> CaQQCT
-----	----	--

8.

318	□□	<b>a</b> Exhibit <b>c</b> 19980401-19981231 <b>j</b> Victoria & Albert Museum <b>k</b> JStC <b>r</b> This item is on loan to the Victoria and Albert Museum until the end of the year <b>5</b> CaQQCT
-----	----	---



## 320 SHËNIMI PËR BIBLIOGRAFITË/INDEKSET/PËRMBLEDHJET BREND BURIMIT

Fusha përmban shënimin për bibliografinë, indeksin ose përmbledhjen (abstraktin) që përmban njësia.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
320		Shënimi për bibliografitë/indekset/përmbledhjet brenda burimit	r
	<b>a</b>	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Treguesi për shfaqjen**</i>
	0	<i>Shfaqet në katalogë dhe bibliografi</i>
	1	<i>Shfaqet në katalogë</i>
2		<i>Nuk është i përcaktuar</i>

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 320a Teksti i shënimit

Shënimi për bibliografitë, indeksin, përmbledhjen në çfarëdo forme.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Shënimi për secilin lloj të shtesës në përmbajtje bëhet në një fushë të përsëritshme 320.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 105 MATERIALI TEKST MONOGRAFIK

Fusha përmban të dhëna të koduara që tregojnë nëse njësia përmban bibliografi ose indeks.

### 321 SHËNIMI PËR INDEKSET/ABSTRAKTET/REFERIMET JASHTË BURIMIT

Fusha përmban shënimin për indekset, abstraktet etj. që ndodhen jashtë njësisë së përshkruar.

## SHEMBUJ

1.

320	□□	<b>a</b> Bibliography: p. 210
-----	----	-------------------------------

2.

320	□□	<b>a</b> Includes bibliographical references
-----	----	--

3.

320	□□	<b>a</b> Consists mostly of bibliographies
-----	----	--

4. \* COBISS.net

320	□□	<b>a</b> Indekse <i>(Për të gjitha llojet e indekseve (e emrave, lëndorë etj.) përdoret termi indeks ose indekse.)</i>
-----	----	---

5. \* COBISS.net

320	□□	<b>a</b> Bibliografia në fund të kapitujve
320	□□	<b>a</b> Indeks
320	□□	<b>a</b> Përmbledhje ; Summary ; Zusammenfassung ; Sunto <i>(Fusha 320 përsëritet për çdo lloj shtese në përmbajtje. Termi shënohet ashtu siç është në botim.)</i>

6. \* COBISS.net

320	□□	<b>a</b> Bibliogr.: f. 62
320	□□	<b>a</b> Indeks
320	□□	<b>a</b> Abstrakt ; Abstract

## 321 SHËNIMI PËR INDEKSET/ABSTRAKTET/REFERIMET JASHTË BURIMIT

Fusha përmban të dhëna për burimet e jashtme, të cilat kanë indekse ose abstrakte të njësisë që përshkruhet. Për materialet e rralla mund të vendoset bibliografia, katalogu etj., ku njësia është cituar ose përshkruar.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
321		Shënimi për indekset/abstraktet/referimet jashtë burimit	r
	a	<i>Teksti i shënimit</i>	nr
	u	<i>Identifikuesi Uniform i Burimit (URI)</i>	nr
	x	<i>ISSN</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Lloji i raportimit</i></b>
	0	<i>Informacion në formën e indekseve ose abstrakteve</i>
	1	<i>Citim në bibliografi, katalog</i>
	□	<i>Nuk jepet informacion</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Treguesi 1 tregon formën e përshkrimit të gjetur në burimin e jashtëm.

Vlera "0" tregon se burimi i jashtëm indeksin njësinë (shih shembullin 2). Vlera e treguesit i përshtatet frazës "Indeksuar në:".

Vlera "1" tregon se burimi i jashtëm citon njësinë (shih shembullin 3). Vlera e treguesit i përshtatet frazës "Citat bibliografik:".

Vlera *zbrazët* tregon se informacioni në fushë është tekst i lirë (shih shembullin 1).

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 321a Teksti i shënimit

Burimi i jashtëm në të cilin njësia është indeksuar ose cituar.

## 321u Identifikuesi Uniform i Burimit (URI)

Identifikuesi Uniform i Burimit – Uniform Resource Identifier ose URI (p.sh. URL ose URN) siguron të dhëna për qasje elektronike në sintaksën standarde. Këto të dhëna mund të përdoren për qasje automatike në burimin elektronik përmes njërës nga protokolet online. Nënfisha u mund të përdoret kur burimi është në dispozicion në versionin elektronik (shih shembullin 2).

## 321x ISSN

ISSN e burimit të jashtëm.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fraza hyrëse nuk krijohet në mënyrë automatike, ajo duhet të vendoset nga kataloguesi. Fusha përsëritet kur janë disa burime të jashtme.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 320 SHËNIMI PËR BIBLIOGRAFITË/INDEKSET/PËRMbledhjet BRENDA BURIMIT

Fusha përmban shënimin për bibliografitë, indeksset ose përmbledhjet në njësinë e përshkruar.

## SHEMBUJ

1.

321	□□	<b>a</b> For a list of contents see Heyer. Historical sets, collected editions and monuments of music <i>(Kompleti i partiturave i përshkruar jashtë burimit.)</i>
-----	----	---

2.

321	0□	<b>a</b> Applied science and technology index x0003-6986
321	0□	<b>a</b> Biography index x0006-3053
321	0□	<b>a</b> Chemical abstracts x0009-2258 <b>u</b> <a href="http://www.cas.org/">http://www.cas.org/</a>
321	0□	<b>a</b> Index medicus x0019-3879
321	0□	<b>a</b> International packaging abstracts x0260-7409
321	0□	<b>a</b> Readers' guide to periodical literature x0034-0464 <i>(Burim në vazhdim që e indeksojnë shërbime të ndryshme të indeksimit, gjegjësisht përpunimit të abstrakteve.)</i>

3.

321	1□	<b>a</b> Reuss, E. Bib. Novi. Testamenti Graeci, p. 35
321	1□	<b>a</b> Rudolphi, E.C. Froschauer, 336

321	1□	<b>a</b> Darlow & Moule, II, p. 586 ( <i>Libër i rrallë, i cituar në disa bibliografi.</i> )
-----	----	---

## 4. \*

200	1□	<b>a</b> The †classical journal
321	0□	<b>a</b> Education index x0013-1385
321	0□	<b>a</b> Annual bibliography of English language and literature x0066-3786
321	0□	<b>a</b> Book review index x0524-0581
321	0□	<b>a</b> Index to book reviews in the humanities x0073-5892
321	0□	<b>a</b> MLA international bibliography of books and articles on the modern languages and literatures (Complete edition) x0024-8215

## 5. \* COBISS.net

321	1□	<b>a</b> Citati bibliografik: Poradeci, Bibliografia e poetëve shqiptar nga 1715 deri 1919, Tiranë 1978, nr. 2
-----	----	--



## 322 SHËNIMI PËR BASHKËPUNËTORËT (MATERIALE PROJEKTIMI, VIDEO DHE REGJISTRIME ZANORE)

Fusha përmban emrat e personave ose organizatave që kanë bashkëpunuar në prodhimin artistik ose teknik të veprës, por nuk janë interpretuesit e saj.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
322		Shënimi për bashkëpunëtorët (materiale projektimi, video dhe regjistrime zanore)	nr
	<b>a</b>	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 322a Teksti i shënimit

Shënimi për personat ose organizatat që kanë bashkëpunuar në prodhimin e njësisë.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 200 *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË*

Nëse emrat e personave ose organizatave që kanë bashkëpunuar në prodhimin e njësisë janë të shënuar në fushën 200, fusha 322 nuk është e nevojshme.

### 323 *SHËNIMI PËR INTERPRETUESIT (MATERIALE PROJEKTIMI, VIDEO DHE REGJISTRIME ZANORE)*

Fusha përmban të dhëna për interpretuesit, grupet interpretuese etj.

### 7XX *BLLOKU I TË DHËNAVE PËR PËRGJEGJËSINË*

Të dhënat për personat ose organizatat që kanë bashkëpunuar në prodhimin e njësisë e që janë vendosur në fushën 322, vendosen edhe në bllokun 7XX.

**SHEMBUJ**

1.

322	□□	<b>a</b> Producer, Ray Jewell; writer, Don Hall; music, Jack Meakin; editor, Rick Eisman.
-----	----	---

2. \* COBISS.net

322	□□	<b>a</b> Poezitë i përzgjedhi Andi Latifi ; përktheu Antigona Kadaj. <i>(Në materialin shoqërues ndodhen edhe të dhënat përgjegjësinë që vendosen në kuadër të shënimeve.)</i>
-----	----	---

3. \* COBISS.net

322	□□	<b>a</b> Materialin nga fonoteka PGP e zgjedhi dhe krijoi post produksionin digjital Alketa Riza.
-----	----	---



## 323 SHËNIMI PËR INTERPRETUESIT (MATERIALE PROJEKTIMI, VIDEO DHE REGJISTRIME ZANORE)

Fusha përmban emrat e aktorëve, interpretuesve, tregimtarëve, prezantuesve etj. në një video ose material projektimi. Përmban gjithashtu emrat e interpretuesve bashkëpunëtor ose grupeve interpretuese dhe mënyrën e interpretimit për regjistrimet zanore.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
323		Shënimi për interpretuesit (materiale projektimi, video dhe regjistrime zanore)	r
	<b>a</b>	<i>Teksti i shënimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 323a Teksti i shënimit

Shënimi për interpretuesit, grupet interpretuese etj.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Shënimi për secilin lloj të interpretuesve bëhet në një fushë të përsëritur 323.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 200 TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË

Nëse emrat e interpretuesve janë vendosur në fushën 200, fusha 323 nuk është e nevojshme.

### 322 SHËNIMI PËR BASHKËPUNËTORËT (MATERIALE PROJEKTIMI, VIDEO DHE REGJISTRIME ZANORE)

Fusha përmban të dhëna për personat ose organizatat që nuk janë interpretues.

### 7XX BLOKU I TË DHËNAVE PËR PËRGJEGJËSINË

Të dhënat për interpretuesit nga fusha 323 vendosen edhe në bllokun 7XX.

## SHEMBUJ

1.

323	□□	<b>a</b> Cast: Mary Pickford, Claire McDowell, Dorothy Bernard, Charles West
-----	----	--

2.

323	□□	<b>a</b> Narrators: Sian Phillips and Nigel Davenport
-----	----	---

3.

323	□□	<b>a</b> Marshall Moss, violin; Neil Roberts, harpsichord
-----	----	---

4.

323	□□	<b>a</b> Narrator: Salome Jens
323	□□	<b>a</b> Cast: Daryl Hannah (Ayla), Pamela Reed (Iza), James Remar (Creb) <i>(Regjistrimi përmban dy fusha 323, për secilin lloj të interpretuesve nga një fushë. Në fushën e dytë 323 brenda klapave është vendosur edhe emri i personazhit, të cilin e luan secili anëtar i trupës.)</i>

5. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Muza <b>b</b> Regjistrim zanor <b>f</b> Robert Bunjaku <b>g</b> [Ilda Kuqi ... et. al.]
323	□□	<b>a</b> Interpretues: Orkestra Simfonike e RTSH-së, Orkestra Simfonike e Filharmonisë së Kosovës, Trupa e Baletit TOP Channel dhe Zig Zak orkestra.

6. \* COBISS.net

323	□□	<b>a</b> Luajnë: James Cromwell, Melanie Griffith, John Malkovich
-----	----	---

7. \* COBISS.net

323	□□	<b>a</b> Instrumentalistë: Jorgo Kaçinari, kitarë klasike dhe elektrike, Dren Abazi, bas kitarë, Tina Hoxha, bateri, Leonard Sopi, flautë, Sara Braho, klarinet, saksofon <i>(Regjistrim bibliografik për regjistrimin zanor "Tinguj modern" me interpretuesit në fushën 323.)</i>
-----	----	---

8. \* COBISS.net

323	□□	<b>a</b> Këngë shqipe të veriut
323	□□	<b>a</b> Këndojnë: Drita Rama dhe Era Krasta

## 324 SHËNIMI PËR ORIGINALIN

Fusha përmban të dhëna që tregojnë se njësia që përshkruhet është riprodhim, p.sh., faksimile ose mikroformë, dhe të dhëna bibliografike për origjinalin.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
324		Shënimi për origjinalin r
	<b>a</b>	<i>Teksti i shënimit</i> nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 324a Teksti i shënimit

Shënohet lloji i riprodhimit (p.sh. faksimile, mikroformë etj..) dhe të dhënat për origjinalin, të cilat mes tyre ndahen duke përdorur shenjat e pikësimit sipas udhëzimeve të ISBD-së.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 325 SHËNIMI PËR RIPRODHIMIN

Në regjistrimin për origjinalin, në fushën 325 vendosen të dhënat për riprodhimin.

## SHEMBUJ

1.

324	□□	<b>a</b> Facsimile reprint of: 1797 ed. originally published as "The complaint and the consolation, or, Night thoughts", London : Richard Edwards, 1797
-----	----	---

2.

324	□□	<b>a</b> Microform reproduction of: Mithridates, or, Mr. Newmans essay on development its own confutation, London : W.J.Cleaver, 1846.
-----	----	--

3.

200	1□	<b>a</b> William Shakespeare sonnets
210	□□	<b>a</b> London <b>c</b> Noel Douglas <b>d</b> 1926
215	□□	<b>a</b> [84] p. <b>d</b> 23 cm
225	□□	<b>a</b> Noel Douglas replicas
324	□□	<b>a</b> Facsimile of: Shake-speare's sonnets. Neuer before imprinted. - At London : By G. Eld for T. T. and are to be solde by John Wright ..., 1609. "Reproduced from the copy in the British Museum".

4. \* COBISS.net

324	□□	<b>a</b> Faksimile: Tiranë : shtypi Petro Gega, 1836 <i>(Në shënime janë vendosur të dhënat për origjinalin.)</i>
-----	----	--

## 325 SHËNIMI PËR RIPRODHIMIN

Fusha përmban shënimin që tregon se ekziston riprodhimi i njësish së përshkruar në regjistrim. Regjistrimi përshkruan origjinalin.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
325		Shënimi për riprodhimin
	<b>a</b>	<i>Teksti i shënimit</i>
		r
		nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 325a Teksti i shënimit

Vendosen të dhënat për karakteristikat e riprodhimit, të cilat e dallojnë nga origjinali. Të dhënat ndahen mes tyre duke përdorur shenjat e pikësimit sipas udhëzimeve të ISBD-së.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 324 SHËNIMI PËR ORIGJINALIN

Në regjistrimin për riprodhimin, në fushën 324 vendosen të dhënat për origjinalin.

## SHEMBUJ

1.

325	□□	<b>a</b> Microfiche. Cambridge : Chadwyck-Healy Ltd, 1988. 2 fiches ; 11x15 cm. (The Nineteenth Century : general collection ; N.1.1.18)
-----	----	--

2.

325	□□	<b>a</b> Ed. microfilme. Lisboa : Biblioteca Nacional, 1987. 1 bobine (71 imagens) ; 35 mm
-----	----	--

3.

325	□□	<b>a</b> Ed. microfилme. Lisboa : Biblioteca Nacional, 1986-1988. 3 bobines ; 35 mm
200	0	▯	<b>a</b> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
503	1	▯	<b>a</b> Kushtetuta
710	01		<b>a</b> Shqipëria

4. \* COBISS.net

200	0	▯	<b>a</b> Ligji për zjarfikje dhe shpëtim
327	10		<b>0</b> Përmban edhe: <b>a</b> Ligji për mbrojtjen nga zjarri
423	▯0		<b>12000</b> ▯ <b>a</b> Ligji për mbrojtjen nga zjarri <b>15031</b> ▯Ligjet etj. <b>171001</b> <b>a</b> Kosova
503	1	▯	<b>a</b> Ligjet etj.
710	01		<b>a</b> Kosova

*(Botimi përmban disa ligje të njësisë së njëjtë politike e territoriale. Në faqen e titullit është vetëm titulli i ligjit të parë, ligji tjetër është i fshehur.)*



## 510 TITULLI I SAKTË PARALEL

Fusha përmban titullin paralel që është titulli i saktë në gjuhën ose shkrimin tjetër.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
510	Titulli i saktë paralel	r
<b>a</b>	<i>Titulli paralel</i>	nr
<b>e</b>	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r
<b>h</b>	<i>Numri i pjesës</i>	r
<b>i</b>	<i>Titulli i pjesës</i>	r
<b>z</b>	<i>Gjuha e titullit paralel</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1" bëhet përshkrimi shtesë për titullin e saktë paralel.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 510a Titulli paralel

Titulli kryesor i njësisë në gjuhën ose shkrimin tjetër, i lidhur me titullin e saktë në nënfushën 200a.

### 510e Informacioni tjetër për titullin

Nintitujt dhe informacionet e tjera për titullin që shfaqen pranë titullit paralel në nënfushën a.

### 510h Numri i pjesës

Numri i pjesës që lidhet me titullin paralel në nënfushën a.

## 510i Titulli i pjesës

Titulli i pjesës që lidhet me titullin paralel në nënfushën a.

## 510z Gjuha e titullit paralel

Kodi për gjuhën e titullit paralel.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret për titullin paralel, për të mundësuar kërkimin e tij dhe kur dëshironi të bëni përshkrim shtesë për të.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 200d *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË, Titulli i saktë paralel*

Kur titulli paralel shfaqet bashkë me titullin e saktë, informacionet e tjera për titullin dhe të dhënat për përgjegjësinë në formën dhe renditjen nga njësia, ai vendoset në fushën 200. Nëse për titullin paralel dëshironi të bëni përshkrim shtesë atë e shënoni edhe një herë në fushën 510.

### 304 *SHËNIMI PËR TITULLIN DHE PËRGJEGJËSINË\*\**

Fusha mund të përmbaj shënimin për titullin paralel ose vetë titullin paralel, nëse ai nuk është shënuar në fushën 200.

### 541 *TITULLI I PËRKTHYER I VËNË NGA KATALOGUESI*

Tituj paralel janë titujt në gjuhët e tjera, të cilët ndodhen në njësi. Nëse titulli nuk është në njësi dhe atë e përkthen kataloguesi ose atë e merr nga një burim tjetër, ai shënohet në fushën 541.

## SHEMBUJ

1.

200	1□	<b>a</b> Resúmenes sobre población en América Latina <b>f</b> Programma de información sobre Población en America Latina <b>d</b> Latin American population abstracts <b>f</b> Latin American Population Information Program <b>zeng</b>
510	1□	<b>a</b> Latin American population abstracts <b>zeng</b> ( <i>Titulli kryesor dhe ai paralel janë vendosur në fushën 200 për shkak të përshkrimit. Institucioni katalogues ka nevojë për përshkrim shtesë të titullit, për këtë arsye titulli në gjuhën angleze është vendosur edhe në fushën 510.</i> )

2.

200	1□	<b>a</b> Information transfer
510	1□	<b>a</b> Transfert de l'information <b>zfre</b>

*(Në fushën 510 është vendosur titulli paralel për shkak të përshkrimit shtesë dhe për shkak të kërkimit.)*

## 3. \*

200	1□	<b>a</b> Post- und Eisenbahn-Reisekarte Deutschland, Holland, Belgien, die Schweiz, Italien bis Neapel, der größte Theile von Frankreich, Ungarn, Polen etc. <b>b</b> Kartografsko gradivo <b>e</b> mit besondere Rücksicht auf Eisenbahnen u. Seedampfschiffahrt <b>f</b> Originalzeichnung v. G. Hanser <b>g</b> Stahlstich der Kunst- u. geograph. Anstalt in Nürnberg
300	□□	<b>a</b> Na ov. nasl. v franc.: Carte de voyage par voies de poste et chemins de fer en Allemagne, Hollande, Belgique, dans presque toute la France, en Suisse, plus de l'Italie à Naples, de l'Hongrie, de la Pologne, etc.
510	0□	<b>a</b> Carte de voyage par voies de poste et chemins de fer en Allemagne, Hollande, Belgique, dans presque toute la France, en Suisse, plus de l'Italie à Naples, de l'Hongrie, de la Pologne, etc. <b>z</b> fre

## 4. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> Krijimi i mjedisit për sjelljen e inovacionit <b>d</b> Shaping the environment for innovation transfer
510	1□	<b>a</b> Shaping the environment for innovation transfer <b>z</b> eng



## 512 TITULLI I KAPAKUT

Fusha përmban titullin nga kapaku i njësisë, i cili ndryshon nga titulli i saktë në fushën 200.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
512	Titulli i kapakut	r
a	<i>Titulli i kapakut</i>	nr
e	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1" bëhet përshkrimi shtesë për titullin e kapakut.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 512a Titulli i kapakut

Titulli nga kapaku i njësisë pa nëntituj ose të dhëna për përgjegjësinë.

### 512e Informacioni tjetër për titullin

Nëntitujt dhe informacionet e tjera për titullin që shfaqen bashkë me titullin e kapakut në nënfushën a.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret kur titulli i kapakut ndryshon nga titulli i saktë.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 300 SHËNIMI I PËRGJITHSHËM

Kjo fushë përdoret edhe për shënimin e titullit të kapakut. Gjatë shënimit përdoret fraza hyrëse përkatëse.

## SHEMBUJ

1.

512	1□	<b>a</b> Woods and trees of the Amazon basin <i>(Në faqen e titullit ndodhet titulli Woods of the Amazon basin. Titulli në kapak Woods and trees of the Amazon basin është vendosur për shkak të kërkimit. Institucioni katalogues ka nevoj për përshkrim shtesë të tij, për këtë arsye vlera e treguesit është "1".)</i>
-----	----	--

2. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Udhëzues për vendet turistike në Shqipëri <b>f</b> Arta Cani, Vesa Berisha, Alban Lekaj
300	□□	<b>a</b> Tit. në kapak: Turizmi në Shqipëri
512	0□	<b>a</b> Turizmi në Shqipëri <i>(Shënimi përkatës për titullin në kapak bëhet edhe në fushën 300.)</i>

3. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Biblioteka shkencore dje, sot, nesër enë 50 vjetorin e themelimit të Bibliotekës Shkencore në Lezhë e1946-1996f[redaktor Antigona Gashi enë 50 vjetorin e themelimit të Bibliotekës Shkencore në Lezhë e1946-1996 f[redaktor Antigona Gashi]
300	□□	<b>a</b> Tit. i kapakut: Qyteti i botës, bota e qytetit
512	0□	<b>a</b> Qyteti i botës, bota e qytetit <i>(Titulli i kapakut ndryshon nga titulli i saktë kryesor.)</i>

## 513 TITULLI NË FAQEN PARALELE TË TITULLIT

Fusha përmban titullin nga faqja paralele e titullit.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
513	Titulli në faqen paralele të titullit	r
<b>a</b>	<i>Titulli në faqen paralele të titullit</i>	nr
<b>e</b>	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r
<b>h</b>	<i>Numri i pjesës</i>	r
<b>i</b>	<i>Titulli i pjesës</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1" bëhet përshkrimi shtesë për titullin në faqen paralele të titullit.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 513a Titulli në faqen paralele të titullit

Titulli nga faqja paralele e titullit pa nëntitu nëntituj ose të dhëna për përgjegjësinë.

### 513e Informacioni tjetër për titullin

Nëntitujt ose informacionet e tjera për titullin që shfaqen bashkë me titullin në faqen paralele të titullit në nënfushën a.

### 513h Numri i pjesës

Numri i pjesës që ka të bëjë me titullin në faqen paralele të titullit në nënfushën a.

## 513i Titulli i pjesës

Titulli i pjesë që ka të bëjë me titullin në faqen paralele të titullit në nënfushën a.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret kur titulli në faqen paralele të titullit ndryshon nga titulli i saktë.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 300 SHËNIMI I PËRGJITHSHËM

Kjo fushë përdoret edhe për shënimin e titullit në faqen paralele të titullit. Gjatë shënitit përdoret fraza hyrëse përkatëse.

## SHEMBUJ

### 1. \* COBISS.net

200	0□	aForrgoten harvest fLily Novy gwith a foreword by Andi Naço gselected and translated by Saranda Bungu
300	□□	aTit. në faqen paralele të tit.: Të korrrat e harruara
513	0□	aTë korrrat e harruara (Shënimi përkatës për titullin në faqen paralele të titullit bëhet edhe në fushën 300.)

### 2. \* COBISS.net

200	1□	aSistemi foljor i shqipes në veprën e Gjon Buzukut fWilfried Fiedler gredaktor Eqrem Basha
300	□□	aTit. në faqen paralele të tit.: Das Albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku
513	0□	aDas †Albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku



## 514 TITULLI I KREUT

Fusha përmban titullin që shfaqet në fillim të faqes së parë të tekstit dhe ndryshon nga titulli i saktë në fushën 200.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
514	Titulli i kreut	r
<b>a</b>	<i>Titulli i kreut</i>	nr
<b>e</b>	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1" bëhet përshkrimi shtesë për titullin e kreut.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 514a Titulli i kreut

Titulli nga fillimi i faqes së parë të tekstit pa nëntituj ose të dhëna për përgjegjësinë.

### 514e Informacioni tjetër për titullin

Nëntitujt dhe informacionet e tjera për titullin që shfaqen bashkë me titullin e kreut në nënfushën a.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret kur titulli i kreut ndryshon nga titulli i saktë.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 300 SHËNIMI I PËRGJITHSHËM

Kjo fushë përdoret edhe për shënimin e titullit të kreut. Gjatë shënimit përdoret fraza hyrëse përkatëse.

## SHEMBUJ

1.

200	1□	<b>a</b> Pacific
514	0□	<b>a</b> Pacific and its wonders <i>(Titulli Pacific është shtypur në fillim (në krye) të faqës së parë të burimit në vazhdim, ndërsa pas tij vazhdon teksti and its wonders. Së bashku krijojnë titullin e kreut Pacific and its wonders.)</i>

2. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Collected guitar works <b>d</b> Gesammelte Gitarrenwerke <b>f</b> José Viñas gedited by Detlev Bork
300	□□	<b>a</b> Tit. i kreut: Collected solo guitar works
514	0□	<b>a</b> Collected solo guitar works <i>(Shënimi përkatës për titullin e kreut bëhet edhe në fushën 300.)</i>

3. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Këngë të vjetra <b>b</b> Muzikë e shtypur epër alt saksofon dhe flautë <b>e</b> = for alto saxophone and flute <b>f</b> Art Begolli
300	□□	<b>a</b> Tit. i kreut:Këngë të vjetra: za alt saksofon, flavto in klavir = for alto saxophone, flute and piano
514	0□	<b>a</b> Këngë të vjetraepër alt saksofon, flautë dhe piano <b>e</b> =for alto saxophone, flute and piano <i>(Nëntitujt e vendosur pranë titullit të kreut, vendosen edhe në fushën 514.)</i>

## 515 TITULLI NË ÇDO FAQE

Fusha përmban titullin, i cili paraqitet lart ose poshtë në faqet e njësisë dhe ndryshon nga titulli i saktë në fushën 200.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
515	Titulli në çdo faqe	r
a	Titulli në çdo faqe	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b>Rëndësia e titullit</b>
	0	Titulli nuk është i rëndësishëm
	1	Titulli është i rëndësishëm
2		<b>Nuk është i përcaktuar</b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1", bëhet përshkrimi shtesë për titullin në çdo faqe.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 515a Titulli në çdo faqe

Titulli që paraqitet lart ose poshtë në faqet e njësisë.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret kur titulli në çdo faqe ndryshon nga titulli i saktë.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 300 SHËNIMI I PËRGJITHSHËM

Fusha përdoret edhe për shënimin e titullit në çdo faqe. Para shënimit të titullit vendoset fraza hyrëse përkatëse.

**SHEMBUJ**

1.

515	0□	<b>a</b> CAD/CAM <i>(Titulli i saktë është Computer aided design and computer aided manufacture.)</i>
-----	----	--

2. \*

200	1□	<b>a</b> Ëndrrat e mia që asnjëher nuk u bënë realitet <b>f</b> Dritan Beqiri
300	□□	<b>a</b> Tit. Në çdo faqe: Ëndrrat e mia
515	0□	<b>a</b> Ëndrrat e mia <i>(Shënimi përkatës për titullin vendoset edhe në fushën 300.)</i>

3. \*

200	1□	<b>a</b> Journal of energy technology
300	□□	<b>a</b> Tit. në çdo faqe.: JET
515	0□	<b>a</b> JET

## 516 TITULLI NË SHPINË

Fusha përmban titullin që shfaqet në shpinën e njësisë dhe ndryshon nga titulli i saktë në fushën 200.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
516	Titulli në shpinë	r
a	<i>Titulli në shpinë</i>	nr
e	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1" bëhet përshkrimi shtesë për titullin në shpinë.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 516a Titulli në shpinë

Titulli nga shpina e njësisë pa nëntituj ose të dhëna për përgjegjësinë.

### 516e Informacioni tjetër për titullin

Nëntitujt dhe informacionet e tjera për titullin që shfaqen bashkë me titullin në shpinë në nënfushën a.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret kur titulli në shpinë ndryshon nga titulli i saktë.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 300 SHËNIMI I PËRGJITHSHËM

Kjo fushë përdoret edhe për shënimin e titullit në shpinën e njësisë. Gjatë shënimit përdoret fraza hyrëse përkatëse.

## SHEMBUJ

1.

516	1□	<b>a</b> The †complete guide to selecting plays <i>(Libri me titull The guide to selecting plays for performance në shpinën e librit ka titullin The complete guide to selecting plays. Institucioni katalogues ka nevojë për përshkrim shtesë të titullit, për këtë arsye treguesi i parë ka vlerën "1".)</i>
-----	----	---

2. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Të fshehtat e paktit detar Shqipëri-Greqi <b>f</b> Myslim Pasha
300	□□	<b>a</b> Tit. në shpinë: Deti që nuk falet
516	0□	<b>a</b> Deti që nuk falet <i>(Në fushën 516 është vendosur varianti i titullit nga shpina e librit. Shënimi përkatës për titullin në shpinë bëhet edhe në fushën 300.)</i>

3. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Libri i zemrës së mbështjellur me gjarpër <b>e</b> (me komente) <b>f</b> Aleister Crowley <b>g</b> [përktheu Janez Trobentar]
300	□□	<b>a</b> Tit. Në shpinë: Liber LXV : me komente
516	0□	<b>a</b> Liber LXV <b>e</b> me komente

## 517 VARIANTE TË TJERA TË TITULLIT

Fusha përmban çfarëdo varianti të titullit që nuk u përket fushave 510–516 ose 518, p.sh. titulli i vendosur nga libërlidhësi, titulli i shkurtuar, titulli në mbështjellësin e librit, titulli në kuti, titull i pjesshëm, titull i varur etj.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
517	Variante të tjera të titullit	r
a	<i>Varianti i titullit</i>	nr
e	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skadat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1" bëhet përshkrimi shtesë për variantin e titullit.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 517a Varianti i titullit

Varianti i titullit pa nëntituj ose të dhëna për përgjegjësinë.

### 517e Informacioni tjetër për titullin

Nëntitujt dhe informacionet e tjera për titullin që shfaqen bashkë me variantin e titullit në nënfushën a.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Shënimet që kanë të bëjnë me këtë titull bëhen në fushën 300 ose 320.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 510-516 LLOJE TË CAKTUARA TË VARIANTEVE TË TITUJVE

Kur varianti i titullit mund të përcaktohet saktë ai vendoset në njërin nga fushat 510 deri 516.

## SHEMBUJ

#### 1. \* COBISS.net

517	1□	<b>a</b> Scotland
300	□□	<b>a</b> Titulli i vendosur nga libërlidhësi: Scotland <i>(Institucioni katalogues ka nevojë për përshkrim shtesë të variantit të titullit, për këtë arsye vlera e treguesit është "1".)</i>

#### 2. \* COBISS.net

517	1□	<b>a</b> Gregorian chants from Hungary
300	□□	<b>a</b> Titulli në kasetë: Gregorian chants from Hungary <i>(Titulli i saktë kryesor i botimit në formë brochure është Magyar Gregorianum.)</i>

#### 3. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> Computing engineering index
300	□□	<b>a</b> I njohur edhe si: COMPENDEX
517	1□	<b>a</b> COMPENDEX <i>(Indeksi është i njohur edhe me akronimin.)</i>

#### 4. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> Tridhjetë vjet të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës
300	□□	<b>a</b> Tit. në kolofon: Tridhjetë vjet ASHAK
517	0□	<b>a</b> Tridhjetë vjet ASHAK

#### 5. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> (Vetë)perceptimet e të rinjëve në fushën e politikës esfidat për nënshtetësinë <b>f</b> Florian Hoxha, Tina Balaj
320	□□	<b>a</b> Përmbledhje ; Sintesi: (Auto)percezione dei giovani nel campo politico : sfide per la cittadinanza ; Summary: (Self)perception of the young in the political field : challenges for citizenship
517	0□	<b>a</b> (Auto)percezione dei giovani nel campo politico esfide per la cittadinanza
517	0□	<b>a</b> (Self)perception of the young in the political field echallenges for citizenship <i>(Për shkak se në fushën 320 është vendosur titulli me nëntitujt e përmbledhjes në gjuhën italiane dhe angleze, të dy nëntitujt vendosen edhe në fushën e përsëritshme 517.)</i>



## 518 TITULLI NË DREJTSHKRIMIN BASHKËKOHOR STANDARD

Fusha përmban titullin, fjalë të caktuara të titullit ose ndonjë variant të titullit të njësisë në drejtshkrimin bashkëkohor standard. Atë e vendosni kur titulli në njësi është shumë i vjetër dhe ju dëshironi ta mundësoni kërkimin edhe me titullin në drejtshkrimin bashkëkohor. Fusha kryesisht përdoret për monografitë e vjetra (antikuare).

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
518	Titulli në drejtshkrimin bashkëkohor standard	r
<b>a</b>	<i>Titulli në drejtshkrimin bashkëkohor standard</i>	nr
<b>e</b>	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën "1" bëhet përshkrimi shtesë për titullin në drejtshkrimin bashkëkohor.

Vlera "0" përdoret edhe kur fusha nuk përmban komplet titullin, por vetëm disa fjalë të përzgjedhura, të cilat mund të përmirësojnë kërkimin (shih shembullin 3).

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 518a Titulli në drejtshkrimin bashkëkohor standard

Titulli ose fjalë të veçanta nga titulli të shënuara në drejtshkrimin bashkëkohor standard, pa nëntituj ose të dhëna për përgjegjësinë.

### 518e Informacioni tjetër për titullin

Nëntitujt dhe informacionet e tjera për titullin që shfaqen bashkë me titullin e shënuar në drejtshkrimin bashkëkohor standard në nënfushën a.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret vetëm kur titulli (titujt) është shumë i vjetër, sa që kërkimi i njësisë pa shënimin e titullit në drejtshkrimin bashkëkohor do të ishte shumë i vështirë ose i pamundur. Fusha 518 nuk plotësohet, nëse përmbajtja e vendosur është e njëjtë me përmbajtjen në nënfushën 500a – *Titulli uniform*.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 200 *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË*

Fusha përmban titullin e saktë kryesor që është i shënuar në formë të vjetër.

### 500 *TITULLI UNIFORM*

Fusha përmban atë titull të cilin gjatë procesit të katalogimit e përzgjedhë institucioni bibliografik për nevojat e identifikimit të veprës, kur në njësi shfaqen tituj të ndryshëm.

### 510-517 *VARIANTET E TITUJVE*

## SHEMBUJ

1.

200	1□	aPistule, i Evanyelya
518	1□	aPistule i evandelja <i>(Institucioni katalogues ka nevojë për përshkrim shtesë të variantit të titullit, për këtë arsye vlera e treguesit është "1".)</i>

2.

200	1□	a#The #Description of the Countrey of Aphrique ...
518	1□	a#The #description of the country of Africa ...

3.

200	1□	aUmbständige Beurtheylung der Frage, ob das Erd-Beben zu Lissabonn der Ausdruck des Zornes Gottes sey
518	0□	aUmständige Beurteilung Erdbeben Lissabon sei <i>(Disa fjalë të titullit përzgjedhen dhe shënohen në në drejtshkrimin bashkëkohor.)</i>

4.

200	1□	a#Il #Cavaliero della Croce Rossa, ola Leggenda della Sanità epoea i dodici canti fdall'inglese di Edmundo Spenser recato in verso italiano, detto ottava rima, da T.J. Mathias
500	10	a#The #shepherd's calender mItalian
518	1□	a#The #shepherd's calendar <i>(Titulli original në formën e vjetër është përzgjedhur për titull uniform; për këtë arsye në fushën 518 vendoset forma bashkëkohore e titullit uniform.)</i>

5.

200	1□	aDeffense des droits du roy catholique Charles II
518	1□	aDéfense des droits du roi catholique Charles II

6.

200	1□	<b>a</b> Les <del>h</del> aventures extravagantes du courtizan grotesque
518	1□	<b>a</b> Les <del>h</del> aventures extravagantes du courtisan grotesque



## 520 TITULLI I MËPARSHËM

Fusha përmban titullin e mëparshëm të burimit të integruar, kur titulli i saktë në regjistrimin ekzistues zëvendësohet me një titull të ri.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
520	Titulli i mëparshëm	r
<b>a</b>	<i>Titulli i saktë i mëparshëm</i>	nr
<b>e</b>	<i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r
<b>h</b>	<i>Numri i pjesës</i>	nr
<b>i</b>	<i>Titulli i pjesës</i>	nr
<b>j</b>	<i>Vitet ose datat e titullit të mëparshëm</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Shfaqja e shënimit</i></b>
	0	<i>Shënimi nuk shfaqet</i>
	1	<i>Shënimi shfaqet</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

Nëse vlera e treguesit të parë është "1" – *Shënimi shfaqet*, shënimi do të ndërtohet nga fraza hyrëse "Titulli i mëparshëm:" dhe të dhënat nga fusha 520.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 520a Titulli i saktë i mëparshëm

Titulli i saktë i mëparshëm i burimit të integruar.

### 520e Informacioni tjetër për titullin

Nëntitujt dhe informacionet e tjera për titullin që shfaqen bashkë me titullin e saktë të titullit të mëparshëm në nënfushën a.

## 520h Numri i pjesës

Numri i pjesës që lidhet me titullin e saktë në nënfushën a.

## 520i Titulli i pjesës

Titulli i pjesës që lidhet me titullin e saktë në nënfushën a.

## 520j Vitet ose datat e titullit të mëparshëm

Numërtimi i viteve (vëllimeve) në periudhën kur burimi i integruar kishte titullin e mëparshëm; nëse numërtimi nuk ekziston vendosen datat. Mund të vendoset edhe periudha.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret kur titulli i një burimi të integruar ndryshon. Titulli i ri vendoset në fushën 200, ndërsa titulli i mëparshëm transferohet në fushën 520. Regjistrimi i ri krijohet vetëm në rastin e bashkimit të dy ose më shumë burimeve të integruara, ose në rastin e ndarjes në dy ose më shumë burime të integruara.

Fusha përsëritet për çdo titull të mëparshëm.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 43X FUSHAT PËR SHËNIMIN E TITUJVE TË MËPARSHËM

Këto fusha lidhëse përdoren për titujt e mëparshëm të burimit në vazhdim, kur çdo titull i mëparshëm i burimit në vazhdim është entitet bibliografik i veçantë dhe çdo titull katalogohet në një regjistrim të veçantë.

## SHEMBUJ

### 1. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> Zyra e Republikës së Kosovës për Ekonominë dhe Biznesin <b>b</b> Burim elektronik
520	1□	<b>a</b> Zyra e Republikës së Kosovës për Ekonominë ( <i>Faqja elektronike e Zyrës së Republikës së Kosovës për Ekonominë dhe Biznesin, ish Zyrës së Republikës së Kosovës për Ekonominë.</i> )

## 530 TITULLI KYÇ

Fusha përmban titullin kyç – titullin unik, të cilin burimit në vazhdim ia ndanë qendra e ISSN-së.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
530	Titulli kyç	nr
<b>a</b>	<i>Titulli kyç</i>	nr
<b>b</b>	<i>Cilësori</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Treguesi i titullit të saktë</i></b>
	0	<i>Titulli kyç është i njëjtë me titullin e saktë</i>
	1	<i>Titulli kyç ndryshon nga titulli i saktë</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 530a Titulli kyç

Titulli kyç pa shpjegime shtesë. Deri në vitin 2003 titujt kyç te titujt e përgjithshëm kanë përfshirë edhe emrin e botuesit. Midis titullit kyç dhe botuesit është vendosur hapësirë, vizë, hapësirë (shih shembujt 3, 4).

### 530b Cilësori

Shpjegimi që bëhet për t'u dalluar nga burimet e tjera në vazhdim që kanë të njëjtin titull (shih shembujt 2, 4, 6, 8). Në titullin kyç shpjegimi bëhet brenda kllapave të rrumbullakta, të cilat vendosen në mënyrë automatike.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Titulli kyç formohet duke respektuar rregullat e *ISSN Manual. Cataloguing Part*. Titullin kyç e cakton qendra kombëtare e ISSN-së, e cila është përgjegjëse për regjistrimin e burimeve në vazhdim, duke u bazuar në të dhënat e botimit në kohën e regjistrimit. Meqë titujt kyç mund t'i caktoj vetëm qendra e ISSN-së, kataloguesi titullin kyç e shënon vetëm nëse atë e gjenë në botim ose nëse atë e dërgon qendra e ISSN-së.

Treguesi i parë tregon nëse titulli kyç është i njëjtë me titullin e saktë në nënfushën 200a. Nëse fusha 530 përmban nënfushën b, vlera e treguesit patjetër është "1".

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 011 ISSN

Sipas rregullave të sistemit ISSN, titulli kyç i lidhur në mënyrë të pandashme me ISSN-në dhe në regjistrim vendosen të dyja të dhënat, nëse ato ekzistojnë.

### 200 TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË

Titulli nga njësia vendoset në fushën 200.

## SHEMBUJ

1.

530	0	aScientific American
-----	---	----------------------

2.

530	1	aLa #Ciencia y la tecnica bBarcelona. 1936 (Shfaqja e titullit kyç: La Ciencia y la tecnica (Barcelona. 1936).)
-----	---	--

3.

530	1	aAnnual accounts - Welsh Water Authority
-----	---	--

4.

530	1	aBulletin - Canadian Association of Medical Records Librarians b1944
-----	---	--

5. \* COBISS.net

200	1	aMalësia
530	0	aMalësia (Titulli kyç është i njëjtë me titullin e saktë.)

6. \* COBISS.net

200	1	aMost
530	1	aMost bZagreb (Titulli kyç ndryshon nga titulli i saktë.)

7. \* COBISS.net

200	1	aShkenca & teknologjia eSh & T fMinistrstria e Shkencës dhe Teknologjisë
530	0	aShkenca & teknologjia

8. \* COBISS.net

200	1	aMenaxheri erevistë për sipërmarrës
530	1	aMenaxheri bTiranë



## 531 TITULLI KYÇ I SHKURTUAR

Fusha përmban titullin kyç të shkurtuar, i cili formohet në përputhje me rregullat që i përcakton Qendra Ndërkombëtare e ISSN-së, duke u bazuar në standardin ndërkombëtar ISO 4.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
531	Titulli kyç i shkurtuar	nr
<b>a</b>	<i>Titulli kyç i shkurtuar</i>	nr
<b>b</b>	<i>Cilësori i shkurtuar i titullit kyç</i>	nr
<b>c</b>	<i>Cilësori i titullit kyç të shkurtuar*</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 531a Titulli kyç i shkurtuar

Titulli kyç i shkurtuar pa shpjegime shtesë. Deri në vitin 2003 titujt kyç të shkurtuar te titujt e përgjithshëm kanë përfshirë edhe emrin e botuesit. Midis titullit kyç të shkurtuar dhe botuesit është vendosur hapësirë, vizë, hapësirë (shih shembullin 3).

### 531b Cilësori i shkurtuar i titullit kyç

Cilësori i shkurtuar që ndryshon nga titujt e tjerë kyç identikë (shih shembujt 1, 5). Në titullin kyç të shkurtuar shpjegimi bëhet brenda kllapave të rumbullakta, të cilat vendosen në mënyrë automatike.

### 531c Cilësori i titullit kyç të shkurtuar\*

Shpjegimi në formë të shkurtuar që ndryshon nga titujt e tjerë kyç identikë (shih shembullin 6). Në titullin kyç të shkurtuar shpjegimi bëhet brenda kllapave të rumbullakta, të cilat vendosen në mënyrë automatike.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Titulli kyç i shkurtuar formohet duke respektuar rregullat e ISSN Manual. Cataloguing Part, të bazuara në standardin ISO 4: *Information and Documentation – Rules for the abbreviation of title words and titles of publications.*

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

530 TITULLI KYÇ

## SHEMBUJ

1.

531	□□	aMedicina. Supl. bB. Aires
-----	----	----------------------------

2.

531	□□	aRockefeller Brothers Fund Annu. rep.
-----	----	---------------------------------------

3.

531	□□	aAnn. - Univ. Cathol. Louvain
-----	----	-------------------------------

4. \* COBISS.net

531	□□	aStud. albanol.
-----	----	-----------------

5. \* COBISS.net

531	□□	aIstor. 20. veka b1959
-----	----	------------------------

6. \* COBISS.net

530	0□	aStudime albanologjike
531	□□	aStud. albanol. cPrishtinë

## 532 TITULLI I ZGJERUAR

Fusha përmban formën e zgjeruar të titullit të saktë ose titullit kyç, kur ata përmbajnë inicialet, akronime, shkurtesa, numra ose simbole që ndikojnë në klasifikim.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
532	Titulli i zgjeruar	r
a	<i>Titulli i zgjeruar</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Lloji i zgjerimit</i></b>
	0	<i>Inicialet dhe akronimet</i>
	1	<i>Numri</i>
	2	<i>Shkurtesa</i>
	3	<i>Tjetër</i>

Treguesi i dytë tregon arsyen e zgjerimit të titullit. Në titull mund të përshkruhen me fjalë inicilat ose akronimet (shih shembujt 2, 7), numrat (shih shembujt 4, 9, 10, 11), shkurtesat (shih shembujt 1, 6) ose simbolet e tjera. P.sh. simboli "&" zëvendësohet me fjalën "dhe" ose "et" (shih shembujt 3, 5, 8). Nëse shfaqet kombinimi i kushteve, përdoret vlerë më e madhe e treguesit të dytë (shih shembujt 3, 5). Vlera "3" përdoret kur ndonjë nga kushtet është i panjohur.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 532a Titulli i zgjeruar

Teksti në tërësi i titullit të zgjeruar.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret për shënimin e formës së zgjeruar të cilitdo titull të saktë ose të burimit në vazhdim edhe titullit kyç (shih shembujt 2, 3, 4). Titujt e zgjeruar janë të kërkueshëm, ndërsa ata që në treguesin e parë kanë vlerën 1 përdoren edhe për klasifikimin e titujve në listat e përgatitura sipas renditjes alfabetike, p.sh. në indekset e bibliografive.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**200a** *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË, Titulli i saktë*

**530** *TITULLI KYÇ*

## SHEMBUJ

1.

532	12	<b>a</b> Saint Mirren Football Club centenary brochure <i>(Titulli i saktë i vendosur në fushën 200 është St. Mirren F. C. centenary brochure. Shkurtesat nga titulli janë përshkruar në fushën 532.)</i>
-----	----	--

2.

532	10	<b>a</b> Institute of Electrical and Electronics Engineers transactions on aerospace and electronic systems <i>(Titulli është IEEE transactions on aerospace and electronic systems.)</i>
-----	----	--

3.

532	13	<b>a</b> Thirty-seven design and environment projects <i>(Titulli 37 design &amp; environment projects fillon me numër dhe përmban simbolin "&amp;". Treguesi i dytë ka vlerën "3" që tregon për simbolet e përshkruara dhe nuk ka vlerën "1" që tregon për numrat e përshkruar.)</i>
-----	----	--

4.

532	11	<b>a</b> Five ways <i>(Titulli është 5 ways.)</i>
-----	----	--

5. \* COBISS.net

200	1	<b>a</b> 100 + 5 ejeto shëndetshëm, që të jetosh më mirë <b>f</b> [autorët e teksteve Majlinda Odaxhiu... [et al.] <b>g</b> ilustrimet Berat Beka <b>g</b> fotografitë Egon Kasami]
532	13	<b>a</b> Njëqind plus pesë <i>(Nëse titulli fillon me numër; në sistemin COBISS.AL atë duhet patjetër ta shënoni në formë të zgjeruar në fushën 532. Vlera e treguesit të parë duhet të jetë "1".)</i>

6. \* COBISS.net

200	1	<b>a</b> St. Petersburg CD-Atlas <b>b</b> Burim elektronik <b>f</b> produced by AO Ingit
532	02	<b>a</b> Saint Petersburg CD-Atlas <i>(Vlera e treguesit të parë është "0", sepse për klasifikim përdoret titulli i shënuar në nënfushën 200a.)</i>

7. \*

200	0	<b>a</b> DDR <b>e</b> Land, Volk, Wirtschaft in Stichworten <b>f</b> Johannes F. Gellert
532	00	<b>a</b> Deutsche Demokratische Republik

8. \*

200	1	<b>a</b> Hegel & the infinite <b>e</b> religion, politics, and dialectic <b>f</b> edited by Slavoj Žižek, Clayton Crockett, Creston Davis
532	13	<b>a</b> Hegel and the infinite

*(Për klasifikim, p.sh. në indeksin e titujve të bibliografisë, përdoret forma e zgjeruar e titullit, për këtë arsye vlera e treguesit të parë është "1".)*

## 9. \* COBISS.net

200	0□	aNumri 1 si shumë dhe produkt i thyesave	fGramos Thaçi
532	01	aNumri një si shumë dhe produkt i thyesave	

## 10. \* COBISS.net

200	1□	a25 vjet KF Drenica	
532	11	aNjëzet e pesë vjet KF Drenica	
532	01	aNjëzet e pesë vjet të Klubit të Futbollit Drenica	

*(Për klasifikim do të përdoret titulli me numrin e përshkruar, por jo edhe me akronimin e përshkruar. Mirëpo për shkak të kërkimit mund të plotësohet edhe një fushë 532 me numrin dhe akronimin e përshkruar. Në këtë rast vlera e treguesit të parë është "0".)*

## 11. \* COBISS.net

200	1□	a1000 fjalët e mia të para	dMy first 1000 words
532	01	aNjëmijë fjalët e mia të para	
532	01	aMy first thousand words	

*(Në fushën 532 mund të shënohet cilido titull, dhe jo vetëm titulli nga nënfusha 200a. Në raste të tilla vlera e treguesit të parë është "0".)*



## 539 TITULLI I SAKTË ME KOMANDAT L<sup>A</sup>T<sub>E</sub>X\*

Fusha përmban titullin e shënuar me simbole matematikore dhe simbole të tjera të veçanta në përputhje me rregullat L<sup>A</sup>T<sub>E</sub>X<sup>1</sup>.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
539	Titulli i saktë me komandat L <sup>A</sup> T <sub>E</sub> X*	nr
	<b>a</b> <i>Titulli i saktë</i>	r
	<b>b</b> <i>Përcaktimi i përgjithshëm i materialit</i>	r
	<b>c</b> <i>Titulli i saktë i veprës së autorit tjetër</i>	r
	<b>d</b> <i>Titulli i saktë paralel</i>	r
	<b>e</b> <i>Informacioni tjetër për titullin</i>	r
	<b>f</b> <i>Përgjegjësia parësore</i>	r
	<b>g</b> <i>Persona të tjerë përgjegjës</i>	r
	<b>h</b> <i>Numri i pjesës</i>	r
	<b>i</b> <i>Titulli i pjesës</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b>Rëndësia e titullit</b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b>Nuk është i përcaktuar</b>

Vlera e treguesit të parë përcakton përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Nëse treguesi ka vlerën 1 bëhet përshkrimi shtesë për titullin e saktë me komandat L<sup>A</sup>T<sub>E</sub>X.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat nga a deri i janë të përshkruara te fusha 200.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Kur në titullin e saktë (fusha 200) ndodhen edhe simbolet matematikore ose simbolet e tjera, komplet përmbajtja e fushës 200 shënohet edhe në fushën 539. Simbolet matematikore dhe simbolet e tjera të veçanta

<sup>1</sup> Literatura referuese:

1. Marko Razpet: *Sedi in piši z LaTeX-om!*, Ljubljana, 1991

2. Leslie Lamport: *LaTeX, a document preparation system, user's guide & reference manual*, Reading, Mass. [etc.], 1986

3. Paul W. Abrahams: *TeX for the Impatient*, Reading, Mass. [etc.], 1990

shënohen në përputhje me rregullat LaTeX. Gjatë plotësimit të nënfushave të veçanta në fushën 539 duhet të respektohen të gjitha rregullat, të cilat janë të vlefshme te plotësimi i nënfushave në fushën 200. Në fushën 539 duhet të plotësohen të gjitha nënfushat, të cilat janë të plotësuara në fushën 200, edhe nëse ndonjëra nga nënfushat nuk ka simbole matematikore ose simbole të tjera të veçanta.

Fillimin dhe përfundimin e shënimit të simboleve matematikore dhe simboleve të tjera të veçanta e përcakton simboli "°".

Fusha përdoret për shfaqjen në programin që mbështet LaTeX.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 200 *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË*

Simbolet matematikore dhe simbolet e tjera të veçanta që jepen në mënyrë të përshkruar në fushën 200, vendosen edhe në fushën 539 në përputhje me rregullat LaTeX.

## SHEMBUJ

1. \*

200	0 <sub>□</sub>	<b>a</b> On $K_{[ast]}(Z/n)$ and $K_{[ast]}(F_{q[t]/(t^2)})$ <b>f</b> Janet E. Aisbett, Emilio Lluís-Puebla and Victor Snaith <b>g</b> (with an appendix by Christophe Soulé)
539	0 <sub>□</sub>	<b>a</b> On "° $K_{[ast]}(Z/n)$ "° and "° $K_{[ast]}(F_{q[t]/(t^2)})$ "° <b>f</b> Janet E. Aisbett, Emilio Lluís-Puebla and Victor Snaith <b>g</b> (with an appendix by Christophe Soulé) (Fillimin dhe përfundimin e shënimit të simbolit LaTeX e përcakton simboli "°", ndërsa simboli "\$" përcakton fillimin dhe përfundimin e shënimit të të dhënave sipas rregullave LaTeX në mjedisin matematikor.)

2. \*

200	1 <sub>□</sub>	<b>a</b> #The #Selberg trace formula for $PSL_{[sub]} 2(\mathbb{R})^{[sup]} n$ <b>f</b> Isaac Y. Efrat
539	0 <sub>□</sub>	<b>a</b> #The #Selberg trace formula for "° $PSL_2(\mathbb{R})^n$ "° <b>f</b> Isaac Y. Efrat (Në bibliografi shfaqet The Selberg trace formula for $PSL_2(\mathbb{R})^n$ / Isaac Y. Efrat.)



## 540 TITULLI SHITESË I VËNË NGA KATALOGUESI

Fusha përmban pjesë të titujve ose tituj të njohur, të cilët nuk ndodhen në njësi dhe të cilët nuk trajtohen si tituj uniform. Mund të përdoret edhe për pikëqasje të titullit, që rrjedh nga titulli i saktë.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
540	Titulli shtesë i vënë nga kataloguesi	r
<b>a</b>	<i>Titulli shtesë</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 540a Titulli shtesë

Titulli, të cilin e vendos kataloguesi.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban titullin, i cili shfaqet në njësi, ndërsa në regjistrim e shton kataloguesi. Bëhet fjalë për një titull të njohur, por jo për titullin uniform.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 500 *TITULLI UNIFORM*

Fusha 500 përdoret për titujt uniform, të cilët përcaktohen duke respektuar rregullat e katalogimit. Këta tituj nuk duhet të vendosen në fushën 540.

### 541 *TITULLI I PËRKTHYER I VËNË NGA KATALOGUESI*

Fusha 541 përdoret për shënimin e titullit të përkthyer, të cilin e vendos kataloguesi.

## SHEMBUJ

### 1. \* COBISS.net

200	0	<b>a</b> Mësimdhënia dhe mësimnxënia <b>f</b> Konferencë e Shkollimit të Mesëm Profesional në Shqipëri, Tiranë, 13-15 dhjetor 1989 <b>g</b> organizator Ministria e Arsimit dhe Shkencës <b>g</b> [redaktore Arta Minaj]
540	0	<b>a</b> Zhvillimi i mëtejshëm i arsimit të mesëm në Shqipëri
540	0	<b>a</b> Shkollimi i Mesëm Profesional në Shqipëri

## 541 TITULLI I PËRKTHYER I VËNË NGA KATALOGUESI

Fusha përmban përkthimin e kataloguesit për një nga titujt që ndodhen në njësi.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
541		Titulli i përkthyer i vënë nga kataloguesi	r
	<b>a</b>	<i>Titulli i përkthyer</i>	nr
	<b>z</b>	<i>Gjuha e titullit të përkthyer</i>	r

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Rëndësia e titullit</i></b>
	0	<i>Titulli nuk është i rëndësishëm</i>
	1	<i>Titulli është i rëndësishëm</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 541a Titulli i përkthyer

Titulli i përkthyer, i vendosur nga kataloguesi.

### 541z Gjuha e titullit të përkthyer

Kodi i gjuhës së titullit të përkthyer.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përdoret vetëm për titujt, të cilët i përkthen kataloguesi ose për përkthimet e marra nga cilido burim tjetër, përveç burimit që katalogohet. Titujt e përkthyer, të cilët i përcaktojnë rregullat e katalogimit, zakonisht trajtohen si tituj uniform dhe vendosen në fushën 500.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

### 200 *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË*

Titulli, në të cilën bazohet përkthimi, gjithmonë duhet të jetë në fushën 200. Nëse përkthimi i titullit ndodhet në njësi, ai vendoset në nënfushën 200d – Titulli i saktë paralel ose në fushën për shënimet, nëse ai nuk ndodhet në burimin e përcaktuar të të dhënave.

### 500 *TITULLI UNIFORM*

Fusha 500 përmban cilindo titull të përkthyer që është trajtuar si titull uniform.

### 510 *TITULLI I SAKTË PARALEL*

Nëse në njësi ndodhet titulli uniform në një gjuhë tjetër, ai vendoset në fushën 510.

## SHEMBUJ

### 1. \*

200	1□	a#Der #Spiegel
541	1□	a#The #Mirror zeng <i>(Në faqen e titullit është Der Spiegel. Në nënfushën 541a kataloguesi ka shtuar titullin e përkthyer.)</i>

### 2. \*

200	1□	a#De #rol van de universiteit bij de ontwikkeling van een Land
541	1□	aRole of universities in national development zeng <i>(Institucioni katalogues të gjithë titujt në gjuhë të tjera i përkthen në gjuhën angleze dhe nuk shënon asnjë nga nyjet e as shenjat NSB/NSE "4". Në faqen e titullit është De rol van de universiteit bij de ontwikkeling van een Land.)</i>

### 3. \* COBISS.net

200	0□	aEdukimi i të rriturve fKonferenca e pestë ndërkombëtare për edukimin e të rriturve, [14. deri 18.] korrik 1997 - CONFINTEA g[botues Zyra e Komision Kombëtar Shqiptar për UNESCO dhe Qendra Shqiptare për Edukim gPërktheu Mirjeta Shkabaj]
541	0□	a#The #Hamburg declaration on adult learning zeng
541	0□	aAgenda for the future zeng <i>(Në kopertinë ndodhen titujt në gjuhën shqipe, të cilët kataloguesi i ka përkthyer dhe i ka shtuar në fushat 541.)</i>

---

# 6XX BLOKU I ANALIZËS SË PËRMBAJTJES

## LISTA E FUSHAVE

- 600 Emër vetjak si emërtim lëndor
- 601 Emër organizate si emërtim lëndor
- 602 Emër familje si emërtim lëndor
- 604 Emër dhe titull si emërtim lëndor
- 605 Titull si emërtim lëndor
- 606 Emër lënde si emërtim lëndor
- 607 Emër gjeografik si emërtim lëndor
- 608 Emërtimi lëndor kronologjik\*
- 609 Forma si emërtim lëndor\*
- 610 Emërtime lëndore të pakontrolluara
- 620 Kërkimi me vend të botimit
- 627 Fjalët kyçe - NUK
- 675 Klasifikimi Dhjetor Universal (KDU)
- 676 Klasifikimi Dhjetor i Djujt
- 680 Klasifikimi i Bibliotekës së Kongresit
- 686 Klasifikime të tjera

Në sistemin e përbashkët të katalogimit emërtimet lëndore vendosen në formë të strukturuar në fushat 600–609 dhe sipas parimeve të sistemit të përzgjedhur për emërtimet lëndore (p.sh. lista e emërtimeve lëndore ose thesarët). Për klasifikim lëndor të unifikuar në katalogimin e përbashkët përdoret Lista e përgjithshme e emërtimeve lëndore COBISS (SGC), e cila është në dispozicion si bazë e njësuar, ndërsa në regjistrime mund të shtohen edhe emërtimet lëndore nga sistemet e tjera. Rregullat për klasifikimin lëndor përmes Listës së përgjithshme të emërtimeve lëndore COBISS (SGC) janë të përshkruara në udhëzimet *Përcaktimi lëndor përmes SGC-së*, të cilat janë të disponueshme na faqen elektronike SGC <https://www.cobiss.si/sgc/>. Nëse shtoni emërtime lëndore edhe nga sistemet e tjera, si udhëzime të përgjithshme apo kritere bazë për zgjedhjen e termave dhe formimin e rubrikave lëndore respektohen udhëzimet në *Splošni slovenski geslovník: navodila za predmetno označevanje knjižničnega gradiva in geslovník*. Ljubljana: Narodna in univerzitetna knjižnica, 2002, ose udhëzimet e sistemeve të tjera të vlefshme për klasifikim lëndor. P.sh. për klasifikim më të hollësishëm në fushën e mjeksisë përdoren termat nga MeSH (Medical Subject Headings).

Me krijimin e bazës së njësuar të të dhënave SGC dhe aplikimit të kontrollit të njësuar të emërtimeve lëndore në sistemin e katalogimit të përbashkët, ka ndryshuar mënyra e shënimit të të dhënave në fushat 60X. Emërtimet lëndore nga SGC nuk shënohen në mënyrë manuale, mirëpo ato transferohen nga baza e njësuar e të dhënave. Lidhja midis regjistrimeve të njësuar dhe emërtimeve lëndore në fushat 60X bëhet përmes nënfushës 60X3 – *Numri i regjistrimit të njësuar*.

Kur emërtimet lëndore janë të lidhura me SGC, format e papranuara nuk shënohen në regjistrimet bibliografike, ndërsa format për emërtimet e tjera lëndore vendosen në fushat 960–969. Kërkimi bëhet njëkohësisht në fushat 600–609 dhe 960–969. Fushat 960–969 lidhen me fushat 600–609 përmes nënfushës 6, në të cilën, tek të dy fushat në lidhshmëri shënohet një numër dyshifror (01-99).

Te plotësimi i fushave 600–609 dhe 960–969 përdoret nënfusha 2, në të cilën shënohet kodi i sistemit të emërtimeve lëndore, i cili përzgjidhet nga lista e kodeve. Nëse përdorni sistemin lokal të emërtimeve lëndore në gjuhën vendase, kodi i së cilës nuk ndodhet në listën e kodeve, kjo nënfushë nuk plotësohet, në të kundërtën plotësimi në nënfushës 2 është i detyrueshëm.

Lista e mëposhtme me kodet e sistemeve të emërtimeve lëndore nuk është e plotë, por ajo ndryshon dhe përditësohet sipas nevojës:

<b>CAE</b>	<i>Emërtime lëndore të Bibliotekës Kombëtare të Kanadasë (Version në anglisht)</i>
<b>CAF</b>	<i>Emërtime lëndore të Bibliotekës Kombëtare të Kanadasë (Version në frëngjisht)</i>
<b>EET</b>	<i>Thesar arsimor evropian</i>
<b>EET/slv</b>	<i>Thesar arsimor evropian/Përkthim në sllovenisht</i>
<b>EUROVOCE</b>	<i>Thesar EUROVOC (Version në anglisht)</i>
<b>EUROVOCS</b>	<i>Thesar EUROVOC (Version në sllovenisht)</i>
<b>GZL</b>	<i>Emërtime lëndore për letërsi</i>
<b>INIS</b>	<i>Sistemi i informacionit bërthamor ndërkombëtar: Thesar</i>
<b>INIS/slv</b>	<i>Sistemi i informacionit bërthamor ndërkombëtar: Thesar/Përkthim në sllovenisht</i>
<b>LC</b>	<i>Emërtime lëndore të Bibliotekës së Kongresit</i> Lista e emërtimeve lëndore është e publikuar në adresën: <a href="https://id.loc.gov/authorities/subjects.html">https://id.loc.gov/authorities/subjects.html</a>
<b>LCCH</b>	<i>Emërtime lëndore për fëmijë të Bibliotekës së Kongresit</i>
<b>MECH</b>	<i>MECH - Inxhinieria mekanike</i> Lista e emërtimeve lëndore është e publikuar në adresën: <a href="https://meshb.nlm.nih.gov">https://meshb.nlm.nih.gov</a>
<b>MESH</b>	<i>Emërtime lëndore mjekësore</i>
<b>MESH/slv</b>	<i>Emërtime lëndore mjekësore/Përkthim në sllovenisht</i>
<b>NAL</b>	<i>Emërtime lëndore të Bibliotekës Bujqësore Kombëtare Sh. B.</i>
<b>NUK</b>	<i>geslovník NUK-a (Listë e terma lëndorë NUK)</i> Fjalori ndodhet në faqen elektronike: <a href="https://sssg.nuk.uni-lj.si">https://sssg.nuk.uni-lj.si</a>
<b>PKK</b>	<i>Predmetnik za katoliške knjižnice (Lista lëndore për Bibliotekat katolike)</i>
<b>RPLB</b>	<i>R"kovodstvo za predmetizacija na literaturata v bibliotekite</i>
<b>SGC</b>	<i>Lista e përgjithshme e emërtimeve lëndore COBISS.SI</i> Lista e emërtimeve lëndore është e publikuar në adresën: <a href="https://plus.cobiss.net/cobiss/si/sl/sgc">https://plus.cobiss.net/cobiss/si/sl/sgc</a>
<b>TPIT</b>	<i>Thesar i termave indeks për psikologjinë</i>
<b>TPIT/slv</b>	<i>Thesar i termave indeks për psikologjinë/Përkthim në sllovenisht</i>
<b>eng</b>	<i>lista lëndore lokale në anglisht</i>

Nënfusha 2 përdoret edhe në fushën 686, ku shënohen kodet nga lista e kodeve për sistemet e klasifikimit. Udhëzime më të hollësishme jepen në fushën 686.





## 600 EMËR VETJAK SI EMËRTIM LËNDOR

Fusha përmban emrin e personit, i cili trajtohet në burimin bibliografik, dhe atë në formën e pikëqasjes, që mund të ketë informacione shtesë për lëndën.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
600	Emër vetjak si emërtim lëndor	r
	<b>a</b> <i>Elementi hyrës</i>	nr
	<b>b</b> <i>Pjesa tjetër e emrit</i>	nr
	<b>c</b> <i>Shtesa të emrit (jo datat)</i>	r
	<b>d</b> <i>Numra romakë</i>	nr
	<b>f</b> <i>Datat</i>	nr
	<b>x</b> <i>Përcaktuesi tematik</i>	r
	<b>y</b> <i>Përcaktuesi gjeografik</i>	r
	<b>w</b> <i>Përcaktuesi i formës</i>	r
	<b>z</b> <i>Përcaktuesi kohor</i>	r
	<b>2</b> <i>Kodi i sistemit</i>	nr
	<b>3</b> <i>Numri i regjistrimit të njësuar</i>	nr
	<b>6</b> <i>Të dhënat për lidhjen</i>	nr
	<b>9</b> <i>Numri i regjistrimit të mëparshëm të njësuar*</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b>Treguesi për shfaqjen*</b>
	□	<i>Nuk ka vlerë</i>
	0	<i>Nuk shfaqet**</i>
	1	<i>Fusha shfaqet për nevojat e katalogut**</i>
	2	<i>Fusha shfaqet për nevojat e bibliografisë**</i>
2	3	<i>Fusha shfaqet për nevojat e katalogut dhe bibliografisë**</i>
		<b>Mënyra e shënimit të emrit</b>
	0	<i>Shënohet vetëm emri ose emri dhe mbiemri</i>
	1	<i>Shënohet mbiemri dhe emri</i>

Treguesi i dytë përcakton nëse emri është vendosur në renditje të drejtë (vetëm emri ose emri dhe mbiemri) apo në formë të përmbysur (mbiemri dhe emri).

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

---

### 600a Elementi hyrës

Pjesa e emrit që në emërtimin lëndor përdoret si element klasifikimi dhe që mundëson klasifikimin dhe kërkimin në katalog. Nënfisha është e detyrueshme.

---

### 600b Pjesa tjetër e emrit

Pjesa tjetër e emrit (emri ose emrat), kur element hyrës është mbiemri (shih shembujt 1, 2, 5). Nëse kjo nënfishë është e plotësuar, vlera e treguesit të dytë duhet të jetë "1".

---

### 600c Shtesa të emrit (jo datat)

Shënohet emërtimi lëndor.

### 610z Gjuha e emërtimit lëndor

Kodi për gjuhën në të cilën janë shënuar emërtimet lëndore.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Emërtimet që i takojnë sistemit të strukturuar të emërtimeve lëndore shënohen në fushat 600–609, me kodin përkatës të sistemit në nënfushën 2.

Mund të vendosen edhe simbolet matematikore dhe simbolet e tjera të veçanta, në përputhje me rregullat  $\text{\LaTeX}$ .<sup>1</sup> Fillimin dhe përfundimin e këtyre të dhënave e përcakton simboli "=".

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**600-609 FUSHAT PËR EMËRTIMET LËNDORE**

### SHEMBUJ

1.

610	1□	<b>a</b> fuel cells <b>a</b> molten carbonate <b>a</b> power
-----	----	--

2.

610	1□	<b>a</b> micrographics <b>a</b> COM <b>a</b> data capture <b>a</b> computer-assisted retrieval
-----	----	--

3.

610	2□	<b>a</b> King, Donald W. <b>a</b> Williams, James G. <b>a</b> Networks, Topology <b>a</b> Public corporation
-----	----	--

4.

610	1□	<b>a</b> Corporation for Open Systems <b>a</b> OSI
-----	----	--

5. \* COBISS.net

610	0□	<b>a</b> COBISS <b>a</b> kompensimi bibliotekar <b>a</b> të drejtat e autorit <b>a</b> bibliotekat <b>a</b> huazimi
-----	----	---

6. \* COBISS.net

610	0□	<b>z</b> eng <b>a</b> ethics <b>a</b> codes <b>a</b> education <b>a</b> National Educational Technology Standards <b>a</b> NETS <b>a</b> information technology
-----	----	---

610	0□	<b>z</b> alb <b>a</b> etika <b>a</b> kodekset <b>a</b> kualifikimi <b>a</b> teknologjia e informacionit (Kur në fushat e përsëritshme 610 shënohen emërtimet lëndore në gjuhë të ndryshme, në çdo fushë 610, në nënfushën 610z vendoset kodi për gjuhën e emërtimit lëndor.)
-----	----	---

<sup>1</sup> Literatura referuese:

1.Marko Razpet: *Sedi in piši z LaTeX-om!*, Ljubljana, 1991

2.Leslie Lamport: *LaTeX, a document preparation system, user's guide & reference manual*, Reading, Mass. [etc.], 1986

3.Paul W. Abrahams: *TeX for the Impatient*, Reading, Mass. [etc.], 1990

## 620 KËRKIMI ME VEND TË BOTIMIT

Fusha përmban vendin e botimit, prodhimit etj., në formën që mundëson kërkimin. Fusha mund të përfshijë emrin e shtetit, njësisë federale, regjionit dhe/ose qytetit.

Përmbajtja e fushës mund të jetë në formë hierarkie (p.sh. shteti, njësia federale dhe qyteti) ose johierarkie (p.sh. vetëm qyteti), varësisht nga praktika e katalogimit.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA			PËRSËRITSHMËRIA
620		Kërkimi me vend të botimit	r
	<b>a</b>	<i>Shteti</i>	nr
	<b>b</b>	<i>Njësia federale, republika etj.</i>	nr
	<b>c</b>	<i>Rrethi</i>	nr
	<b>d</b>	<i>Qyteti</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

### SHEMBUJ

1. \*

620	□□	<b>a</b> United States <b>b</b> Alabama <b>d</b> Montgomery <i>(Njësia është botuar në qytetin Montgomery, në shtetin Alabama. Fusha është në formë hierarkie.)</i>
-----	----	--

2. \* COBISS.net

620	□□	<b>d</b> Prishtinë <i>(Njësia është botuar në Prishtinë. Fusha nuk është plotësuar në formë hierarkie.)</i>
-----	----	--

3. \*

620	□□	<b>a</b> United States <b>b</b> Virginia <b>c</b> Prince William County <b>d</b> Haymarket <i>(Njësia është botuar në Haymarket, shteti Virginia. Fusha është plotësuar në formë hierarkie. Është vendosur edhe rrethi.)</i>
-----	----	---

4. \* COBISS.net

620	□□	<b>a</b> Shqipëria <b>d</b> Tirana <i>(Njësia është botuar në Tiranë. Fusha është plotësuar në formë hierarkie.)</i>
-----	----	---



## 675 KLASIFIKIMI DHJETOR UNIVERSAL (KDU)

Fusha përmban numrin e klasifikimit, i cili i është ndarë njësisë në përputhje me skemën e Klasifikimit Dhjetor Universal me një tregues për botimin e përdorur.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
675	Klasifikimi Dhjetor Universal (KDU)	r
<b>a</b>	<i>Numri</i>	nr
<b>b</b>	<i>Grupi*</i>	nr
<b>c</b>	<i>KDU*</i>	nr
<b>s</b>	<i>Statistika*</i>	nr
<b>u</b>	<i>KDU për katalogët lokalë*</i>	nr
<b>v</b>	<i>Botimi</i>	nr
<b>z</b>	<i>Gjuha e botimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 675a Numri

Numri nga tabela e Klasifikimit Dhjetor Universal.

### 675b Grupi\*

Në këtë nënfushë vendoset numri i KDU-së në formë të shkurtuar, i cili përdoret për klasifikim në përgatitjen e bibliografive dhe për nevoja të tjera lokale. Rekomandohet përdorimi i listës lokale të kodeve.

Nëse në regjistrim vendosen disa grupe të KDU-së, regjistrimi në bibliografitë standarde klasifikohet në grupin e parë.

### 675c KDU\*

Në këtë nënfushë vendoset numri i KDU-së, i cili përdoret për kërkimin dhe klasifikimin e përmbajtjes në COBIB dhe në bazat lokale të të dhënave. Shënimi i të dhënave mbështetet nga

lista lokale e kodeve, e cila është uniforme për të gjitha llojet e materialeve (shih *Shtojca G*). Nënfisha është e detyrueshme.

---

### 675s Statistika\*

Në këtë nënfushë vendoset numrin KDU i shkurtuar, i cili përdoret për statistika të ndryshme. Rekomandohet përdorimi i listës lokale të kodeve.

---

### 675u KDU për katalogët lokalë\*

Në këtë nënfushë vendoset numri i KDU-së për nevojat e tjera lokale. Rekomandohet përdorimi i listës lokale të kodeve.

---

### 675v Botimi

Identifikimi i botimit të tabelës, nga e cila është marrë numri i vendosur në nënfushën a.

---

### 675z Gjuha e botimit

Kodi i gjuhë së botimit të tabelës, nga e cila është marrë numri i vendosur në nënfushën a.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në nënfushën a vendoset numri nga tabelat e KDU-së, të cilat i përdor institucioni katalogues. Tabelat e KDU-së janë të botuara në gjuhë të ndryshme dhe kohë pas kohe përpunohen/redaktohen dhe publikohen si botim i ri. Çdo botim i publikuar i tabelave të KDU-së rrjedh nga UDCMRF (Universal Decimal Classification Master Reference File).

Për shkak se disa biblioteka i katalogojnë materialet para se të bëjnë përpunimin e tyre përmbajtësor, në nënfushën 675c mund të vendoset kodi i përkohshëm "fik". Gjatë përpunimit përmbajtësor kodi fiktiv zëvendësohet me numrin përkatës për kërkim.

Deri në vitin 1992 për printimin e botimit Bulletin Scientifique janë përdorur edhe nënfushat 675x dhe 675y.

## SHEMBUJ

1.

675	□□	a633.13-155(410) "18" v4 zeng
-----	----	-------------------------------



*(Numri i klasifikimit i formular sipas botimit të 4-t anglez të tabelës së KDU-së, për veprën me titull Machinery for harvesting oats in Great Britain in the 19th century.)*

2.

675 □□ **a681.3.04.071.8:025.3:05:07 v4 zeng**  
*(Numri i klasifikimit për veprën me titull Data elements essential to the interchange of serials records.)*

3. \* COBISS.net

675 □□ **a929Bogdani P. b929 c929 vUDCMRF 2006**  
*(Fjala shënohet menjëherë pas numrit KDU, pa hapësirë. Te emrat vetjakë shënohet edhe shkronja e parë e emrit.)*

4. \*

675 □□ **a025.3/.5:004.738.5 b02 c02 vUDCMRF 2011**  
*(Nënfusha 675b përdoret për klasifikimin e njërive në bibliografi. Kjo nënfushë nuk është e detyrueshme.)*

5. \*

675 □□ **a821.163.6-93-32(0.034.2) b821.163.6 c821.163.6-93 s82 vUDCMRF12**  
*(Numri në nënfushën 675a është përcaktuar në bazë të botimit të 4-t elektronik të tabelës së Klasifikimit Dhjetor Universal UDCMRF12, për këtë arsye në nënfushën 675v vendoset kodi "UDCMRF12".)*

6. \*

675 □□ **a929Vidali V. b929 c929 s929 vUDCMRF12**  
 675 □□ **a329.15(450):929Vidali V. c329 vUDCMRF12**  
*(KDU për veprën me titull Vittorio Vidali: jeta e komunistit të Triestës në periudhën 1916-1956. Në fushë e parë 675, në nënfushën a dhe c vendoset numri i KDU-së, i cili bazuar në përmbajtjen e librit është parësor. Nënfusha 675b dhe 675s në regjistrim zakonisht shfaqen vetëm një herë.)*



## 676 KLASIFIKIMI DHJETOR I DJUIT

Fusha përmban numrin e klasifikimit që i është ndarë njësisë në përputhje me skemën e Klasifikimit Dhjetor të Djuit (Dewey).

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
676	Klasifikimi Dhjetor i Djuit	r
<b>a</b>	<i>Numri</i>	nr
<b>v</b>	<i>Botimi</i>	nr
<b>z</b>	<i>Gjuha e botimit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 676a Numri

Numri nga tabela e Klasifikimi Dhjetor të Djuit.

### 676v Botimi

Numri i botimit të tabelës nga e cila është marrë numri i vendosur në nënfushën a. Shkronja "a" pranë numrit tregon botimin e shkurtuar (abridged edition) (shih shembullin 6).

### 676z Gjuha e botimit

Kodi i gjuhës së botimit nga i cili është marrë numri i vendosur në nënfushën a.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në nënfushën a vendoset numri i marrë nga tabelat e përdorura prej agjencisë së katalogimit. Numri mund të përmbajë shenjën (/), e cila tregon vendet e miratuara në shkallë ndërkombëtare, tek të cilat numri mund të shkurtohet. Numri nuk duhet të përmbaj të dhëna shtesë që përcaktojnë kopjet e veçanta të njësisë.

Nënfusha z përdoret vetëm nëse versioni i përkthyer ndryshon nga origjinali, p.sh. kur pjesë të skemës së klasifikimit i janë përshtatur kërkesave lokale.

## SHEMBUJ

1.

676	□□	<b>a943.0840924 v19</b> (Numri i klasifikimit për librin me titull 'Kaiser Wilhelm II : new interpretations', koleksionin e eseve biografike për perandorin gjerman Vilhelm II., 1890-1917. Njësia është klasifikuar sipas botimit të 19-të të tabelës.)
-----	----	---

2.

676	□□	<b>a823.912 v19</b> (Numri i klasifikimit për librin me tregime për fëmijë me titull 'Paddington at the station'. Libri është klasifikuar sipas botimit të 19-të të tabelës.)
-----	----	--

3.

676	□□	<b>a823/.912 v19</b> (Numri i klasifikimit për të njëjtën vepër; institucioni përdor vizën e pjerrët.)
-----	----	---

4.

676	□□	<b>a001.64/092/2 v19</b> (Numri i klasifikimit për librin me titull 'Computer pioneers'.)
-----	----	--

5.

676	□□	<b>aA823/.2 v19</b> (Numri i klasifikimit për librin me prozë në periudhën 1890-1945. Tabelat lejojnë përdorimin e numrit klasifikues A823.2 për dallim nga numri 823.2 (që tregon prozën britanike në periudhën 1400-1558).)
-----	----	--

6.

676	□□	<b>a914.3 v11a</b> (Numri i klasifikimit nga botimi i 11-të i shkurtuar.)
-----	----	--

## 680 KLASIFIKIMI I BIBLIOTEKËS SË KONGRESIT

Fusha përmban numrin e klasifikimit që i është ndarë njësisë sipas sistemit të klasifikimit të Bibliotekës së Kongresit.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
680		Klasifikimi i Bibliotekës së Kongresit
	<b>a</b>	<i>Numri</i>
		r
		nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 680a Numri

Numri nga tabela e klasifikimit të Bibliotekës së Kongresit.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Klasifikimin e Bibliotekës së Kongresit mund ta përdorë çdo bibliotekë që ka tabelën e Bibliotekës së Kongresit.

## SHEMBUJ

1.

680	□□	<b>aQL737.C27C723</b> <i>(Numri klasifikues për veprën "A proposed delineation of critical grizzly bear habitat in the Yellowstone region : a monograph presented at the Fourth International Conference on Bear research and Management".)</i>
-----	----	--

2.

680	□□	<b>aPZ8.3.A6A6</b> <i>(Numri klasifikues për veprën "The adventures of Egbert the Easter egg", të autorit Richard Willard Armour.)</i>
-----	----	---



## 686 KLASIFIKIME TË TJERA

Fusha përmban numra klasifikimi nga sistemet e klasifikimit që nuk kanë përdorim ndërkombëtar, mirëpo janë të kuptueshëm dhe të disponueshëm për publikun e gjërë.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
686	Klasifikime të tjera	r
<b>a</b>	<i>Numri</i>	r
<b>b</b>	<i>Numri i librit</i>	r
<b>c</b>	<i>Nënndarja e klasifikimit</i>	r
<b>2</b>	<i>Kodi i sistemit</i>	nr

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

---

### 686a Numri

Numri nga skema e caktuar e klasifikimit.

---

### 686b Numri i librit

Numri i librit që e ndanë agjencia e katalogimit.

---

### 686c Nënndarja e klasifikimit

Nënndarja e numrit të klasifikimit nga skema e caktuar e klasifikimit.

---

### 6862 Kodi i sistemit

Kodi i sistemit të klasifikimit që përdoret te nënndarja e numrit të klasifikimit.

<b>BL</b>	<i>Boggs&amp;Lewis</i>
<b>CC-APA</b>	<i>Content Classification System APA</i>

<b>CR 83</b>	<i>Full Computing Reviews Classification System 83</i>
<b>CR 86</b>	<i>Full Computing Reviews Classification System 86</i>
<b>CR 87</b>	<i>Full Computing Reviews Classification System 87</i>
<b>CR 91</b>	<i>Full Computing Reviews Classification System 91</i>
<b>CR 92</b>	<i>Full Computing Reviews Classification System 92</i>
<b>CTK</b>	<i>Klasifikimi CTK</i>
<b>FRASCATI</b>	<i>Klasifikimi sipas Fraskatit</i>
<b>GDK</b>	<i>Klasifikimi dhjetor i pylltarisë</i>
<b>INSPEC</b>	<i>INSPEC</i>
<b>MECH</b>	<i>MECH</i>
<b>MSC 2000</b>	<i>Mathematics Subject Classification 2000</i>
<b>MSC 2010</b>	<i>Mathematics Subject Classification 2010</i>
<b>MSC 2020</b>	<i>Mathematics Subject Classification 2020</i>
<b>MSC 60</b>	<i>Mathematics Subject Classification 1960</i>
<b>MSC 70</b>	<i>Mathematics Subject Classification 1970</i>
<b>MSC 80</b>	<i>Mathematics Subject Classification 1980</i>
<b>MSC 85</b>	<i>Mathematics Subject Classification 1985</i>
<b>MSC 91</b>	<i>Mathematics Subject Classification 1991</i>
<b>OILJ</b>	<i>Klasifikimi OILJ</i>
<b>PACS</b>	<i>PACS</i>
<b>RTPS</b>	<i>Sistemi kompjuterik teologjiko-pastoral</i>

## SHEMBUJ

1.

686	□□	<b>aW1 bRE359 2usnlm</b> (Numri i klasifikimi nga skema e Bibliotekës Kombëtare të Mjekësisë në SHBA.)
-----	----	---

2.

686	□□	<b>a281.9 bC81A 2usnal</b> (Numri i klasifikimi nga skema e Bibliotekës Kombëtare të Bujqësisë në SHBA.)
-----	----	---

3. \*

200	□□	<b>aEvropski matematični kenguru 1996-2001 fGregor Dolinar, Darjo Felda, Matjaž Željko</b>
686	□□	<b>a97U402MSC 2000</b> (Numri i klasifikimit nga skema e klasifikimit matematikor dhe lëndor.)



---

# 7XX BLOKU I TË DHËNAVE PËR PËRGJEGJËSINË

## LISTA E FUSHAVE

- 700 Emër vetjak – përgjegjësi parësore
- 701 Emër vetjak – përgjegjësi alternative
- 702 Emër vetjak – përgjegjësi dytësore
- 710 Emër organizate – përgjegjësi parësore
- 711 Emër organizate – përgjegjësi alternative
- 712 Emër organizate – përgjegjësi dytësore

Bloku 7XX përmban emra të personave dhe organizatave që kanë përgjegjësi intelektuale për njësinë bibliografike që përshkruhet.

Shënimi i emrave vetjakë në fushat 700, 701, 702, 900, 901 dhe 902 (në vazhdim 70X dhe 90X) dhe emrave të organizatave në fushat 710, 711, 712, 910, 911 dhe 912 (në vazhdim 71X dhe 91X) varet nga prania ose jo e kontrollit të njësuar të emrave vetjakë dhe emrave të organizatave në sistemin e përbashkët të katalogimit. Kontrolli i njësuar i emrave vetjakë për momentin funksionon në sistemet COBISS.SI, COBISS.BG dhe COBISS.AL, ndërsa kontrolli i njësuar i emrave të organizatave vetëm në sistemin COBISS.SI.

Me ndërtimin e bazës së njësuar të të dhënave dhe me zbatimin e kontrollit të njësuar të emrave vetjakë dhe emrave të organizatave në sistemin e katalogimit të përbashkët ka ndryshuar mënyra e shënimit të të dhënave në fushat 70X, 90X dhe 71X, 91X. Derisa emërtimet uniforme për emrat vetjakë në fushat 70X mund të transferohen vetëm nga baza e njësuar e të dhënave, emërtimet uniforme për organizatat në fushat 71X mund të transferohen nga baza e njësuar e të dhënave ose të shënohen në mënyrë manuale. Lidhja midis regjistrimeve të njësuara dhe emrave vetjakë në fushat 70X, apo emrave të organizatave në fushat 71X të regjistrimit bibliografik bëhet përmes nënfushës 7XX3 – *Numri i regjistrimit të njësuar* (shih manualin *COBISS3/Katalogimi*, kap. *Shënimi i të dhënave në fushat me kontroll të njësuar* dhe manualin *COMARC/A Formati për të dhënat e termave të njësuar*). E njëjta gjë vlenë edhe për shtimin e varianteve të emërtimeve dhe emërtimeve në lidhshmëri, ku fushat përkatëse 90X dhe 91X shtohen në mënyrë automatike në regjistrimet bibliografike.

Në sistemin, në të cilin shënimi i emrave vetjakë apo emrave të organizatave nuk kontrollohet, kataloguesi duhet t'i plotësoj vet të gjitha nënfushat përkatëse në fushat 70X dhe 90X si dhe fushat 71X dhe 91X.

Në përshkrimin e fushave 70X dhe 90X me dy yllthe "\*\*\*" janë identifikuar edhe fushat, të cilat janë anuluar pas zbatimit të kontrollit të njësuar (ndonëse ato vazhdojnë të përdoren në sistemet pa kontroll të njësuar).

## 700 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI PARËSORE

Fusha përmban emrin e personit që ka përgjegjësi parësore për veprën e përshkruar në regjistrimin bibliografik. Emri vendoset në formën e emërimit (kryetitullit) uniform.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
700	Emër vetjak – përgjegjësi parësore	nr
	<b>a</b> <i>Elementi hyrës</i>	nr
	<b>b</b> <i>Pjesa tjetër e emrit</i>	nr
	<b>c</b> <i>Shtesa të emrit (jo datat)</i>	r
	<b>d</b> <i>Numra romakë</i>	nr
	<b>e</b> <i>Vendi i punësimit**</i>	nr
	<b>f</b> <i>Datat</i>	nr
	<b>s</b> <i>Shkrimi*</i>	nr
	<b>3</b> <i>Numri i regjistrimit të njësuar</i>	nr
	<b>4</b> <i>Kodi për llojin e autorësisë</i>	r
	<b>7</b> <i>Kodi i kërkuesit shkencor*</i>	nr
	<b>8</b> <i>Kodi i institucionit/organizatës*</i>	r
	<b>9</b> <i>Numri i regjistrimit të mëparshëm të njësuar*</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Treguesi për shfaqjen*</i></b>
	□	<i>Nuk ka vlerë (shfaqet në bibliografinë personale)</i>
	2	<i>Nuk shfaqet në bibliografinë personale</i>
2		<b><i>Mënyra e shënimit të emrit</i></b>
	0	<i>Shënohet vetëm emri ose emri dhe mbiemri</i>
	1	<i>Shënohet mbiemri dhe emri</i>

Treguesi i parë përcakton nëse njësia shfaqet në bibliografinë personale ose jo.

Treguesi i dytë përcakton formën apo mënyrën e shënimit të emrit vetjak. Treguesi përcakton nëse emri është vendosur në renditje të drejtë (vetëm emri ose emri dhe mbiemri) ose në formë të përmbysur (mbiemri dhe emri).

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 700a Elementi hyrës

Pjesa e emrit që në emërtim (kryetitull) përdoret si element klasifikimi dhe që mundëson klasifikimin dhe kërkimin në katalog. Element hyrës zakonisht është mbiemri. Nëse pjesa e parë e

emrit përbëhet nga dy apo më shumë elemente, ashtu vendoset edhe në nënfushën a (shih shembujt 3, 4, 6, 7, 9, 17). Nënfusha a në fushën 700 është e detyrueshme.

---

### 700b Pjesa tjetër e emrit

Pjesa tjetër e emrit (emri ose emrat) kur mbiemri është element klasifikimi. Nëse kjo nënfushë është e plotësuar, vlera e treguesit të dytë duhet të jetë "1" (shih shembujt 1–6, 8, 10–17,19).

---

### 700c Shtesa të emrit (jo datat)

Shtesa të ndryshme të emrit (përveç dateve) që nuk janë pjesë përbërëse e emrit, p.sh. titujt, nofkat etj. (shih shembujt 8, 9). Nëse janë disa shtesa të emrit nënfusha përsëritet.

Shtesa shënohet kur disa autorë kanë të njëjtin emër dhe duhet të bëhet dallimi.

---

### 700d Numra romakë

Numrat romakë që janë pjesë e emrave të papëve, mbretërve dhe klerikëve. Nëse me numrin është e lidhur edhe nofka (ose emri shtesë), të dyja të dhënat vendosen në këtë nënfushë, edhe numri edhe nofka. Nëse nënfusha plotësohet, treguesi i dytë duhet të ketë vlerën "0" (shih shembullin 9).

---

### 700e Vendi i punësimit\*\*

Nënfusha është plotësuar deri në vitin 1991 për printimin e botimit Bulletin Scientifique.

---

### 700f Datat

Datat e lidhura me emrin vetjak. Në këtë nënfushë mund të vendosen edhe shenjat që tregojnë llojin e datës (p.sh. data e lindjes, data e vdekjes, periudha e veprimtarisë), në formë të plotë ose të shkurtuar.

Data ka rolin e elementit dallues kur janë disa autorë me emra të njëjtë. Zakonisht vendoset në formën "viti i lindjes—" ose "viti i lindjes–viti i vdekjes" (shih shembujt 10, 12, 13).

---

### 700s Shkrimi\*

Nënfusha përmban kodin për shkrimin e emërtimit (kryetitullit) (shih shembujt 18, 19). Përdoret vetëm në sistemet COBISS ku katagolët janë në disa shkrime.

---

### 7003 Numri i regjistrimit të njësuar

Në këtë nënfushë shënohet numri identifikues (ID) i regjistrimit të njësuar për emrin vetjak (shih shembujt 4–14).

---

### 7004 Kodi për llojin e autorësisë

Në këtë nënfushë vendoset kodi që tregon marrëdhënien midis personit dhe njësisë bibliografike (shih shembujt 5–19). Përdoret lista globale e kodeve (shih *Shtojca H*).

---

### 7007 Kodi i kërkuesit shkencor\*

Nënfusha përdoret për udhëheqjen e bibliografive në sistemin COBISS.

Në sistemin COBISS.SI përdoret në regjistrimet për të gjitha dokumentet ose veprat, autorët e të cilave janë të regjistruar në sistemin SICRIS ose kanë kodin që e ndanë IZUM-i. Në sistemin COBISS.AL përdoret në regjistrimet për të gjitha dokumentet ose veprat, autorët e të cilave janë të regjistruar në sistemin E-CRIS. Lista globale e kodeve të kërkuesve shkencorë përmban këto të dhëna: kodin e kërkuesit shkencor, mbiemrin dhe emrin, vitin e lindjes dhe fushën e veprimtarisë (shih shembujt 12, 13).

---

### 7008 Kodi i institucionit/organizatës\*

Nënfusha përdoret për udhëheqjen e bibliografive të institucioneve në sistemin COBISS. Nënfusha është e detyrueshme në regjistrimet, të cilat institucioni i caktuar dëshiron t'i klasifikoj në bibliografinë e institucionit (shih shembullin 13). Përdoret lista globale e kodeve të institucioneve /organizatave (shih *Shtojca F7*).

---

### 7009 Numri i regjistrimit të mëparshëm të njësuar\*

Nënfusha krijohet gjatë bashkërendimit automatik të regjistrimeve bibliografike me regjistrimet e njësuara që janë të përzgjedhura për t'u fshirë ose përmbajnë fushën 990 – *Rilidhjet*.

Nëse fusha 700 është e lidhur me një regjistrim të tillë të njësuar, gjatë procesit të bashkërendimit në nënfushën 3 vendoset në mënyrë automatike numri identifikues i regjistrimit të njësuar, i cili përdoret në vend të regjistrimit "të fshirë" ose "të ndarë", ndërsa përmbajtja e nënfushës 3 transferohet në nënfushën 9 (shih shembullin 14).

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Kur regjistrimi shfaqet në formatin ISBD, nga fusha 700 formohet emërtimi (kryetitulli) i përshkrimit kryesor. Në regjistrim nuk mund të jenë të plotësuara edhe fusha 700 edhe fusha 710 – *Emër organizate* –

*përgjegjësi parësore*, sepse nuk mund të jenë në të njëjtën kohë të përcaktuara si emërtime (kryetitull) të përshkrimit kryesor edhe emri vetjak edhe emri i organizatës.

Në fushën 700 duhet të plotësohet patjetër nënfusha 4 – *Kodi për llojin e autorësisë* (shih *Shtojca H*).

Në sistemet COBISS që kanë katalogë në disa shkrime dhe aplikojnë kontrollin e njësuar, fusha 700 është e përsëritshme (shih shembujt 18, 19). Regjistrimi i njësuar mund të përmbaj dy pikëqasje të njësuara në shkrime alternative (cirilik, latin), për këtë arsye fusha e përsëritshme 700 është e lidhur me regjistrimet e tilla të njësuara. Në fushën e parë 700 shfaqet emërtimi (kryetitulli) në shkrimin që përputhet me shkrimin e titullit të saktë.

Elementi hyrës duhet të shënohet me shkronja të vogla, të cilat shndërrohen në mënyrë automatike në shkronja të mëdha kur regjistrimi shfaqet.

### **Bibliografitë e kërkuesve shkencorë**

Nëse vlera e treguesit të parë është "2", njësia largohet nga paraqitja e bibliografisë personale të autorit. Treguesi nuk ndikon në paraqitjen e bibliografive të tjera.

Nënfushat 70X7 dhe 70X8 përdoren për udhëheqjen dhe vlerësimin e bibliografive të kërkuesve shkencorë. Shënimi i të dhënave të autorëve për udhëheqjen e bibliografive të kërkuesve shkencorë në mënyrë të hollësishme është përshkruar në *Shtojca F*.

## **FUSHAT NË LIDHSHMËRI**

### **200f** *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË, Përgjegjësia parësore*

Në fushën 200 shënohen të dhënat në formën siç janë në njësi. Në fushën 700 shënohet emri i personit që ka përgjegjësi parësore për veprën dhe është i shënuar në nënfushën f.

### **701** *EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI ALTERNATIVE*

Fusha përdoret kur përgjegjësinë për veprën e bartin disa autorë të barasvlershëm. Të dhënat në fushën 701 vendosen sipas të njëjtave rregulla, të cilat respektohen për vendosjen e të dhënave në fushën 700.

### **702** *EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI DYTËSORE*

Fusha përdoret për personat, përgjegjësia e të cilëve për veprën është më e vogël se e personave nga fushat 700 dhe/ose 701. Të dhënat në fushën 702 vendosen sipas të njëjtave rregulla, të cilat respektohen për vendosjen e të dhënave në fushën 700.

### **900** *EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI PARËSORE (VARIANTI I EMËRTIMIT)\**

Varianti i emërtimit është varianti ose forma e papranuar e emrit të autorit, i cili është shënuar në fushën 700.

### **903** *EMËR VETJAK (EMËRTIM NË LIDHSHMËRI)\**

Emërtimi në lidhshmëri është emërtimi uniform, që është i lidhur me emërtimin uniform në fushën 70X.

### **904** *EMËR VETJAK (EMËRTIM PARALEL)\**

Emërtimi paralel është emërtimi uniform për personin nga fusha 70X në një gjuhë ose shkrim tjetër.

## SHEMBUJ

1.

700	□1	<b>a</b> Benson, <b>b</b> Rowland S. <i>(Kjo mënyrë është e përshtatshme për sistemet që shenjat e pikësimit nuk vendosen në mënyrë automatike gjatë shfaqjes së regjistrimit. Në sistemet COBISS presja nuk vendoset në fund të nënfushës a.)</i>
-----	----	---

2.

700	□1	<b>a</b> Lawrence <b>b</b> D.H.
700	□1	<b>a</b> Lawrence <b>b</b> David Herbert
700	□1	<b>a</b> Lawrence <b>b</b> D.H. <b>g</b> David Herbert <i>(Emri i autorit të njëjtë është shënuar në forma të ndryshme në fushat 700. Shembulli shërben si ilustrim për të treguar se në institucione të ndryshme përdoren rregulla të ndryshme të katalogimit.)</i>

3.

700	□1	<b>a</b> Day Lewis, <b>b</b> Cecil <i>(Cecil Day Lewis ka dy mbiemra, midis të cilëve nuk ka vizë. Emri i tij është shënuar në përputhje me rregullat, të cilat përcaktojnë shënimin e emrit të autorit në formën Day Lewis, Cecil.)</i>
-----	----	---

4.

700	□1	<b>3014678 a</b> Bridges-Webb, <b>b</b> Charles <i>(Në nënfushën 3 është shënuar numri identifikues i regjistrimit të njësuar.)</i>
-----	----	--

5. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Princesha Argjiro epomë për fëmijë të moshës së mesme dhe të rritur shkollorë <b>f</b> Ismail Kadare
700	□1	<b>3412774 a</b> Kadare <b>b</b> Ismail <b>4070</b> <i>(Në nënfushën 3 është shënuar numri identifikues i regjistrimit të njësuar në bazën e të dhënave CONOR.AL.)</i>

200	□1	<b>a</b> Kadare <b>b</b> Ismail
-----	----	---------------------------------

6. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Ora e ligë <b>f</b> Gabriel Garcia Marquez
700	□1	<b>33641446 a</b> García Márquez <b>b</b> Gabriel <b>4070</b>

7. \*

200	0□	<b>a</b> Samorastniki ekoroške povesti <b>f</b> Prežihov Voranc
700	□0	<b>3955235 a</b> Prežihov Voranc <b>4070</b> <i>(Nëse nënfusha b nuk është e plotësuar, vlera e treguesit të dytë duhet të jetë "0".)</i>

8. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Stina ime <b>f</b> Martin Doli, i riu
700	□1	<b>3xxxxxx a</b> Doli <b>b</b> Martin ci riu <b>4070</b>

9. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Catholic church <b>f</b> Joannes Paulus II
700	□0	<b>3xxxxxx a</b> Joannes Paulus <b>d</b> II <b>cpapë 4070</b> <i>(Nëse është plotësuar nënfusha d, vlera e treguesit të dytë është "0".)</i>

## 10. \* COBISS.net

200	0	<b>a</b> Identiteti i shqiptarëve dhe të metat e debatit Qose-Kadare <b>f</b> Kristo Frashëri
700	1	<b>3535654 a</b> Frashëri <b>b</b> Kristo <b>f</b> 1920-2016 <b>4070</b>

## 11. \* COBISS.net

200	0	<b>a</b> Pinoku <b>f</b> [shkroi dhe ilustroi Melisa Dreshaj]
700	1	<b>3xxxxxx a</b> Dreshaj <b>b</b> Melisa <b>4070 4440</b> <i>(Autorja ka shkruar tekstin dhe ka bërë ilustrimet për këtë arsye është përsëritur nënfusha 4.)</i>

## 12. \* COBISS.net

200	0	<b>a</b> Samiu ynë i madh <b>f</b> Kristo Frashëri
700	1	<b>3535654 a</b> Frashëri <b>b</b> Kristo <b>f</b> 1920-2016 <b>r00728 4070</b> <i>(Kodi i kërkuesit shkencor nga nënfusha 200r e regjistrimit të njësuar transferohet në nënfushën 7007 të regjistrimit bibliografik.)</i>

200	1	<b>a</b> Frashëri <b>b</b> Kristo <b>f</b> 1920-2016 <b>r00728</b> <i>(Kërkuesi shkencor Kristo Frashëri ka kodin 00728.)</i>
-----	---	--

## 13. \*

200	0	<b>a</b> Energija - za življenje in gospodarstvo <b>f</b> Franc Lobnik
700	1	<b>31649507 a</b> Lobnik <b>b</b> Franc <b>f</b> 1942- 700952 <b>4070 83-104.01</b> <i>(Kërkuesi shkencor me kodin 00952 është i angazhuar në Departamentin për Agronomi, Fakulteti Biotenik, Universiteti i Lubjanës me kodin e institucionit 3-104.01.)</i>

## 14. \* COBISS.net

200	0	<b>a</b> Gjuha jonë sa e mirë etregime, përralla, vjersha e poema <b>f</b> Naim Frashëri
700	1	<b>31064806 9485478 a</b> Frashëri <b>b</b> Naim <b>4070</b> <i>(Në nënfushën 9 pas bashkërendimit të regjistrimeve bibliografike me regjistrimet e njësuara në mënyrë automatike transferohet numri identifikues (ID) i regjistrimit të njësuar, i cili është përzgjedhur për t'u fshirë, ndërsa në nënfushën 3 numri identifikues i regjistrimit të njësuar që zëvendëson regjistrimin e "fshirë".)</i>

001	1	<b>ad bx ca x6006115</b>
200	1	<b>a</b> Manfredi <b>b</b> Massimo Valerio
835	1	<b>a</b> Duplikat <b>b</b> Manfredi, Valerio Massimo <b>d</b> 20030521

200	1	<b>a</b> Manfredi <b>b</b> Valerio Massimo
836	1	<b>b</b> Manfredi, Massimo Valerio <b>d</b> 20030521

## 15. \* COBISS.net

200	0	<b>a</b> Agolli <b>f</b> Ditëro
700	1	<b>a</b> Agolli <b>b</b> Dritëro <b>4070</b>

## 16. \* COBISS.net

200	0	<b>a</b> Gjarpërinjtë e gjakut froman <b>f</b> Adem Demaçi
700	1	<b>a</b> Demaçi <b>b</b> Adem <b>4070</b>



## 17. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Kualifikimi i mësimdhënësve në kuadër të politikave të të mësuarit gjatë gjithë jetës <b>f</b> Arbërore <b>B</b> erisha- <b>B</b> icaj
700	□1	<b>a</b> Arbërore <b>B</b> erisha <b>b</b> Bicaj <b>4070</b>

## 18. \* COBISS.net

101	0□	<b>a</b> bul
200	0□	<b>a</b> Ноев ковчег ероман <b>f</b> Йордан Димитров Радичков
700	□1	<b>31854053 sca a</b> Радичков <b>b</b> Йордан Димитров <b>f1929-2004 4070</b>
700	□1	<b>31854053 sba a</b> Radičkov <b>b</b> Jordan Dimitrov <b>f1929-2004 4070</b> <i>(Fusha paralele 70X përdoret vetëm në sistemet kombëtare COBISS që kanë katalogë në shkrim cirilik dhe latin.)</i>

## 19. \* COBISS.net

100	□□	<b>bd c1985 h</b> bul <b>I</b> ba
101	0□	<b>a</b> eng
200	0□	<b>a</b> Mr. William Shakespeares comedies, histories and tragedies, published according to the true original copies
700	□1	<b>3975717 sba a</b> Shakespeare <b>b</b> William <b>f1564-1616 4070</b>
700	□1	<b>3975717 sca a</b> Шекспир <b>b</b> Уилям <b>f1564-1616 4070</b> <i>(Te fushat paralele 70X nënfusha s është e detyrueshme. Shkrimi në fushën e parë 700 përputhet me shkrimin e titullit të saktë.)</i>



## 701 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI ALTERNATIVE

Fusha përmban emrin e personit që bartë përgjegjësinë alternative për veprën e përshkruar në regjistrimin bibliografik. Emri shënohet në formën e përzgjedhur si emërtim (kryetitull) uniform.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
701	Emër vetjak – përgjegjësi alternative	r
<b>a</b>	<i>Elementi hyrës</i>	nr
<b>b</b>	<i>Pjesa tjetër e emrit</i>	nr
<b>c</b>	<i>Shtesa të emrit (jo datat)</i>	r
<b>d</b>	<i>Numra romakë</i>	nr
<b>e</b>	<i>Vendi i punësimit**</i>	nr
<b>f</b>	<i>Datat</i>	nr
<b>s</b>	<i>Shkrimi*</i>	nr
<b>3</b>	<i>Numri i regjistrimit të njësuar</i>	nr
<b>4</b>	<i>Kodi për llojin e autorësisë</i>	r
<b>6</b>	<i>Të dhënat për lidhjen**</i>	nr
<b>7</b>	<i>Kodi i kërkuesit shkencor*</i>	nr
<b>8</b>	<i>Kodi i institucionit/organizatës*</i>	r
<b>9</b>	<i>Numri i regjistrimit të mëparshëm të njësuar*</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Treguesi për shfaqjen*</i></b>
	□	<i>Nuk ka vlerë (shfaqet në bibliografinë personale)</i>
	0	<i>Shfaqet në bibliografi</i>
	1	<i>Shfaqet në bibliografi dhe katalogë</i>
2	2	<i>Nuk shfaqet në bibliografinë personale</i>
		<b><i>Mënyra e shënimit të emrit</i></b>
	0	<i>Shënohet vetëm emri ose emri dhe mbiemri</i>
	1	<i>Shënohet mbiemri dhe emri</i>

Treguesi i parë përcakton shfaqjen. Vlera "0" dhe "1" ndikojnë në përshkrimet shitesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Në sistemet e tjera treguesi nuk është i përcaktuar, me përjashtim të vlerës "2", me anë të së cilës mund të largohet njësia nga bibliografia personale.

Treguesi i dytë përcakton formën apo mënyrën e shënimit të emrit vetjak. Treguesi përcakton nëse emri është vendosur në renditje të drejtë (vetëm emri ose emri dhe mbiemri) ose në formë të përmbysur (mbiemri dhe emri).

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 7016 Të dhënat për lidhjen\*\*

Shënohet një numër 2 shifror (01-99) për lidhjen e fushave 701 me fushat përkatëse 901.

Për nënfushat e tjera vlejné udhëzimet e përshkruara në fushën 700 (shih përshkrimin e fushës 700).

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në regjistrimin për veprën e dy apo tre autorëve individualë, emërtimi (kryetitulli) për autorin e parë vendoset në fushën 700 (si emërtim i përshkrimit kryesor), për të dytin në fushën 701 dhe për të tretin në fushën e përsëritshme 701. Në një regjistrim që përmban fushën 700 mund të jenë më së shumti dy fusha 701.

Në regjistrimin për veprën me më shumë se tre autorë individualë fusha 700 nuk plotësohet. Emërtimi (kryetitulli) për autorin e parë shënohet në fushën 701. Nëse përcaktoheni për shënimin e një numri më të madh të autorëve, për çdo autor shtoni një fushë të re 701 (shih *Shtojca F*).

Në fushën 701 patjetër duhet të plotësohet edhe nënfusha 4 – *Kodi për llojin e autorësisë* (shih *Shtojca H*).

Te katalogimi pa kontroll të njësuar duhet të plotësohet nënfusha 6 – *Të dhënat për lidhjen\*\** (shih shembujt 5, 6) e cila përdoret për lidhjen e emërtimit (kryetitullit) uniform me format e tjera të emrit të autorit. Fushat 701 dhe 901 lidhen duke vendosur në nënfushën 6 numrin e njëjtë (01–99) në të dyja fushat. Nëse fushës 701 i takojné disa fusha 901, në nënfushën 6 vendoset numër i njëjtë në të gjitha fushat përkatëse 901. Me aplikimin e kontrollit të njësuar të emrave vetjakë nënfusha 7016 është larguar, sepse lidhja midis fushave 701 dhe 901 bëhet përmes nënfushës 3 – *Numri i regjistrimit të njësuar*.

Në sistemet COBISS, ku katalogët i kanë në disa lloje të shkrimit dhe aplikojné kontrollin e njësuar, fusha 701 mund të përsëritet edhe për autorin e njëjtë (shih shembujt 7, 8). Regjistrimi i njësuar mund të përmbaj dy pikëqasje të njësuara në shkrime alternative (cirilik, latin), për këtë arsye edhe fusha 701 është e përsëritshme dhe lidhet me regjistrimin e tillë të njësuar. Në fushën e parë 701 shënohet emërtimi në shkrimin që përputhet me shkrimin e titullit të saktë.

### Bibliografitë e kërkuesve shkencorë

Nëse vlera e treguesit të parë është "2", njësia largohet nga paraqitja e bibliografisë personale të autorit. Treguesi nuk ndikon në paraqitjen e bibliografive të tjera.

Nënfushat 70X7 dhe 70X8 përdoren për udhëheqjen dhe vlerësimin e bibliografive të kërkuesve shkencorë. Shënimi i të dhënave të autorëve për udhëheqjen e bibliografive të kërkuesve shkencorë në mënyrë të hollësishme është përshkruar në *Shtojca F*.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**200f**    *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË, Përgjegjësia parësore*

Në fushën 200 shënohen të dhënat në formën siç janë në njësi. Nëse në nënfushën f janë të shënuar disa persona (deri në tre), te personi i dytë dhe i tretë zakonisht bëhet fjalë për përgjegjësi alternative dhe të dhënat për autorin shënohet në fushën 701.

**700 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI PARËSORE**

Te veprat me më së shumti tre autorë në fushën 700 shënohet emërtimi (kryetitulli) për autorin e parë. Të dhënat në fushën 700 vendosen sipas të njëjtave rregulla, të cilat respektohen për vendosjen e të dhënave në fushën 701.

**702 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI DYTËSORE**

Fusha përdoret për personat, përgjegjësia e të cilëve për veprën është më e vogël se e personave nga fushat 700 dhe/ose 701. Të dhënat në fushën 702 vendosen sipas të njëjtave rregulla, të cilat respektohen për vendosjen e të dhënave në fushën 701.

**901 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI ALTERNATIVE (VARIANTI I EMËRTIMIT)\***

Varianti i emërtimit (kryetitullit) që është varianti apo forma e emrit të autorit e vendosur në fushën 701.

**903 EMËR VETJAK (EMËRTIM NË LIDHSHMËRI)\***

Emërtimi alternativ është emërtimi uniform që është i lidhur me emërtimin (kryetitullin) uniform në fushën 70X.

**904 EMËR VETJAK (EMËRTIM PARALEL)\***

Emërtimi paralel është emërtimi uniform për personin nga fusha 70X në një gjuhë ose shkrim tjetër.

## SHEMBUJ

1.

700	□1	aNewton, bClive R. (autori parësor)
701	□1	aParker, bR.S. (autori alternativ)

2. \* COBISS.net

200	0□	aFjalor sinonimik i gjuhës shqipe dmbi 30.000 zëra fAli Dhrimo, Edmond Tupja, Eshref Ymeri gdrejtuar dhe redaktuar nga Ali Dhrimo
700	□1	32038630 aDhrimo bAli 4070
701	□1	3180326 aTupja bEdmond 4070
701	□1	3169318 aYmeri bEshref 4070
<i>(Kur njësia është vepër e më së shumti tre autorëve me përgjegjësi të barasvlershme, në fushën 700 shënohet autori i parë, ndërsa në fushat 701 dy të tjerët.)</i>		

3. \* COBISS.net

200	1□	aGramatika e gjuhës shqipe h#Vëll. #2 isintaksa fMehmet Çeliku ... [et al.]
701	□1	31121126 aÇeliku bMehmet 4070
<i>(Kur vepra ka më shumë se tre autorë me përgjegjësi të barasvlershme, zakonisht në fushën 701 shënohet autori i parë. Nuk është e detyrueshme, mirëpo mund të shënoni të gjithë autorët, nëse dëshironi të jenë të kërkueshëm ose të shfaqen në formatin standard të regjistrimit.)</i>		

4. \* COBISS.net

200	1□	aGastroenterologjia fBashkim Resuli ... [et al.] g[redaktore Angelina Ceka]
300	0□	aBashkëautorë: Skerdi Prifti, Ilir Bibolli, Ilir Kajo, Jovan Basho, Adriana Babameto

701	□1	3257638	aResuli bBashkim 700513 4070
701	□1	3249446	aPrifti bSkerdi 700517 4070
701	□1	3257382	aBibolli bIlir 700516 4070
701	□1	3496486	aKajo bIlir 4070
701	□1	33174	aBasho bJovan 700514 4070
701	□1	3496742	aBabameto bAdriana 4070
702	□1	3496998	aCeka bAngjelina 4340

*(Kur vepra ka më shumë se tre autorë në regjistrim mund të shtohen disa fusha 701, ndërsa për bashkëautorët bëhet shënim në fushën 300. Te regjistrimet e krijuara para aplikimit të kontrollit të njësuar, nënfusha 3 në fushat 70X mund të jetë e zbrazët.)*

## 5. \*

200	0□	aFoundations of psychology fJoan E. Grusec, Robert S. Lockhart, Gary C. Walters
700	□1	35554278 aGrusec bJoan E. 4070
701	11	35554534 aLockhart bRobert S. 4070
701	11	35554790 aWalters bGary C. 4070

*(Regjistrimi është krijuar në sistemin, në të cilin shtypen skedat për katalogun manual. Për shkak të përshkrimit shtesë në fushën 701 vlera e treguesit të parë është "1".)*

## 6. \* COBISS.net

200	1□	aTeknologjia e informacionit fArben Rama ... [et al.] g[redaktor Endrit Kelmendi]
701	11	aRama bArben 4070
702	01	aKelmendi bEndrit 4440

*(Nëse njësia ka më shumë se tre autorë me përgjegjësi të barasvlershme, në fushën 701 zakonisht vendoset autori i parë.)*

## 7. \* COBISS.net

200	1□	aНајлепше класичне бајке fАндерсен, Грим, Перо gизабрала и приредила Снежана Кићовић-Пејаковић
701	11	37661415 scb aАндерсен bХанс Кристијан f1805-1875 4070
701	11	37661415 sba aAndersen bHans Christian f1805-1875 4070
701	01	33079271 scb aГрим bЈакоб f1785-1863 4070
701	01	33079271 sba aGrimm bJacob f1785-1863 4070
701	01	33079527 scb aГрим bВилхелм f1786-1859 4070
701	01	33079527 sba aGrimm bWilhelm f1786-1859 4070
701	01	33079271 scb aПеро bШарл f1628-1703 4070
701	01	33079271 sba aPerrault bCharles f1628-1703 4070

*(Fusha paralele 70X përdoret vetëm në sistemet kombëtare COBISS që kanë katalogë në shkrim cirilik dhe latin.)*

## 8. \* COBISS.net

200	0□	aЕлектроенергетика fПеткоНотов, Стефка Неделчева
700	□1	310230629 sca aНотов bПетко Петров f1935- 4070
700	□1	310230629 sba aNotov bPetko Petrov f1935- 4070
701	11	313328229 sca aНеделчева bСтефка Иванова f1953- 4070
701	11	313328229 sba aNedelčeva bStefka Ivanova f1953- 4070

*(Nënfushat 3 në fushat paralele 70X përmbajnë të njëjtin numër të regjistrimit të njësuar, sepse format paralele të emërtimit (kryetitullit) transferohen nga regjistrimi i njëjtë i njësuar.)*

## 702 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI DYTËSORE

Fusha përmban emrin e personit që bartë përgjegjësinë dytësore për veprën e përshkruar në regjistrimin bibliografik (p.sh. ilustrator, përkthyes, redaktor, këshillues (mentor), fotograf etj.). Emri shënohet në formën e përzgjedhur si emërtim (kryetitull) uniform.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
702	Emër vetjak – përgjegjësi dytësore	r
	<b>a</b> <i>Elementi hyrës</i>	nr
	<b>b</b> <i>Pjesa tjetër e emrit</i>	nr
	<b>c</b> <i>Shtesa të emrit (jo datat)</i>	r
	<b>d</b> <i>Numra romakë</i>	nr
	<b>e</b> <i>Vendi i punësimit**</i>	nr
	<b>f</b> <i>Datat</i>	nr
	<b>s</b> <i>Shkrimi*</i>	nr
	<b>3</b> <i>Numri i regjistrimit të njësuar</i>	nr
	<b>4</b> <i>Kodi për llojin e autorësisë</i>	r
	<b>5</b> <i>Institucioni për të cilin zbatohet fusha</i>	nr
	<b>6</b> <i>Të dhëna për lidhjen**</i>	nr
	<b>7</b> <i>Kodi i kërkuesit shkencor*</i>	nr
	<b>8</b> <i>Kodi i institucionit/organizatës*</i>	r
	<b>9</b> <i>Numri i regjistrimit të mëparshëm të njësuar*</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Treguesi për shfaqjen*</i></b>
	□	<i>Nuk ka vlerë (shfaqet në bibliografinë personale)</i>
	0	<i>Shfaqet në bibliografi</i>
	1	<i>Shfaqet në bibliografi dhe katalogë</i>
	2	<i>Nuk shfaqet në bibliografinë personale</i>
2		<b><i>Mënyra e shënimit të emrit</i></b>
	0	<i>Shënohet vetëm emri ose emri dhe mbiemri</i>
	1	<i>Shënohet mbiemri dhe emri</i>

Treguesi i parë përcakton shfaqjen. Vlera "0" dhe "1" ndikojnë në përshkrimet shtesë në sistemet, të cilat shtypin skedat për katalogun manual. Në sistemet e tjera treguesi nuk është i përcaktuar, me përjashtim të vlerës "2", me anë të së cilës mund të largohet njësia nga bibliografia personale.

Treguesi i dytë përcakton formën apo mënyrën e shënimit të emrit vetjak. Treguesi përcakton nëse emri është vendosur në renditje të drejtë (vetëm emri ose emri dhe mbiemri) ose në formë të përmbysur (mbiemri dhe emri).

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 7025 Institucioni për të cilin zbatohet fusha

Emri i institucionit në formë të koduar. Shënohet kodi i bibliotekës (sigla).

### 7026 Të dhëna për lidhjen\*\*

Shënohet një numër 2 shifror (01–99) për lidhjen e fushave 702 me fushat përkatëse 902.

Për nënfushat e tjera vlejné udhëzimet e përshkruara në fushën 700 (shih përshkrimin e fushës 700).

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha 702 mund të plotësohet edhe nëse nuk janë të plotësuara fushat 700 dhe 710. Në fushën 702 patjetër duhet të plotësohet nënfusha 4 – *Kodi për llojin e autorësisë* (shih *Shtojca H*).

Te katalogimi pa kontroll të njësuar duhet të plotësohet nënfusha 6 – *Të dhëna për lidhjen\*\**, e cila përdoret për lidhjen e emërtimit (kryetitullit) uniform me format e tjera të emrit të autorit. Fushat 702 dhe 902 lidhen duke vendosur në nënfushën 6 numrin e njëjtë (01–99) në të dyja fushat. Nëse fushës 702 i takojné disa fusha 902, në nënfushën 6 vendoset numër i njëjtë në të gjitha fushat përkatëse 902. Me aplikimin e kontrollit të njësuar të emrave vetjakë nënfusha 7026 është larguar, sepse lidhja midis fushave 702 dhe 902 bëhet përmes nënfushës 3 – *Numri i regjistrimit të njësuar*.

Në sistemet COBISS, ku katalogët i kanë në disa lloje të shkrimit dhe aplikojné kontrollin e njësuar, fusha 702 mund të përsëritet edhe për autorin e njëjtë (shih shembujt 7, 8). Regjistrimi i njësuar mund të përmbaj dy pikëqasje të njësuara në shkrime alternative (cirilik, latin), për këtë arsye edhe fusha 702 është e përsëritshme dhe lidhet me regjistrimin e tillë të njësuar. Në fushën e parë 702 shënohet emërtimi në shkrimin që përputhet me shkrimin e titullit të saktë.

### Bibliografitë e kërkuesve shkencorë

Nëse vlera e treguesit të parë është "2", njësia largohet nga paraqitja e bibliografisë personale të autorit. Treguesi nuk ndikon në paraqitjen e bibliografive të tjera.

Nënfushat 70X7 dhe 70X8 përdoren për udhëheqjen dhe vlerësimin e bibliografive të kërkuesve shkencorë. Shënimi i të dhënave të autorëve për udhëheqjen e bibliografive të kërkuesve shkencorë në mënyrë të hollësishme është përshkruar në Shtojca *Shtojca F*.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**200fg** *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË, Përgjegjësia parësore, Persona të tjerë përgjegjës*



Në fushën 200 shënohen të dhënat në formën siç janë në njësi. Emërtimi (kryetitulli) uniform për personin nga nënfusha f ose g, i cili ka përgjegjësi dytësore, vendoset në fushën 702.

**700 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI PARËSORE**

Te veprat me më së shumti tre autorë në fushën 700 shënohet emërtimi (kryetitulli) për autorin e parë. Të dhënat në fushën 700 vendosen sipas të njëjtave rregulla, të cilat respektohen për vendosjen e të dhënave në fushën 702.

**701 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI ALTERNATIVE**

Fusha përdoret kur përgjegjësinë për veprën e bartin disa autorë të barasvlershëm. Të dhënat në fushën 701 vendosen sipas të njëjtave rregulla, të cilat respektohen për vendosjen e të dhënave në fushën 702.

**902 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI DYTËSORE (VARIANTI I EMËRTIMIT)\***

Varianti i emërtimit (kryetitullit) që është varianti apo forma e emrit të autorit e vendosur në fushën 702.

**903 EMËR VETJAK (EMËRTIM NË LIDHSHMËRI)\***

Emërtimi alternativ është emërtimi uniform që është i lidhur me emërtimin (kryetitullin) uniform në fushën 70X.

**904 EMËR VETJAK (EMËRTIM PARALEL)\***

Emërtimi paralel është emërtimi uniform për personin nga fusha 70X në një gjuhë ose shkrim tjetër.

## SHEMBUJ

1.

702	□1	<b>a</b> Irvin <b>b</b> Thomas Francis 4440 <i>(Emri i personit me përgjegjësi dytësore, përfshirë kodin e autorësisë që në këtë shembull është ilustrator.)</i>
-----	----	---

2. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Pranvera e përgjakur <b>f</b> Agim Xhaka <b>g</b> [përthyes dhe ilustrator Bardh Koka]
700	□1	<b>a</b> Xhaka <b>b</b> Agim 4070
702	□1	<b>a</b> Koka <b>b</b> Bardh 4080 4730 <i>(Kur personi ka disa lloje të autorësisë përsëritet nënfusha 4. Në regjistrimet e krijuara para aplikimit të kontrollit të njësuar nënfusha 3 në fushat 70X mund të jetë e zbrazët.)</i>

3. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Historia e Shqipërisë epër shkollat e mesme <b>f</b> Kristo Frashëri, Stefanaq Pollo gredaktore Vasilika Stavre
700	□1	3535654 <b>a</b> Frashëri <b>b</b> Kristo <b>f</b> 1920-2016 700728 4070
701	□1	34618598 <b>a</b> Pollo <b>b</b> Stefanaq 4070
702	□1	36338150 <b>a</b> Stavre <b>b</b> Vasilika 4340

4. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> CIA kundër KGB earti i spiunazhit <b>f</b> Allen Dulles <b>g</b> përktheu nga rusishtja Nikolla Sudar gredaktor Nexhat Myftiu
700	□1	<b>a</b> Dulles <b>b</b> Allen 4070
702	□1	<b>a</b> Sudar <b>b</b> Nikolla 4730
702	□1	<b>a</b> Myftiu <b>b</b> Nexhat 4340 <i>(Në regjistrimet e krijuara para aplikimit të kontrollit të njësuar nënfusha 3 në fushat 70X mund të jetë e zbrazët.)</i>

## 5. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Koktej <b>e</b> Victor Hygo <b>f</b> përgatitur nga Orion Zavalani <b>g</b> redaktor letrar Maksim Gjinaj
700	□1	<b>a</b> Hygo <b>b</b> Victor 4070
702	01	<b>a</b> Zavalani <b>b</b> Orion 4220
702	01	<b>a</b> Gjinaj <b>b</b> Maksim 4340 <i>(Regjistrimi është krijuar në sistemin, në të cilin shtypen skedat për katalogun manual, për këtë arsye është përcaktuar treguesi i parë në fushat 702.)</i>

## 6. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> Fjalor i shqipes së sotme <b>e</b> me rreth 35000 fjalë <b>f</b> hartuar nga Androkli Kostallari ... [et al.]
702	01	<b>a</b> Kostallari <b>b</b> Androkli 4220

## 7. \* COBISS.net

200	0□	<b>a</b> Les <b>#</b> historiens français à l'œuvre: 1995-2010 <b>f</b> sous la direction de Jean-François Sirinelli ... [et al.]
702	01	<b>3</b> 14127973 <b>sba</b> <b>a</b> Sirinelli <b>b</b> Jean-Francois <b>f</b> 1949- 4340
702	01	<b>3</b> 14127973 <b>sca</b> <b>a</b> Сиринели <b>b</b> Жан-Франсоа <b>f</b> 1949- 4340 <i>(Fushat paralele 70X përdoren vetëm në sistemet kombëtare COBISS që kanë katalogë në shkrim cirilik dhe latin.)</i>

## 8. \* COBISS.net

200	1□	<b>a</b> Интервенционизам Уједињених нација <b>e</b> 1991-2004 <b>f</b> приредили Матс Бердал и Спирос Икономидис <b>g</b> превела са енглеског језика Наташа Бошковић
702	11	<b>3</b> 13918873 <b>scb</b> <b>a</b> Бердал <b>b</b> Матс 4340 4080
702	11	<b>3</b> 13918873 <b>sba</b> <b>a</b> Berdal <b>b</b> Mats 4340 4080
702	01	<b>3</b> 13918903 <b>scb</b> <b>a</b> Икономидис <b>b</b> Спирос 4340 4080
702	01	<b>3</b> 13918903 <b>sba</b> <b>a</b> Economides <b>b</b> Spyros 4340 4080
702	01	<b>3</b> 1497703 <b>scb</b> <b>a</b> Бошковић <b>b</b> Наташа <b>f</b> 1982- 4730
702	01	<b>3</b> 1497703 <b>sba</b> <b>a</b> Bošković <b>b</b> Nataša <b>f</b> 1982- 4730

## 710 EMËR ORGANIZATE – PËRGJEGJËSI PARËSORE

Fusha përmban emrin e organizatës që bartë përgjegjësinë parësore për veprën e përshkruar në regjistrimin bibliografik. Emri vendoset në formën e përzgjedhur për emërtimin (kryetitullin) uniform.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
710	Emër organizate – përgjegjësi parësore	nr
<b>a</b>	<i>Elementi hyrës</i>	nr
<b>b</b>	<i>Nënndarje</i>	r
<b>c</b>	<i>Shtesa të emrit ose cilësori</i>	r
<b>d</b>	<i>Numri i mbledhjes</i>	nr
<b>e</b>	<i>Vendi i mbledhjes</i>	r
<b>f</b>	<i>Viti i mbledhjes</i>	nr
<b>g</b>	<i>Elementi i përmbysur</i>	nr
<b>h</b>	<i>Pjesa e emrit (jo elementi hyrës ose i përmbysur)</i>	nr
<b>3</b>	<i>Numri i regjistrimit të njësuar</i>	nr
<b>4</b>	<i>Kodi për llojin e autorësisë</i>	r
<b>8</b>	<i>Kodi i institucionit/organizatës*</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b>Lloji i organizatës</b>
	0	<i>Emër organizate</i>
Te fushat, përmbajtja e të cilave me kohë ndryshon, ndodhet nënfusha 0 – *Periudha kohore* dhe nënfusha 1 – *Shënime për periudhën kohore*. Në të parën vendoset periudha për të cilën vlejnjë të dhënat në fushë, ndërsa në të dytën shënimet e mundshme për këtë periudhë.

Nëse autori (personi ose organizata) kryen një funksion të caktuar në periudha të ndryshme, të dhënat për këtë vendosen në një fushë 702 apo 712 dhe në të përsëritet nënfusha 0. Një fushë 702 apo 712 përdoret edhe nëse autori në një periudhë kohore kryen disa funksione. Në këtë rast përsëritet nënfusha 4. Llojet e ndryshme të autorësisë së një autori të caktuar, në periudha të ndryshme kohore, vendosen në fushat e përsëritshme 702 apo 712.

## 011 ISSN

Kjo fushë është e detyrueshme dhe e nevojshme për identifikimin dhe kërkimin e serialeve. Plotësohen nënfushat 011e dhe/ose 011c. Të dhënat vendosen sipas rregullave të njëjta sikurse te përshkrimi bibliografik (shih kapitullin 011 – *ISSN*).

## 200 TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË

Kjo fushë është e detyrueshme dhe e nevojshme për identifikimin dhe kërkimin e serialeve. Plotësohen nënfushat 200abhi. Të dhënat vendosen sipas rregullave të njëjta sikurse te përshkrimi bibliografik (shih kapitullin 200 – *Titulli dhe të dhënat për përgjegjësinë*).

## 702 EMËR VETJAK – PËRGJEGJËSI DYTËSORE

Në këtë fushë shënohen të dhënat e emërimit (kryetitullit) uniform për personin që bartë përgjegjësinë dytësore për serialin (p.sh. redaktor, përkthyes etj.).

Treguesi i dytë ka vlerën e paracaktuar "1", sepse në nënfushën 702a zakonisht shënohet mbiemri, ndërsa në nënfushën 702b emri.

Në vazhdim janë përshkruar ato nënfusha të fushës 702, të cilat në bazat bibliografike ose mungojnë fare ose përdoren ndryshe. Për përshkrimin e nënfushave të tjera shih kapitullin 700 – *Emër vetjak – përgjegjësi parësore*.

---

### 7020 Periudha kohore

Në këtë nënfushë shënohet periudha për të cilën vlejnjë të dhënat në fushë.

1. viti1-viti2

(Të dhënat në fushë vlejnjë për periudhën e shënuar.)

2. viti-  
(Të dhënat në fushë vlejné për periudhën nga viti i shënuar e në vazhdim.)
3. viti  
(Të dhënat në fushë vlejné për vitin e shënuar.)

Nënfusha 0 - *Periudha kohore* është e përsëritshme, sepse e dhëna në fushë mund të vlejë për periudha të ndryshme.

## 7021 Shënime për periudhën kohore

Shënimet bëhen kur të dhënat për vitet e vendosura në nënfushën 0 - *Periudha kohore* nuk mjaftojnë për identifikimin e periudhës. Këto shënime u ndihmojnë bibliografëve dhe në bibliografi nuk shfaqen.

## 7023 Numri i regjistrimit të njësuar

Në nënfushë vendoset numri identifikues i regjistrimit të njësuar për emrin vetjak të vendosur në këtë fushë.

## 7024 Kodi për llojin e autorësisë

Në këtë nënfushë shënohet kodi që përcakton marrëdhënien midis personit, emri i të cilit është shënuar në fushë, dhe njësisë bibliografike.

Në listën e kodeve për këtë nënfushë janë vetëm kodet më të rëndësishme për serialet:

<b>130</b>	<i>disenjator grafik</i>
<b>340</b>	<i>redaktor</i>
<b>341</b>	<i>anëtar i bordit redaktorial*</i>
<b>342</b>	<i>redaktor i ftuar (i përkohshëm)*</i> Personi që redakton një pjesë të numrit të revistës (blloku tematik).
<b>343</b>	<i>redaktor shkencor*</i>
<b>344</b>	<i>kryeredaktor*</i>
<b>345</b>	<i>redaktor përgjegjës*</i>
<b>346</b>	<i>kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës*</i>
<b>347</b>	<i>anëtar i bordit redaktorial*</i>
<b>348</b>	<i>kryetar i bordit redaktorial*</i>
<b>349</b>	<i>redaktor teknik*</i>
<b>400</b>	<i>financues/sponsor</i>
<b>440</b>	<i>ilustrator</i>
<b>540</b>	<i>mbikëqyrës/kontraktues</i>
<b>600</b>	<i>fotograf</i>
<b>730</b>	<i>përkthyes</i>
<b>901</b>	<i>recensues*</i>
<b>913</b>	<i>autor i përmbledhjes (abstraktit)*</i>

<b>914</b>	<i>përkthyes i përmbledhjes (abstraktit)*</i>
<b>925</b>	<i>konsulent*</i>
<b>926</b>	<i>korrektor gjuhësor*</i>
<b>930</b>	<i>redaktor i numrit tematik*</i> Personi që redakton komplet numrin tematik të revistës.

## 7029 Numri i regjistrimit të mëparshëm të njësuar

Nënfusha formohet gjatë bashkërendimit automatik të regjistrimeve nga baza e të dhënave CORES me regjistrimet e njësuara që janë të përzgjedhur për t'u fshirë.

Kur fusha 702 është e lidhur me regjistrimin e njësuar të përzgjedhur për t'u fshirë, gjatë bashkërendimit në nënfushën 3 në mënyrë automatike vendoset numri identifikues i regjistrimit të vlefshëm të njësuar, ndërsa në nënfushën 9 transferohet numri identifikues i regjistrimit "të fshirë".

## 712 EMËR ORGANIZATE – PËRGJEGJËSI DYTËSORE

Në këtë fushë shënohet emërtimi (kryetitulli) uniform për organizatën që ka përgjegjësi dytësore për njësinë.

Në vazhdim janë përshkruar ato nënfusha të fushës 712, të cilat në bazat bibliografike ose mungojnë fare ose përdoren ndryshe. Për përshkrimin e nënfushave të tjera shih kapitullin 710 – *Emër organizate – përgjegjësi parësore*.

## 7120 Periudha kohore

Në këtë nënfushë shënohet periudha për të cilën vlejnë të dhënat në fushë (shih nënfushën 7020 - *Periudha kohore*).

## 7121 Shënime për periudhën kohore

Shënimet bëhen kur të dhënat për vitet e vendosura në nënfushën 0 – *Periudha kohore* nuk mjaftojnë për identifikimin e periudhës. Këto shënime u ndihmojnë bibliografëve dhe në bibliografi nuk shfaqen.

## 7124 Kodi për llojin e autorësisë

Në këtë nënfushë shënohet kodi që përcakton marrëdhënien midis organizatës, emri i së cilës është shënuar në fushë, dhe njësisë bibliografike.

Në listën e kodeve për këtë nënfushë janë vetëm kodet më të rëndësishme për serialet (shih nënfushën 7024 – *Kodi për llojin e autorësisë*).

## 2. REDAKTIMI

Regjistrimi për serialin në bazën e të dhënave CORES.XX. kërkohet përmes numrit të ISSN-së (011ec) ose përmes titullit të saktë (200a). Redaktohet dhe ruhet në të njëjtën mënyrë sikurse në bazën bibliografike.

Nëse në bazën CORES.XX nuk ndodhet regjistrimi për serialin e caktuar, regjistrimi shkarkohet nga baza e përbashkët e të dhënave. Në këtë mënyrë nga baza e përbashkët në bazën retrospektive të të dhënave transferohen nënfushat 011ec dhe 200abhi. Regjistrimi plotësohet me të dhënat retrospektive dhe ruhet.

Në bazën e të dhënave për retrospektivën e serialeve nuk mund të krijohen regjistrimet e reja. Për këtë arsye çdo regjistrim për serialet fillimisht duhet të krijohet dhe të ruhet në bazën bibliografike të të dhënave.

## 3. PARAQITJA

Te përgatitja e bibliografive personale, krahas regjistrimeve nga baza bibliografike do të respektohen edhe regjistrimet nga baza retrospektive e serialeve.

Regjistrimi nga baza e të dhënave për retrospektivën e serialeve përfshihet në bibliografinë personale nëse në fushën 702 ka të dhënat për personin për të cilin përgatitet bibliografia, dhe e dhëna në nënfushën 0 – *Periudha kohore* mbulon periudhën për të cilën përgatitet bibliografia.

## SHEMBUJ

1.

011	□□	e0570-8966
200	□□	aArheološki vestnik
702	01	330281571 aKorošec bJosip 4340 81-008 01950-1958 (Josip Korošec ka qenë redaktor i revistës nga viti 1950 deri 1958.)
702	01	31938275 aKastelic bJože 4341 702596 01973-1983 (Jože Kastelic nga viti 1959 deri 1966 ka qenë redaktor, ndërsa nga viti 1973 deri 1983 ka qenë anëtar i bordit redaktorial. Për shkak të dy llojeve të autorësisë në periudha të ndryshme është përsëritur fusha 702.)
702	01	31513315 aGabrovec bStane 4340 700284 84-048 01960-1966 01968 (Stane Gabrovec ka qenë redaktor nga viti 1960 deri 1966 dhe në vitin 1968.)
702	01	32283875 aDolenc Vičič bAndreja 4349 704622 81-008 02006- (Andreja Dolenc Vičič është redaktor teknik i revistës nga viti 2006.)

Nëse përgatitni bibliografinë e Jože Kastelic për periudhën që përfshihet në nënfushën 0 (p.sh. nga viti 1950 e në vazhdim), në mesin e njësive bibliografike do të jetë edhe *Arheološki vestnik*. Paraqitja (në formatin ISO):

...

### AUTORËSIA DYTËSORE

#### Redaktor

...

96. *Arheološki vestnik*. Kastelic, Jože (redaktor 1959-1966, anëtar i bordit redaktorial 1973-1983). Ljubljana: Slovenska akademija znanosti in umetnosti, 1950-. ISSN 0570-8966.

...

2.

011	□□	e0352-1982
200	□□	aAB
702	01	33197283 aKoželj bJanez 01998- 4730 4341 709810 (Janez Koželj është përkthyes dhe anëtar i bordit redaktorial të revistës nga viti 1998 e në vazhdim.)
702	01	35079907 aLobnik bUroš 01999 4342 721512 1Red. I ftuar (i përkohshëm) për nr. 143/144, julij 1999 (Uroš Lobnik ka qenë redaktor i ftuar vetëm në një numër të revistës. Kjo e dhënë vendoset në nënfushën I.)

Nëse përgatitni bibliografinë personale të Janez Kožel për periudhën nga viti 1998 e në vazhdim, në mesin e njërive bibliografike do të jetë edhe revista AB. Paraqitja (në formatin ISO):

...

### AUTORËSIA DYTËSORE

#### Redaktor

...

4. AB. *Arhitektov bilten*. Koželj, Janez (anëtar i bordit redaktorial 1998-). Ljubljana: Društvo arhitektov, 1972-. ISSN 0352-1982.

...

#### Përkthyes

...

15. AB. *Arhitektov bilten*. Koželj, Janez (përkthyes 1998-). Ljubljana: Društvo arhitektov, 1972-. ISSN 0352-1982.

...

3.

712	01	aSlovenija bMinistrstvo za kulturo 4400 01994- (Ministria për Kulturë mbështet financiarisht botimin e serialit që nga viti 1994.)
-----	----	---

4.

011	□□	e1580-8432
200	0□	aAgricultura
702	01	361027939 aPrevolnik Povše bMaja 02018- 4344 727890 83-209 (Numri i revistës <i>Agricultura</i> është botuar me vonesë, për këtë arsye në nënfushën 0 vendoset viti si numërtim (2018) dhe jo viti i botimit (2020), i cili ndodhet edhe në revistë.)

5.

011	□□	e1424-8220
200	0□	aSensors bBurim elektronik
702	01	3217520739 aTomažič bSimon f1987- 02023 4930 735420 83-107 1Redaktor i numrit tematik "Intelligent soft sensors" (Numri tematik është botuar në vitin 2023. Artikujt e një teme të caktuar brenda numrit tematik janë botuar në numrat e rregullt të revistës <i>Sensors midis viteve 2021 dhe 2023</i> .)

## F.4 KARAKTERISTIKAT NË PËRPUNIMIN E DISA LLOJEVE TË DOKUMENTEVE

### 1. KATALOGIMI I ARTIKUJVE QË NDODHEN NË NJË SERIAL

Kur seriali nuk ka ISSN të vlefshme, atij duhet t'i caktohet numri i brendshëm i burimit në vazhdim, i cili vendoset në nënfushën 011c (shih fushën 011).

Artikulli lidhet me serialin përmes numrit të vlefshëm të ISSN-s ose numrit të brendshëm, i cili në regjistrimin për artikullin vendoset në nënfushën 011a.

Artikulli nuk duhet të lidhet me serialin përmes fushës 464.

Në fushën 997 vendosen të dhënat për koleksionet.

seriali	011eISSN ose 011cnumri i brendshëm
	200aTitulli i serialit
	↑
artikulli	011aISSN ose numri i brendshëm
	200aTitulli i artikullit

Shih shembullin 1.

### 2. KATALOGIMI I PJESËVE PËRBËRËSE QË NDODHEN NË NJË MONOGRAFI

Në nënfushën 4641 shënohet numri identifikues COBISS-ID i botimit.

Në fushën 996 vendosen të dhënat për koleksionet.

monografia	ID
	200aTitulli i monografisë
	↑
pjesa përbërëse	4641ID
	200aTitulli i pjesës përbërëse

Shih shembullin 2.

### 3. KATALOGIMI I ARTIKUJVE/PJESËVE PËRBËRËSE QË NDODHEN BREND A NJË PËRMBLEDHJE PUNIMESH DHE NJË NUMRI TEMATIK

Në këtë grup përfshihen artikujt/pjesët përbërëse nga botimet, të cilat për sa i përket mënyrës së botimit klasifikohen edhe si seriale (përmbledhjet e punimeve, vjetarët, kalendarët, librat-udhëzues, almanakët, botimet e tjera dytësore, numrat tematik të revistave). Këto botime zakonisht kanë ISBN dhe ISSN.

Artikulli/pjesa përbërëse lidhet me botimin kryesor me anë të nënfushës 4641 në të cilën shënohet numri identifikues i regjistrimit (COBISS-ID) dhe në nënfushën 011a shënohet ISSN e serialit. Shënimi i të dhënave në 011a është i nevojshme për kërkimin e të gjithë artikujve të një seriali të caktuar.

Në regjistrimin për monografinë në fushën 225 shënohet titulli i serialit. ISSN e botimit vendoset në nënfushën 225x.

Zakonisht të dhënat për koleksionet shënohen te serialet. Për çdo numër tematik (ose përmbledhje punimesh) që dëshironi të katalogoni duhet të krijoni një regjistrim të pavarur për monografinë. Të dhënat për koleksionet nuk vendosen në fushën 996 të regjistrimit për monografinë, por vetëm krijohet lidhja me koleksionet në regjistrimin e serialit. Lidhja bëhet me anë të nënfushës 992y ku vendoset numri inventarit dhe numrin e serialit nga nënfusha korresponduese 997m, nëse ajo ekziston. Të dhënat ndahen nga njëra tjetra me presje.

Në rastin e serialeve që zakonisht dalin një herë në vit (përmbledhjet e punimeve), të dhënat e koleksioneve mund të shënohen në regjistrimin për monografinë, në fushën 996. Në këtë rast të dhënat e koleksioneve nuk duhet të shënohen te serialet (nuk duhet të plotësohet as fusha 998). Kjo nuk mund të zbatohet për serialet e huaja të cilat janë siguruar përmes koordinimit të pasurimit. Në këtë rast, të dhënat për koleksionet nuk shënohen në fushën 996 të monografisë, por në fushën 997 në regjistrimin për serialin.

seriali	<b>011e</b> ISSN ose <b>011c</b> numri i brendshëm
	<b>200a</b> Titulli i serialit
	<b>997f</b> nr. i inv. <b>j</b> viti <b>k</b> viti i botimit <b>m</b> numri
	↑
monografia	COBISS-ID
	<b>200a</b> Titulli i monografisë (përmbledhjes së punimeve)
	<b>225a</b> Titulli i serialit <b>x</b> ISSN ISSN e serialit
	↑
artikulli	<b>011a</b> ISSN e serialit
	<b>4641</b> COBISS-ID
	<b>200a</b> Titulli i artikullit

Shih shembullin 3.

### 4. KATALOGIMI I SEPARATËVE

Për paraqitjen e separatit si njësi bibliografike brenda bibliografisë, ai duhet të katalogohet sipas rregullave të vlefshme për artikullin, përkatësisht pjesën përbërëse (maska A).



Separatët në sistemin COBISS katalogohen vetëm nëse huazohen (kanë numër inventari), dhe vetëm si monografi (maska M). Nëse të dhënat për botuesin mungojnë, të cilat zakonisht janë të detyrueshme, fusha 210 nuk plotësohet.

Separatët e kataloguar si monografi, në nënfushën 105b duhet të kenë kodin "8" – *separat* (për të krijuar mundësinë e eliminimit nga paraqitja e bibliografisë) dhe nuk duhet të përmbajnë nënfushën 001t – *Tipologjia e dokumenteve/veprave\**.

## SHEMBUJ

1.

001	uu	<b>an ba cs dl</b>
011	uu	<b>e0585-5047</b>
100	uu	<b>ba c1964 d9999 halb</b>
101	0u	<b>amul glat</b>
102	uu	<b>aalb</b>
110	uu	<b>aa bj ca</b>
200	1u	<b>aStudia albanica</b>
210	uu	<b>aTirana cInstitut d'histoire et de linguistique cAcadémie des Sciences d'Albanie. Section des Sciences d1964-</b>
215	uu	<b>d24 cm</b>
326	uu	<b>aGjashtëmujore</b>
530	uu	<b>aStudia Albanica</b>
675	uu	<b>a3(406.5) c3 b3 u9</b> <i>(Regjistrimi për serialin.)</i>

001	uu	<b>an ba ca d2 t1.05</b>
011	uu	<b>a0585-5047</b>
100	uu	<b>c2012 halb</b>
101	0u	<b>afre</b>
102	uu	<b>aalb</b>
200	0u	<b>a#L#Assemblée Nationale de Vlora et ses principes européens fKristo Frashëri</b>
215	uu	<b>af. 5-9 h#Nr. #2 k2012</b>
675	uu	<b>a94(496.5) "1912" b94 c94(496.5) s94</b>
700	u1	<b>3535654 aFrashëri bKristo f1920-2016 700728 4070</b> <i>(Regjistrimi për artikullin.)</i>

2.

001	uu	<b>an ba cm dl</b>
100	uu	<b>c1989 halb</b>
101	0u	<b>aalb</b>
102	uu	<b>aalb</b>
200	1u	<b>aStudime për epokën e Skënderbeut f[redaktor Selami Pulaha, Luan Malltezi, Përparime Huta] h#Vëll. #2</b>
210	uu	<b>aTiranë cInstituti i Historisë d1989</b>
215	uu	<b>a687 f. d23 cm</b>
300	0u	<b>aNë krye të faqes së titullit: Akademia e RPSSH. Instituti i Historisë</b>
320	0u	<b>aBibliogr. Në fund të punimeve</b>
675	uu	<b>a94(496.5)</b>

702	u1	32689382 aPulaha bSelami 4340
702	u1	3462150 aMalltezi bLuan 4340
702	u1	34755046 aHuta bPërparime 4340 (Regjistrimi për monografinë.)

001	uu	an ba ca d2 t1.16
100	uu	c1989 halb
101	0u	aalb
102	uu	aalb
200	0u	aGjergj Kastrioti Skënderbeu në pragun e Kryengritjes Çlirimtare të vitit 1443 fKristo Frashëri
215	uu	aF. 224-241
464	u1	11537342448
675	uu	a94(496.5)[Skënderbeu]
700	u1	3535654 aFrashëri bKristo f1920-2016 700728 4070 (Regjistrimi për pjesën përbërëse.)

3.

001	uu	ac ba cs d0
011	uu	e0351-0026
040	uu	aZDVAFY
100	uu	ba c1962 d9999 hslv
101	0u	aslv
102	uu	asvn
110	uu	aa bf ca
200	1u	aZdravstveno varstvo erevija za teorijo in prakso preventivnega zdravstvenega varstva e= Slovenian journal of public health
210	uu	aLjubljana cUniverzitetni zavod za zdravstveno in socialno varstvo d1962-
207	u0	aLet. 1, št. 1 (1962)-
215	uu	d29 cm
326	uu	aMesečno
421	u1	x0353-3352
421	u1	x1318-0665
421	u1	x1318-0657
530	0u	xZdravstveno varstvo
531	uu	aZdrav. varst.
675	uu	a613/614 b614
997	02	c1 df2n4572\s34,1995 f199502760 jLet.\34 k1995 mšt.\1/2 +3/4+5/8<I. slovenski kongres preventivne medicine>+9-10+11/12 o19950623 p4 vd (Regjistrimi për serialin.)

001	uu	an ba cm dl
021	uu	asvn
100	uu	c1995 hslv
101	0u	aslv deng
102	uu	asvn
105	uu	ad bz cl
200	0u	aI. slovenski kongres preventivne medicine, Bled, 19.-22. oktober 1994
210	uu	aLjubljana cInstitut za varovanje zdravia Republike Slovenije d1995
215	uu	aStr. 138-385 cgraf. prikazi d28 cm
225	2u	aZdravstveno varstvo x0351-0026 vLet. 34, št. 5/8

300	1□	<b>a</b> Ov. nasl.
320	0□	<b>a</b> Bibliografija pri večini prispevkov
320	0□	<b>a</b> Povzetek v angl. pri vseh prispevkih
512	1□	<b>a</b> I. Slovenian preventive medicine congress
540	0□	<b>a</b> Slovenski kongres preventivne medicine
540	0□	<b>a</b> Slovenian preventive medicine congress
675	□□	<b>a</b> 614(082)
710	12	<b>a</b> Slovenski kongres preventivne medicine <b>d</b> 1 <b>f</b> 1994 <b>e</b> Bled
992	□□	<b>y</b> 199502760,5/8 ( <i>Regjistrimi për numrin tematik.</i> )

001	□□	<b>a</b> n <b>b</b> a <b>c</b> a <b>d</b> 2 <b>t</b> 1.04
011	□□	<b>a</b> 0351-0026
100	□□	<b>c</b> 1995 <b>h</b> slv
101	0□	<b>a</b> slv
102	□□	<b>a</b> svn
200	1□	<b>a</b> Možni izvori onesnaženja tal in podtalnic <b>f</b> Franc Lobnik ... [et al.]
215	□□	<b>a</b> Str. 145-148
464	□1	<b>a</b> 56026880
675	□□	<b>a</b> 628.112:504.064 <b>b</b> 621.1/.2+621.4
701	11	<b>a</b> Lobnik <b>b</b> Franc 4070 700952
701	01	<b>a</b> Pintar <b>b</b> Marina 4070 710024
701	01	<b>a</b> Suhadolc <b>b</b> Metka 4070
701	01	<b>a</b> Zupan <b>b</b> Marko 4070 708834 ( <i>Regjistrimi për artikullin.</i> )



## F.5 PARAQITJA E BIBLIOGRAFIVE NË SISTEMIN COBISS

Regjistrimet bibliografike që kanë të bëjnë me rezultatet e veprimtarisë kërkimore janë të destinuara për përdorues të ndryshëm, me kërkesa të ndryshme. Për paraqitjen e bibliografive janë në dispozicion COBISS/OPAC-u dhe COBISS/Raportet.

Përzgjedhja e regjistrimeve për paraqitje në bibliografi mund të bëhet përmes kodit të kërkuesit shkencor. Nëse autori nuk ka kod të kërkuesit shkencor përzgjedhja mund të bëhet përmes mbiemrit dhe emrit.

Është logjike që bibliografia personale të shfaqet nga baza e përbashkët e të dhënave COBIB, e cila duhet të përmbaj regjistrimet e të gjitha bazave lokale të të dhënave. Përfundimisht përbëjnë vetëm rastet kur në bazën lokale të sistemit COBISS regjistrimet janë transferuar përmes konvertimit retrospektiv. Paraqitja e bibliografisë teknikisht mund të bëhet edhe nga baza e lokale e bibliotekave të veçanta, por nuk është e garantuar plotësia e saj. Studiuesit shpesh i ndryshojnë institucionet dhe disa prej tyre punojnë njëkohësisht në disa institucione.

Bibliografia mund të paraqitet për një periudhë kohore të caktuar dhe njësitë bibliografike mund të përzgjidhen sipas gjuhës së dokumentit/veprës, sipas vendit të botimit etj.

Për momentin njësitë bibliografike mund të shfaqen në tri formate standarde:

- shfaqja e referimeve në formatin ISO 690 (Documentation - Bibliographic references - Content, form and structure,
- shfaqja në formatin ISBD (International Standard Bibliographic Description) për nevojat e bibliotekave,
- shfaqja e referimeve në formatin që përdoret te botimit e The Institute of Electrical and Electronics Engineers, inc. - IEEE.

Bibliografia mund të shfaqet në një kolonë (vlera e paracaktuar) ose në dy kolona.

Njësitë bibliografike mund të klasifikohen sipas llojit të dokumentit/veprës, vitit të botimit, autorit dhe titullit ose emërtimit (kryetitullit). Janë të mundshme këto variante:

- lloji i dokumentit/veprës, viti i botimit, autori, titulli (vlera e paracaktuar),
- viti i botimit, lloji i dokumentit/veprës, autori, titulli,
- lloji i dokumentit/veprës, autori, titulli,
- viti i botimit, autori, titulli,
- autori, titulli.

Bibliografia e institucioneve/organizatave shfaqet në të njëjtën mënyrë.

Për personalizimin e paraqitjeve në aplikacionet lokale, është i mundur shkarkimi i regjistrimeve bibliografike, të strukturuar sipas fushave/nënfushave të veçanta dhe sipas llojit të dokumentit/veprës.



## F.6 TIPOLOGJIA E DOKUMENTEVE/VEPRAVE – PËRCAKTIMET DHE REKOMANDIMET

ARTIKUJ DHE PJESE TË TJERA PËRBËRËSE	
<b>1.01</b>	<p><i>artikull shkencor origjinal</i></p> <p>Artikull shkencor origjinal është vetëm botimi i parë i rezultateve origjinale kërkimore në një formë të tillë që lejon përsëritjen e kërkimit (hulumtimit) shkencor dhe verifikimin e rezultateve. Zakonisht ky artikull organizohet sipas skemës IMRAD (Introduction, Methods, Results And Discussion) për kërkimet eksperimentale ose në mënyrë përshkruese për fushat përshkruese shkencore. Artikulli duhet të jetë i botuar në një revistë shkencore me sistem recensues për pranimin e artikujve dhe duhet të jetë i recensuar. Sistemi recensues duhet të jetë i evidentuar nga udhëzimet e autorëve.</p> <p>Kontributet e konferencave, edhe nëse janë botuar në revistë shkencore nuk klasifikohen në këtë kategori, por ato klasifikohen në kategorinë "1.06" ose "1.08". Përjashtim bëjnë artikujt e shkruar pas konferencës, me ftesë të redaksisë së revistës, veçanërisht për numrin e rregullt të revistës dhe janë pranuar për botim sipas kriterëve e procedurave të njëjtave recensuese si artikujt në numrin e rregullt të revistës si dhe i përshtaten përkufizimit për kategorinë "1.01".</p>
<b>1.02</b>	<p><i>artikull recensues</i></p> <p>Artikull recensues është një vështrim i veprave më të reja në një fushë të caktuar, veprave të kërkuesve individual ose të një grupi kërkuesish me qëllim përmbledhjen, analizën, vlerësimin dhe sintetizimin e informacioneve, të cilat tashmë janë botuar. Ky lloj artikulli sjell sintheza të reja, që përfshijnë edhe rezultatet e kërkimeve të vetë autorëve. Artikulli duhet të jetë i botuar në një revistë shkencore me sistem recensues për pranimin e artikujve dhe duhet të jetë i recensuar. Sistemi recensues duhet të jetë i evidentuar nga udhëzimet e autorëve.</p> <p>Kontributet e konferencave, edhe nëse janë botuar në një revistë shkencore, nuk klasifikohen në këtë kategori, por në "1.06" ose "1.08". Përjashtim bëjnë artikujt e shkruar pas konferencës, me ftesë të redaksisë së revistës, veçanërisht për numrin e rregullt të revistës dhe janë pranuar për botim sipas kriterëve e procedurave të njëjtave recensuese si artikujt në numrin e rregullt të revistës si dhe i përshtaten përkufizimit për kategorinë "1.02".</p>
<b>1.03</b>	<p><i>artikuj të tjerë shkencorë</i></p> <p>Artikuj të tjerë shkencorë janë artikujt shkencorë origjinalë, në të cilët mund të mungojnë disa nga elementet e skemës IMRAD. Ai përmbledh rezultatet e një punimi shkencor të përfunduar ose të një punimi shkencor në proces. Këtu klasifikohen recensionet e shkurtra (mini review) dhe publikimet paraprake, nëse ato kanë tiparet e artikullit shkencor.</p> <p>Gjithashtu klasifikohen edhe artikujt me të dhëna, të cilët nuk i plotësojnë kushtet për t'u klasifikuar në kategorinë "1.01" ose "1.02". Artikulli me të dhëna është botimi i parë i të dhënave origjinale kërkimore, në formën që mundëson përsëritjen e kërkimit, ndërsa të gjeturat verifikohen. Në revistë është botuar përshkrimi i kërkimit, ndërsa të dhënat kërkimore janë të disponueshme në linkun përkatës të përshkruar. Duhet të jetë i botuar në një revistë shkencore me sistem recensues të pranimit të artikujve.</p> <p>Këtu klasifikohen edhe editorialet në numrat tematikë të revistave, nëse kanë pjesë diskutimi, përfundimi ose rishikimi qartësisht të ndarë, nëse në detaje përmbledhin dhe përcaktojnë temën ose problemin kërkimor, nëse përmbajnë analizë të shkurtër të arritjeve shkencore të artikujve të botuar në numrin special ose bllokun tematik, nëse përdorin aparat shkencor dhe janë të recensuara në të njëjtën mënyrë sikurse artikujt shkencorë.</p> <p>Kontributet e konferencave, edhe nëse janë botuar në revistë shkencore nuk klasifikohen në këtë kategori, por ato klasifikohen në kategorinë "1.06" ose "1.08". Përjashtim bëjnë artikujt e shkruar pas konferencës, me ftesë të redaksisë së revistës, veçanërisht për numrin e rregullt të revistës dhe janë pranuar për botim sipas kriterëve e procedurave të njëjtave recensuese si artikujt në numrin e rregullt të revistës si dhe i përshtaten përkufizimit për kategorinë "1.03".</p> <p>Kontributet e shkurtra të konferencave, edhe nëse janë botuar në një revistë shkencore, nuk klasifikohen në këtë kategori (kategori), por në "1.10" ose "1.12".</p>

	Komentet për artikullin (p.sh. në formën e një letre drejtuar redaktuesit) nuk klasifikohen në këtë kategori, por në kategorinë "1.21", përveç rasteve, kur përmbajnë edhe rezultate të autorit dhe i përshtaten përkufizimit për kategorinë "1.03".
<b>1.04</b>	<i>artikull profesional</i> Artikull profesional është prezantimi i asaj që tashmë është e njohur, me synim zbatimin e rezultateve shkencore origjinale dhe përhapjen e njohurive, ndërsa kompleksiteti i tekstit u përshtatet nevojave të përdoruesve dhe atyre të lexuesve të revistave profesionale ose shkencore apo burimit të integruar. Kontributet e konferencave, edhe nëse janë botuar në një revistë profesionale ose shkencore apo në një burim të integruar, nuk klasifikohen në këtë kategori (kategori), por në "1.07" ose "1.09".
<b>1.05</b>	<i>artikull popullor</i> Artikull popullor është artikulli, i cili bën popullarizimin e njohurive shkencore ose profesionale dhe rolin social të veprimtarive kërkimore. Artikulli popullor zakonisht botohet në një revistë me interes të përgjithshëm, gazetë, revistë për popullarizimin e dijes apo në një burim të integruar. Kontributet e konferencave, edhe nëse janë botuar në një revistë profesionale ose shkencore apo në një burim të integruar, nuk klasifikohen në këtë kategori por në "1.07" ose "1.09".
<b>1.06</b>	<i>kontribut shkencor i botuar në konferencë (ligjëratë e të ftuarit)</i> Ligjëratat e të ftuarit duhet të jetë e evidentuar në botim ose në programin e konferencës si dhe duhet t'i plotësojë kriteret për kategorinë "1.08". Ligjëratat e të ftuarit për nga rëndësia (por edhe për nga kohëzgjatja) ndryshon nga të gjitha leksionet e tjera në të njëjtën konferencë. Këtu klasifikohen vetëm ligjëratat plenare të hapjes/mbylljes ose ligjëratat nga sektori i të ftuarve, të cilat në përmbledhjen e punimeve zakonisht janë të paraqitura në rubrikë të veçantë (p.sh. <i>keynote speaker</i> ). Ftesat rutinë për bashkëpunim në konferencë nuk klasifikohen në këtë kategori.
<b>1.07</b>	<i>kontribut profesional i botuar në konferencë (ligjëratë e të ftuarit)</i> Ligjëratat e të ftuarit duhet të jetë e evidentuar në botim ose në programin e konferencës si dhe duhet t'i plotësojë kriteret për kategorinë "1.09". Ligjëratat e të ftuarit për nga rëndësia (por edhe për nga kohëzgjatja) ndryshon nga të gjitha ligjëratat e tjera në të njëjtën konferencë. Këtu klasifikohen vetëm ligjëratat plenare të hapjes/mbylljes ose ligjëratat nga sektori i të ftuarve, të cilat në përmbledhjen e punimeve zakonisht janë të paraqitura në rubrikë të veçantë (p.sh. <i>keynote speaker</i> ). Ftesat rutinë për bashkëpunim në konferencë nuk klasifikohen në këtë kategori.
<b>1.08</b>	<i>kontribut shkencor i botuar në konferencë</i> Kontribut shkencor i botuar në konferencë (ligjëratë, prezantim, poster) i botuar në tërësi, në një përmbledhje punimesh konference, në revistë shkencore ose në faqen elektronike të konferencës apo organizatorit të konferencës. Kontributi i botuar duhet të jetë i organizuar të paktën si artikull shkencor. Recensimi sipas kriterëve për artikujt shkencorë origjinal/të rishikuar, përkatësisht pjesët përbërëse shkencore në monografi bëhet duke u bazuar në tipologjinë e përmbledhjes së punimeve të konferencës, e cila mund të jetë monografi e pavarur, e rregullt ose numër i veçantë i revistës, suplementit apo burim online. Përmbledhjet (abstraktet) dhe përmbledhjet e zgjeruara ose slajdet e botuara nuk klasifikohen në këtë kategori (shih kategorinë "1.12").
<b>1.09</b>	<i>kontribut profesional i botuar në konferencë</i> Kontribut profesional i publikuar në konferencë (leksion, prezantim, poster) i botuar në tërësi, në një përmbledhje punimesh konference, në revistë profesionale (ose shkencore) ose në faqen elektronike të konferencës apo organizatorit të konferencës. Përmbledhjet (abstraktet) dhe përmbledhjet e zgjeruara ose slajdet e botuara nuk klasifikohen në këtë kategori (shih kategorinë "1.13").
<b>1.10</b>	<i>përmbledhje (abstrakt) e kontributit shkencor të botuar në konferencë (ligjëratë e të ftuarit)</i>



	<p>Ligjërata e të ftuarit duhet të jetë e evidentuar në botim ose në programin e konferencës si dhe duhet t'i plotësojë kriteret për kategorinë "1.12".</p> <p>Ligjërata e të ftuarit për nga rëndësia (por edhe për nga kohëzgjatja) ndryshon nga të gjitha ligjëratat e tjera në të njëjtën konferencë. Këtu klasifikohen vetëm ligjëratat plenare të hapjes/mbylljes ose ligjëratat nga sektori i të ftuarve, të cilat në përmbledhjen e punimeve zakonisht janë të paraqitura në rubrikë të veçantë (p.sh. <i>keynote speaker</i>). Ftesat rutinë për bashkëpunim në konferencë nuk klasifikohen në këtë kategori.</p>
<b>1.11</b>	<p><i>përmbledhje (abstrakt) e kontributit profesional të botuar në konferencë (ligjëratë e të ftuarit)</i></p> <p>Ligjërata e të ftuarit duhet të jetë e evidentuar në botim ose në programin e konferencës si dhe duhet t'i plotësojë kriteret për kategorinë "1.13".</p> <p>Ligjërata e të ftuarit për nga rëndësia (por edhe për nga kohëzgjatja) ndryshon nga të gjitha ligjëratat e tjera në të njëjtën konferencë. Këtu klasifikohen vetëm ligjëratat plenare të hapjes/mbylljes ose ligjëratat nga sektori i të ftuarve, të cilat në përmbledhjen e punimeve zakonisht janë të paraqitura në rubrikë të veçantë (p.sh. <i>keynote speaker</i>). Ftesat rutinë për bashkëpunim në konferencë nuk klasifikohen në këtë kategori.</p>
<b>1.12</b>	<p><i>përmbledhje (abstrakt) e kontributit shkencor të botuar në konferencë</i></p> <p>Përmbledhja (abstrakti) e kontributit (ligjëratë, prezantim, poster) në një konferencë, që është botuar në përmbledhjen e punimeve të një konference apo në një revistë shkencore ose profesionale, ose në faqen elektronike të konferencës, përkatësisht organizatorit.</p> <p>Këtu klasifikohen edhe përmbledhjet (abstraktet) e zgjeruara dhe slajdet e botuara.</p>
<b>1.13</b>	<p><i>përmbledhje (abstrakt) e kontributit profesional të botuar në konferencë</i></p> <p>Përmbledhje (abstrakt) e kontributit (ligjëratë, prezantim, poster) në një konferencë, që është botuar në përmbledhjen e punimeve të një konference apo në një revistë shkencore ose profesionale, apo në faqen elektronike të konferencës, përkatësisht organizatorit.</p> <p>Këtu klasifikohen edhe përmbledhjet (abstraktet) e zgjeruara dhe slajdet e botuara.</p>
<b>1.16</b>	<p><i>pjesë përbërëse shkencore e pavarur ose kapitull në një monografi</i></p> <p>Pjesa përbërëse shkencore e pavarur ose kapitulli në një monografi katalogohet si njësi bibliografike e pavarur vetëm kur vlen për të ashtuquajturin botim redaktorial me kontribute të pavarura të autorëve individual dhe jo për tekstin e pandarë të disa autorëve, të cilët janë të shënuar në faqen e titullit të monografisë. Pjesa përbërëse shkencore e pavarur, së paku në parim duhet të jetë e organizuar si artikull shkencor. Këtu klasifikohen edhe hartat origjinale shkencore, kur ato përfaqësojnë një kontribut të pavarur me autorësi të njohur.</p> <p>Në këtë kategori nuk klasifikohen kontributet e konferencave, të cilat janë të botuara në përmbledhjen e punimeve të konferencës, në një numër special ose tematik të një reviste, si dhe pjesët përbërëse ose kapitujt në botimet e kategorisë "2.04", "2.05", "2.12", "2.13" dhe "2.14".</p>
<b>1.17</b>	<p><i>pjesë përbërëse profesionale e pavarur ose kapitull në një monografi</i></p> <p>Pjesa përbërëse profesionale e pavarur ose kapitulli në një monografi katalogohet si njësi bibliografike e pavarur vetëm kur vlen për të ashtuquajturin botim redaktorial me kontribute të pavarura të autorëve individual dhe jo për tekstin e pandarë të disa autorëve, të cilët janë të shënuar në faqen e titullit të monografisë. Këtu klasifikohen edhe hartat profesionale, kur ato përfaqësojnë një kontribut të pavarur me autorësi të njohur.</p> <p>Në këtë kategori nuk klasifikohen kontributet e konferencave, të cilat janë të botuara në përmbledhjen e punimeve të konferencës, në një numër special ose tematik të një reviste, si dhe pjesët përbërëse ose kapitujt në botimet e kategorisë "2.04", "2.05", "2.12", "2.13" dhe "2.14".</p>
<b>1.18</b>	<p><i>pjesë përbërëse profesionale në fjalor, enciklopedi ose leksikon</i></p> <p>Pjesa përbërëse përmban një vështrim sistematik me bazë profesionale dhe prezantim të një teme të caktuar, problemi, lënde, fjale, personi ose ngjarjeje, zakonisht me shpjegim. Pjesa përbërëse duhet të jetë më e gjatë se 200 fjalë, përndryshe ajo klasifikohet në kategorinë "1.25".</p> <p>Këtu klasifikohen vetëm pjesët përbërëse autoriale.</p>

<b>1.19</b>	<i>recension, recension libri, kritikë</i> Kontribut në një botim shkencor ose profesional (revistë, libër etj.), ku autori vlerëson ose provon saktësinë/pa saktësinë e një punimi shkencor ose profesional, kriteri, mendimi ose përfundimi dhe/ose ai mohon/mbështet/vlerëson përfundimet, punimet ose mendimet e autorëve të tjerë. Shfaqja e një mendimi profesional, gjykim i një punimi shkencor, profesional ose artistik, veçanërisht lidhur me cilësinë e tij.
<b>1.20</b>	<i>parathënie, editorial, pasthënie</i> Pjesë përbërëse e shkurtër para ose pas tekstit kryesor, që flet për atë tekst dhe autorin e tij. Fjalët përshëndetëse, falënderimet etj. nuk katalogohen. Studimet hyrëse ose shoqëruese të natyrës shkencore ose profesionale në monografi mund të klasifikohen në "1.16" ose "1.17". Editorialet e natyrës shkencore ose profesionale në revista mund të klasifikohen në "1.03".
<b>1.21</b>	<i>polemikë, diskutim, koment</i> Kontribut, në të cilin autori provon saktësinë e një kriteri të caktuar, mendimin ose përfundimin e tij dhe mohon përfundimin ose mendimin e autorëve të tjerë.
<b>1.22</b>	<i>intervistë</i> Bashkëbisedim për publikun rreth temave të rëndësishme shkencore ose profesionale, i cili është botuar kryesisht në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve. Kontributet, bazuar në përgjigjet e pyetjeve, por jo të botuara në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve, si edhe deklaratat individuale, kontributet në tavolinat e rrumbullakta dhe anketat, nuk klasifikohen në këtë kategori.
<b>1.23</b>	<i>pjesë përbërëse artistike</i> Poezi, prozë, kompozim dhe pjesë përbërëse artistike të tjera, të cilat janë pjesë e një veprë të plotë muzikore.
<b>1.24</b>	<i>bibliografi, indeks etj.</i>
<b>1.25</b>	<i>pjesë të tjera përbërëse</i>
<b>1.26</b>	<i>pjesë përbërëse shkencore në fjalor, enciklopedi, leksikon</i> Pjesa përbërëse përmban një vështrim sistematik me bazë profesionale ose një prezantim të një teme të caktuar, problemi, lënde, fjale, personi ose ngjarjeje, zakonisht me shpjegim, i cili zakonisht është pjesë e një fjalori themelor shkencor, leksiku (kategoria "2.26") ose fjalori shkencor terminologjik, enciklopeditë, leksiku tematik (kategoria "2.27"), dhe gjithashtu pjesë e një fjalori profesional, enciklopeditë, leksiku (kategoria "2.06"). Këtu klasifikohen vetëm pjesët përbërëse autoriale.

<b>MONOGRAFI DHE VEPRA TË TJERA TË PËRFUNDUARA</b>	
<b>2.01</b>	<i>monografi shkencore</i> Monografi shkencore është një botim, në të cilin në mënyrë shkencore, sistematike, të hollësishme dhe universale trajtohet një problem, një çështje ose subjekt, person ose ngjarje, në një vëllim ose në një numër të caktuar vëllimesh të botuara njëkohësisht ose në një periudhë kohore të paracaktuar. Trajtimi shkencor përfshin analizën e literaturës shkencore për problemin e trajtuar, e cila në bazë të rezultateve të veta kërkimore dhe përvojave, sintetizohet në njohuri origjinale. Botimi duhet të jetë i recensuar, duhet të ketë CIP dhe ISBN (ISMN). Këtu klasifikohen edhe hartat shkencore. Botimet kritike të burimit, të cilat përfshijnë riprodhimin, kopjimin ose përkthimin e burimit historik, klasifikohen në kategorinë "2.28", ndërsa fjalorët shkencorë, enciklopeditë ose leksikët në kategorinë "2.26" ose "2.27". Përmbledhjet e punimeve të konferencave, raportet e përfunduara dhe raportet e tjera për detyrat dhe projektet kërkimore etj. (edhe nëse janë në formë të lidhur) nuk klasifikohen në këtë kategori. Disertacionet e doktoraturave, të cilat më pas botohen si monografi shkencore, nuk klasifikohen në këtë kategori, nëse në përmbajtjen e veprës nuk ka përditësime/ndryshime.
<b>2.02</b>	<i>monografi profesionale</i>

	<p>Monografi profesionale është një botim, në të cilin trajtohet në mënyrë profesionale, sistematike, të hollësishme dhe universale një problem, një çështje ose subjekt, person ose ngjarje, në një vëllim ose në një numër të caktuar vëllimesh të botuara njëkohësisht ose në një periudhë kohore të paracaktuar. Botimi duhet të ketë CIP dhe ISBN (ISMN).</p> <p>Përmbledhjet e punimeve nga konferencat, raportet e përfunduara dhe raportet e tjera për detyrat dhe projektet kërkimore etj. (edhe nëse janë në formë të lidhur) nuk klasifikohen në këtë kategori.</p>
<b>2.03</b>	<p><i>tekst mësimor universitar, i arsimit të lartë ose i shkollës së lartë, i recensuar</i></p> <p>Tekst mësimor universitar, i arsimit të lartë dhe i shkollës së lartë është një lloj i botimit për studentë, si material mësimor i detyrueshëm për një degë ose lëndë të caktuar studimi (p.sh. një tekst mësimor i algjebërës, një kurs mësimor praktikë).</p>
<b>2.04</b>	<p><i>tekst mësimor për shkollat fillore, të mesme ose tekste të tjera mësimore të recensuara</i></p> <p>Tekst për shkollat fillore dhe të mesme si edhe për arsim tjetër parauniversitar, i cili përgatitet sipas një plani të caktuar mësimor dhe miratohet në bazë të procedurave përkatëse.</p>
<b>2.05</b>	<p><i>material tjetër mësimor</i></p> <p>Përpunim sistematik i materialit mësimor sipas programit të studimit, të cilin autori e përgatit në bazë të materialeve të tij apo të dikujt tjetër (shënime leksionesh, materiale të mbledhura, materiale kursesh), përmbledhje ushtrimesh dhe detyrash për një lëndë të caktuar dhe mjete të tjera mësimore (p.sh. regjistrime zanore, materiale mësimore multimedia etj.).</p>
<b>2.06</b>	<p><i>ffjalor, enciklopedi, leksikon, manual, atlas, hartë</i></p> <p>Botim me karakter të përgjithshëm ose profesional që paraqet qartë të dhëna dhe udhëzime për një fushë ose subjekt të caktuar.</p>
<b>2.07</b>	<p><i>bibliografi</i></p> <p>Vështrim i organizuar i veprave të botuara dhe/ose të interpretuara që kanë dalë si monografi.</p>
<b>2.08</b>	<p><i>disertacion për doktoratë</i></p> <p>Disertacioni për doktoratë është punim, me të cilin autori merr titullin doktor i shkencës.</p>
<b>2.09</b>	<p><i>tezë për master</i></p> <p>Tezë për master është punim, me të cilin autori merr titullin magjistër në shkencë ose titullin master sipas programit të bolonjës.</p>
<b>2.10</b>	<p><i>tezë për specialist</i></p> <p>Tezë për specialist është punim, me të cilin autori merr titullin specialist.</p>
<b>2.11</b>	<p><i>punim diplome (universitare)</i></p> <p>Punim diplome (universitare) është punimi, që i jep autorit titull profesional të vlefshëm.</p>
<b>2.12</b>	<p><i>raport përfundimtar i rezultateve të kërkimit</i></p> <p>Botim, që tregon ecurinë dhe përfundimet (njohuritë dhe zbulimet) e një detyre kërkimore shkencore ose zhvillimore. Këtu klasifikohen vetëm raportet e përfunduara, që janë të disponueshme për publikun. Nuk regjistrohen raportet e përkohshme, të ndërmjetme, vjetore si dhe raportet administrative të financierëve.</p>
<b>2.13</b>	<p><i>trajtesë, studim paraprak, studim</i></p> <p>Raport për realizimin e një detyre në kuadër të një projekti, në formën e një botimi ose dokumenti profesional të përfunduar, për përdorues të njohur, në të cilin trajtohet në mënyrë sistematike dhe të detajuar një problem ose temë, në bazë të burimeve përkatëse të informacionit dhe jepen udhëzime për zgjidhjen e problemeve si dhe propozime për punën në të ardhmen.</p>
<b>2.14</b>	<p><i>dokumentacion projekti (projekt paraprak, projekt pune)</i></p> <p>Projekti mund të jetë një botim i përfunduar, i cili përcakton se çfarë duhet të bëhet dhe si, përkatësisht është një përmbledhje planesh, përshkrimesh teknike dhe shqyrtim i shpenzimeve lidhur me një objekt (p.sh. projekti i një rruge, një ndërtesë në inxhinierinë e ndërtimit dhe arkitekturë, projekti i</p>

	një makine në inxhinierinë mekanike, projekti i një sistemi të informacionit, një projekt investimi në ekonomi etj.).
<b>2.15</b>	<i>vendime ekspertize, arbitrazhi</i>
<b>2.16</b>	<i>vepër artistike</i> Poezi, prozë, kompozime, filma, piktura dhe vepra të tjera artistike.
<b>2.17</b>	<i>katalog ekspozite</i>
<b>2.18</b>	<i>film shkencor, botim shkencor audio ose video</i> Botimet e problemeve dhe rezultateve shkencore në shirit filmi ose magnetik, apo në ndonjë mjedis tjetër elektronik të informacioneve. Botimi duhet të jetë i recensuar, duhet të ketë numrin e ISBN-së (ISMN-së), të cilin e merr botuesi. Duhet të përmbaj metodologji kërkimore, rezultate dhe diskutim.
<b>2.19</b>	<i>transmetim në radio ose televizion, podcast, intervistë, konferencë për gazetarë</i> Transmetim në radio ose televizion, podcast, intervistë, konferencë për gazetarë në bartës elektronik të informacionit, që trajton në mënyrë profesionale një përmbajtje të caktuar. Katalogohet në bazë të regjistrimit të paraqitur, përndryshe si ngjarje klasifikohet në kategorinë "3.11". Filmat promocional dhe prezantimet e organizatave nuk klasifikohen në këtë kategori, por në "2.25".
<b>2.20</b>	<i>koleksion i plotë shkencor i të dhënave kërkimore</i> Koleksion elektronik i të dhënave kërkimore, rëndësia shkencore e të cilit pasqyrohet në përdorimin e tij në hulumtimin e një vargu të gjërë të problemeve teorike dhe të aplikuara. Koleksioni i të dhënave duhet të jetë rezultat i kërkimeve të përfunduara dhe në përputhje me kriteret e cilësisë së lartë. Cilësia vlerësohet në bazë të dokumenteve shoqëruese. Koleksioni i të dhënave duhet të jetë i disponueshëm për publikun në arkivin (repositorin) kombëtar ose ndërkombëtar të të dhënave shkencore. Koleksioni i të dhënave kërkimore duhet të jetë i dokumentuar dhe i disponueshëm në atë formë, që të bëjë të mundur përsëritjen e gjetjeve shkencore të botuara, të bëra në bazë të tij. Koleksioni i veçantë i të dhënave kërkimore është një korpus uniform, koleksion i teksteve autentike, brenda i strukturuar dhe i përcaktuar në mënyrë standarde, i krijuar në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe me qëllim të caktuar, i disponueshëm në formën elektronike dhe i pajisur me mjete, që mundësojnë kërkimin shumëdimensional dhe përpunimin statistikor të të dhënave.
<b>2.21</b>	<i>program (softuare)</i> Program në një mjedis kompjuterik, i disponueshëm për publikun ose i prodhuar për një klient të njohur dhe përfaqëson një vepër të pavarur me autorësi të njohur. Programi që përdoret për të mbështetur një sistem ose proces informacioni, te i cili autorësia zakonisht është kolektive, nuk klasifikohet në këtë kategori.
<b>2.22</b>	<i>varietet i ri</i> Varieteti i ri i bimëve është pronë intelektuale, i cili dëshmohet me vendim për konfirmimin ose mbrojtjen e varietetit, të cilin e lëshon autoriteti kompetent shtetëror në bazë të rezultateve të krahasueshme në nivel ndërkombëtar DUS (Dallueshmëri, Uniformitet dhe Stabilitet), të arritura nga testimi në institucionet e njohura në nivel të BE-së dhe është i përfshirë në Katalogun e Përbashkët të Varieteteve të BE-së.
<b>2.23</b>	<i>aplikimi për patentë</i> Statusin e aplikimit për patentë e ka kërkesa për marrjen e patentës nga paraqitja e aplikimit deri në botimin e patentës në gazetën zyrtare të zyrës së autorizuar për mbrojtjen e pronës intelektuale. Zyra lëshon certifikatë për kërkesën e pranuar. Për të njëjtën shpikje, në bibliografi përfshihet vetëm një aplikim për patentë.
<b>2.24</b>	<i>patentë</i> Patenta është një shpikje e mbrojtur. Ajo jepet në ditën kur patenta botohet në gazetën zyrtare të zyrës së autorizuar për mbrojtjen e pronës intelektuale. Patenta dëshmohet me vendimin për dhënien e patentës ose me botimin e saj në internet (ESPACENET). Me dhënien e patentës, kategoria "2.23" duhet të ndryshohet në "2.24" si dhe të plotësohen të dhënat. Nëse për të njëjtën shpikje në vende të ndryshme janë dhënë disa patenta, të cilat janë anëtare të së njëjtës shoqëri të patentave, mund të vlerësohet vetëm një patentë e dhënë, dhe atë sipas zgjedhjes së

	shpikësit ose aplikuesit. Për patentën e shoqërisë së njëjtë të patentave krijohet vetëm një regjistrim, në të cilin në shënime vendosen edhe patentat e tjera të dhëna, nëse ato ekzistojnë. Përjashtim përbëjnë patentat me ndryshim thelbësor nga shpikja bazë.
<b>2.25</b>	<i>monografi të tjera dhe vepra të tjera të përfunduara</i>
<b>2.26</b>	<i>fjalor themelor shkencor ose leksik</i> Këtu klasifikohen veprat leksikografike, të cilat plotësojnë këto kritere: (1) kanë koncept pretendues dhe me bazë profesionale, (2) rrjedhin nga një material gjithëpërfshirës ose nga një material i mbledhur në sasi të mëdha, (3) kanë nivel të lartë të organizimit fillestar të materialit, (4) janë krijuar në grup, sepse për përgatitjen e tyre nevojiten të paktën 70 vjet punë intelektuale, (5) plotësisht ose në pjesën më të madhe bazohen në literaturën përkatëse, (6) sjellin analizë të materialit nga aspekte shumë të ndryshme në nivel të lartë profesional, (7) janë plotësisht ose në një nivel të lartë informues, (8) sjellin gjetje të reja gjuhësore ose aplikojnë të dhëna të reja të rëndësishme, (9) përfshijnë vetëm të dhëna të interpretuara nga qenie njerëzore (të dhënat e prodhuara nga makina mund të përfshihen vetëm si përmbajtje shtesë), të cilat (të paktën fillimisht) janë konceptuar apo interpretuar për përdoruesit njerëzor, (10) të dhënat shfaqen në ato mënyra, të cilat janë të zbatueshme në leksikografinë moderne shkencore (çdo metodë e re e mundshme duhet të vlerësohet në mënyrën e duhur si nga ana e përdoruesve ashtu edhe e ekspertëve); të gjitha pjesët (potenciale) të fjalorit duhet të bazohen në konceptin koherent, i cili rrjedh nga logjika e njëjtë gjuhësore dhe duhet të merret me çështje të ngjashme në mënyrë të ngjashme, (11) i kanë të gjitha tekstet e dhura shoqëruese dhe (12) kanë rëndësi të madhe kombëtare dhe ndërkombëtare.
<b>2.27</b>	<i>fjalor terminologjik shkencor, enciklopedi ose leksikon tematik</i> Këtu klasifikohen veprat leksikografike, të cilat plotësojnë të paktën nëntë nga dymbëdhjetë kriteret, e shënuara në kategorinë "2.26". Përveç kësaj, fjalorët terminologjik duhet të jenë normativ ose të paktë të demonstrojnë përpjekjen për standardizimin e terminologjisë.
<b>2.28</b>	<i>botim kritik</i> Botimi kritik i burimit përfshin riprodhimin dhe/ose kopjen dhe/ose përkthimin e burimit historik (p.sh. material tekst, me nota muzikore, artistik ose hartografik) si dhe shënimet shkencore dhe dokumente të tjera me më shumë se 32 faqe shkrimi në dy kolona (shënimet e lidhura me kritikën e tekstit dhe/ose përmbajtjes, literaturën dhe studimin). Botimi duhet të jetë i recensuar dhe duhet të ketë të gjitha elementet e përcaktuara për marrjen e CIP-it dhe ISBN-së (ISMN-së).
<b>2.29</b>	<i>model</i> Modeli është pamja e jashtme e produktit e mbrojtur me ligj, i cili është i ri dhe i natyrës individuale. Modeli është rezultat i kërkimit shkencor në fushën e projektimit (dizajnit) të produktit dhe duhet t'i përshtatet kërkesave të caktuara të funksionimit ose përmirësimit të funksionimit të produktit (Klasifikimi Locarno). Modeli regjistrohet duke u bazuar në botimin për regjistrimin e modelit në zyrën kompetente për pronësinë intelektuale.
<b>2.30</b>	<i>përmbledhje të kontributeve profesionale ose shkencore të parecensuara nga konferencat</i> Këtu klasifikohen edhe përmbledhjet e punimeve, të cilat për nga përmbajtja janë shkencore, mirëpo nuk janë të recensuara.
<b>2.31</b>	<i>përmbledhje të kontributeve shkencore të recensuara nga konferencat ndërkombëtare ose të huaja</i>
<b>2.32</b>	<i>përmbledhje të kontributeve shkencore të recensuara nga konferencat kombëtare</i> Përmbledhje të kontributeve shkencore të recensuara nga konferencat ndërkombëtare ose të huaja Përmbledhje të kontributeve shkencore të recensuara nga konferencat kombëtare Përmbledhje e kontributeve të recensuara shkencore nga konferencat, të cilat janë të recensuara sipas kritereve të caktuara për artikujt shkencorë origjinalë/të recensuar ose për pjesët përbërëse shkencore të pavarura në monografi. Përmbledhja e kontributeve mund të jetë monografi e pavarur, numër i rregullt ose i parregullt i një reviste, shtojcë ose burim elektronik online. Nëse kontributet e recensuara nuk janë të vërtetueshme, bëhet shënimi përkatës në referencat e botimit. Një konferencë kombëtare mund të quhet ndërkombëtare, kur të paktën 1/3 e pjesëmarrësve aktiv, kontributet e të cilëve janë të publikuara në përmbledhjen e punimeve, vijjnë nga jashtë vendit.

<b>2.33</b>	<i>film shkencor; videoregjistrim ose audioregjistrim</i> Botimi i problemeve dhe rezultateve profesionale në një shirit filmi ose shirit magnetik ose në një bartës tjetër elektronik të informacionit. Këtu klasifikohen edhe videoregjistrimet e leksioneve të pavarura (p.sh. Videlectures) dhe prezantimet e projekteve. Podkastet, intervistat, konferencat e gazetarëve nuk klasifikohen në këtë kategori, mirëpo në "2.19". Filmat promocional dhe prezantimet e organizatave nuk klasifikohen në këtë kategori, mirëpo në "2.25".
-------------	--

VEPRA TË EKZEKUTUARA (NGJARJE)	
<b>3.10</b>	<i>interpretim artistik</i> Koncerte, interpretime teatrale dhe operistike si dhe ekzekutime të tjera publike të veprave artistike.
<b>3.11</b>	<i>ngjarje në radio ose televizion</i> Pjesëmarrje në raporte, prezantime, diskutime etj. në radio ose televizion.
<b>3.12</b>	<i>ekspozitë</i> Ngjarje, të cilën e organizon autori i veprave të ekspozuara ose nga autori (organizatori) i ekspozitës.
<b>3.14</b>	<i>leksion në universitetin e huaj</i> Leksion në një universitet, në një institucion shkencor ose akademik dhe shoqatë shkencore jashtë Shqipërisë. Angazhimet e të ftuarit në universitetet e huaja për një periudhë të gjatë klasifikohen në biografi.
<b>3.15</b>	<i>kontribut konference i pabotuar</i> Titulli i kontributit duhet të jetë i dukshëm në programin e konferencës.
<b>3.16</b>	<i>leksion i të ftuarit në konferencë i pabotuar</i> Një leksion i të ftuarit duhet të jetë i dukshëm në programin e konferencës. Leksioni i të ftuarit për nga rëndësia (por edhe për nga kohëzgjatja) dallon nga të gjitha leksionet e tjera në të njëjtën konferencë. Në kategorinë "3.16" klasifikohen vetëm seancat plenare të hapjes/mbylljes ose ligjëratat nga sektori i të ftuarve. Ftesat rutinë për pjesëmarrje në konferencë nuk klasifikohen në këtë kategori.
<b>3.25</b>	<i>vepra të tjera të ekzekutuara</i>

## UDHËZIME DHE SHPJEGIME SHITESË

Regjistrimet bibliografike në sistemin COBISS i krijojnë kataloguesit e kualifikuar në biblioteka. Artikujt dhe pjesët e tjera përbërëse, monografite dhe veprat e tjera të përfunduara përpunohen sipas dokumentit/veprës parësore. Veprat e ekzekutuara (ngjarjet) regjistrohen në bazë të provave përkatëse për veprën e ekzekutuar. Nëse botimi nuk ndodhet në bibliotekë, autori duhet t'ia siguroj atë bibliotekarit. Për klasifikimin e saktë të njësive bibliografike sipas kësaj tipologjie, përgjegjës janë kryesisht autorët, ndërsa llojin e dokumentit/veprës mund ta caktojë edhe specialisti i fushës.

Kategoria i artikullit përcaktohet në bazë të:

- shënimit për kategorinë, e cila zakonisht ndodhet në krye të artikullit;
- shënimit, se revista boton vetëm artikuj të kategorive të caktuara, i cili zakonisht botohet nga redaksia në udhëzimet për autorët;
- emrit të rubrikës ku është botuar artikulli, nëse revista është e ndarë në këtë mënyrë.

Në raste të tjera bibliotekari së bashku me autorin ose me një specialist të fushës përcakton llojin e dokumentit/veprës sipas përshkrimit të kategorive të dokumenteve/veprave në këtë tipologji. Institucioni shtetëror kompetent vendos për përjashtimet për të gjitha llojet e shkencës.

Në sistemin COBISS zakonisht nuk krijohen regjistrimet për pjesët përbërëse në botimet që janë ende në shtyp (p.sh. regjistrimet për artikujt në revista dhe regjistrimet për kapitujt në monografi).

#### Përjashtimet

- Artikujt, të cilët plotësojnë tri kushtet:
  - artikulli është pranuar për botim;
  - në faqen e internetit të botuesit është botuar komplet teksti i artikullit;
  - artikullit i është dhënë identifikuesi DOI.
- Kapitujt në monografi, të cilët plotësojnë tri kushtet:
  - në faqen e internetit të botuesit tashmë është publikuar komplet teksti i kapitullit;
  - kapitullit, përkatësisht monografisë i është dhënë identifikuesi DOI;
  - në faqen e internetit të botuesit duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme për monografinë, në mënyrë që kataloguesi të krijoj regjistrimin e ri.

Për pjesët përbërëse që i plotësojnë kushtet e paraqitura, kataloguesit krijojnë regjistrimin fillestar të paplotë.

Para krijimit të regjistrimeve fillestare të paplota, kërkuesit shkencorë janë të detyruar të informojnë kataloguesit, nëse bëhet fjalë për kontribut konference, i cili do të botohet në revistë.

Kataloguesit mund t'i plotësojnë regjistrimet e paplota vetëm pas botimit të revistës apo monografisë, dhe për këtë duhet të njoftohen nga kërkuesit shkencorë. Tipologjia nuk verifikohet derisa regjistrimet të jenë të plota.

Në rastet kur duhet të krijohen disa regjistrime, sepse përmbajtja e njëjtë paraqitet në mjedise të ndryshme ose botime të ndryshme, në vlerësim merret vetëm një regjistrim (të tjerët duhet të eliminohen nga vlerësimi). Kjo vlen për monografitë e botuara në formën e shtypur ose elektronike; punimet e diplomave që botohen më vonë; artikujt që janë publikuar (gabimisht) në dy numra të së njëjtës revistë etj.

Në sistemin COBISS vlejnjë këto rregulla:

- krijohet vetëm një regjistrim për një nga variantet, nëse ekziston varianti i shtypur dhe elektronik i artikullit;
- krijohet vetëm një regjistrim, nëse artikulli është publikuar edhe në origjinal edhe i përkthyer në të njëjtin botim;
- nuk krijohen regjistrime për organizimin e ngjarjeve dhe për çmimet e dhëna, sepse këto të dhëna vendosen në biografi.





## F.7 LISTA E KODEVE TË INSTITUCIONEVE / ORGANIZATAVE

Kodi i institucionit/organizatës vendoset në nënfushat 70X8 dhe 71X8. Ai përbëhet nga dy pjesë të cilat ndahen me vizë "-".

### Pjesa 1:

Në sistemin COBISS.SI pjesa e parë e kodit fillon me numër që tregon llojin e institucionit kërkimor.

Në sistemet COBISS jashtë Sllovenisë kodi fillon me shkurtësën e sistemit COBISS (p.sh. CG3-100 Universiteti i Malit të Zi).

### Pjesa 2:

Kjo pjesë është e ndryshueshme dhe gjatësia e saj varet nga struktura organizative e institucionit/organizatës dhe nga kërkesat për përgatitjen e bibliografive. Niveli më i lartë i strukturës organizative përcaktohet përmes një numri treshifror, ndërsa nivelet më të ulëta përmes grupeve të numrave dyshifror, që ndahen me pikë. Struktura e pjesës 2 është *nnn.nn.nn...* etj. Rekomandohen më së shumti katër nivele hierarkike.

Te institucionet publike arsimore në nivelin më të lartë janë universitetet dhe fakultetet. Te pjesa 2 kodi i parë tregon universitetin.

Kjo strukturë e listës së kodeve të organizatave mundëson pargatitjen e bibliografisë së kërkuesve shkencorë për:

- **departamentin e caktuar**  
Select FC=3-207.10 (kërkohen regjistrimet për bibliografinë e Departamentit të Matematikës të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Mariborit);
- **fakultetin**  
Select FC=3-216\* (kërkohen regjistrimet për bibliografinë e Fakultetit të Pedagogjisë në Universitetin e Mariborit);
- **universitetin**  
Select FC=3-2\* (kërkohen regjistrimet për bibliografinë e Universitetit të Mariborit).

Lista e kodeve përditësohet në vazhdimësi. Në Slloveni ajo plotësohet nga IZUM-i, ndërsa në shtetet e tjera nga qendrat COBISS.

<b>1-001</b>	<i>Institut Jožef Stefan</i>
<b>1-001.01.01</b>	<i>Institut Jožef Stefan. Odsek za teoretično fiziko (F1)</i>
<b>1-001.01.02</b>	<i>Institut Jožef Stefan. Odsek za fiziko nizkih in srednjih energij (F2)</i>
<b>1-001.01.03</b>	<i>Institut Jožef Stefan. Odsek za tanke plasti in površine (F3)</i>
<b>1-002</b>	<i>Kemijski inštitut</i>
<b>1-002.01</b>	<i>D01 Odsek za računsko biokemijo in načrtovanje učinkovin</i>
<b>1-002.02</b>	<i>Laboratorij za spektroskopijo materialov** (glej 1-002.10)</i>
<b>2-001</b>	<i>Elektrogospodarstvo Slovenije - razvoj in inženiring, d. d.</i>
<b>2-002</b>	<i>Gorenje Gospodinjski aparati</i>
<b>2-003</b>	<i>Telekom Slovenije d. d.</i>
<b>2-004</b>	<i>Banka Slovenije</i>

<b>3-100</b>	<i>Univerza v Ljubljani</i>
<b>3-101</b>	<i>Univerza v Ljubljani, Akademija za glasbo</i>
<b>3-102</b>	<i>Univerza v Ljubljani, Akademija za gledališče, radio, film in televizijo</i>
<b>3-102.01</b>	<i>Univerza v Ljubljani, Akademija za gledališče, radio, film in televizijo, Center za teatrologijo in filmologijo</i>
<b>3-103</b>	<i>Univerza v Ljubljani, Akademija za likovno umetnost in oblikovanje</i>
<b>3-103.01</b>	<i>Univerza v Ljubljani, Akademija za likovno umetnost, Oddelek za industrijsko oblikovanje** (glej 3-103)</i>
<b>3-103.02</b>	<i>Univerza v Ljubljani, Akademija za likovno umetnost, Oddelek za vizualne komunikacije** (glej 3-103)</i>
<b>4-001</b>	<i>Akademski raziskovalna mreža Slovenije - ARNES</i>
<b>4-002</b>	<i>Andragoški center Republike Slovenije</i>
<b>4-003</b>	<i>Center za mednarodno sodelovanje in razvoj</i>
<b>4-004</b>	<i>Ekonomski inštitut Prave fakultete</i>

## F.8 REGJISTRIMI BIBLIOGRAFIK PËR VEPRËN E EKZEKUTUAR (NGJARJEN)

Regjistrimet bibliografike për veprat e ekzekutuara (ngjarjet) krijohen për shkak të bibliografive, kryesisht të kërkuesve shkencorë, të cilat i përgatisin institucionet ku ata janë të angazhuar. Këto regjistrime zakonisht nuk përdoren për qëllime të tjera. Regjistrimi për ngjarjen krijohet kur vepra e caktuar shkencore ose artistike nuk është e disponueshme në ndonjë medium fizik ose online. Për krijimin e regjistrimeve bibliografike për këto lloje të veprave ndihmojnë dokumentet, të cilat janë të lidhura me ngjarjen dhe gjatë katalogimit janë të disponueshme.

Në procedurën e katalogimit duhet të keni parasyshë se qëllimi i katalogimit është dokumentimi i veprës së prezantuar përmes ngjarjes. Dokumentet që janë të disponueshme gjatë katalogimit janë vetëm burim i informacioneve, por jo edhe objekt i katalogimit.

Me përshkrim të qëndrueshëm të veprave të ekzekutuara (ngjarjeve) mundësohet:

- ndarja e qartë e regjistrimeve për veprat e ekzekutuara nga regjistrimet e tjera;
- kërkimi i regjistrimeve për veprat e ekzekutuara përmes kriterëve elementare (autori, titulli, tema, tipologjia e dokumenteve, lloji i regjistrimit);
- paraqitja e regjistrimeve në bibliografitë e kërkuesve shkencorë.

Regjistrimet krijohen vetëm për ngjarjet e realizuara, dhe asnjëherë për ngjarjet e paralajmëruara.

## KRIJIMI I REGJISTRIMIT PËR VEPRËN E EKZEKUTUAR

Gjatë krijimit të regjistrimit për veprën e ekzekutuar duhet të respektohen këto kritere:

1. Regjistrimi duhet të përmbajë minimumin e të dhënave që janë të nevojshme për identifikimin e veprës së ekzekutuar (ngjarjes).
2. Të dhënat e koduara kanë për qëllim identifikimin e regjistrimit dhe jo veprës.
3. Titulli dhe të dhënat për përgjegjësinë duhet të identifikojnë sa më saktë veprën e ekzekutuar (ngjarjen) dhe kontekstin e saj.
4. Në përcaktimin e titullit dhe të dhënave për përgjegjësinë mund të ndihmojë interpretimi dhe zberthimi i informacioneve nga burimet dytësore.
5. Në shënime jepen informacionet për burimin e të dhënave dhe për shpjegimet shtesë rreth ngjarjes.
6. Vepra e ekzekutuar (ngjarja) nuk ka bartës publik të disponueshëm të përmbajtjes, për këtë arsye në regjistrim nuk ka as përcaktues të materialit e as të dhëna për materialin ose botuesin.
7. Nëse dokumentet e lidhura me veprën e ekzekutuar (ngjarjen) ruhen në ndonjë arkiv personal të autorit ose arkiv të institucionit, mund të bëhet shënim për kushtet e përdorimit.
8. Lloji i autorësisë që lidh veprën dhe personin ose organizatën vendoset duke u bazuar në të dhënat në burimin dytësor.

Te përzgjedhja e veprave, për të cilat krijohen regjistrimet për veprat e ekzekutuara, respektohet *Tipologjia e dokumenteve/veprave për përgatitjen e bibliografive në sistemin COBISS*.

Në vazhdim janë përshkruar fushat e formatit COMARC/B në regjistrimet për veprat e ekzekutuara. Këshillat për vendosjen e të dhënave në regjistrimin bibliografik për veprën e ekzekutuar janë bazuar në rregullat e vlefshme të katalogimit për materialin bibliotekar, rregullat ndërkombëtare për përshkrimin e

materialit arkivor dhe nga praktikat e katalogimit që me vite të tëra aplikohen në sistemin COBISS për përgatitjen e bibliografive të kërkuesve shkencorë.

Regjistrimi për veprën e ekzekutuar krijohet në maskën N (materiale jolibra).

---

## Burimet dytësore të të dhënave

Regjistrimet bibliografike për ngjarjet krijohen në bazë të burimeve dytësore që lajmërojnë ose komentojnë veprën e ekzekutuar, e cila është subjekt i regjistrimit bibliografik. Si burime dytësore klasifikohen: programet e ngjarjeve, ftesat, njoftimet në radio, televizion, revistë ose ato online, komentet në mediat e shtypura ose elektronike etj.

---

## 0XX Blloku i identifikimit

Në nënfushën 001b – *Lloji i regjistrimit* shënohet kodi "u" – ngjarje, ndërsa në nënfushën 001c – *Niveli bibliografik* kodin "d" – *vepër e ekzekutuar*. Në nënfushën 001t – *Tipologjia e dokumenteve/veprave\** mund të shënohet vetëm tipologjia që fillon me numrin 3.

---

## 1XX Blloku i të dhënave të koduara

Në regjistrimin për veprën e ekzekutuar (ngjarjen) duhet patjetër të vendoset e dhëna për vitin e ngjarjes në nënfushën 100c – *Viti i botimit 1*, sepse ai është i nevojshëm për klasifikimin e njësive bibliografike në bibliografinë personale.

Nënfusha 101a – *Gjuha e tekstit* shtohet vetëm në regjistrimin për veprën (ngjarjen) që është ekzekutuar me fjalë ose është kënduar dhe gjuha (ose disa gjuhë) dihet.

Shënimi i të dhënave në nënfushën 102a – *Shteti* nuk bënë pjesë në tërësinë e fushave dhe nënfushave të rekomanduara në regjistrimin për veprën e ekzekutuar, mirëpo për shkak të statistikave ajo mund të përdoret për vendosjen e kodit për vendin e ngjarjes.

Të dhënat e tjera të koduara nuk vendosen.

---

## 2XX Blloku i përshkrimit kryesor

Regjistrimet për veprat e ekzekutuara përmbajnë titullin, të cilin kataloguesi e përcakton në bazë të dokumenteve të lidhura me ngjarjen. Qëllimi i titullit është identifikimi i veprës dhe tregimi i kontekstit të ngjarjes në të cilën është ekzekutuar vepra. Për këtë arsye titujt janë të saktë dhe sipas mundësisë përfshijnë:

- temën e veprës së ekzekutuar (ngjarjes) dhe llojin e ngjarjes,
- personat ose institucionet e lidhura me ngjarjen,
- kontekstin e ngjarjes,
- kohën dhe vendin e ngjarjes.

Në parim titulli duhet të jetë në gjuhën e katalogimit. Mirëpo nëse në të është përdorur ndonjë pjesë e tekstit nga burimi dytësor, titulli mund të jetë edhe në gjuhën e burimit dytësor.

Në nënfushën 200a – *Titulli i saktë* shënohet titulli i veprës së ekzekutuar ose ngjarjes, përkatësisht teksti që përshkruan më së miri përmbajtjen e saj.

Nëse të dhënat në nënfushën 200a nuk mjaftojnë për kuptimin e kontekstit të veprës së ekzekutuar, në nënfushën 200e – *Informacioni tjetër për titullin* mund të shënohen të dhënat për llojin e ngjarjes si dhe të dhënat për vendin dhe kohën e ngjarjes. Numrat që shton kataloguesi janë arabë.

Te veprat e ekzekutuara të dhënat për përgjegjësinë shënohen në zonën e titullit dhe të përgjegjësisë, edhe nëse ato janë marrë nga burimet dytësore. Në nënfushën 200f – *Përgjegjësia parësore* shënohen të dhënat për personat dhe institucionet që kanë përgjegjësi parësore dhe nuk janë të shënuar në titull.

Shënimi i të dhënave të tjera për përgjegjësinë varet nga lloji i veprës së ekzekutuar. Më shumë të dhëna për përgjegjësinë zakonisht shënohen te ngjarjet muzikore, vizuale dhe teatrale, nëse ato janë gjetur në burimet dytësore. Për përcaktimin e renditjes së të dhënave për përgjegjësinë ju ndihmojnë rregullat e ISBD-së për burimet muzikore dhe audiovizuale.

Pavarësisht faktit se të dhënat në fushën 200 zakonisht i formëson kataloguesi, ato nuk vendosen në kllapa katrore. Në regjistrimet për veprat që nuk janë në bartës fizik nuk plotësohen fushat dhe nënfushat për botuesin, prodhimin ose botimin e materialit, si dhe fushat dhe nënfushat për veçoritë fizike të veprës.

Në maskën N, nënfusha 200a – *Titulli i saktë*, në bllokun 2XX, është e detyrueshme.

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.10</b>
100	□□	<b>c2012 halb lba</b>
200	0□	<b>a</b> Koncert në piano i Artan Dedës dhe Drita Sopi <b>e</b> Teatri i Operas dhe Baletit, Tiranë, 20 januar 2012 <i>(Regjistrimi për një rikrijim artistik. Në titull janë përfshirë të gjitha të dhënat që identifikojnë ngjarjen: llojin e koncertit, të dy ekzekutuesit, vendin dhe kohën e ngjarjes.)</i>

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.10</b>
100	□□	<b>c2012 halb lba</b>
200	0□	<b>a</b> Tinguj shpirti e koncert i Filharmonisë së Kosovës, Teatri Kombëtar, Prishtinë, 4 mars 2012 <b>f</b> Kori i Filharmonisë së Kosovës <b>g</b> dirigjent Adriana Tango <b>g</b> bateri Nina Beqa <i>(Me koncertin janë të lidhur disa persona. Kur ata të shënohen duhet të vendoset edhe lloji i autorësisë.)</i>

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.12</b>
100	□□	<b>c2004 halb lba</b>
200	0□	<b>a</b> 20 vjet zhvillimi i sistemit bibliotekar të informacionit eekspozitë në kuadër konferencës COBISS 2004, Qendra e Kongreseve Habakuk, Maribor, 9-11 nëntor dhe Instituti i Shkencave të Informacionit nga 15 nëntori deri në fund të nëntorit 2004 <b>f</b> autorë të ekspozitës Breda Emeršič, Andrej Korošec dhe MarijBizjak <i>(Ekspozita nuk ka katalog. Nga programi i konferencës është nxjerrë titulli, i cili përmban temën e ekspozitës, ngjarjen në kuadër të së cilës është organizuar ekspozita, vendin dhe kohën e ngjarjes.)</i>

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.11</b>
100	□□	<b>c2012 halb lba</b>
101	0□	<b>aalb</b>
200	0□	<b>a</b> Akademik Rexhep Qosja e intervistë në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, emisioni Mendje të ndritura, Radio Kosova, Programi i parë, 29. 6. 2012, nga ora 16.30 deri 17.00 <i>(Regjistrimi për një emision në radio që nuk është i disponueshëm në internet. Në titull është vendosur titulli i ngjarjes konkrete dhe detaje të emisionit.)</i>

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.14</b>
100	□□	<b>c2013 halb lba</b>
101	0□	<b>aeng</b>
102	□□	<b>afre</b>
200	0□	<b>a</b> Colored scalars and Higgs physics lecture at Laboratoire de Physique, Théorique d'Orsay, Université Paris-Sud, February 7, 2013 fSvetlana Fajfer <i>(Regjistrimi për ligjëratën në një universitet të huaj. Në fushën për titullin është shënuar titulli, vendi dhe koha e ngjarjes.)</i>

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.15</b>
100	□□	<b>c2011 halb lba</b>
101	0□	<b>aeng</b>
200	0□	<b>a</b> COBISS.Net: support to knowledge, intercultural dialogue and development of the region for a successful integration into EU e presentation at 40th International ABDOS Conference, Ljubljana, May 30 to June 2, 2011 fMarta Seljak, Pero Šobot <i>(Regjistrimi për kontributin në konferencë që nuk është botuar. Në fushën për titullin është shënuar titulli i kontributit dhe të dhënat që identifikojnë konferencën.)</i>

### 3XX Blloku i shënimeve

Në shënime vendosen të dhënat për burimet në bazë të të cilave është formuar titulli dhe të dhënat e tjera në përshkrim, si dhe vendosen informacionet për kontekstin e ngjarjes, të cilat për shkak të parimeve të saktësisë nuk janë vendosur në fushën 200.

Në fushën 300 bëhet shënim për burimet dytësore në bazë të të cilave përshkruhet vepra e ekzekutuar. Nëse dorëshkrimi i veprës së ekzekutuar, që është subjekt i regjistrimit, është i disponueshëm nën kushtet e caktuara, këtë mund ta shpjegoni në shënime.

Të dhënat e tjera për kontekstin e ngjarjes që tejkalojnë përmasat e të dhënave të nevojshme për identifikimin e veprës, sipas nevojës vendosen në fushën e përsëritshme 300 – *Shënimi i përgjithshëm*. Në fushën 323 – *Shënimi për interpretuesit (materiale projektimi, video dhe regjistrime zanore)* vendosen edhe interpretuesit e tjerë të veprës artistike.

Shënimet për çmimet, parasegjithash për interpretimet dhe ekspozitat e veprave artistike, vendosen në fushën 334 – *Shënimi për çmimin*.

Nëse titulli përmban shprehje të përgjithshme si: koncert, recital, lojë etj., për përmbajtjen e ngjarjes në imtësi mund të bëhet shënim në fushën 327 – *Shënimi për përmbajtjen*.

200	0□	aFjalimi i Adem Demaçit me rastin e hapjes së ekspozitës së 5-të të fotografive nga masakra e Dubravës, Prishtinë 22 maj 2016
300	□□	aPërshkrimi bazuar në ftesën për ekspozitë (Shënimi për burimin në bazë të të cilit është krijuar regjistrimi.)

200	0□	aKoncert i kitaristëve Anton Dema dhe Jonida Braçe esalla e koncerteve, Gjakovë, 20 janar 2012
300	□□	aPërshkrimi sipas programit të koncertit
327	01	0Program: aSuite for two guitars / William Lawes. Les deux amis ; Fantazija za dve kitari op. 41 / Fernando Sor. Afrodita ; Izgubljeni ples / Jerko Novak. Suite italiana / Mario Gangi (Programi i koncertit është vendosur si shënim për përmbajtjen e ngjarjes.)

200	0□	aCOBISS.Net: support to knowledge, intercultural dialogue and development of the region for a successful integration into EU epresentation at 40th International ABDOS Conference, Ljubljana, May 30 to June 2, 2011 fMarta Seljak, Pero Šobot
300	□□	aPërshkrimi sipas programit dhe dokumenteve të autorëve
300	0□	aDorëshkrimin e kontributit e ofron biblioteka e Institutit të Shkencave të Informacionit në Maribor me lejen e autorëve (Në shënime janë vendosur kushtet për përdorimin e dorëshkrimit.)

200	0□	aNina Prešiček et Dejan Prešiček eà la suite du 13ème concours de Musique de Chambre, Paris, le 19 mai 2001 - Concours International d'Interprétation Pierre Lantier
334	□□	aÇmimi i tretë Grand Prix International (Shënimi për çmimin. Formati i plotësuar ISO 690 tregon përmbajtjen e fushës 334.)

## 6XX Blloku i analizës së përmbajtjes

Përmbajtja e veprës së ekzekutuar përcaktohet përmes numrit të KDU-së që vendoset në nënfushën 675c – KDU\*.

Emërtimet lëndore për veprat e ekzekutuara zakonisht nuk vendosen, pos në rastet kur ekziston regjistrimi për veprën me tematikë të ngjashme e autorit të njëjtë ose në rastet e riprodhimit artistik të veprës. Emërtimet lëndore vendosen në fushën 610, përkatësisht fushat 600–609 sipas praktikës së vendosur nga biblioteka.

200	0□	aKoncert i kitaristëve Anton Dema dhe Jonida Braçe esalla e koncerteve, Gjakovë, 20 janar 2012
610	0□	amuzika akoncertet
675	□□	c78

200	0□	aCOBISS.Net: support to knowledge, intercultural dialogue and development of the region for a successful integration into EU epresentation at 40th International ABDOS Conference, Ljubljana, May 30 to June 2, 2011 fMarta Seljak, Pero Šobot
610	0□	aCOBISS.Net aSICRIS abibliografia e kërkuesve shkencor
675	□□	a021.64:012 c02 (Përpunimi lëndor është bërë në bazë të dorëshkrimit të kontributit.)

## 7XX Blloku i të dhënave për përgjegjësinë

Në regjistrimet për veprat e ekzekutuara (ngjarjet) zakonisht vendosen vetëm autorët me përgjegjësi parësore. Përfundimisht përbëjnë regjistrimet për rikrijimet artistike (muzikore ose teatrale), ku të dhënat vendosen për disa lloje të përgjegjësive. Te vendosja e të dhënave për përgjegjësinë ndiqen rregullat e përdorimit të fushave 700–702 në formatin COMARC/B dhe përzgjedhet kodi sa më i saktë për llojin e autorësisë.

Në nënfushën 70X3 – *Numri i regjistrimit të njësuar* shënohet numri i regjistrimit përkatës të njësuar për emrin vetjak. Te kërkuesit shkencorë duhet pasur kujdes që regjistrimet e njësuara të përmbajnë kodin e kërkuesit shkencor, sepse ai është një nga kushtet për udhëheqjen e bibliografisë personale të kërkuesit shkencor. Në nënfushën 70X4 – *Kodi për llojin e autorësisë* shënohet roli që ka personi te vepra e ekzekutuar (ngjarja). Kodi i saktë i llojit të autorësisë (p.sh. "545" – muzikant ose "005" – aktor ose "721" – këngëtar në vend të kodit "590" – interpretues) shënohet nëse burimet dytësore të të dhënave e mundësojnë këtë. Në nënfushën 70X8 – *Kodi i institucionit/organizatës\** vendoset kodi i institucionit që ka mundësuar krijimin e veprës.

Në fushat 71X – *Emër organizate* më së shpeshti shënohen grupet muzikore ose artistike, të cilat janë të lidhura me veprën e ekzekutuar, ndërsa në nënfushën 71X4 – *Kodi për llojin e autorësisë* shënohet kodi i saktë i llojit të autorësisë.

200	0□	aKoncert i kitaristëve Anton Dema dhe Jonida Braçe esalla e koncerteve, Gjakovë, 20 janar 2012
700	□1	aDema bAnton 4545
701	□1	aBraçe bJonida 4545

200	0□	a20 vjet zhvillimi i sistemit bibliotekar të informacionit eekspozitë në kuadër konferencës COBISS 2004, Qendra e Kongreseve Habakuk, Maribor, 9-11 nëntor dhe Instituti i Shkencave të Informacionit nga 15 nëntori deri në fund të dhjetorit 2004 fautorë të ekspozitës Breda Emeršič, Andrej Korošec dhe Marij Bizjak
700	□1	336964195 aEmeršič bBreda 740054 4904 84-007
701	□1	34813155 aKorošec bAndrej 719457 f1972- 4904 84-007
701	□1	361576035 aBizjak bMarij 4904 84-007

200	0□	aAkademik Rexhep Qosja eintervistë në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, emisioni Mendje të ndritura, Radio Kosova, Programi i parë, 29. 6. 2012, nga ora 16.30 deri 17.00
700	□1	aQosja bRexhep 4460



200	0□	aTinguj shpirti ekoncert i Filharmonisë së Kosovës, Teatri Kombëtar, Prishtinë, 4 mars 2012 fKori i Filharmonisë së Kosovës gdirigjente Adriana Tango gbateri Nina Beqa
702	□1	aTango bAdriana 4250
702	□1	aBeqa bNina 4545
710	02	aKori i Filharmonisë së Kosovës 4590

## SHEMBUJ

1.

001	□□	an bu cd d0 t3.10 7ba
100	□□	c2012 halb lba
200	0□	aKoncert i kitaristëve Anton Dema dhe Jonida Braçe esalla e koncerteve, Gjakovë, 20 janar 2012
300	□□	aPërshkrimi sipas programit të koncertit
327	10	0Programi: aSuite for two guitars / William Lawes. Les deux amis ; Fantazia e dy kitarëve / Fernando Sor. Afrodita ; Vallëzimi i humbur / Anton Dema. Suite italiana / Mario Gangi
675	□□	a785.6 c785
700	□1	aDema bAnton 4545
701	11	aBraçe bJonida 4545

Formati ISO 690:

DEMA, Anton (muzikant), BRAÇE, Jonida (muzikant). Koncert i kitaristëve Anton Dema dhe Jonida Braçe : *salla e koncerteve, Gjakovë, 20 janar 2012.*

2.

001	□□	an bu cd d0 t3.10
100	□□	c2012 halb lba
200	0□	aTinguj shpirti ekoncert i Filharmonisë së Kosovës, Teatri Kombëtar, Prishtinë, 4 mars 2012 fKori i Filharmonisë së Kosovës gdirigjente Adriana Tango gbateri Nina Beqa
300	□□	aPërshkrimi sipas programit të koncertit
675	□□	a78.087.68 c78.08 vUDCMRF 2006
702	01	aTango bAdriana 4250
702	01	aBeqa bNina 4545
710	02	aKori i Filharmonisë së Kosovës 4590
970	□□	aKori i Filharmonisë së Kosovës (interpretues)

Formati ISO 690:

Kori i Filharmonisë së Kosovës (interpretues). *Tinguj shpirti : Teatri Kombëtar, Prishtinë, 4 mars 2012.*

3.

001	□□	an bu cd d0 t3.12
100	□□	c2004 hslv lba
200	0□	a20 vjet zhvillimi i sistemit bibliotekar të informacionit eekspozitë në kuadër konferencës COBISS 2004, Qendra e Kongreseve Habakuk, Maribor, 9-11

300	□□	<b>a</b> Përshkrimi sipas programit të konferencës
675	□□	<b>c</b> 02
700	□1	<b>336964195 a</b> Emeršič <b>b</b> Breda <b>740054 4904 84-007</b>
701	11	<b>34813155 a</b> Korošec <b>b</b> Andrej <b>719457 f</b> 1972- <b>4904 84-007</b>
701	11	<b>361576035 a</b> Bizjak <b>b</b> Marij <b>4904 84-007</b>

Formati ISO 690:

EMERŠIČ, Breda (autor i ekspozitës), KOROŠEC, Andrej (autor i ekspozitës), BIZJAK, Marij (autor i ekspozitës). *20 vjet zhvillimi i sistemit bibliotekar të informacionit eekspozitë në kuadër konferencës COBISS 2004, Qendra e Kongreseve Habakuk, Maribor, 9-11 nëntor dhe Instituti i Shkencave të Informacionit nga 15 nëntori deri në fund të dhjetorit 2004.*

4.

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.11</b>
100	□□	<b>c</b> 2012 <b>halb lba</b>
101	0□	<b>aalb</b>
200	0□	<b>a</b> Akademik Rexhep Qosja eintervistë në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, emisioni Mendje të ndritura, Radio Kosova, Programi i parë, 29. 6. 2012, nga ora 16.30 deri 17.00
675	□□	<b>c</b> 82
700	□1	<b>31936742 a</b> Qosja <b>b</b> Rexhep <b>4460</b> <i>(Emisioni nuk është i disponueshëm në internet.)</i>

Formati ISO 690:

QOSJA, Rexhep (i intervistuar). *Akademik Rexhep Qosja : intervistë në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, emisioni Mendje të ndritura, Radio Kosova, Programi i parë, 29. 6. 2012, nga ora 16.30 deri 17.00.*

5.

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.14</b>
100	□□	<b>c</b> 2013 <b>halb lba</b>
101	0□	<b>aeng</b>
102	□□	<b>afre</b>
200	0□	<b>a</b> Colored scalars and Higgs physics <b>e</b> lecture at Laboratoire de Physique, Théorique d'Orsay, Université Paris-Sud, February 7, 2013 <b>f</b> Svjetlana Fajfer
300	□□	<b>a</b> Përshkrimi sipas ftesës dhe dorëshkrimi të ligjëratës
675	□□	<b>c</b> 539.1
700	□1	<b>a</b> Fajfer <b>b</b> Svjetlana <b>4070</b> <i>(Regjistrimi përmban edhe fushën 102, sepse për institucionin është e rëndësishme statistika sipas shteteve.)</i>

Formati ISO 690:

FAJFER, Svjetlana. *Colored scalars and Higgs physics : lecture at Laboratoire de Physique, Théorique d'Orsay, Université Paris-Sud, February 7, 2013.*

6.

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.14</b>
100	□□	<b>c</b> 2012 <b>halb lba</b>
101	0□	<b>aalb</b>

200	0┘	<b>a</b> Dialekti gegë në gjuhën standarde shqipe eligjëratë e të ftuarit në Universitetin ELTE në Budapest, 22. 3. 2012 <b>f</b> Bashkim Behraja
300	┘┘	<b>a</b> Përshkrimi sipas ftesës
675	┘┘	<b>c</b> 811.18
700	┘1	<b>a</b> Behraja <b>b</b> Bashkim <b>4070</b>

Formati ISO 690:

BEHRAJA, Bashkim. *Dialekti gegë në gjuhën standarde shqipe : ligjëratë e të ftuarit në Universitetin ELTE në Budapest, 22. 3. 2012.*

7.

001	┘┘	<b>an bu cd d0 t3.15</b>
100	┘┘	<b>c2012 halb lba</b>
101	0┘	<b>a</b> eng
200	0┘	<b>a</b> COBISS.Net: support to knowledge, intercultural dialogue and development of the region for a successful integration into EU epresentation at 40th International ABDOS Conference, Ljubljana, May 30 to June 2, 2011 <b>f</b> Marta Seljak, Pero Šobot
300	┘┘	<b>a</b> Përshkrimi sipas programit të konferencës dhe dokumentacionit të autorëve
300	┘┘	<b>a</b> Dorëshkrimin e kontributit e ofron biblioteka e Institutit të Shkencave të Informacionit në Maribor me lejen e autorëve
610	0┘	<b>a</b> COBISS.Net <b>a</b> SICRIS <b>a</b> bibliografia e kërkuesve shkencorë
675	┘┘	<b>a</b> 021.64:012 <b>c</b> 02
700	┘1	<b>a</b> Seljak <b>b</b> Marta <b>4070</b>
701	11	<b>a</b> Šobot <b>b</b> Pero <b>4070</b>

Formati ISO 690:

SELJAK, Marta, ŠOBOT, Pero. *COBISS.Net: support to knowledge, intercultural dialogue and development of the region for a successful integration into EU : presentation at 40th International ABDOS Conference, Ljubljana, May 30 to June 2, 2011.*

8.

001	┘┘	<b>an bu cd d0 t3.25</b>
100	┘┘	<b>c2013 halb lba</b>
200	1┘	<b>a</b> Zgjidhja e problemeve përmes mënyrave juridike dhe alternative etyçzë e rrumbullakët në konferencën me të njëjtin titull në organizim të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, 23.–24. 4. 2013, Ferizaj <b>f</b> bashkëpunëtorë Mendim Kasta... [et al.]
300	┘┘	<b>a</b> Përshkrimi sipas ftesës
300	┘┘	<b>a</b> Bashkëpunëtorë edhe: Ardita Rrapi, Jones Smith, Teuta Demo, Petrit Koka, Andi Loka, Peter Pfeiffer; moderatorë Peter Jambrek in Barney Jordaan
675	┘┘	<b>a</b> 001.891.32(497.4) <b>c</b> 001.891
701	11	<b>a</b> Kasta <b>b</b> Mendim <b>4905</b>
701	01	<b>a</b> Rrapi <b>b</b> Ardita <b>4905</b>
701	01	<b>a</b> Smith <b>b</b> Jones <b>4905</b>
701	01	<b>a</b> Demo <b>b</b> Teuta <b>4905</b>
701	01	<b>a</b> Koka <b>b</b> Petrit <b>4905</b>
701	01	<b>a</b> Loka <b>b</b> Andi <b>f</b> 1970- <b>4905</b>
701	01	<b>a</b> Pfeiffer <b>b</b> Peter <b>4905</b>
701	01	<b>a</b> Jambrek <b>b</b> Peter <b>4905</b>
701	01	<b>a</b> Jordaan <b>b</b> Barney <b>4905</b>

*(Nga burimet në dispozicion nuk është e qartë në cilën gjuhë kanë diskutuar pjesëmarrësit truezën e rrumbullakët. Për këtë arsye në regjistrim nuk ndodhet fusha 101.)*

Formati ISO 690:

KASTA, Mendim (diskutues), RRAPI, Ardita (diskutues), SMITH, Jones (diskutues), DEMO, Teuta (diskutues), KOKA, Petrit (diskutues), LOKA, Andi (diskutues), PFEIFFER, Peter (diskutues), JAMBREK, Peter (diskutues), JORDAAN, Barney (diskutues). *Zgjidhja e problemeve përmes mënyrave juridike dhe alternative etryezë e rrumbullakët në konferencën me të njëjtin titull në organizim të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, 23.-24. 4. 2013, Ferizaj.*

9.

001	□□	<b>an bu cd d0 t3.16</b>
100	□□	<b>c2013 halb lba</b>
101	0□	<b>aeng</b>
200	0□	<b>a</b> Liquid crystal phase transitions under nanoconfinement and role of nanoparticles eguest lecture at the I-CAMP 2013 Summer School on Liquid Crystals and Inter-Continental Advanced Materials for Photonics Summer School, University of Cambridge, United Kingdom, July 2, 2013 <b>f</b> Antigona Kraja
300	□□	<b>a</b> Përshkrimi sipas ftesës
675	□□	<b>c532</b>
700	□1	<b>a</b> Kraja <b>b</b> Antigona <b>4070</b>

Formati ISO 690:

KRAJA, Antigona. *Liquid crystal phase transitions under nanoconfinement and role of nanoparticles : guest lecture at the I-CAMP 2013 Summer School on Liquid Crystals and Inter-Continental Advanced Materials for Photonics Summer School, University of Cambridge, United Kingdom, July 2, 2013*

## G TABELA E KDU-SË (675C)

Lista e kodeve është përshtatur për kërkesat e sistemit COBISS.SI. Lista e kodeve mund të përshtatet sipas nevojës me të gjitha sistemet e tjera COBISS në kuadër të rrjetit COBISS.Net.

<b>001</b>	<i>Shkenca dhe dituria në përgjithësi. Organizimi i punës intelektuale</i>
<b>001.18</b>	<i>E ardhmja e dijes. Futurologjia</i>
<b>001.32</b>	<i>Qendrat shkencore dhe teknologjike. Institutet hulumtuese etj. Shoqëritë shkencore</i>
<b>001.8</b>	<i>Metodologjia shkencore</i>
<b>001.89</b>	<i>Organizimi i shkencës dhe i punës shkencore</i>
<b>001.891</b>	<i>Kërkimi shkencor</i>
<b>001.895</b>	<i>Novacione. Risi</i>
<b>002</b>	<i>Dokumentacioni. Librat. Shkrimet. Autorësia</i>
<b>002.6</b>	<i>Qendrat e dokumentacionit</i>
<b>003</b>	<i>Sistemet e shkrimit dhe shkrimet</i>
<b>003.3</b>	<i>Shkrimet</i>
<b>004</b>	<i>Shkenca dhe teknologjia e kompjuterit</i>
<b>004.2</b>	<i>Arkitektura e kompjuterit</i>
<b>004.3</b>	<i>Harduare</i>
<b>004.4</b>	<i>Softuare</i>
<b>004.42</b>	<i>Programimi për kompjuter. Programet e kompjuterit</i>
<b>004.43</b>	<i>Gjuhët e programimit për kompjuter</i>
<b>004.45</b>	<i>Sistemet e softuareve</i>
<b>004.5</b>	<i>Bashkëveprimi njeri-kompjuter. Ndërfaqja e përdoruesit. Mjedisi i përdoruesit</i>
<b>004.55</b>	<i>Hipermedia. Hiperteksti</i>
<b>004.6</b>	<i>Të dhënat</i>
<b>004.7</b>	<i>Komunikimi kompjuterik. Rrjetet kompjuterike</i>
<b>004.738.5</b>	<i>Interneti</i>
<b>004.8</b>	<i>Inteligjenca artificiale</i>
<b>004.9</b>	<i>Teknikat e përdorimit të kompjuterit</i>
<b>004.92</b>	<i>Grafika e kompjuterit</i>
<b>004.93</b>	<i>Mënyrat e përpunimit të informacionit</i>
<b>004.94</b>	<i>Simulimi</i>
<b>005</b>	<i>Menaxhimi</i>
<b>005.1</b>	<i>Teoria e menaxhimit</i>
<b>005.2</b>	<i>Agjentët e menaxhimit. Mekanizmat. Treguesit</i>
<b>005.3</b>	<i>Veprimtaritë menaxhuese</i>
<b>005.336.1</b>	<i>Efikasiteti. Performanca e biznesit</i>
<b>005.336.3</b>	<i>Cilësia</i>
<b>005.4</b>	<i>Proceset e menaxhimit</i>
<b>005.44</b>	<i>Globalizimi</i>
<b>005.5</b>	<i>Veprimet e menaxhimit. Drejtimi</i>
<b>005.57</b>	<i>Komunikimi i brendshëm, informimi</i>
<b>005.6</b>	<i>Menaxhimi i cilësisë. Menaxhimi total i cilësisë (MTC)</i>
<b>005.7</b>	<i>Menaxhimi organizativ (MO)</i>
<b>005.8</b>	<i>Menaxhimi i projektit</i>
<b>005.9</b>	<i>Fusha e menaxhmentit</i>
<b>005.912:82-6</b>	<i>Korrespondenca e biznesit</i>
<b>005.912:82-86</b>	<i>Korrespondenca e biznesit** (shih 005.912:82-6)</i>

005.912	<i>Menaxhimi i zyrës. Shërbimet e zyrës.</i>
006	<i>Standardizimi i produkteve, operacionet, peshat, masat dhe koha</i>
006.3/.8	<i>Standardet</i>
006.91	<i>Metrologjia. Peshat dhe masat në përgjithësi</i>
006.92	<i>Horologjia. Përcaktimi dhe standardizimi i kohës</i>
007	<i>Veprimtaria dhe organizimi. Teoria e komunikimit dhe e kontrollit në përgjithësi. (Kibernetika)</i>
007.5	<i>Sistemet e vetë-veprimit</i>
007.52	<i>Operatorët pa njeriun. Automatët. Robotët</i>
008	<i>Qytetërimi. Kultura. Progresi</i>
009	<i>Shkencat humanitare. Studimet e artit në përgjithësi**</i>
01	<i>Teoria e bibliografisë</i>
01(051)	<i>Bibliografitë. Katalogët. Listat e librave**</i>
011/014	<i>Bibliografitë. Bibliografitë universale dhe të përgjithshme. Listat e përmbajtjes</i>
015	<i>Bibliografitë e vendit. Bibliografitë kombëtare</i>
016:929	<i>Biobibliografitë</i>
016	<i>Bibliografitë e veçanta tematike</i>
017/019	<i>Katalogët e bibliotekave</i>
017.3/.4	<i>Katalogët e ankandëve. Katalogët e shitjes së librave</i>
02	<i>Bibliotekonomia</i>
022	<i>Objektet e bibliotekave. Pajisjet</i>
023	<i>Administrimi i bibliotekave. Personeli.</i>
025.3	<i>Katalogimi. Teknika e katalogimit</i>
025.4	<i>Klasifikimi dhe indeksimi</i>
026/027	<i>Bibliotekat</i>
026	<i>Bibliotekat speciale</i>
027	<i>Bibliotekat e përgjithshme</i>
027.54	<i>Bibliotekat kombëtare</i>
027.7/.8	<i>Bibliotekat e shkollave. Bibliotekat akademike</i>
028	<i>Leximi. Teknika e leximit. Këshillimi i lexuesve</i>
030	<i>Veprat e përgjithshme referuese</i>
050	<i>Botimet seriale. Periodikët</i>
050.8/.9	<i>Vjetarët. Direktoritë, librat e adresave. Almanakët. Kalendarët</i>
06	<i>Korporatat. Shoqatat. Kongreset. Ekspozitat**</i>
061	<i>Organizatat dhe tipe të tjera bashkëpunimi.</i>
061.12	<i>Akademitë** (shih 001.32)</i>
061.1EU	<i>Bashkimi European</i>
061.2	<i>Organizatat joqeveritare. Shoqëritë. Fondacionet</i>
061.213	<i>Organizatat e të rinjve** (shih 061.2)</i>
061.22	<i>Organizatat për përparimin e dijes, shkencës, kulturës. Shoqëritë e të mësuarit** (shih 001.32 or 061.2)</i>
061.5(4/9)	<i>Ndërmarrjet e biznesit** (shih 334.72)</i>
061.6	<i>Institucionet, qendrat dhe shërbimet shkencore e teknike** (shih 001.32)</i>
069	<i>Muzetë. Muzeologjia. Ekspozitat e përherëshme. Koleksionet e muzeve</i>
070	<i>Gazetat. Shtypi</i>
070.48	<i>Llojet e veçanta të gazetave</i>
070.481	<i>Revistat zyrtare, buletinet** (shih 070.48)</i>
070.489	<i>Buletinet e institucioneve dhe ndërmarrjeve** (shih 070.48)</i>
082.1	<i>Përmbledhjet (koleksionet)</i>
084.11	<i>Materiale pikturë. Skica. Filma vizatimorë</i>

087.5	<i>Botimet për të rinj</i>
09	<i>Dorëshkrimet. Vepra të rralla dhe të shquara</i>
091	<i>Dorëshkrimet</i>
093	<i>Inkunabulat</i>
094/096	<i>Vepra të tjera të çmuara, të shquara ose të rralla</i>
097	<i>Shenjat e pronësisë ose origjinës (ex libris, etiketat e pronësisë, monograme)</i>
1 A/Ž	<i>Filozofët** (shih 1A/@)</i>
1	<i>Filozofia. Psikologjia</i>
1(091)	<i>Historia e filozofisë</i>
1(3)	<i>Filozofia antike</i>
1(4/9)"19/20"	<i>Filozofia bashkëkohore</i>
1(4)"04/14"	<i>Filozofia europiane e Mesjetës</i>
1(4)"05/15"	<i>Filozofia europiane, Mesjeta** (shih 1(4)"04/14")</i>
1(4)"15/19"	<i>Filozofia europiane, periudha moderne</i>
11/12	<i>Metafizika. Filozofia e natyrës** (shih 11)</i>
11	<i>Metafizika. Ontologjia</i>
111.852	<i>Estetika (objektive dhe subjektive)</i>
113/119	<i>Kosmologjia. Filozofia e natyrës (shih edhe: 524)</i>
130.2	<i>Filozofia e kulturës. Teoria e komplekseve kulturore</i>
133	<i>Paranormalja. Okultja. Psi fenomenet</i>
14	<i>Sistemet dhe pikëpamjet filozofike</i>
141	<i>Sistemet filozofike** (shih 14)</i>
141.7	<i>Llojet e pikëpamjeve sipas qëndrimit ndaj shoqërisë njerëzore</i>
159.9	<i>Psikologjia</i>
159.92	<i>Zhvillimi dhe kapaciteti mendor. Psikologjia krahasuese</i>
159.93/.94	<i>Ndjeshmëria. Perceptimi shqisor</i>
159.95	<i>Proceset e larta mendore</i>
159.96	<i>Gjendje dhe procese mendore të veçanta</i>
159.964	<i>Psikologjia e thellësisë</i>
159.97	<i>Psikologjia anormale</i>
159.98	<i>Psikologjia e zbatuar (psikoteknologjia) në përgjithësi</i>
16	<i>Logjika. Sistemi në shkencë == shih 161/162</i>
161/162	<i>Bazat e logjikës</i>
165	<i>Teoria e njohjes. Epistemologjia</i>
165.6/.8	<i>Pikëpamjet dhe doktrinat epistemologjike</i>
167/168	<i>Metodologjia logjike SHIH EDHE: 001 Shkenca dhe dituria në përgjithësi</i>
17	<i>Filozofia morale. Etika. Filozofia praktike</i>
1A/Ž	<i>Filozofët</i>
2	<i>Feja. Teologjia</i>
21	<i>Fetë prehistorike dhe primitive</i>
22	<i>Fetë me origjinë nga Lindja e Largët</i>
23/24	<i>Hinduizmi. Budizmi** (shih 23 ose 24)</i>
23	<i>Fetë me origjinë nga nën-kontinenti Indian. Feja Hindu në kuptim të gjerë</i>
24	<i>Budizmi</i>
25	<i>Fetë e antikitetit. Kultet dhe fetë e vogla</i>
255	<i>Antikiteti klasik</i>
257	<i>Fetë e Europës</i>
258	<i>Fetë e Amerikës Jugore dhe Qendrore. Fetë indiane pre-kolumbiane</i>
259	<i>Fetë e zonave të tjera</i>
26	<i>Judaizmi</i>

27	<i>Krishtërimi. Kishat dhe denominacionet kristiane</i>
271/279	<i>Kishat dhe denominacionet kristiane</i>
271	<i>Kisha e Lindjes</i>
272	<i>Kisha katolike romane</i>
27-1	<i>Teologjia kristiane</i>
27-23	<i>Bibla</i>
27-236.5	<i>Tregimet e Biblës</i>
27-242	<i>Testamenti i Vjetër</i>
27-246	<i>Testamenti i Ri</i>
27-27	<i>Veprat kritike. Hyrje në Bibël</i>
27-28	<i>Tekstet kristiane jo-biblike</i>
27-29	<i>Literatura kristiane</i>
27-31	<i>Jezu Krishti. Kristologjia</i>
27-36	<i>Shenjtët</i>
27-4	<i>Teologjia praktike. Praktika kristiane</i>
27-46	<i>Teologjia pastorale. Puna pastorale. Bamirësia kristiane</i>
27-47	<i>Edukimi kristian</i>
27-5	<i>Adhurimi dhe rituale kristiane</i>
27-52	<i>Pajisjet e kishës, objektet. Veshjet fetare. Arti. Simbolet</i>
27-55	<i>Sakramentet</i>
27-58	<i>Misticizmi krishter dhe spiritualizmi</i>
27-72	<i>Kisha. Kisha kristiane. Eklesiologjia</i>
27-76	<i>Misionet kristiane</i>
27-78	<i>Organizatat dhe unionet krishtere</i>
27-784	<i>Grupet fetare dhe urdhurat** (shih 27-78)</i>
27-788	<i>Urdhërat e murgjive. Murgjëria. Urdhërat fetare** (shih 27-78)</i>
27-87	<i>Herezi</i>
27-9	<i>Historia e kishës. Historia e përgjithshme e kishës kristiane</i>
28	<i>Islami</i>
29	<i>Lëvizjet shpirtërore moderne</i>
2-1	<i>Teoria dhe filozofia e fesë. Natyra e fesë. Fenomeni i fesë</i>
2-18	<i>Njeriu. Njerëzimi. Antropologjia doktrimore</i>
2-5	<i>Adhurimi në gjerësi. Kult. Ritet dhe ceremonitë</i>
3	<i>Shkencat sociale</i>
303	<i>Metodat e shkencave sociale</i>
304	<i>Çështjet sociale. Praktika sociale. Praktika kulturore</i>
305	<i>Studime gjinore. Studime për gratë</i>
308	<i>Sociografia. Studime përshkruese të shoqërisë. Gjendja sociale</i>
308(4)	<i>Gjendja sociale në vendet europiane</i>
308(496.5)	<i>Gjendja sociale në Shqipëri</i>
308(496.51)	<i>Gjendja sociale në Kosovë</i>
308(497.4)	<i>Gjendja sociale në Slloveni</i>
308(5/9)	<i>Gjendja sociale në vendet jo-europiane</i>
311/314	<i>Statistika. Demografia**</i>
311	<i>Statistika si shkencë. Teoria statistikore</i>
314	<i>Demografia. Studime për popullsinë</i>
314.15	<i>Migrimi. Zhvendosjet e popullatës</i>
314.151.3(=163.6)	<i>Emigrantët sllovenë</i>
314.7	<i>Migrimi. Lëvizja e popullsisë** (shih 314.15)</i>
314.743(=163.6)	<i>Emigrantët sllovenë** (shih 314.151.3(=163.6))</i>



316	<i>Sociologjia</i>
316.2	<i>Pikëpamjet dhe rrymat sociologjike</i>
316.3	<i>Struktura sociale. Shoqëria si sistem social. Shoqëritë globale</i>
316.334	<i>Sociologjia e ekonomisë. Sociologjia politike. Sociologjia e së drejtës. Sociologjia e nënsistemeve dhe institucioneve ekonomike</i>
316.34	<i>Shtresëzimi social. Diferencimi social</i>
316.346	<i>Diferencimi demografik sipas seksit dhe moshës</i>
316.35	<i>Grupet sociale. Organizimet sociale</i>
316.36	<i>Martesa dhe familja</i>
316.4	<i>Proceset sociale. Dinamika sociale</i>
316.6	<i>Psikologjia sociale</i>
316.653	<i>Opinionet publik</i>
316.7	<i>Sociologjia e kulturës</i>
316.72	<i>Nënkulturat. Stili i jetesës. Sociologjia e jetës së përditshme</i>
316.77	<i>Komunikimi social. Sociologjia e komunikimit</i>
32	<i>Politika. Shkenca politike</i>
321	<i>Format e organizimit politik. Shtetet si pushtete politike. Sistemet politike</i>
321.01	<i>Teoria e pëgjithshme e shtetit. Teoria dhe filozofia e pushtetit. Shteti dhe territori. Autoriteti dhe opozita. Uzurpimi</i>
322	<i>Marrëdhëniet ndërmjet kishës dhe shtetit. Politika ndaj fesë. Politika e kishës</i>
323	<i>Politika e brendëshme. Gjendja politike</i>
323.1	<i>Lëvizjet dhe problemet kombëtare, popullore dhe etnike. Minoritetet etnike kombëtare Shovinizmi. Racizmi</i>
323.15	<i>Minoritetet kombëtare</i>
323.15(=163.6)	<i>Minoritetet kombëtare sllovene</i>
323(497.4)	<i>Sllovenia, politika e brendëshme. Gjendja politike në Slloveni</i>
